

Flori Bruqi

Guxim shqipitar



Prishtinë, 2008

Biblioteka:
Lumi i Bardhë

Redaktor:
Nehat S. Hoxha

Recensues:
AKADEMIK DR. NAMIK SHEHU
ABDULLAH KONUSHEVCI

Shtypi:
Printing Press
Prishtinë, 2008

Guxim shqipëtar

Flori Bruqi



www.sps.com

Përmbajtja

HISTORI

Populli shqiptar nga lashtësia	11
Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve.....	17
Mbrojtja e Plavës dhe Gucisë(tetor 1879-janar 1880)	33
Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe rëndësia e infrastrukturës logjistike për luftë.....	51
Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët.....	57

PËR RAMUSHIN

“Dora e Zezë” e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës (Intervistë me z. Adem Demaçi)	67
Hero në luftë - hero në paqe: Ramush Haradinaj.....	71
Ramushi – viktimë e situatës (neo)koloniale.....	77

ANTROPOLOGJI

Jakov Milaj dhe raca shqiptare	81
Jeta dhe vepra e Jakov Milajt	81
Një pasqyrë e shkurtër e hulumtuesve të tjerë	83
Treguesi qefalik dhe veçantitë	88
Të tjerët për Milajn?.....	93
Teoritë racore apo raciste.....	103
Resume.....	104

POLITIKË

Arvanitasit, Çamëria, Epiri i Veriut dhe gjendja sot	107
Rishikim retrospektiv historik.....	108

Imoraliteti politik ndaj Çamërisë	110
Grekët në vazhden e rrugës së krimeve	115
Strategjia e re greke dhe aktiviteti i patriotëve tanë	117
Mësime për t'u nxjerrë nga historia.....	120
Po me problemin çam si u ballafaqua diktatori shqiptar? ...	121
Strategjitë më të fundit greke	122
A ka “Intifadë” shqiptare në Iliridë?	125
Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë	131
Nder, respekt dhe krenari për Albin Kurtin	135
Le të mbetet Doktori shëruesi i njerëzve, nderi i të gjithë shqiptarëve!.....	137
Interviste me Doktor Namik Shehu	141
Mirupafshim në Kosovën e lirë!	149
A do të ketë një “Nuremberg Shqiptar” për komunistët dhe krimet e tyre	151
Kryqëzata e tetë.....	153
Prapaska ideologjike	157
Prapavija gjeopolitike.....	159

SPIUNAZH

Agjenturat Greke dhe Sigurimi i Fshehtë i Shtetit Shqiptar.....	165
Kush janë agjentët me influencë në Kosovë.....	177
Aktivitetet kriminale të shtyra nga shërbimet sekrete armiqësore në Kosovë	180

GJUHË & LETËRSI

Origjina e gjuhës shqipe.....	193
Censura dhe shterpësia letrare	211
Jusuf Vrioni si “dëm”	222
Lavdia e de Radës.....	225
Branko Merxhani - ky emër i harruar i gazetarisë shqiptare.....	235
Ismail Kadare.....	239
Umberto Eco	241
Bodoni, Eco dhe ne.....	241

Klasikët e romanit postmodernist	247
Valerio Massimo Manfredi.....	248
Umberto Eco.....	249
Alessandro Baricco	250
Homeri dhe Odiseja nuk kthehen më në truallin grek	253
Palamas, Kavafis, Ritsos, Elitys	253
Në 60-vjetorin e lindjes së shkrimtarit e atdhetarit Jusuf Bardhosh Gërvalla	259
Letërsia e sotme greke.....	257
A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar?	271
Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi.....	281
Kush është Koleç Traboini?	287
Keze (Kozeta) Zylo.....	307
Kush është Gani Xhafolli?	321
Kush është Nehat S. Hoxha	325
Muxhahedinët si «Golden Boys».....	337
Rekuiem për.....	341
Persekutimi komunist mbi vajzat e Bajram Currit	343
Polemikë pa dorashka.....	347
Gërmime në llagëme të pista	348
Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviçit.....	353

PSIKANALIZË, ASTROLOGJI & EROTIKË

Ç'është psikologjia, psikanaliza dhe kush është Siegmund Freud	359
Mendimet jorefektuese.....	361
Siegmund Freud (1856 - 1939).....	362
A duhet besuar horoskopit?	365
Psikologji erotike	369
<i>Fjala e redaktorit</i>	<i>383</i>
Zbardhje e çështjes kombëtare	383
<i>Fjala e recensuesve</i>	<i>385</i>
Nga forma elektronike te forma e shtypur	401

HISTORI

Populli shqiptar nga lashtësia

Pirro (296-272) para Krishtit. Pirroja ishte, ndoshta Sundimtari më i shquar i Epirit. Ai, si pasardhës i largët i Akilit, ishte i biri i Akidit. Kushëriri i Aleksandrit të Molosisë, që sundoi Molosët e Janinës. Fatkeqësisht, Akidi u ngatërrua në grindje politike familjare e krahinore dhe, si rrjedhojë, në fillim humbi mbretërinë e pastaj edhe jetën në vitin 313 para Kr. I biri tij, Pirroja në atë kohë vetëm 6 vjeç, u shpëtua nga Glaukia, Princi i fisit Ilir të Taulantëve. Në moshë të re ai hipi në fron për një kohë të shkurtër, por u rrëzua prej tij dhe filloi karrierën ushtarake me Antigonin e Maqedonisë, Komandantin veteran që kishte shërbyer me Aleksandrin e Madh. Në njërën nga betejat, ai u kap rob dhe u dërgua si peng në Aleksandri. Aty fitoi admirimin e Ptolemit, i cili i dha për grua të bijën, dhe në vitin 296 para Krishtit dhe e vuri përsëri në fronin e mbretërisë së tij. Pirroja gëzonte nam për fisnikërinë dhe trimërinë e tij në beteja. Epirotët e quanin “Shqiponjë”.

Sipas një tradite Shqiptare, pretendohet se emri “Shqiptar” (Bij të Shqipës) e ka origjinën nga thënia e Pirros. Kur dikush lavdëronte zhdërvjelltësinë e lëvizjes së trupave të tij, ai i përgjigjej me krenari se një gjë e tillë ishte normale, pasi ushtaret e tij ishin “Bijtë e Shqipës”, kështu që lëvizjet e tyre, natyrisht u shëmbëllenin fluturimeve të madhërishtme të mbretit të shpendëve.

Sipas një versioni tjetër, disi të ndryshëm, kur trupat e tij thurnin lëvdata sulmeve të tij të guximshme e të shpejta, dhe e quanin “Shqiponjë” ai u përgjigjej se ata ishin flatrat e tij, që

bënin të mundur fluturimin e shpejtë të shqiptonjës.

Thuhet se kjo çoi në adoptimin e këtij emri, të cilin populli shqiptar e përdor edhe sot e kësaj dite. Pra, jo “ALBANË”, por “Shqiptarë” ose “Bij të Shqipës”.

Pikërisht në këtë kohë, kolonitë e Korfuzit e të ishujve të tjerë në Detin Jon, nisen ta thërrisnin fqinjën e tyre në kontinent “Epir” (Tokë në kontinent), për të dalluar atë nga banesa e tyre ishullore. Gradualisht historianët grekë e nxorën jashtë përdorimi termin “Molosia” dhe zunë të përdornin emërtime të tilla si “Mbretëria e Epirit” ose “Pirroja i Epirit”.

Sidoqoftë, ky ndryshim emri nuk ndikoi në karakterin Pellazg, apo Shqiptar të asaj krahinë. Epiri u shtri në jug deri në gjirin e Ambrakisë (Artës). Në fakt, Gjeografi grek Straboni, shkruante se “për arkananiasit, që janë grek, kurse në të majtë ndodhen Nikopoja dhe Kasopia, që janë Epirotë”.

Pra, Straboni bënte dallimin midis epirotëve dhe grekëve. Ambrakia dikur kishte qenë një qytet i lulëzuar, mirëpo tani ishte rrënuar. Pirroja “e zbukuroi atë më shumë se çdo njeri tjetër dhe e bëri rezidencën e tij Mbretërore. Pirroja njihej nga të gjithë si një princ i madh dhe i mirë. Ai zgjeroi territorin e vet duke lidhur ishullin e Korfuzit dhe krahinat e Maqedonisë. Në atë atmosferë, ku mbizotëronte Lufta e vazhdueshme për pushtet midis Princave krahinorë dhe me ata kufij shumë të luhatsëm, që përcaktonin juridiksionin e tyre, konflikti ishte i pashmangshëm dhe i përjetshëm; thuhet se gjatë një beteje me farefisën e vet maqedon, ushtarëve maqedonas u bëri aq shumë përshtypje shëmbëllimi i Pirros me Aleksandrin e Madh, sa që braktisën Mbretin e tyre dhe u bashkuan me të.

Dhe vërtet, kur maqedonët rrëzuan nga fronti mbretin e tyre të pazot, Demetrin, ata e ftuan Pirron që të sundonte edhe mbi Maqedoninë. Mirëpo, brenda shtatë muajsh, ai kuptoi se maqedonët krenarë do të preferonin më mirë që sundimtari më i keq maqedonas ishte më i mirë se sa ai jomaqedonas. Prandaj hoqi dorë vullnetarisht nga fronti në Vitin 287 para Kr. Pirroja ëndërronte të ngrinte një perandori në perëndim, të ngjashme me atë të propozuar 40 vjet më parë nga kushëriri i atit të tij, Aleksandër Molosi.

Roma, që tradicionalisht konsiderohet e themeluar në vitin 753 p.e.s, ishte ngritur gradualisht si qyteti-shtet më i fuqishmi në Itali, dhe me pas kishte bashkuar grupet e ndryshme në një konfederatë nën udhëheqjen Romake. Si rrjedhojë, ajo ishte bërë gati një republike e bashkuar, mjaft e fuqishme.

Pushtimi i galëve, apo i keltëve, vërshoi nga Veriu rreth Vitit 400 para Kr. duke e shkatërruar Romën pjesërisht me anë të një zjarri në vitin 390 para Kr. dhe duke dominuar në pjesë të madhe të Italisë për njëfarë kohe. Luftërat samnite të viteve 326-312 para Kr. dhe 299-291 para Kr. sapo kishin përfunduar, kur Pirroja nisi të hidhte një sy nga Perëndimi, i frymëzuar ndoshta nga ura portative që kishte ngritur mbi Helespont persiani Kserksi 200 vjet më parë, Pirroja, sipas Plinit, ishte i pari që konceptoi një urë të ngjashme përmes Adriatikut në pikën e tij më të ngushtë, në ngushticën e Otrantos.

Rasti i volitshëm erdhi në vitin 282 para Kr. Qyteti i pasur tregtar i Tarentit (Taranto) në jug të Italisë, një koloni Spartane, e kishte halë në sy flotën Romake në portin e vet (gjë që binte në kundërshti me marrëveshjen), kërkoi ndihmë nga Pirroja. Pa pritur që të zgjidhte problemet inxhinierie të urës, ai shfrytëzoi metodën konvencionale, duke kaluar me anije përmes Adriatikut 25.000 trupa. Përveç 3000 kalorësve, ai mori dhe 19 elefantë lufte, kafshë gjigante, të cilat italianët i shihnin për herë të parë. Kur panë ushtrinë romake tek i afrohej Tarentit, i dhanë Pirros komandën supreme të forcave antiromake, duke preferuar që më mirë t'i nënshtroheshin Pirros pellazg, sesa Romakeve Barbarë.

Në fillim, Pirroja i shkroi konsullit Romak, Valer Levinit, duke i kërkuar që të vepronte si arbitër midis Romës dhe Tarentit. Mirëpo, konsulli ia preu shkurt duke i thënë që të shihte punët e veta dhe të kthehej në Epir.

Kur prapavija romake kapí një spiun Epirot, Levini i tregoi atij legjioni gjatë një loje stërvitore dhe pastaj e lëshoi që t'i thoshte Pirros se, nëse e brente kureshtja për ushtarët dhe taktikat romake, duhej të shkonte e t'i shihte me sytë e vet.

Në betejën që u zhvillua më pas, në Heraklea, afër Tarentit (280 para Kr.), Pirroja u ndesh me një ushtri Romake dy

herë më të madhe se ushtria e tij dhe doli Fitimtar. Mirëpo, ai humbi aq shumë oficerë dhe ushtarë, sa që thirri: “Edhe një betejë tjetër si kjo dhe më duhet të kthehem vetëm në Epir”. Prej këtej lindi edhe shprehja “Fitore si e Pirros”. Ky ishte kontakti i parë ushtarak i Romës me Botën Greke në lindje. Por jo edhe i fundit. Duke shpresuar për paqen dhe Lirinë e bashkësive greke në Itali, Pirroja dërgoi në Romë ministrin e tij më të zot në artin e oratorisë, Linean. Kujtesa fenomenale e këtij të dërguari, e habiti Plinin, pasi që ai “Kishte fiksuar emrat e senatorëve dhe të kalorësve romakë vetëm një ditë pas mbërritjes në Romë. Por, Roma nuk pranoi të hynte në bisedime, andaj Pirroja marshoi drejt kryeqytetit, i cili mbrohej nga ushtria dhe milicia. Në pamundësi që ta pushtonte qytetin, ai u kthye mbrapshtë që të kalonte dimrin në Jug. Gjatë rrugës, lëshoi robërit romakë, të veshur e të mbathur dhe me para, duke u thënë që të ndërmjetësonin për paqe në emër të tij. Ndërkohë që Kartagjena pranoi t’i vinte në ndihmë Romës me një aleance ushtarake, duke shpresuar që të zgjeronte zotimet e saj në Sicili. Kjo e alarmoi shumë koloninë greke të Sirakuzes, e cila iu lut Pirros për ndihmë ushtarake kundër Kartagjenës. Pirroja nuk priste që t’i thoshin 2 herë. Ai u hodh në Sicili në vitin 278 para Kr. dhe me strategjinë e tij të shkëlqyer arriti t’ua rimmerre Kartagjenasve pjesën më të madhe të ishullit.

Fatkeqësisht, ai u përpoq të sundonte mbi këta grekë liri-dashës po aq arbitrarisht sa edhe Ptolemeu mbi Egjiptin, prandaj grekët nuk mund ta duronin dot. Ata e hodhën poshtë ofertën e tij që të bëhej mbreti i tyre: disa prej tyre preferonin më mirë Kartagjenën sesa regjimin ushtarak. Dionisi i Halikarnasit, që duhej të ishte ndikuar si historian nga origjina e tij greke dhe nga ambienti romak ku jetonte, i hodhi fajin Pirros. Ai shkruante se Pirroja u soll në mënyrë arrogante e tiranike, ashtu si shtypësit e tyre italianë, duke konfiskuar pasuritë dhe duke shpërndarë ofiqe të larta për miqtë e kapitenët e tij.

Ai internoi, e madje ekzekutoi njerëz të shquar me akuza të sajura; fyeu ndjenjat e Popullatës duke plaçkitur thesaret e paraujtura në tempujt e tyre. Kur u tërhoq në drejtim të Tarentit, erërat e tërbuara shkatërruan disa nga anijet e tij, midis të cilave

edhe ato që bartnin thesarin e popullit. Me gjithë avantazhet e shumta që kishte, Pirroja e humbi betejën tjetër “për shkak të zemërimit të perëndeshës”. Kjo ishte beteja jopërfundimtare e Bevenetos.

Pas kësaj, në vitin 275 para Kr., ai u kthye në atdhe, duke lënë pas një garnizon në Tarent, por duke e lënë në Itali, në duart e Romakëve. Jo vetëm Epiri, por edhe Greqia dhe gjithë Lindja po bëheshin tashmë të vetëdijshëm për fuqinë e re që po ngrihej në Perëndim.

Edhe Ptolemi i Egjiptit po përpiqej të zgjeronte kufijtë e tij. I pakënaqur me kontrollin e rrugëve detare në Egje, ai nxiti kryengritje në Greqi e Maqedoni. Në fakt, Pirros iu mbush mendja fare lehtë për të pushtuar Maqedoninë nga perëndimi, por kjo nuk dha ndonjë rezultat të madh. Ndërkohe, ILIRINË nuk mund ta sulmonte, pasi mbreti i saj Glaukia, e kishte strehuar që të vogël dhe e kishte ndihmuar të hipte në fronin e MOLOSISË, që në moshën 12 vjeçare. Kështu, ai i drejtoi armët kundër Greqisë. Depërtoi në lindje deri në Argosin e Peloponezit dhe u step nga frika kur pa argivet që nuk donin ta pranonin brenda mureve të qytetit. Pikërisht aty, në Argosin pellazg, në vitin 272 para Kr., karriera e tij do merrte fund. Ashtu si heroi i tij, Aleksandri i Madh, që e kishte mbyllur karrierën e tij të shkëlqyer në mënyrë aq të lavdishme, me turp në muret e Argosit, kur një grua e zemëruar do t'i hidhte një tjegull nga çatia e do ta linte të vdekur në vend!

Në veprën e tij “Historia Natyrore”, Plini shkroi për një dukuri shumë të pazakontë që ndodhi në Romë. “Dita që Vdiq Pirroja; kokat e prera të kafshëve të flijuara, rrokullisen në tokë, duke lëpirë gjakun e tyre; shenjë kjo jashtëzakonisht e mbarë”. Një bust, të cilin studiuesit e identifikojnë si me atë të Pirros, u gjet në Herkulan, rrëzë malit të Vezuvit, dhe ruhet në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Napolit.

Aleksandri (272-?para Kr.)

Vendin e Pirros e zuri i biri, Aleksandri, i cili pati grindje të vazhdueshme me MAQEDONINË. Sidoqoftë, është domethënës fakti që asnjëra nga këto mbretëri të hershme Shqiptare, nuk kërkoi aleancë me Greqinë për të luftuar kundër tjetrës.

Copëzimi (?-168 para Kr.)

Pas Aleksandërit, Epiri u nda midis një numri princash fisnorë, të cilët i qeverisnin krahinat e tyre si mbretëri të vogla. Shumë prej tyre morën anën e Perseut të Maqedonisë në luftën e tij kundër Romës. Rrjedhimisht, senati i zemëruar Romak e urdhëroi gjeneralin e sapoemëruar, Emil Paulin, të autorizonte ushtarët e tij që, si ndëshkim, të plaçkitnin qytetet e Epirit. Pas betejës së Pidnes, trupat Romake shkatërruan 70 qytete Epirote, pjesa më e madhe e të cilëve i përkiste fisit të molosëve, dhe kishin si skllëvër 150.000 banorë. Shumica e tyre u transportuan në Itali.

Një shekull më vonë, Straboni shkruante se, ndonëse zonat fshatare ishin të ashpra e plot me male, “ I gjithë Epiri dhe Iliria dikur ishin tërësisht të populluara. Tani, pjesa më e madhe ka mbetur e shkretë, kurse zonat e banuara janë katandisur në fshatra ose në rrëpira. Madje edhe Orakulli i Dodonës ka mbetur pothuajse i braktisur fare. “Dëshmi të heshtura të hakmarrjes së egër të Romës mbi Epirin, u gjetën 2000 vjet më vonë, kur gërmimet në Antigonea të Gjirokastrës nxorën në dritë një shtresë goxha të trashë prej hiri, të mbetur nga zjarri që rrënoi plotësisht këtë qytet, dhe 69 të tjerë si ai...

(Pjesë të marra nga Libri “Populli Shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1912”, shkruar nga Edwin.E.Jacques.)

Botuar: 3.11.2005: <http://floart.blogspot.com/2005/11/pirro-296-272-para-krishtit.html>

Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve

Flori Bruqi, 2006

Kosova:1389

Në Mesjetë, një ngjarje e madhe për popullin tonë dhe për Ballkanin në përgjithësi, ishte edhe Beteja e Kosovës, 1389. Në këtë betejë, njëra nga figurat qendrore u shqua dhe Milosh Kopiliqi, pasi që mundi të vriste Sulltan Muratin I, që ishte Sovrani i Perandorisë Osmane.

Serbët e konsiderojnë atë si hero te vetin, por edhe shqiptarët e Kosovës e kanë ruajtur të gjallë kujtimin e tij dhe i kanë kënduar këngë për 5 shekuj.

Beteja, sipas Kostandin Jireçekut, filloi të martën dhe vazhdoi deri të premten. Njëri nga shtatë princërit që mori pjesë në këtë betejë, ishte edhe Gjergj II Balsha, sundimtari i Shkodrës, Teodor Muzaka, i cili u vra në betejë. Në një përshkrim që i bën betejës, humanisti dubrovnikas, abati benediktin i manastirit të Shën Andreas dhe Shën Jakobit në Vishnjice, A. C. Tubera, (i njohur me emrin Tuberon Krijeviq) shkruan se në këtë betejë morën pjesë: Dardanët, Ilirët, Maqedonasit.

D. Kostiq, i cili i ka kushtuar një studim të gjerë çështjes se emrit të M. Kopiliqit, konkludon që “ai ishte dinarian, i dalë prej simbiozës serbo-shqiptare; pra, Ballkanas i serbizuar.

Siç thamë, M. Kopiliqit i janë kënduar kënga nga shqiptarët e Kosovë. I pari ka qenë Dervish Ahmeti nga Gjakova (1918), ndërsa i dyti, G. Elezoviq (1923). “Jedna arnautska pesma o

boju na Kosovu”, Elezoviçi e kishte dëgjuar nga Xhemë Bojku i Vushtrrisë.

Cajkanoviçi ka konstatuar, më 912: “Kulti i Milosh Kopiliqit është shumë i fortë ndër shqiptarët dhe ata e quajnë hero të tyre”. Duke u nisur nga mbiemri i tij, dimë që ndërmjet Pejës dhe Mitrovicës, gjendet edhe sot fshati Kopiliq në Drenicë dhe akoma edhe sot, kur banorët e këtij fshati zihen me banorë të fshatrave të tjera, ata thonë “unë jam nga Kopiliqi, ku lindi ai burrë që vrau sulltanin”.

Serbët nuk kanë këngë për M. Kopiliqin. E përmendin në disa këngë, por e përmendin bashkë me të tjerët. Dhe, në një këngë e dallojnë edhe etnikisht, kur thonë: “Kopiliq qëndron ndërmjet dy vojvodëve Serbë”. Interesi i serbëve për Miloshin, sipas studiuesve, u zgjua nga fundi i shekullit XVII, kur koha kishte errësuar tashmë origjinën e tij. Në këtë kohë iu ndryshua edhe mbiemri, nga Kopiliq, iu bë Obiliq. Në shekullin XVIII, historianët P. Julinaç dhe V. Petroviçi i dhanë atij emrin Obiliq (*bollëk, teprë*).

Historiografia serbe është përpjekur vazhdimisht, dhe po përpiqet që Kosovën gjatë sundimit të Nemanjidëve (fund i shek. XII deri në vitin 1371) dhe në përgjithësi, në periudhën para sundimit osman, ta paraqesë të banuar vetëm nga serbët. Pretendimeve të këtilla tendencioze, një përgjigje të merituar shkencore u dha profesor dr. J. Dranqolli, i cili thekson: “Burimet e kohës, që ruhen në arkiva, kisha dhe biblioteka, japin të dhëna krejtësisht të tjera nga ato që na i ofron historiografia serbe”.

Para se të parashtrijmë këto të dhëna, vlen të përmendet një konkludim shumë i qëlluar i studiuesit francez, A. Dyselje, i cili pohon se Kosova gjatë shek. XIII-XIV ka qenë qendra ekonomike dhe politike e mbretërisë mesjetare serbe, por në mënyrë shkencore vëren se vendosja e një qendre të pushtetit politik dhe ekonomik në një territor të caktuar nuk garanton aspak, veçanërisht në mesjetë, karakterin etnik sundues të atyre që e kanë pushtetin politik. Në këtë mënyrë, ai merr shembull despotatin e vogël “serb” të Serit në Greqinë Veriore, i cili mundi të sundonte nga viti 1355 deri më 1371, një popullsi, pjesa më e madhe e së cilës ishte greke.

Prania e popullsisë serbe në Kosovë, sipas burimeve të shkruara, dëshmohet që në shek. XI, ndërsa në një farë mase fillon të shtohet në gjysmën e dytë të shek. XII, dhe në fillim të shek. XIII, atëherë kur Kosova hyri në kuadrin e Shtetit të Nemanjidëve. Një rritje e dukshme e popullsisë serbe në Kosovë, pa dyshim, bëhet atëherë kur Serbia fitoi statusin e Perandorisë.

Në atë periudhë, popullsia e viseve veriore serbe filloi të depërtojë me të madhe në drejtim të jugut, pra edhe të Kosovës. Në çfarë raporti arriti ajo ndaj popullsisë vendase arbërore, nuk mund të thuhet kurrgjë.

Të dhënat burimore, po ashtu dëshmojnë se arbrit, gjatë gjithë mesjetës vazhduan të jetojnë në trevat e tyre autoktone të Kosovës. Kjo provohet nga vetë dokumentet cirilike të shek. XIII-XIV, në të cilat, krahas antroponimeve shumicë serbe, hasen në masë të konsiderueshme edhe aso të pastra arbërore, por dhe arbërore të sllavizuara. Kur jemi tek të dhënat burimore cirilike, vlen të përmendet se në to hasen edhe familje të përziera në aspektin antroponomik.

Kështu p.sh., sipas një të dhëne që i përket viteve 1293-1302, mësojmë se në vendin Ship të Klinës, në mesin e banorëve të tij është edhe Dobroslavi, bir i Gjinit. Rast të njëjtë hasim edhe në krisobulën e manastirit të Deçanit (1330) ku thuhet: “Gjoni dhe djemtë e tij, Radosllavi dhe Bogosllavi”.

Nga të dyja rastet shihet qartë se prindërit mbanin emra arbërorë, kurse djemtë e tyre emra sllavë (serbë), respektivisht emrin e serbit ka mundur ta mbajë edhe arbri.

Duke marrë parasysh faktin se pushteti politik-kishtar ishte në duart e klasës politike-kishtare serbe, atëherë, lirisht mund të thuhet se arbrit plotësisht u janë nënshtruar formave të diskriminimit, me të vetmin qëllim që t’i sundonin më lehtë, dhe tek e fundit nëpërmjet antroponimisë së imponuar sllave t’i identifikonin si sllavë. Prandaj, antroponimia e tyre në masë të konsiderueshme u humb në atë sllave (serbe).

Prania e etnosit arbëror provohet edhe nga burimet latine, përkatësisht raguziane. Kështu, më 1369, përmenden tre tregtarë prizrenas që i kishin borxh Raguzës, dhe sipas emrave që

mbanin (Liepur-Lepur, Lumasius-Lumi dhe Jovanich-Gjon) na dalin arbërorë. Në këtë drejtim duhet përmendur edhe Dhimitër Drançin dhe presbit Gjinin nga Novobërda, të cilët më 1382 mbanin lidhje afariste me Raguzën.

Prania e arbërve në Kosovë gjatë feudalizmit të zhvilluar, mund të shpjegohet edhe me disa shembuj nga sfera e toponimeve të përkatësisë arbërore. Vend të rëndësishëm në këtë drejtim zënë toponimet: Unjemir (Ujmiri i sotëm), Lloçan dhe fshati Arbanas. Në krisobulën e Stefan Dushanit të vitit 1348 (mbi themelimin e manastirit të shenjtoreve Mihal e Gabriel në Prizren), zihen në gojë edhe një sërë fshatrash arbërorë: Gjinovci, Magjerci, Pegogllavci, Flokovci, Çruca, Çaparçi, Gonovci, Shpinadinci dhe Novaci, e mbi të gjitha aty arbrit përmenden me emrin e tyre etnik. Ky fakt jo vetëm që dëshmon praninë e popullsisë arbërore në Kosovë, por njëkohësisht, në aspektin juridik, atë e paraqet të nivelizuar me popullsinë serbe.

Jo rastësisht përshkurtazi përmendëm praninë e arbërve në Kosovë, sepse pikërisht në territorin e tyre u zhvillua beteja e famshme e Kosovës (15, përkatësisht 28 qershor 1389). Beteja e Kosovës ishte një nga përpjekjet më të vendosura të popujve ballkanikë, për të ndaluar ekspansionin e mëtejshëm osman në Gadishullin Ballkanik.

Për të arritur këtë qëllim ata bashkuan forcat e tyre në një koalicion të përbashkët, të cilit i printe sundimtari serb Lazar Hreblanoviç, dhe vendosën t'i bënin ballë ushtrisë osmane, e cila udhëhiqej nga vetë Sulltan Murati I dhe djemtë e tij, Bajaziti dhe Jakupi. Përgatitjet serioze, numri i madh i ushtarëve të ushtrive kundërshtarë, rrjedhat e betejës, rrjedhojat dhe pasojat, kontribuan që ajo të hyjë në analet historike dhe njëkohësisht të shërbejë si motiv për krijimin e njërit nga ciklet më të mëdha dhe më të bukura të epik ballkanik.

Në fushatën e tyre për pushtimin e brendisë së Gadishullit Ballkanik, ushtritë osmane, të kryesuara nga Sulltan Murati, më 1386, depërtuan në Serbi, ku pushtuan Nishin. Më pas, tek Ploçniku (sot fshat pranë Prokuples), Murati u ndodh përpara sundimtarit të Serbisë, Lazarit. Ky i fundit nuk guxoi të konfrontohej në një betejë të hapur me Sulltanin, por i premtoi Muratit

dhënien e një tributi, si dhe një trupe ndihmëse ushtarake prej 1000 vetash, mirëpo shumë shpejt hoqi dorë nga premtimi i dhënë.

Në këtë kohë edhe Shteti i Balshajve kalonte çaste të vështira. Në të vërtetë, për shkak të veçantisë së brendshme feudale dhe nën sulme të vazhdueshme osmane, ku për pasojë territori i Gjergjit II Balsha u ngushtua bukur shumë (përfshinte vetëm Shkodrën, Drishtin, Ulqinin dhe Tivarin), dhe për të mos humbur krejtësisht zotërimet e mbetura, ai pranoi që të hynte nën vasalitetin osman.

Sipas Orbinit, kjo u bë në vitin 1386, respektivisht para 27 janarit të po atij vit, sepse po të ishte në këtë kohë në armiqësi me osmanët, Gjergji nuk do të mund t'u siguronte liri tregtarëve raguzianë në trevat e tij. Nga ana tjetër, mospërmendja e osmanëve nga ana e Gjergjit, lë vend për të konkluduar se ai kishte pranuar sovranitetin osman vetëm formalisht.

Duket se, për të hequr qafet sovranitetin formal osman, Gjergji planifikoi t'u jepte atyre një goditje vendimtare. Në këtë drejtim, derisa në njërin anë i nxitu dhe u premtoi ndihmë osmanëve kundër Bosnjës (me mbretin e së cilës, Tvërtkon, deri atëherë ishte në marrëdhënie të këqija), në anën tjetër fshehurazi vuri në lëvizje planin e dëshiruar antiosman, duke u afruar me vjehrrin e tij, Lazar Hreblanoviqin dhe me Tvërtkon.

Njëkohësisht, planet e tij duhet t'i jenë bërë të njohura edhe Raguzës, për arsye se më 23 gusht 1388, aty u ndodh i deleguari i Gjergjit, Gjoni, i cili siç thuhet "erdhi për shkak të bisedimeve me osmanët, për të mirën tonë".

Planet antiosmane arriti t'i konkretizojë në verë të vitit 1388. Forcat osmane, nën komandën e Lala Shahinit, që në këtë kohë depërtuan në Bosnjë, u thyen rëndë nga forcat aleate të Tvërtkos, Gjergjit II Balshës dhe Lazarit.

Në këtë disfatë të osmanëve, rolin udhëheqës e kishte pasur Gjergji, sepse, siç pohon Bitlisi, ai ishte bërë shkak për vrasjen e 10 deri 15 mijë luftëtarëve. Pas kësaj disfate të osmanëve, Gjergji duhej të kishte hequr qafe sovranitetin formal osman, sepse Neshriu, duke përshkruar rrethanat që sollën në

konfliktin e Bosnjës, Gjergjin II Balshën e cilësonte “të nënshtruar të sulltanit”, kurse Bitlisi, duke përshkruar përgatitjet e pjesëmarrësve udhëheqës të Koalicionit ballkanik për ditën e mynxyrës së Kosovës (1389), e radhiste atë në mesin e “banditëve” dhe të “pafeve”.

Mospërmbushja e detyrimeve nga ana e Lazarit, disfata në Bileçe të Bosnjës dhe roli vendimtar i Gjergjit II Balshës në atë disfatë që iu shkaktua osmanëve, u bë, siç thotë kronikani osman, Idris Bitlisi, “e domosdoshme dhe detyrë ndaj vullnetit perandorak që të përgatiteshin për të vënë në vend nderin e ushtarëve të vrarë dhe të likuidonin intrigat dhe ngatërresat e kokëfortëve”.

Pra, siç mund të shihet, parapërgatitjet që u paralajmëruan nuk kishin për qëllim që në një betejë vendimtare të thyenin vetëm qëndresën e sundimtarit serb Lazarit, siç pretendon historiografia serbe, por, në fakt synohej që të thyheshin sundimtarët ballkanikë.

Përgatitjet e osmanëve, në krye me Sulltan Muratin, për një ndeshje vendimtare me sundimtarët ballkanikë, sipas të gjitha gjasave kishin filluar që në fund të vitit 1388.

Murati dha urdhër perandorak, u bënte thirrje komandantëve të Anadollit dhe të Rumelisë, respektivisht të gjithë bejlerbejve të vilajeteve, djemve të tij, Bajazitit dhe Jakupit, disa princave nga Azia e Vogël, si dhe sundimtarëve të krishterë, të cilët kishin pranuar vasalitetin ndaj shtetit osman, që me forcat e tyre të mbledheshin dhe të drejtoheshin për t’i mposhtur sundimtarët ballkanikë. Përveç të sipërpërmendurve, Sulltanit i erdhi ndihmë “edhe nga persët edhe nga arabët”, dhe në këtë mënyrë u krijua një ushtri e madhe në krye të së cilës qëndronin Sulltan Murati dhe dy djemtë e tij, Bajaziti dhe Jakupi.

Përmendëm pjesëmarrjen e këtij spektri të gjerë forcash në kuadër të ushtrisë osmane, nga shkaku se në historiografinë serbe, jo vetëm që anashkalohet kjo e vërtetë, por nga ana tjetër synohet që të minimizohet Koalicioni ballkanik, duke theksuar se “lajmet e mëvonshme osmane janë krejtësisht fantastike, ku, sipas të cilave, Lazarin e ndihmuan edhe... arbitrit, vllëhtët dhe hungarezët”, dhe gjithnjë sipas tyre, “duhej ta paraqitnin

fitoren osmane sa më të rëndë dhe sa më të rëndësishme”. Po të kishte qenë me të vërtetë ashtu, atëherë kronikanët osmanë nuk do të përshkruanin edhe spektrin e gjerë të ushtrisë osmane (duke përmendur si pjesëtarë të saj edhe turqit nga principatat selxhuke të Kastamonisë dhe të Karamanisë, të cilat hynë nën mbrojtjen e Sulltan Muratit vetëm formalisht (1387), ngase ato edhe më tej ruajtën autonominë e tyre, madje edhe gjatë shek. XV u gjendën në luftë me shtetin osman, derisa u pushtuan prej tij; si dhe ndihmën që i erdhi asaj nga persët dhe arabët; por do të kënaqeshin me përshkrimin e pjesëmarrësve të Koalicionit ballkanik.

Me qëllim që ta kishin më të lehtë këtë fushatë, forcat e mbledhura të ushtrisë osmane mendonin që atë ta nisnin në pranverë, prandaj dimrin e kaluan në Plovdiv të Bullgarisë. Përgatitjet e Muratit i shqetësuan dhe i vunë në lëvizje sundimtarët e vendeve të ndryshme të Ballkanit.

Për t’i bërë ballë rrezikut, zotërinjtë e tyre lanë mënjanë grindjet dhe konfliktet e vjetra dhe formuan një koalicion nën kryesinë e sundimtarit serb, Lazar Hreblanoviçit. Gjergji II Balsha, i cili që prej kohësh e kishte ndjerë rrezikun osman, siç duket shumë kohë përpara Betejës së Kosovës, d.m.th. qysh në vitin 1388, ishte angazhuar në përgatitjen e koalicionit antiosman. Vitin në fjalë, atë së bashku me Vuk Brankoviçin, i ndeshim te vjehrrin e tyre, Lazari.

Prandaj, sipas kësaj të dhëne, mund të dyshohet se ata u morën vesh për një aksion të përbashkët kundër osmanëve.

Pjesëtarët e Koalicionit patën kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur dhe për t’u mbledhur në momentin e duhur. Kjo dëshmohet nga vetë kronikanët osmanë, të cilët flasin mbi traktatet diplomatike ndërmjet të të deleguarve të Muratit dhe udhëheqësit të Koalicionit, Lazarit, ku preken çështjet për zgjidhjen e konfliktit të tyre dhe ku njëkohësisht mësohet për përgatitjet ushtarake të palëve kundërshtarë.

S’ka dyshim se një rol udhëheqës në përgatitjen e Koalicionit ballkanik patën edhe arbitrit. Në këshillimin për mënyrën e strategjisë së luftës (të cilën do ta zbatonin sundimtarët ballkanikë kundër osmanëve) të zhvilluar në prag të betejës,

jo rastësisht kaloi propozimi i Jorgjit (Gjergj Kastriotit- gjyshi i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut), që konflikti me osmanët të zhvillohej ditën dhe jo natën, siç kishte propozuar udhëheqësi i Koalicionit, Lazari.

Jo vetëm gjykimi i tij që i drejtë, por edhe miratimi i propozimit të tij në mënyrë unanime nga sundimtarët pjesëmarrës (duke përfshirë këtu edhe vetë Lazarin), është një dëshmi tjetër se sa autoritativ kishte qenë ai në mesin e pjesëmarrësve të Koalicionit, aq më tepër kur dihet se kishte një forcë të rëndësishme ushtarake.

Le të ndalemi tani pak në çështjen e dilemave që ekzistojnë në historiografi lidhur me identifikimin e Jorgjit dhe me numrat e ushtarëve të ushtrive kundërshtarë.

Disa studiues Jorgjin e identifikojnë si Gjergji II Balsha, kurse disa studiues të tjerë si Gjergj Kastrioti. Ne konsiderojmë se mund të mbështetet qëndrimi i dytë, ngase kronikanët osmanë Gjergjin II Balshën e cilësuan “Sundimtar të Shkodrës Arbërore”, por pa i shtuar këtij emërtimi emrin e tij, me çka u la vend për t’u kuptuar se nuk bëhet fjalë për Gjergjin II Balshën, por për Gjergj Kastriotin.

Po ashtu duhet shtuar se disa studiues kanë shprehur mendimin se gjyshi i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Gjergji, do të jetë quajtur Gjon, kurse studiues të tjerë, duke u mbështetur në njoftimet e Gjon Muzakës, se i ati i Skënderbeut quhej Pal, përcaktohen për këtë emër.

Ndërsa, lidhur me numrat e ushtarëve të ushtrive kundërshtarë në burimet osmane dhe në ato serbe ato janë tepër të ekzagjeruara, ku për pasojë në shkencën historiografike janë paraqitur mendime të ndryshme. Ne konsiderojmë si më të pranueshëm konkludimin e studiuesit P. Thëngjillit, i cili duke analizuar këtë fenomen, ka ardhur tek përfundimi se numri prej 20000-25000 ushtarësh në anën serbe (Koalicionit) dhe prej 30000-40000 ushtarësh në anën osmane, i paraqitur nga studiuesit serbë, me qëllim të minimizimit të Koalicioni ballkanik, është tepër i zvogëluar. Studiuesi në fjalë ka lënë vend që të kuptohet se duhet mbështetur numra më të mëdhenj, nga ata që

na i ofrojnë studiuesit serbë. Kurse ne konsiderojmë se numrat në fjalë duhet zmadhuar edhe ca, ngase njëri nga kronikanët osmanë, siç është Oruçi, duket se është më afër realitetit.

Ai thekson: “Ai (Sulltani- Q. D.) me pesëdhjetë-gjashtëdhjetëmijë ushtarë shkoi dhe doli në fushën e Kosovës”).

Pas trajtimit të dilemave në fjalë, i rikthehemi vazhdimit të problematikës së sipërpërmendur, përkatësisht rolit udhëheqës që patën arbrit në përgatitjen e Koalicionit ballkanik.

Në këtë drejtim duhet përmendur edhe rolin e rëndësishëm të princit nga Kosova, Milosh Kopiliqit (kronikani osman Enveri, Milosh Kopiliqin e përmend me titujt: “Princ” dhe “Ban”; humanisti raguzian Feliks Petançi, “Princ Ilir”; humanisti arbëror nga Kosova, ipeshkvi i Ulqinit, Martin Seguni, “Baron”; arqipeshkvi i Tivarit, Andrea, “Ban”; kurse humanisti ynë Marin Beçikemi e vë atë në cilësinë e “Perandorit të Mizisë”), i cili për kryezot kishte Vuk Brankoviqin.

Se sa personalitet me peshë kishte qenë ai në radhët e krerëve të Koalicionit, vërtetohet nga një e dhënë e Enverit, ku thuhet: “Lazari i dha Miloshit një gotë me pije, duke i thënë: “thonë për ty që je bërë tradhtari im...” Miloshi i përgjigjet: “nesër ke për ta parë tradhtarin, ke për të parë nëse jam njeri i drejtë apo tradhtar”. Lazari në atë moment e mori në dorë gotën e dollisë dhe e piu”.

Përshkrime afërsisht të ngjashme të këtij momenti na ofrojnë edhe humanistët raguzianë Feliks Petançi, A. Cerva – Tuberoni dhe Mauro Orbini, si dhe humanisti slloven Benedikt Kuripeshi. Ngritja e dollisë nga ana e Lazarit, vetëm atëherë pasi u sigurua për besnikërinë e Kopiliqit, flet qartë se ai ishte njëri nga princërit kryesorë të Koalicionit, dhe një prestigj të tillë e kishte arritur, padyshim, pasi që ishte përfaqësuar me një forcë të rëndësishme ushtarake.

Po pse u vendos që beteja të zhvillohej pikërisht në fushën e Kosovës? Rrethanat e karakterit ushtarak e strategjik, si dhe fakti se agresioni osman tashmë i kërcënonte drejtpërsëdrejti trevat e Ballkanit Qendror, bënë që beteja të zhvillohej në Kosovë, në afërsi të Prishtinës; në një rajon ku mund të organizo-

heshin më mirë ushtritë e shteteve feudale ballkanike, por që ishte njëkohësisht një pikë ku kryqëzoheshin rrugët nga mund të depërtonin më tutje osmanët.

Në rrethana të këtilla, ushtritë e Koalicionit, të kryesuara nga sundimtarët e tyre, në mëngjes të 15, përkatësisht të 28 qershorit 1389, zunë nga një pozicion të veçantë në fushën e Kosovës. Në burimet osmane, të cilat me të drejtë janë cilësuar si shumë më të pasura se burimet serbe e bizantine, dallohen dy grupe kryesore lidhur me pjesëmarrësit në betejë: nga njëri grup, pjesëmarrësit përmenden në mënyrë të papërcaktuar, ku thuhet se krahas ushtrive të Lazarit morën pjesë edhe arbitrit, boshnjakët, vllehtë, çekët, hungarezët, polakët dhe frëngjit; dhe nga grupi tjetër, pjesëmarrësit përcaktohen drejtpërsëdrejti, si më kryesorë serbët, arbitrit dhe boshnjakët, duke i dalluar këta nga forcat e tjera ndihmëse.

Ushtria e Koalicionit u rreshtua në fushën e luftimit, duke pasur në qendër Lazarin, djathtas Vuk Brankoviçin dhe majtas fisnikun boshnjak Vlatko Vukoviçin dhe atë arbëror Dhimitër Jonimën, zotërimet e të cilit shtriheshin në zonën midis Lezhës dhe Rrëshenit, kurse kronikani osman, Mehmet Neshriu, e quan atë i biri i Jundit, Dimitri.

Përndryshe, prijësit e tjerë ballkanikë dhe arbërorë ishin rreshtuar në të dy krahet e ushtrisë së Koalicionit. Nga kjo shihet se ndonjë nga zotërinjtë arbërorë (kuptohet jashtë trevës së Kosovës) merrte pjesë me forcat e veta pikërisht në krahun e djathtë, ndërsa forcat e arbërve të Kosovës, logjikisht ishin në kuadër të forcave të Vukut, dhe shikuar nga këndvështrimi i kritikës historike, pse aty, si vasal i Vukut, me forcat e veta të mos ishte edhe Milosh Kopiliqi.

Rreth pjesëmarrjes, apo mospjesëmarrjes së Gjergjit II Balshës në Betejën e Kosovës, është shkruar bukur shumë në historiografi. Studiuesit sllavë kryesisht e mohojnë pjesëmarrjen e tij. Ndërsa, historiografia shqiptare e mbështet në tërësi pjesëmarrjen e tij.

Nëse u besojmë kronikave osmane, atëherë del e qartë se ai ka marrë pjesë në betejë. Në të vërtetë, duke marrë parasysh

faktin se Gjergji II Balsha në kronikat osmane cilësohet “Sundimtar i Shkodrës Arbërore” dhe “Sundimtar i Shkodrës së Arbërve”, atëherë, të dhënë që na e ofron Bitlisi lidhur me përgatitjet e pjesëmarrësve të Koalicionit ballkanik për ditën e mynxyrës së Kosovës, në mesin e të cilëve përmend “Sundimtarin e Arbërve”, s’është gjë tjetër, veçse është fjala për Gjergjin II Balshën. Pjesëmarrjen e tij e mbështesin edhe njoftimet e këngëve epike serbe.

Sipas tyre, ai i ishte përgjigjur thirrjes së Lazarit për ndihmë, duke shkuar në Kosovë me një ushtri prej 6000 vetash. Në njërën nga këngët në fjalë madje thuhet se kishte marrë pjesë në betejë “Balsha me trimat e Zetës dhe arbërorët e rreptë”.

Në Betejën e Fushë-Kosovës morën pjesë edhe sundimtarë të tjerë të fuqishëm arbërorë, si: sundimtari i Despotatit të Beratit, Theodori II Muzaka, i cili me vete kishte një ushtri të madhe arbërore; zotër të tjerë të Arbrit, në mesin e të cilëve ishin edhe zotër feudal arbërorë të Himarës dhe të Epirit. Arbrit kishin mbushur gjithashtu edhe radhët e shigjetarëve të ushtrisë së Koalicionit, të cilët ishin të parët që filluan betejën.

Sipas kronikanëve osmanë, beteja filloi në mëngjes. Të njëjtën gjë e pohon edhe Anonimi nga Firencja, kurse sipas kujtimeve të Konstandin Jireçeku, ajo filloi të mërkurën dhe përfundoi të premten. Konfrontimi ndërmjet ushtrive kundërshtare që i ashpër.

Pas disa sukseseve fillestare të ushtrisë së Koalicionit, ku ajo theu krahun e majtë të ushtrisë osmane që udhëhiqej nga Jakupi, me ndërhyrjen e Bajazitit që komandonte krahun e djathtë, sukseset ushtarake u kthyen në të mirë të osmanëve, të cilëve përfundimisht u takoi fitorja. Por humbjet në njerëz nga të dyja palët ishin të mëdha, saqë, po të hidhej vështrimi, në çdo anë nuk shihej gjë tjetër veçse koka të prera. Në mesin e të rënëve mbetën edhe dy udhëheqësit e betejës, Murati dhe Lazari. Aty u vranë edhe Theodori II Muzaka dhe vrasësi i Sulltanit, Milosh Kopiliqi.

Pas vrasjes së Muratit, Bajaziti u tërhoq për në Edrene me qëllim që ta siguronte marrjen e fronit të zbrazur. Tek pjesëmarrësit e Koalicionit ballkanik, kjo tërheqje krijoi përshtypjen

se osmanët u thyen. Kështu, mbreti i Bosnjës, Tvërtko, në letrën e tij të shkruar disa ditë pas betejës (1 gusht 1389) njoftonte qytetin e Trogirit, se “duke fituar me triumf fushën e luftës, u shkaktuam disfatë atyre (osmanëve) ... i vramë, saqë nga ata mbetën pak të gjallë”. Lajmi i fitores duket se ishte përhapur me të madhe.

Për këtë dëshmojnë:

- a) *Në letrën e datës 20 tetor 1389 që qytet-shteti i Firences i dërgonte Tvërtkos, (në përgjigje të njoftimit të tij për fitoren mbi osmanët) i bënte të ditur se këtë lajm të gëzuar e dinte që më parë, dhe se atë e kishte marrë përmes zërave të përhapura dhe letrave të shumta. Prandaj e dinte mirë ngjarjen e 15 qershorit, ku në fushë të Kosovës kishte mbetur i vrarë edhe Murati, kurse në atë betejë të lavdishme, fitorja i kishte takuar Mbretërisë;*
- b) *Udhëpërshkruesi francez i shek. XIV, Filip de Mezier, në veprën “Ëndrra e Pelerinit të moçëm”, të shkruar në muajin tetor të vitit 1389, thekson: “Murati... u mposht plotësisht nga të krishterët”.*

Në fakt, këto ishin përshtypje të gabuara, pasi, siç kemi cekur më lart, fitorja u takoi osmanëve, të cilëve njëherit i hapën dyert për të depërtuar në pjesët e Ballkanit Veriperëndimor.

Më lart, kalimthi përmendëm se në betejë morën pjesë edhe arbitrit e Kosovës. Por, problemi i pjesëmarrjes së tyre në betejë është prekur pak në historiografi, sepse mungojnë të dhënat historike të drejtpërdrejta mbi këtë problematikë. Në qoftë se më lart dëshmuam për praninë e arbërve në Kosovë, atëherë ata nuk do të mund të qëndronin të mënjanuar dhe të mos merrnin pjesë në ngjarjet e mëdha politike-ushtarake të kohës, të zhvilluara në truallin e tyre autokton.

Mospërmendja në mënyrë të drejtpërdrejtë në burimet historike e pjesëmarrjes së tyre në betejë, shpjegohet me faktin se autorët e kohës që ishin sllavë, bizantinë e osmanë, janë kënaqur me paraqitjen e pjesëmarrjes së formacioneve politike-shoqërore e të sundimtarëve të tyre, kurse, si zakonisht, nuk i kanë marrë parasysh masat popullore. Ajo është mbuluar me paraqitjen e pjesëmarrjes në luftë të sundimtarit serb të Kosovës, Vuk Brankoviçit dhe ushtrisë së tij.

Në favor të këtij vlerësimi, vlen të përmendet e dhëna e Shën Denisit, ku thuhet: “Mbreti i Kosovës mblodhi një ushtri jo vetëm nga feudalët, por edhe nga popullsia e rëndomtë” d.m.th. arbërore. Përkundër faktit se kronika ka të bëjë me Betejën e Rovinës të vitit 1395, përmendja e pjesëmarrjes së popullsisë vendase në një betejë jashtë territorit të saj, është një sinjal i fortë se popullsia në fjalë do të ketë marrë pjesë edhe më masovikisht (në kuadër të ushtrisë së kryezotit të saj, Vuk Brankoviqit) në Betejën e Kosovës, ngase ajo u zhvillua pikërisht në territorin e saj. Humanisti raguzian Tuberoni, nënshtetasit e Lazarit i quan dardanë, ilirë dhe maqedonas, ndërkaq Lazarin mbret të dardanëve, të cilët gjatë betejës mbroheshin me aq guxim, saqë turqit mezi bënëin ballë.

S’ka dyshim se është fjala për popullsinë arbërore të Kosovës, që autori e përmend me emrin e saj të vjetër. Se arbitri e Kosovës kishin marrë pjesë masovikisht në betejë, dëshmohet edhe nga një e dhënë tjetër, “despoti Lazar i Serbisë, bullgarët ... dhe sundimtarë të Arbrit nga Dardania ... u mblodhën ... u hapën luftë turqve, por Lazari dhe shumë të tjerë humbën jetën në betejë”.

Tek e fundit, Filip de Mezier, jo rastësisht, këtë betejë e vendosi në pjesët e Arbrit, me çka la vend që të kuptohet drejt karakteri etnik arbëror i Kosovës, pasi kuptimi gjeografik, parimisht nuk e mohon kuptimin etnik.

Është e vërtetë se përmes traditës popullore nuk mund të ndërtohet historia, posaçërisht nëse ajo nuk gjen mbështetje në burimet historike. Por, tradita jonë popullore që i kushtohet Betejës së Kosovës, me një kuadër të hollësishëm të ngjarjeve për: organizimin dhe nisjen e ushtrive osmane nga Anadulli, itinerarin e tyre në Ballkan, marshin nëpër Selanik e Shkup dhe arrijten në Fushë-Kosovë; si dhe për zhvillimin e luftimeve, vrasjen e Sulltan Muratit dhe fundin e Miloshit, gjen një mbështetje pikërisht në burimet historike osmane, të cilat po ashtu, na njoftojnë për këto ngjarje.

Prandaj, si e tillë, ajo mund të merret në konsideratë për trajtimin e ngjarjeve për këtë betejë. Pikërisht pjesëmarrjen e arbërve të Kosovës në këtë betejë e dëshmon ekzistenca e këngës

së vjetër arbërore – shqiptare mbi Betejën e Kosovës, që në fakt është këngë e popullsisë vendase arbërore të Kosovës, sepse të gjithë botuesit e varianteve të ndryshme të këngës në fjalë, japin shënime të qarta se personat nga të cilët ata i kanë mbledhur këto këngë, që të gjithë janë nga Kosova.

Pra kënga lindi në Kosovë, sepse popullsia e saj mori pjesë në betejë.

Vargjet e fundit të këngës popullore arbërore - shqiptare, flasin për largimin e një pjese të popullsisë arbërore të Kosovës pas disfatës në betejë. “Një çik oms (d.m.th. të ëmës) ça kish pas thon”:

- *Ku po shkojmë mori non?*
- *Na po ikim prej turku, i ka thon.*
- *E kur vim ko, mori non?*
- *Kur çartojet turku, sikur na”*

Mendojmë se ky emigrim mund të gjejë mbështetje në faktin se, qysh në vitin 1390, në Raguzë tanimë jetonte familja Kopiliqi, aq më tepër kur dihet fakti se përveç ekzistimit të oazave arbërore që jetonin gjatë gjithë mesjetës në pjesën jugore të bregdetit Adriatik gjer në Raguzë, si dhe në prapatokë (pra, edhe në troje të Bosnjës e Hercegovinës dhe të Malit të Zi) gjatë shekujve XIV-XV në trojet e përmendura, veçmas në Raguzë, ndeshim shumë mërgimtarë arbërorë, të cilët lëshuan atdheun e tyre për shkaqe të ndryshme.

Pjesëmarrja e arbërve të Kosovës në betejë mund të shtrihet deri aty sa të pretendohet me të drejtë e të diskutohet edhe për përkatësinë etnike arbërore të Milosh Kopiliqit, përndryshe hero i Betejës së Kosovës. Emri dhe mbiemri i tij ka zgjuar interes që prej kohësh, që së paku, duke e analizuar atë në dritën e të dhënave antroponimike, t’i afrohet zgjidhjes së çështjes së përkatësisë së tij etnike.

Por, në këtë drejtim, historiani serb i shek. XVIII, P. Julianac, më 1765, nuk zgjodhi kriteret (për ta identifikuar atë më lehtë si serb - Q. D.) dhe ia tjetërsoi mbiemrin nga Kopiliq / Kopil(i) ose Kobil(i) më vonë e ka marrë sufiksionin sllav Kopil(iq) – Kobil(iq)/ në Kobilic - Obilic, term i cili u pranua nga his-

torianët pasardhës të historiografisë serbe.

Përkundër faktit se mbiemri i Miloshit tek kronikani osman, Ashik Pashazade, i shkruar me grafinë osmane, në radhë të parë mund të lexohet si Kopila e pastaj Kobila, studiuesit G. Elezoviq dhe A. Olesnicki, në rastin konkret përcaktohen dhe përdorin variantin Kobila, kuptohet që në bazë të termit serb *kobita* ‘pelë’, të lihej vend që përkatësia e tij etnike të kërkohej vetëm në mesin e serbëve.

Mirëpo, studiuesi K. Jireček, lidhur me këtë problematikë, që prej kohësh me të drejtë sinjalizonte se në shekullin XVIII emri që rridhte nga pela ishte i pahijshëm, prandaj e tjetërsuan, duke i dhënë për bazë termat (serbë) *obilan* dhe *obilje*. Nga ana tjetër, rezultatet shkencore nga fusha e gjuhësisë, megjithatë dëshmojnë origjinën thjesht arbërore të emrit dhe mbiemrit të tij. Kështu, prapashtesat osh, ush dhe oshe janë të përhapura sot e kësaj dite në të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët.

Edhe rrënja Mil (Mill) lidhet me emrat shqiptarë, si, bie fjala, Mëhill, Mhill, Milo, (humanisti raguzian F. Petançi e përmend Miloshin me emrat: Milon dhe Milo) dhe diç të ngjashme.

Studiuesi ynë E. Çabej, duke analizuar përkatësinë gjuhësore të një vargu fjalësh, pohon: “Një problem më vete përbëjnë disa fjalë që janë të përbashkëta për shqipen, sllavishten ballkanike e rumanishten, pjesërisht dhe për greqishten e re. Fjalë, të cilat kryesisht me ndërmjetësinë e rumunëve kanë depërtuar edhe në disa gjuhë të tjera, si në çekishten, sllovakishten, polonishten e ukrainishten.

Hyjnë aty, ndër të tjera: balgë, buzë, gushë, katund dhe kopil”. Studiuesit F. Mikloshiq dhe P. Skok mendojnë se bëhet fjalë për term (d.m.th. kopil) me prejardhje shqipe, përkatësisht për një huazim nga shqipja. Në të vërtetë, emri Kopil është shumë i hershëm, dhe në dokumente të shkruara përdoret në krisobulën e Shën Shtjefnit të Banjskës së Kosovës në vitin 1313, kurse si Kipil haset në fshatin Çabiq, i regjistruar në krizobulat e Deçanit.

Përndryshe, supozohet se emri Kopil ka prejardhje ilirothrakase, i cili në gjuhën e vjetër arbërore-shqiptare ka kuptimin

e fëmijës të cilit nuk i dihet prindi-babai, ndërsa në gjuhën rumune ka kuptimin e fëmijës. Në këtë drejtim, duket se enigmën e ka zgjidhur studiuesi kosovar prof. dr. sci. J. Drançolli, i cili pohon: “Emri Kopil, gjithashtu është një emër me prejardhje thjesht shqiptare. Përveç të tjerash, sot në shqip fjala kopil, ka kuptimin e sythit të mbirë në një rrënjë, trung a në degë të një bime”.

Është e njohur se në traditën mesjetare fshati merrte emrin e zotërisë, e së këndejmë fshati Kopiliq i Drenicës, përgjithësisht njihet si vend i Milosh Kopiliqit, aq më tepër kur këtë fshat (përkatësisht Kopiliqin e Epërm dhe Kopiliqin e Poshtëm) e hasim në regjistrin osman të vitit 1455, kushtuar krahinës së Brankoviçëve.

Përkatësia thjesht arbërore e heroit të betejës, dëshmohet edhe nga vetë kënga arbërore - shqiptare për Betejën e Kosovës, ku ai del si figurë kryesore e këngës. V. Çajkanoviç, duke shpjeguar motivet e këngës arbërore – shqiptare, të botuar nga ana e G. Elezoviçit, e karakterizon atë, “epopeja shqiptare... nuk është gjë tjetër veçse kënga për Miloshin”.

Ai më tej shton se gjatë qëndrimit të tij në afërsi të Elbasanit, në rrethanat e luftës ballkanike (1912), i kanë treguar për disa shqiptarë vendas se janë pasardhës të Milosh Kopiliqit. E gjithë kjo, vazhdon më tej. Ai tregon se heroi, Miloshi, kishte kultin dhe traditën e tij në mesin e shqiptarëve.

Ndërsa M. Gjurgjeviç (shumë kohë përpara këtij të fundit) që qëndronte në Prishtinë si zyrtar i Austro-Hungarisë në vitet 60 të shekullit XIX, e ka vlerësuar përshkrimin e Betejës së Kosovës, sipas traditës gojore vendëse, si më reale sesa të dhënat e shpjegimit historiografik, serb të modifikuara nga prirjet politike shoviniste.

Kënga në fjalë është një poemë me një lëndë origjinale dhe autentike, me tipare të dalluara nga ato të këngëve epike serbe për Betejën e Kosovës. Në të nuk i këndohet knjaz Lazarit ose figurave të tjera të bujarëve feudalë serbë që morën pjesë në betejë, siç ndodhi në epikën serbe.

Pavarësisht nga roli pozitiv që luajtën në luftën kundër

vërshimit osman, ato mbeteshin të huaja për botën arbërore-shqiptare, e cila epopenë ia kushtoi pikërisht heroit që doli nga gjiri i saj.

Në këtë truall, tek shqiptarët, krahas këngës, organikisht jetojnë edhe një sërë legjendash, kujtimesh, toponimesh etj. Sipas legjendës popullore: “Miloshi ka pas lindur në Kopiliqin e Epërm, por më vonë është vendosur në Kopiliqin e Poshtëm”.

Pleqtë e Drenicës tregojnë se “Milosh Kopiliqi â kanë prej ktuhit” (Drenicës).

Ata vënë një vijë të qartë demarkacioni: “Car Lazari â kanë i serbëve, Milosh Kopiliqi i yni”; “Milosh Kopiliqi â kanë më i madhi kreshnik i shqiptarëve në luftën e Kosovës”. Në Kopiliq të Poshtëm ka vende që quhen: “Te trolli i Miloshit”, “Vneshta e Miloshit”, “Te kisha e Miloshit” etj. Në Sallabajë gjendet “Vorri i Milosh Kopiliqit”. “Miloshi e mbante ushtrinë në pyjet e Çiçavicës e të Kukës” (pyje të Drenicës). “Car Lazari... venin e tij e ka pas kah Kraleva dhe jo në Kosovë”. ...

Kosova :2006

Kosova edhe tani i shërben politikës serbe për të krijuar unitetin e humbur në shoqëri dhe brenda klasës politike të Pashallëkut të Beogradit.

Të gjithë, unanimisht votuan tekstin. Në mesin e deputetëve ka intelektualë të mirëfilltë, doktorë të shkencave, por si zakonisht përsëritet i njëjti fenomen: mendja e tyre është e suspenduar dhe nuk arrin ta vështojë nga distanca dukurinë e kësaj natyre që në mënyrë ciklike prodhon kriza, fatkeqësi, tragjedi, rrënime, eksode, shkelje drastike të të drejtave të njeriut.

Çuditërisht, askush nga deputetët nuk parashtroi pyetjen sesi ata do ta arrinin të menaxhonin, të dilnin në krye me një Kosovë forcërisht të aneksuar, me dy milionë shqiptarë të mllëfosur dhe të armiqësuar me shtetin?

Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari duhet të analizojmë natyrën e nacionalizmit serb, e cila prodhon aberracione ciklike të politikës serbe nga rrjedhat normale historike. Nacio-

nalizmin neurotik serb e karakterizon resantimani, ose ndjenja e dinjitetit të nëpërkëmbur, bindja për humbje të padrejtë, mëria për tjetrin si pasojë e përbuzjes, apeli për hakmarrje, për qërim hesapësh, për riinterpretim të historisë, por edhe si xhelozia kundër të tjerëve që janë më të suksesshëm.

Mëria zakonisht ka prodhuar konflikte serbe me fqinjët, ndërkaq xhelozia ka prodhuar antievropianizmin fanatik. Kur filloi e gjitha kjo? Kur dhe kush e zbuloi mitin e Kosovës? Kur nisi ky ortek i iracionalizmit? Zakonisht mendohet se etnologu serb, Vuk Karaxhiq, është prodhuesi i këtij miti, por misionin hulumtues atij ia besoi etnologu dhe linguisti i njohur slloven J. Kopitar, i cili bashkëpunonte ngushtë me Gëten.

Shkrimtari gjerman kishte obsesion periudhën antike greke, kohën që sipas tij, në qenien e njeriut ka ekzistuar harmonia mes elementit apolonik (racional) dhe atij dioniziak (irracional, emotiv).

Gëte mendonte se qytetërimi perëndimor lëngon nga ngadhënjimi i plotë i racionalizmit, që e vlerësonte si një shkarje të rrezikshme. Ai kishte shpresë të madhe se harmonia e dikurshme antike mund të gjendej ende në baladat e popujve të Ballkanit.

Së këndejmi, në kuadër të interesimit të tij për gjetjen e harmonisë së humbur, fitoi misionin hulumtues edhe serbi Vuk Karaxhiq, i cili nisi të mblidhte baladat në mjedise të ndryshme ballkanike, madje dhe në ato shqiptare.

Megjithatë, rapsodi i tij kryesor ishte Filip Vishnjq, i cili dukej sa mistik aq dhe mitik, ngaqë ishte i verbër. Ai në mënyrë fragmentare rrëfente për heronjtë e betejës së Kosovës. Në këtë mënyrë epika u bë mit, ndërkaq miti histori.

Çuditërisht, dramën e parë për betejën e Kosovës, një tragjedi renesansiane e ka shkruar shkrimtari anglez në fillim të shekullit të 16-të, Tomas Gofi me titull “The Courageous Turk or Murat the First” (Turku guximtar ose Murati i parë), ndërkaq dramat e para serbe me këtë temë janë shkruar dy shekuj më parë.

Është fakt i pamohueshëm se para Vuk Karaxhiqit, serbët nuk dinin dhe nuk jetonin me epopenë mitike të Kosovës, nuk këndonin as për Car Llazarin, as për tradhtarin Vuk Brankoviq,

as për Milosh Obiliqin, i cili plotësisht ka qenë i harruar për shkak të prejardhjes së tij shqiptare. Pas këtij inaugurimi të mitit të Kosovës, këto ngjarje dhe personazhe u fetishizuan duke marrë atribute religjioze, mesianike dhe mistike.

Siç thamë më lart, Miti i Kosovës, pa marrë parasysh të vërtetën, prodhoi të paktën tre lloje aktivitetesh: artistike, politiko-ushtarake dhe religjioze. Linja artistike prodhoi një varg veprash letrare, figurative, muzikore dhe filmore. Shkrimet e para filluan nga mesi i shekullit 19-të në kuadër të organizatës “Rinia e bashkuar serbe” me seli në Novi Sad, të cilët përhapnin ide, madje kanibaliste ndaj turqve, vendin e të cilëve kohët e fundit e kanë marrë shqiptarët.

Cikli i ri letrar me tematikë kosovare nisi në fillim të shekullit 20-të me veprat e M.

Rakiq, Aleksa Shantiq, Jovan Duçiq, Millosh Cërnjanski, Drago Luboviq dhe dhjetëra të tjerë.

Në fillim të viteve të 50-ta të shekullit të 20-të, mitizimin e betejës së Kosovës e vazhduan shkrimtarët Dushan Matiq, Vasko Popa, Zoran Mishiq, Miodrag Pavloviq etj. Ndërkaq, në vitet e 80-ta, stafetën e shkrimeve plot pikëllim dhe mëri e vazhduan shkrimtarët si Millan Komneniq, i cili në dialogun mes intelektualëve shqiptarë dhe serbë, me arrogancë e përfundoi fjalimin me kërcënimin ogurzi: “Zotërinj ne jemi në luftë”.

Ky lloj i letërsisë, i përshkuar me ndjenjat resantimane, prodhohej edhe nga shkrimtarët e tjerë si Millorad Gjuriq, Gojko Gjogo, Millovan Vitezoviq, Branko V. Radiçeviq etj.

Ndërmjet Luftës së Parë Botërore dhe asaj të dytës, në skenën e krijimitarisë serbe u shfaq edhe një lloj i surealizmit të vonuar. Këta shkrimtarë, si epigonë të shqetësimeve të dikurshme të Gëtes për të zbuluar harmoninë e humbur mes të racionale dhe irracionale, zgjodhën afirmimin e irracionale, si kontribut tipik serb, i pakërkuar nga askush për ripërtëritjen e “Evropës së degjeneruar”.

Në këtë kohë shkruheshin ese, ku në mënyrë të hapur, Evropa dhe kultura perëndimore perceptohej si një kënetë, si një qytetërim i degjeneruar, që lypsej regjeneruar përmes gjenit

barbar serb (*srpski barbarogenij*). Përmes kultizimit të irracionalishtit, intelektualët serbë synonin ta ndërtonin relevancën e tyre në sofrën evropiane. Kjo begenisje e imazhit irracionel, ky adhurim i çmendurisë u bë specifiteti diferencues i identitetit serb.

Nocionet moralisht negative, si gënjeshtër, vjedhja, dhuna, vrasja etj., në këtë rrafsh merrnin konotacione pozitive. Nga ky kënd Evropa perceptohej përmes thjerrëzës përthyesë të resantimanit, me xhelozë dhe mëri.

Është tepër indikative të analizohen dhe të krahasohen aspiratat serbe me shqetësimet e krijuesve shqiptarë të kësaj periudhe kohore. Këto shqetësime janë diametrisht të kundërta me ato serbe. Në këtë periudhë eseistët shqiptarë me në krye Branko Merxhanin, hodhën idenë e neoshqiptarizmit, shqiptarët që zhveshin mendësinë orientale, misticizmin dhe irracionalizmin dhe kërkojnë prehje në racionalizmin evropian. Evropa dhe qytetërimi i saj perceptohej pozitivisht, prandaj shqiptari i ri duhej t'i kishte këto tipare. Këto përcaktime nuk janë ndryshuar sot e kësaj dite.

Linja politiko-militare e instrumentalizimit të mitit të Kosovës, mund të thuhet se zë fill në fillim të vitit 1882, në kohën e Kral Millutinit, i cili, i dobësuar në fronin që mbante, vriste mendjen sesi ta rikthente besimin e humbur. Për këtë qëllim ai zgjodhi festimin e jubileut 500-vjeçar të betejës së Kosovës. Krali Millutin nuk arriti të organizojë këtë manifestim, ngaqë ndodhën ndërrime të përgjakshme në fronin serb.

Ata që erdhën, nuk hoqën dorë nga manifestimi edhe pse faktori ndërkombëtar, ashtu si 100 vite më vonë, përmes reagimit të ministrit austro-hungarez të Punëve të Jashtme, i tërhoqi vëmendjen qeverisë serbe se ky manifestim mund të jetë lojë e rrezikshme.

Kompromisi që bëri qeveria e atëhershme, ishte nisma e krenimit disa ditë para Vidovdanit (28 qershorit, dita e betejës së Kosovës) dhe atë në Akademinë Mbretërore. Porosia që doli nga ky manifestim, sot e kësaj dite ka mbetur e njëjtë: vdekja e Knjaz Lllazarit është amanet për të ruajtur unitetin e popullit

serb. Në këtë kohë u ndërtua ideja se beteja e Kosovës u humb për shkak të mosunitetit, përçarjeve dhe tradhtisë. Në këtë diskurs, heroi tragjik ishte Knjaz Llazari, tradhtari Vuk Brankoviç, ndërkaq hakmarrësi Millosh Obiliç (ose Kopiliç sipas versionit shqiptar).

Resantimani si nocion përmban fyerjen, përbuzjen, humbjen e padrejtë dhe hakmarrjen për ta rivendosur drejtësinë.

Të gjitha këto elementë ngërthehen në mitin serb mbi Kosovën.

Për t'iu larguar kritikave perëndimore, kremtimi jubilar i 500-vjetorit në vitin 1889 u organizua në Krushevc.

Miti i Kosovës u ngulit aq shumë në imagjinatën serbe, sa që prodhonte halucinacione kolektive. Këtë fenomen e përshkruan Mircea Eliade, i cili dëshmon se në vitin 1912, një brigadë e tërë serbe paskësh parë Krali Markon sesi e sulmon Prilepin. 100 vjet më vonë, Sllobodan Millosheviç, sërish e instrumentalizoi mitin e Kosovës për ta përforcuar legjitimitetin e tij politik dhe moral, duke ringjallur konceptet anakronike të së kaluarës. Ai, për t'i eliminuar kundërshtarët e vet rikujtoi popullatën për efektet rrënuese të tradhtisë për kauzën serbe.

Në Gazimestan ai theksonte se në Kosovë, para 600 vjetësh serbët u katandisën për shkak të mosunitetit. Përçarja dhe tradhtia në Kosovë do ta ndjek popullin serb si një ogur i zi gjatë tërë historisë së tij. Mosuniteti i politikanëve serbë e la pas Serbinë, ndërkaq inferioriteti i tyre e përbuzte Serbinë.

Prandaj, klithte Sllobodan Millosheviç njësoj si të tjerët një shekull më parë, “gjashtë shekuj më vonë sërish jemi në beteja dhe para betejave. Ato nuk janë të armatosura edhe pse, as ato nuk përjashtohen.

Por, sidoqofshin ato, betejat nuk mund të fitohen pa vendosmëri, guxim dhe flijim”. Në këtë rrëfim, në këtë mit të ripërtëritur, Millosheviç ishte Llazari i ringjallur; ashtu si Krishti, kundërshtarët e tij politikë, bëheshin Juda (ose sipas versionit serb Vuk Brankoviç); ndërkaq, rolin e hakmarrësit, Milosh Obiliçit, e merrnin gjeneralët aktualë serbë, prej Kadijeviçit e deri te Arkani. Çdokush e shihte veten në role mitike.

Apeli i kryeçetnikut Slllobodan Millosheviq për unitet, ishte në esencë në funksion të përforcimit të regjimit të tij. Duke u thirrur në përçarjet mitike që paskan ndikuar në humbjen e Betejës së Kosovës, ai në mënyrë krejtësisht të lehtë dhe banale i eliminoi kundërshtarët e vetë duke u kanosur me mallkimin se mund të trajtohen si tradhtari Vuk Brankoviç.

Miti i Kosovës ngërthen më vete edhe elementë religjiozë, që nënkupton se pas golgotës vjen ringjallja, duke marrë kështu elementë të Dhjatës së re, përkatësisht simbolikën e vuajtjes (kalvarit dhe ringjalljes). Millosheviqi veten e paraqiste si Llazari i rilindur, i cili do të hakmerret për betejat e humbura, për tradhtinë brenda radhëve të popullit, për përbuzjet që i janë bërë gjatë shekujve popullit serb.

Mirëpo, fundi i Slllobodan Millosheviqit nuk ishte aspak mitik, por tepër banal. Ai prej Mesias mitike të popullit serb u shndërrua në Vozhd (prijës), në personazh të novelës së R. Domanoviçit me po këtë titull, i cili e përshkruan katandinë e një populli që verbërisht e ndjek Vozhdin (prijësin) e verbër, derisa ai nuk i shpie në buzë të humnerës.

Kur populli i habitur dhe i rraskapitur nga ky gabim, me inat pyesin atë: ku na solle? Ai pa të keq përgjigjet: unë jam i verbër, por ju ku i patët sytë?.

Aktualisht në skenën politike serbe u paraqit një tjetër Vozhd (prijës), që garanton se i ka sytë dhe se do t'i prijë popullit serb drejt horizonteve të reja, parajsës së premtuar.

Fjalori i tij është po aq mitik. Ai flet për triumfin moral të viktimitës, duke paraqitur gjithnjë serbin si viktimë, ndërkaq të tjerët, shqiptarët dhe perëndimorët, si agresorë. Në kuadër të mitit ngurtësohen idetë, konceptet, armiqtë, miqtë dhe veçanërisht koha. Car Llazari, Vuk Brankoviçi, Krali Markoja etj. ende jetojnë nëpër cepat e trurit që prodhojnë imagjinatën.

Në emër të mitit ata kërkojnë leje për t'i ridënuar shqiptarët. Ka dhe të tjerë që ofrojnë ide më moderne për ta fituar të njëjtën të drejtë për dënimin e shqiptarëve. Ata, gjoja më të mençur dhe më dinakë ndërlidhen me temat aktuale, si bie fjala: lufta kundër ekstremizmit politik islamik, terrorizmit, krimin të

organizuar, prostitucionit, korrupsionit etj.

Mesazhet e tyre janë të qarta: mos lejoni që Kosova të bëhet shtet i pavarur, sepse do të shndërrohet në Kolumbi të Evropës. Këto janë argumente për faktorin e jashtëm, ndërkaq për faktorin e brendshëm përdoren nocionet romantiko-religjioze si uniteti, tradhtia, kalvari, hakmarrja e kështu me radhë.

Para disa ditësh, kryeministri serb nxori nëpërmjet agjencisë “Tanjug” etj., në vazhden e riciklimit të mitit për Kosovën, elaboratin për copëzim të Kosovës, që në thelb është një prelud për konflikt të ri në Ballkan. Ky projekt, jo vetëm që destabilizon Kosovën, por automatikisht edhe Maqedoninë, Bosnje-Hercegovinën, vetë Serbinë, si dhe Shqipërinë dhe Bullgarinë. Serbët dhe Serbia i ngjasojnë pllakës së prishur të magnetofonit që prodhon të njëjtin avaz më se 1 shekull me radhë. Natyrisht gjilpëra nuk mund të ndreq vetveten, por duhet ndihma nga jashtë.

Mr. sci. Flori Bruqi

(Një pjesë e të dhënave për këtë artikull janë marrë nga libri “Ana serbe e luftës” të autorëve të ndryshëm serbë)

Mbrojtja e Plavës dhe Gucisë(tetor 1879-janar 1880)

Flori Bruqi

Me revoltën e armatosur të Gjakovës dhe me aksionin diplomatik të pranverës së vitit 1879, Lidhja Shqiptare ia hoqi Portës së Lartë de facto të drejtën që të fliste në emër të Shqipërisë. Veç kësaj, me qëndresën e saj energjike, ajo bëri që të zvarriteshin e të mos zbatoheshin menjëherë dy vendimet e rëndësishme të Kongresit të Berlinit, që cenonin interesat kombëtarë të Shqipërisë, njëri në favor të Malit të Zi (neni 28 i Traktatit) dhe tjetri në dobi të Greqisë (Protokolli nr. 13 i Kongresit).

Megjithatë Lidhja e Prizrenit nuk e kishte plotësuar ende përfundimisht programin e saj. As gjashtë Fuqitë e Mëdha nuk ishin të prirë t'i anulonin vendimet që kishin marrë në Kongresin e Berlinit, as dy shtetet fqinje ballkanike nuk kishin ndërmend të hiqnin dorë nga viset që u kishin premtuar Fuqitë e Mëdha. Si rrjedhim, lufta për mbrojtjen e trojeve shqiptare ende nuk kishte marrë fund, përkundrazi, parashikohej që ajo të merrte trajta të përgjakshme.

Pas vrasjes në Gjakovë të mareshal Mehmet Ali Pashës, Porta e Lartë u dha të kuptojnë Fuqive të Mëdha se e kishte tepër të vështirë të përmbushte kundrejt Malit të Zi detyrimet territoriale që rridhnin nga Traktati i Berlinit. Por knjaz Nikolla nuk donte të dinte për asnjë justifikim. Nga frika se me kalimin e kohës mund të ndryshonin rrethanat ndërkombëtare në dëm të

saj, Cetina kërkonte vazhdimisht ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha për ta detyruar Perandorinë Osmane të dorëzonte sa më parë krahinat e Podgoricës, të Shpuzës, të Zhabjakut, të Plavës, të Gucisë e të Rugovës, të cilat Kongresi i Berlinit ia kishte dhënë Malit të Zi. Veç kësaj, si kundërpeshë ajo po e vononte dorëzimin e Ulqinit, të Dinoshit dhe të Bregut të Bunës, të cilat i mbante të pushtuara qysh nga koha e luftës, por që sipas Traktatit të Berlinit duhej t'i ktheheshin Perandorisë Osmane.

Presionin më të fortë ndaj Perandorisë Osmane e ushtroi Rusia cariste, e cila vijoi ta kushtëzonte tërheqjen e ushtrive të saj pushtuese nga Traka me dorëzimin e krahinave që i qenë premtuar Malit të Zi. Fuqitë e tjera të Mëdha u bashkuan me presionin carist, pasi e shikonin me shqetësim qëndrimin e mëtejshëm të ushtrive ruse në afërsi të Stambollit. Kështu, në fund të vitit 1878, Porta e Lartë vendosi t'i zbatonte detyrimet territoriale kundrejt Malit të Zi.

Vendimi i Stambollit ngriti përsëri në këmbë shqiptarët. Për të shqyrtuar gjendjen e re u mbledh menjëherë, në fillim të janarit 1879, Komiteti Kombëtar i Lidhjes, i cili ripohoi me vendosmëri qëndrimin e vet të caktuar më parë. Sipas kësaj vije, Lidhja e Prizrenit nuk do ta pengonte dorëzimin e Podgoricës, të Shpuzës e të Zhabjakut, pasi ato banoreshin nga popullsi të përziera sllavo-shqiptare, por do ta kundërshtonte me armë lëshimin e Plavës dhe të Gucisë, popullsia e të cilave ishte në masën dërrmuese shqiptare. Vendimin e Komitetit Kombëtar e miratuan të dy komitetet ndërkrahinore të vilajeteve të Shkodrës dhe të Kosovës, të cilat po në janar 1879 mbledhën kuvendet e tyre të jashtëzakonshme, pothuajse në atë kohë që zhvilloi punimet e veta edhe Kuvendi Ndërkrahinor i Prevezës. Meqenëse Plava e Gucia bënë pjesë në vilajetin e Kosovës, barrën e drejtimit dhe të organizimit të luftës për mbrojtjen e tyre e mori përsipër Komiteti Ndërkrahinor i Prizrenit, i cili nga ana e vet formoi një shtab ushtarak të posaçëm, me Ali pashë Gucinë në krye.

Ndërkaq u mbledh në fshatin Virpazar, në afërsi të liqenit të Shkodrës, komisioni turko-malazez, i cili më 2 shkurt 1879

nënshkroi marrëveshjen dypalëshe për formalitetet e dorëzimit brenda një jave të krahinave të vilajetit të Shkodrës, që i takonin njëra-tjetrës sipas Traktatit të Berlinit. Nga frika e kryengritjes së shqiptarëve, Porta e Lartë nuk pranoi ta përfshinte në marrëveshje dorëzimin e Plavës e të Gucisë, duke e lënë çështjen e tyre për t'u zgjidhur më vonë. Sipas marrëveshjes, dorëzimi i Podgoricës, i Shpuzës dhe i Zhabjakut nga ana e autoriteteve turke u krye pa vështirësi. Po ashtu u bë edhe dorëzimi i Ulqinit, i Dinoshit dhe i Bregut të Bunës nga ana e autoriteteve malazeze.

Por Mali i Zi nuk deshë ta linte punën të zgjatej më tej. Knjaz Nikolla iu drejtua menjëherë Fuqive të Mëdha, duke kërkuar prej tyre që ta detyronin Perandorinë Osmane t'ia dorëzonte dy krahinat shqiptare (Plavën dhe Gucinë) Malit të Zi. Nga ana e vet Porta e Lartë u kërkoj Fuqive të Mëdha të dërgonin në Plavë e në Guci një Komision Ndërkombëtar për t'u bindur për vështirësitë që gjente te shqiptarët e egërsuar nga padrejtësitë e Kongresit të Berlinit. Në vend të tij ato dërguan Komisionin Ndërkombëtar për caktimin e vijës së kufirit, të përbërë nga përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha dhe të dy shteteve të interesuara. Komisioni filloi nga puna në maj 1879 dhe për disa muaj me radhë u mor me caktimin e pikave të kufirit turko-malazez në vilajetin e Shkodrës. Por gjatë verës, kur Komisioni Ndërkombëtar donte të shkonte në Plavë e në Guci, përfaqësuesit e Komitetit Ndërkrahinor të Prizrenit u paraqitën Fuqive të Mëdha, më 22 gusht 1879, një notë me shkrim, me të cilën deklarorin se nuk do të njihnin asnjë ndryshim të kufirit me Malin e Zi pa pjesëmarrjen në Komisionin Ndërkombëtar të krerëve të Lidhjes Shqiptare dhe pa u miratuar vendimet e tij nga e "gjithë" Shqipëria. Pas kësaj note të rreptë, Komisioni Ndërkombëtar e ndërpreu punën e vet, pezulloj udhëtimin e tij për në Plavë e në Guci.

Me këtë rast filluan përsëri protestat e Malit të Zi dhe ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha për ta detyruar Perandorinë Osmane që ta zgjidhte sa më parë çështjen e Plavës e të Gucisë. Porta e Lartë provoi t'i bindte banorët e dy krahinave kufitare

që të hiqnin dorë nga qëndresa e mëtejshme, duke u premtuar familjeve, që nuk dëshironin të jetonin nën sundimin malazez, se do t'u jepte tokë në vendbanime të reja dhe se do t'i çlironte nga taksat për dhjetë vjet. Por shqiptarët nuk u lëkundën nga vendimi i tyre. Atëherë knjaz Nikolla filloi të kërcënonte se do ta zgjidhte këtë çështje me anën e luftës së armatosur dhe se në një rast të tillë nuk do të aneksonte vetëm Plavën e Gucinë, por edhe vise të tjera shqiptare.

Në këto rrethana, marrëdhëniet shqiptaro-malazeze erdhën duke u keqësuar vazhdimisht. Gjatë muajit tetor 1879 Mali i Zi filloi përqendrimin e ushtrive në kufi, duke e çuar numrin e tyre në 5 600 veta. Këtyre masave Lidhja e Prizrenit iu përgjigj duke vënë në gatishmëri luftarake forcat e saj të armatosura.

Sipas vendimit që Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes kishte marrë më 3 tetor 1879, Komisioni Ushtarak a Shtabi Ushtarak, nën kryesinë e Ali pashë Gucisë, i krijuar nga Komiteti Ndërkrahinor i Lidhjes Shqiptare për Kosovën, shpalli për zonën e Plavës e të Gucisë gjendjen e luftës. Të gjithë burrat plavianë e gucianë të aftë për armë u shpallën luftëtarë që do të qëndronin në gatishmëri në shtëpitë e tyre. Po në tetor 2 mijë gjakovarë të armatosur u nisën për në Guci. Në fund të tetorit mbërritën këtu edhe vullnetarë nga Shkodra e Malësia. Porta e Lartë, për të mënjeluar konfliktin e armatosur, i propozoi Cetinës që në vend të krahinave shqiptare të Plavës e të Gucisë t'i jepte disa vise sllave të Hercegovinës. Por propozimin e Stambollit, të cilin e kundërshtoi Austro-Hungaria, nuk e pranoi as Mali i Zi.

Pas disa ndeshjeve sporadike kufitare, që ndodhën gjatë tetorit, knjaz Nikolla vendosi më në fund të kalonte në sulme të hapura. Më 31 tetor dhe 1 nëntor 1879 forcat malazeze, duke dashur të tërheqin vëmendjen e Fuqive të Mëdha dhe, njëherazi, të matnin pulsën e shqiptarëve, kryen dy inkursione kundër vijës mbrojtëse të forcave të Lidhjes, të parin në fshatin Pepaj dhe të dytin në fshatin Arzhanicë. Në këtë të fundit vranë në befasi 30 fshatarë dhe dogjën mjaft shtëpi, por pas disa orë luftimesh u dëbuan nga forcat e Lidhjes. Në të vërtetë këto qenë sulme demonstrative, të cilat shqiptarët i përballuan pa ndonjë vësh-

tirësi. Edhe pse dështoi, sulmi malazez nxiti një valë të madhe mobilizimi në të katër anët e Shqipërisë. Me mijëra vullnetarë të tjerë vrapuan në krahinat e Gjakovës, të Pejës, të Dibrës e të Shkodrës. Gatishmëria e shqiptarëve qe aq masive, sa Shtabi Ushtarak i Lidhjes së Prizrenit, i vendosur në Guci, u detyrua të pengonte nisjen e tyre drejt frontit, pasi nuk ua ndiente nevojën dhe nuk kishte mundësi për t'i sistemuar.

Në fillim të muajit dhjetor forcat kryesore malazeze qenë rreshtuar gjatë vijës kufitare, në fshatrat Murinë, Pepaj, Arzhanicë e Velikë, kurse forcat shqiptare përballë tyre në fshatrat Guci, Kolenivicë, Martinaj, Plavë e Nokshiq. Midis forcave malazeze dhe shqiptare në sektorin verilindor kalonte lumi Lim vetëm me një urë prej druri. Zona malazeze ishte kryesisht malore, ndërsa në atë shqiptare dominonte pllaja e Plavës.

Më 4 dhjetor 1879, pjesa më e mirë e ushtrisë malazeze prej 4 mijë ushtarësh, nën komandën e Mark Milanit, ndërmoi një sulm të furishëm në sektorin e Nokshiqit, në drejtim të Plavës e të Gucisë. Shtabi ushtarak i Lidhjes, i përbërë nga Ali pashë Gucia (kryetar), Jakup Ferri, Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Filip Çeka, Jusuf Sokoli e të tjerë, midis të cilëve kishte edhe disa oficerë të karrierës, u përgjigj duke hedhur në sulm rreth 2 mijë luftëtarë. Luftimet më të ashpra u bënë në luginën e Nokshiqit, ku u angazhuan forca të shumta malazeze. Luftëtarët u përleshën aq ashpër me njëri-tjetrin, sa që të dy palët lanë mënjane hutat dhe nxorën jataganët, duke u përleshur trup me trup. Përleshja vazhdoi disa orë me radhë. Forcat vullnetare të Lidhjes ndalën sulmin e ushtrisë malazeze dhe i shkaktuan asaj disfatë në Nokshiq, duke e detyruar të tërhiqej brenda kufijve të Malit të Zi. Edhe pse të dhënat për humbjet e të dy palëve janë kontradiktore, mund të nxirret si përfundim se nga malazezët pati 300 të vrarë e të mbytur në lumë gjatë tërheqjes, ndërsa nga shqiptarët 300-400 veta. Në këto luftime u vra edhe një nga komandantët e shquar të ushtrisë së Lidhjes, Jakup Ferri.

Vendosmëria e shqiptarëve për të qëndruar deri në fund dhe këmbëngulja e Cetinës për të vazhduar më tej luftën alarmuan si Fuqitë e Mëdha, ashtu edhe Perandorinë Osmane. Nga

frika e ndërlikimeve të reja, Porta e Lartë vendosi ta zgjidhte me çdo kusht dorëzimin e dy krahinave kufitare. Për këtë qëllim ajo nisi menjëherë për në Kosovë mareshal Ahmet Muhtar pashën, i cili atë kohë ishte komandanti i Armatës osmane të Rumelisë me qendër në Manastir. Mareshali, i shoqëruar nga 11 batalione (rreth 6 000 ushtarë), sapo arriti në Prizren thirri në takim anëtarët e Komitetit Kombëtar të Lidhjes për t'i bindur që t'i nënshtroheshin vendimit të sulltanit. Por ata nuk pranuan. Më 14 dhjetor 1879 lëshoi një shpallje, me të cilën u kërkonte shqiptarëve që të merrnin në konsideratë gjendjen kritike të Portës së Lartë dhe të mos pengonin dorëzimin e dy krahinave kufitare, pasi me qëndresën e tyre po shkaktonin shkatërrimin e Perandorisë Osmane, por as lutjet, as kërcënimet nuk dhanë rezultat. Më 15 dhjetor 1879 u mbledh në Guci Kuvendi i përfaqësuesve të Komitetit Ndërkrahinor të Kosovës, i cili vendosi që ta kundërshtonte me armë deri në fund dorëzimin e kalasë së Gucisë. “Ne, banorët e Plavës e të Gucisë, - thuhej në memorandumun e miratuar nga Kuvendi, - nuk i njohim traktatet e shteteve evropiane që u japin malazezëve tokat e trashëguara nga prindërit tanë. Ne do ta kundërshtojmë me armë dorëzimin e tokave tona”.

Sipas porosisë që kishte dhënë Porta e Lartë, Ahmet Muhtar pasha mori masa ushtarake për të penguar vajtjen e vullnetarëve shqiptarë në Plavë e në Guci. Për këtë qëllim ai solli nga Mitrovica edhe 7 batalione të tjera, të cilat i vendosi nëpër shtigjet e rrugëve. Pas kësaj u nis për në Gjakovë, ku gjeti një gjendje më të acaruar se në Prizren. Gjakovarët e paralajmëruan se, po ta vazhdonte më tej rrugën drejt kufirit, do të pësonte fatin e Mehmet Ali pashë Maxharit. Kur pa se edhe Peja e kishte bllokuar rrugën për në Plavë e në Guci, mareshali osman e ndërpreu misionin e vet, hoqi dorë nga vajtja në Guci dhe u kthye në Prizren. Dështimi i misionit të Ahmet Muhtar pashës e bindi përfundimisht knjaz Nikollën të mos shpresonte më as të ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha. Si rrjedhim, ai vendosi të ndërmernte kundër forcave të Lidhjes Shqiptare një mësymje të përgjithshme, e cila u zhvillua javën e parë të muajit janar 1880.

Në këtë mësymje u hodh pothuajse e gjithë ushtria malazeze, 25 batalione me rreth 9 mijë veta, që u rreshtuan përballë Plavës e Gucisë.

Sapo u njoftua për përgatitjet ushtarake të Cetinës, Shtabi Ushtarak Shqiptar i përforcoi masat mbrojtëse. Me thirrjen e Lidhjes Shqiptare u mobilizuan mijëra vullnetarë nga e gjitha Shqipëria, nga Plava, Gucia, Peja, Prizreni, Gjakova, Shkodra, Dibra dhe nga krahinat më të largëta të Shqipërisë së Jugut. Por shtabi ushtarak i kryesuar nga Ali pashë Gucia, që mori vetë në dorë drejtimin e operacioneve luftarake, përqendroi në zonën kufitare me Plavën e Gucinë 4 mijë luftëtarë vendas dhe 3 mijë vullnetarë të tjerë, gjithsej 7 mijë veta.

Komanda malazeze kishte rreshtuar në vijën e parë të frontit forcat vullnetare të komanduara nga Mark Milani, të cilët do të fillonin sulmin sipas taktikës së tyre tradicionale që kishte pasur kurdoherë sukses përballë ushtrive osmane. Forcat malazeze ishin përqendruar në një sektor të ngushtë (Velikë-Pepaj), me qëllim që t'i shpartallonin shqiptarët që me sulmin e parë, në drejtim të Plavës. Por Shtabi Ushtarak Shqiptar ua mori malazezëve në mënyrë të papritur iniciativën. Më 6 dhe 7 janar 1880 njësi të vogla shqiptarësh, me qëllim që të tërhiqnin vëmendjen e komandës ushtarake malazeze, ndërmorën dy sulme në verilindje të Malit të Zi, nga ana e sanxhakut të Novi Pazarit. Komanda ushtarake malazeze, duke kujtuar se shqiptarët do të vazhdonin të sulmonin nga verilindja, për t'u dalë forcave të tyre prapa shpine e tërhoqi ushtrinë nga zona jugore dhe e nisi drejt veriut. Duke përfituar nga kjo rrethanë, forcat shqiptare, të rreshtuara në sektorin e Plavës, shpërthyen më 8 janar një sulm të furishëm kundër pozitave të armikut që ndodhej në Velikë, në Pepaj e në Arzhanicë.

Sulmin e nisën luftëtarët e Nokshiqit të komanduara nga Kurt Asllani dhe Nure Kurti. Mësymja ishte e furishme dhe pas luftimesh të ashpra e trup më trup forcat malazeze, të përbëra nga 4 mijë luftëtarë, u detyruan të tërhiqeshin. Ushtritë e Lidhjes, pasi thyen edhe njësitë malazeze të komanduara nga Mark Milani, hynë në tokën malazeze, shtinë në dorë Arzhanicën,

Velikën e Pepajt dhe u drejtuan për në Murinë. Luftimet më të përgjakshme u bënë në Velikë e në Pepaj, prandaj përpjekja e 8 janarit mori emrin e tyre. Ushtria malazeze u tërhoq në Sutjeskë. Por Shtabi Shqiptar nuk kishte ndërmend të vazhdonte përparimin në thellësi të tokës së Malit të Zi. Më 9 janar ai urdhëroi forcat shqiptare, që nuk hasën ndonjë kundërshtim nga ushtritë malazeze, të tërhiqeshin në kufirin e vjetër.

Gjatë betejës së Pepajt e të Velikës, të dyja palët patën dëme në njerëz, por, sipas të dhënave të ndryshme, ato të Malit të Zi qenë më të shumta. Shqiptarët lanë në këto luftime edhe dy kapedanët trima, Kurt Asllanin e Nure Kurtin.

Vrulli patriotik që përshkoi luftën në Velikë e në Pepaj dhe fitorja që shqiptarët korrën kundër ushtrive malazeze më 8 janar 1880, la përshtypje të thellë në opinionin ndërkombëtar. Disa ditë më vonë, kryekonsulli austro-hungarez në Shkodër, Shmuker, i cili e ndoqi së afërmi zhvillimin e betejës, i raportonte qeverisë së vet: “Vetë malazetët pohojnë se në luftën e Velikës e të Pepajt shqiptarët luftuan burrërisht dhe fituan mbi ta. Dhe me të vërtetë, fuqia e Lidhjes (së Prizrenit - shën. i aut.) e theu atë ushtri malazeze që ka qenë kurdoherë e zonja t’u bëjë ballë forcave turke. Shqiptarët luftuan të shtyrë nga ideja kombëtare”. Pas kësaj, opinionin publik evropian filloi të interesohet për historinë e popullit shqiptar dhe për të drejtat e tij kombëtare. Veç kësaj, disa publicistë kritikuan Kongresin e Berlinit që nuk i kishte përfillur të drejtat e një kombi aq trim dhe aq liridashës, siç ishte populli shqiptar.

Me fitoren që korrën në Nokshiq, në Pepaj e në Velikë shqiptarët i dhanë të kuptonte diplomacisë evropiane se Perandoria Osmane, sado që po e mbante Shqipërinë prej pesë shekujsh nën zgjedhë, nuk ishte zonjë e trojeve të saj dhe se zotër të këtyre trojeve ishin banorët shqiptarë. Disfata që pësoi në front e bindi qeverinë malazeze se ajo vetë nuk ishte në gjendje ta thyente qëndresën e Lidhjes Shqiptare me anën e luftës së armatosur. Për këtë arsye knjaz Nikolla shpalli menjëherë se i kishte pezulluar veprimet luftarake në kufi dhe se zbatimin e Traktatit të Berlinit në këtë pikë po ua linte përsëri

në dorë Fuqive të Mëdha. Madje ai kërkoi nga konsulli britanik në Shkodër që të ndërhynte pranë autoriteteve qeveritare të vilajetit, me qëllim që edhe shqiptarët t'i pezullonin veprimet e mëtejshme luftarake!

Botuar në: <http://lajme.dervina.com/?sherbimi=lajme&lajmi=5135-1062:953>

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe rëndësia e infrastrukturës logjistike për luftë

Shkencëtari Oliver Smith thotë: “Shkenca është marrë deri më tash në mënyrë intensive me betejat e veçanta të Skënderbeut. Por studime moderne për historinë e luftës evropiane tregojnë se beteja gjendet në fund të një zinxhiri të gjatë procesesh, të cilët janë shumë më të rëndësishëm se konfrontimi ushtarak. Edhe prijësi më i shquar nuk e fiton betejën pa suitë, e cila nuk është e ushqyer, e pajisur dhe e paguar mirë. Dhe këto detyra ia dha vetes edhe Skënderbeu. Se si i kapërceu ai ato vështirësi, do të paraqitet në vijim mbi bazë materiale kryesisht të reja arkivore nga Venediku, Dubrovniku dhe Milano.

Skënderbeu e filloi luftën si komandant i një lige fisnikësh. Por shpejt doli në shesh se Arianitët, Muzakët dhe, pos të tjerash, Dukagjinasit nuk ishin gati t’i nënshtroheshin Skënderbeut.

Nga kujtimet e Gjon Muzakës kuptohet mirë arsyeja: familjet e vjetra nuk i shikonin Kastriotët si të barasvlershëm dhe secili bënte një politikë të jashtme më vete. Për atë prezantohej Skënderbeu fillimisht si Balsha i ri: ai desh të përfitonte nga nami i princit të famshëm të Shqipërisë së Veriut, Balsha III, për t’u profiluar kundër familjeve të vjetra. Por prapë u bë shpejt e qartë se Skënderbeu nuk mund të mbështetej te fisnikëria shqiptare, përkundrazi Balshajt në Shqipërinë e Mesme ai i detyroi në ekzil; Muzakajt humbën pas betejës së Beratit më 1455 çdo rëndësi; Arianitët nuk mundën të mbanin zonën e tyre të eksponuar në

jug; dhe Lekë Dukagjini u bë rival i rrezikshëm, i cili edhe në Itali gëzonte nam të madh.

Sikur Skënderbeu t'i besonte vetëm fisnikërisë, atëherë ai shumë shpejt do t'u nënshtrohej osmanëve. Në burime, të kapshëm bëhen ata burra, që zëvendësonin Skënderbeun jashtë Shqipërisë. Aty vërehen dy grupe. Së pari, do përmendur zëvendësit e Kishës katolike të Shqipërisë. Rëndësia e tyre nuk mund të mbivlerësohet aspak. Qysh mes viteve 1446 dhe 1450 ndërmerren abat Llazari legata të rëndësishme në Romë, Napoli dhe Burgund. Më 1447 udhëton abat Pjetri, një i afërm i Skënderbeut, për në Napoli ipeshkvi Andrea Summa nga Albanum është më 1448 në Dubrovnik, ipeshkvi Stefani nga Kruja gjendet tre vjet më vonë në Napoli. Nuk duhen harruar rregulltarët: dominikani Nicolaus Begruzzi ose një françeskan, që udhëtoi më 1466 për në Napoli. Së shpejti ngrihet abati nga Roteza, Georg Pellinus, si figurë e rëndësishme në diplomacinë e Skënderbeut; deri më 1463 udhëton ai pa mundim nëpër oborret italiane. Prej vitit 1460 e merr në dorë iniciativën figura më e rëndësishme e Kishës katolike e mesjetës së vonshme në Shqipëri, Pal Engjëlli, nga Qrivasto, argjipeshkëv i Durrësit. Ai nuk përcjell vetëm legata për në Napoli, Milano, Romë dhe Venedik; por ai është edhe një figurë e rëndësishme në parapërgatitjet e kryqëzatës së Pius II. Përkrenaren e famshme të Skënderbeut duhet ta ketë porositur ai përkrenarja është një kopje e përpiktë e përkrenares së Aleksandrit të Madh. Pal Engjëlli mori premtimin nga Papa Piu II si kompensim për pjesëmarrjen e Skënderbeut në kryqëzatë, se do të kurorëzonte Skënderbeun. Arqipeshkvi i Durrësit desh ta prezantonte monarkun e ri në gjuhën politike të Evropës së Renesancës, dhe kjo gjuhë politike ishte e ndikuar krejtësisht prej Antikës. Kështu planifikonte Kisha katolike e Shqipërisë t'i prezantojë opinionit evropian Skënderbeun si Aleksandër të Madh, që do të dëbonte osmanët nga Evropa. Pal Engjëlli udhëhiqte jo vetëm politikën e jashtme të Skënderbeut, por e bënte edhe Atleti Christ-in në traditën e kryqëzatave të mesjetës një princ renesance.

Pranë rolit të shkëlqyeshëm të klerikëve, duken laikët pak të zbehur. Por edhe ata kanë luajtur rol të rëndësishëm. Kështu

p.sh. Ninac-i, udhëheqës i sekretarisë së Skënderbeut; Petrus Smachi, protonoter i Krujës; Çelnik Rajani; Francesco Maramonte, i cili zëvendësoi Skënderbeun më 1456 në Milano; Esopus Sgurus, legat në Napoli më 1453; kabrësi Martin Musachi, i cili udhëtoi prej në Napoli nëpër Romë deri në Burgund. Një rol kyç luan familja Gazuli, përmes të cilit kalonin kontakte të rëndësishme të Skënderbeut për në Dubrovnik. Kalorësi Pal Gazuli merrej me zhvendosje parash, ashtu dhe me legata për në Napoli, Romë dhe Burgund; astronomi i njohur Johannes Gazuli kujdesej për çështje financash dhe krijonte kontakte me Hungarinë; ai mendohej t'i sqarojë Republikës së Dubrovnikut më 1455, pse e zgjeroi Skënderbeu Kepin e Rodonit në kështjellë; ai administronte para të rëndësishme të kryqëzatave, të cilat Dubrovniku, duhej t'ia kalonte Skënderbeut; ai siguronte armë (1454) dhe një zift-punues për ndërtimin e një anijeje (1455). Familja Gazuli i siguronte pra Skënderbeut para dhe teknologji lufte.

Rrethit të ngushtë i takonte edhe familja patrice Gongola Gunduliq nga Dubrovniku, veçanërisht Paul, Michael dhe Paladino de Gongola, të cilët merrnin përsipër legata për Skënderbeun, rekrutnin specialistë për konstruksion anijesh dhe kështjellash në Rodon dhe vepronin si të autorizuar të Skënderbeut në Dubrovnik. Gondolasit u shfaqën si prominentë, kur Skënderbeu vizitoi Dubrovnikun; dhe nuk do të habiste fakti, se ata kultivonin kontakte tregtare me Shqipërinë: 1464 blejnë Junius, Paladino dhe Paul de Gongola me shumën e madhe prej 1450 dukatesh drithë në zonën e sundimit të Skënderbeut. Kontakte të ngushta me Skënderbeun mbanin edhe familjet Bona dhe Poza/Pucic. Klerikët, shqiptarët në Dubrovnik dhe patricët dubrovnikas bënë pjesë në rrethin më të ngushtë të Skënderbeut; përkundër fisnikërisë shqiptare, lojaliteti i tyre për Skënderbeun ishte i qartë. Ishte ky rrjeti personel, kjo suitë, e cila në mënyrë jospektakulare, por shumë efektive dhe vendimtare u kujdes për logjistikën e luftërave të Skënderbeut. Afër suitës së tij të ngushtë Skënderbeu kultivonte kontakte të jashtme intensive dhe të hulumtuara mirë. Në një fazë të parë ai u përqendrua te fqinjët e tij joshqiptarë në Evropën Juglindore:

me mbretin boshnjak, Duka Stefan Vukçiq në Hercegovinë, me Stefan Crnojeviq në Mal të Zi dhe për një farë kohe edhe me despotin serb George Brankoviç. Edhe më me rëndësi ishin kontaktet e tij në Hungari, me Gjon Hunjadin, më vonë edhe me Mattias Corvinus.

Shumë herët vendosi Skënderbeu të ndërkombëtarizojë luftën kundër osmanëve, me anë të aleancave me fqinjët e tij ballkanas, por pastaj edhe me anë të lidhjeve të ngushta me shtetet italiane. Këto kontakte të jashtëm shërbenin parimisht për dy qëllime: sigurimi i parave dhe i teknologjisë luftarake. Këto të dyja mungonin në territorin e tij. Burim të ardhurash kryesore ai kishte eksportin e drithit dhe të drurit. Ky ndodhej kryesisht në duar të tregtarëve nga Dubrovniku, por edhe të venedikasve. Një burim tjetër të ardhurash ofronte dhënia me qira e doganave po ashtu të investuesve të huaj: këto qira garantonin të ardhura afatgjate.

Duke marrë parasysh jostabilitetin politik, investimi për tregtarët nuk ishte aspak i sigurt; por me sa duket fitimi ishte shumë premtues. Më 1464 gjendet madje edhe një tregtar nga Milano si qiraxhi dogane. Po ashtu Skënderbeu u garantonte investuesve një sigurim të lartë ligjor, këtë e dëshmojnë burimet e pabotuara nga Dubrovniku: kështu, më 1465, një tregtar nga Dubrovniku iu nënshtrua me dëshirën e vetë gjyqësorisë së Skënderbeut e jo asaj të qytetit të tij.

Tregtia kalonte zakonisht nëpër portin e vogël të Shufadës. Skënder-beu, në të vërtetë një bir malesh, kuptoi rëndësinë e detit sa vinte e më shumë: ai e zhvendosi pikëqëndrimin e pushtetit të tij në bregdet. Jo Kruja, por Rodoni ishte kështjella e tij kryesore; sepse prej këtu ai bënte kontakte në Itali, në bregdet ai merrte armë dhe para. Afër Rodonit luante edhe Lezha, me një rol të njëjtë kryesor; Lezha lidhte bregdetin me botën mallore, Lezha ishte për dukagjinast dhe për Skënderbeun portë e vërtetë për në Itali. Qyteti administrohej prej Venedikut, por nuk mund dhe aq të kontrollohej, si Durrësi i shtrirë mu afër detit. Qyteti mund, pra, të quhet si zonë kontakti mes botës së fisnikërisë shqiptare dhe Adriatikut. Skënderbeu këtë e mori parasysh, duke u munduar t'i largohej varësisë me Venedikun,

nëpërmjet të komunikimit me Italinë; por për këtë atij i duheshin anije, ku punësoi mjeshtër ndërtimi anijesh nga Dubrovniku dhe luti edhe Venedikun, t'i verë anije në dispozicion dhe këtë edhe pse ai vetë, siç informon një burim venedikas, detin nuk e pëlqente. Mungesa e një flote luftarake, por edhe e anijeve tregtare u tregua për kohë të gjatë si mangësi Skënderbeu merrote anije me qira nga Dubrovniku, dhe për një kohë të caktuar vende edhe Venediku anije në dispozicion; por kjo qe një zgjidhje e përkohshme.

Për këtë ishin lidhjet e tij me Dubrovnikun edhe më të rëndësishme, i cili si shtet neutral ofronte përkrahje.

Është më lehtë të marrësh para, se sa t'i administrosh ato: këtu u tregua Skënderbeu si organizator i aftë, i cili përdorte metodat e atëhershme moderne të biznesit bankar. Dubrovniku ishte për këtë disk rrotullues vendimtar, sepse aty kishin filialet e tyre edhe banka nga Firenze, kështu p.sh. (për shembull) godina e bankës Albizzi dhe Strozzi, zëvendësi i të cilëve, Berto Belfradelli, në Shqipëri blinte dru dhe e eksportonte për në Apuli; një florencez tjetër, Forco Pauli de Beuzi bënte tregti me drithë shqiptar. Më 1458 gjejmë Celik Rajan-in në Dubrovnik, i cili thyen një çek të bakës Pazzi Si princat e tjerë ballkanas, ashtu edhe Skënderbeu mbante një depozitim te banka e Republikës së Dubrovnikut; Pal Gazuli dhe Rajani i përmendur tërhiqnin prej aty para. Rëndësia e metodave financiare moderne nuk mund të çmohet kurrë sa duhet. Se cilën sasi kishin të ardhurat e Skënderbeut nga eksporti dhe qiratë doganore, as nuk mund të hamendësohet. E qartë është, se ajo nuk mjaftonte për financimin e luftës. Përkrahjet sidomos të shteteve italiane merrnin për këtë një rëndësi të madhe. Këtu u tregua shteti kishtar shumë herët si shtyllë e rëndësishme; Venediku premtoi para të rregullta vjetore, por të cilat për shkak të konflikteve mes guvernatorëve venedikas dhe Skënderbeut nuk u paguan rregullisht. Sidomos në fazën e fundit të jetës së tij Skënderbeu ishte urgjentisht i varur prej pagave ndihmëse nga Italia. Një pyetje tjetër janë ndihmat në formë furnizimi me drithë. Menjëherë pas fillimit të kryengritjes mudohej Skënderbeu të kontrollojë burimet bujqësore të Shqipërisë së Veriut. Kjo ishte arsyeja për luftën e tij

kundër Venedikut. Jo vetëm Venediku, por edhe Dukagjinasi e bllokoni ekspansionin e Skënderbeut për në veri. Puna ishte te drithi, te kripa dhe te vërrini për bagëtinë, burim i rëndësishëm ekzistencial. Por edhe dalja në det te Lezha dhe kontrolli mbi rrugët tregtare për në Prizren ishin të rëndësishme: Skënderbeu e humbi këtë konflikt. Baza e tij ekonomike mbeti e kufizuar me Shqipërinë e Mesme. Në vite të qeta ai mundi prej këtu të eksportonte drithë. Por gjatë sulmeve osmane, veçanërisht në vitet 1446 dhe 1467, korrjet u dëmtuan. Sidomos kah fundi i jetës së tij, Skënderbeu ishte i varur nga importi i drithit nga Apulia: më 1466 ai luti Papën urgjentisht të mos dërgojë trupa, sepse Shqipëria e grabitur prej osmanëve nuk mund t'i ushqente as banorët e saj: strategjia e tokës së djegur e Mehmetit II kishte qenë pra e suksesshme.

I qartë është fakti se Shqipëria e Mesme për kohë të gjatë kishte bazë shumë të dobët demografike dhe ekonomike për luftën kundër osmanëve.

Skënderbeu mundi t'u bënte rezistencë një çerekshekull osmanëve, sepse ai ishte një prijës ushtrie i talentuar, por më së shumti, sepse ai e kuptoi rëndësinë e infrastrukturës logjistike për udhëheqje të luftës. Për të minimizuar ndikimin e fisnikërisë shqiptare, ai mbështetej mbi një suitë jofisnike, por lojale, e cila, pos të tjerash, përbëhej prej klerikëve të Kishës katolike dhe një grupi të vogël laikësh në rrethin e sekretarisë së tij. Këta burra krijuan kontakte të rëndësishme për të mbijetuar me fqinjët e krishterë në Evropën Juglindore dhe Perëndimore. Së dyti, Skënderbeu përdorte teknikat financiare bashkëkohore për të financuar blerjen e armëve dhe teknologjinë e luftës.

Vendi financiar - Dubrovniku - luante aty një rol vendimtar. Struktura fleksibile e pushtetit të tij, mobiliteti i suitës drejtpeshoi superioritetin sasior të osmanëve për shumë vite. Nuk ishin betejat spektakulare, por organizimi i strukturave sunduese, të cilat na japin sqarime thelbësore për mbijetesën e Skënderbeut.

Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët

Adolf Thierès, ish-president i Francës, shkruan: Vëllai i madh i Bonapartit në 1806 pohon se familja e tij ishte arbëreshe. Kishte miqësi me Ali Pashë Tepelenën .

Për ne, shqiptarët, nuk ka rëndësi sa qëndron në këmbë teza e qenies me origjinë arbëreshe të familjes së Napoleon Bonapartit.

Për ne, ka rëndësi konsiderata që kanë të huajt për të shfaqur heronjtë e tyre me origjinë shqiptare. E kemi për detyrë që këtë “konsideratë të mirë” ta mbajmë.

Kjo për ne meriton përgëzim. Në studime e punime të ndryshme me vlerë historike ose në relacione e kronika ngjarjesh, historianë të huaj dhe personalitete politike e shoqërore, kanë dhënë gjatë shekujve mendime të shumta për popullin tonë, për shpirtin lirishtës dhe atdhetar të tij. Në këta autorë rreshtohet edhe personaliteti i shquar i kohës, historiani i dëgjuar francez Adolf Thierès, që ka shkruar dhe historinë e revolucionit francez dhe që më vonë u bë President i Francës.

Prejardhja arbëreshe

Në kujtimet e tij, që pasqyrohen në librin e Ahmet Myftit bej Libohovës, “Tependli Ali Pasha”, botuar në Kajro më 1903, Adolf Thierès shkruan: “Kur Josef Bonaparti, vëllai i madh i Napoleon Bonapartit u bë mbret i Napolit më 1806, shqiptarëve të Napolit, që shkuan për t’i uruar mirëseardhjen u tha: “Edhe

familja Bonaparti është me origjinë arbëreshe”.

Ahmet Myfit Libohova, në veprën e tij lidhur me këto shpjegime të Adolf Thiersit shton: “Sipas hetimeve të bëra del se është e vërtetë që mbiemri Kallomeri, që do të thotë në greqisht “anë e mirë”, që u ndërrua në italisht “buona parte” është mbiemri i Napoleon Bonapartit.

Kjo familje shqiptare, me shumë atdhetarë të tjerë u vendosën në Korsikë, formuan një fshat dhe gjithashtu është fakt se paraardhësi i Napoleon Bonapartit është prej këtij fshati arbëresh”. Këto shpjegime i jep në librin e tij Libohova.

Mbi origjinën e familjes Bonaparti na hedh dritë të mjaftueshme dhe profesor Robert d’Angely me origjinë nga Korsika në veprën e tij “Enigmat e origjinës së racave dhe të gjuhëve të pellazgëve, arianëve, helenëve, etruskëve, grekëve dhe shqiptarëve”.

Libër prej shtatë vëllimesh dhe mbi 30 vjet punë

Në faqen 113-117 shkruan se Napoleon Bonaparti ishte shqiptar, ashtu si ishte Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu.

Ky profesor i dëgjuar korsikan shton se mbiemrin i vjetër i Bonapartit ka qenë “Kalimiri” dhe jo Kalimeros ‘ana e mirë’ siç e bënë grekët. Sipas enciklopedisë së madhe greke “Piros”, vëllimi i tretë, Athinë 1929, faqe 413-425, thuhet: “Shtrirja e shqiptarëve në drejtim të Peloponezit (Moresë) është zgjeruar nga shekulli XIV.

Enciklopedia greke

Sipas kësaj enciklopedie, në Peloponez u krijuan krahina banimi të reja si: Mani, Bardhunja, Lala; Filati, Hekali, Lopësi. Edhe sot dihet që një lagje e Himarës është shpërngulur në krahinën e Peloponezit dhe krijuan Manin.

Shqiptarët qëndruan në Peloponez (në More) midis 100 vjet rreth vendasve grekë dhe nuk duhet të na duket çudi në qoftë se mbiemri i Napoleonit (Kalë-mirë) është greqizuar sh-trembërisht nga grekët në kallomeros ‘ana e mirë’.

Bëni dhe krahasimin që i bëjnë grekët kalit të Lekës së

Madh(Aleksandrit të Madh) që e quajtën Kokëmadh.

Me zbritjen e vazhdueshme të ushtrive të panumërta osmane në Peloponez, një pjesë e shqiptarëve u largua nëpërmjet detit drejt Italisë së Jugut.

Ata u shpërndanë dhe në ishujt e saj arritën deri në Korsikë, ku u përzier me banorët e lashtë italianë. Atje ndërtuan dhe vendbanimet e tyre. Nuk duhet të duket çudi në qoftë se stërgjyshi i Napoleon Bonapartit (sipas shpjegimeve që i jep ish-presidenti francez, Adolf Thiers) të jetë me origjinë nga ky fshat arbëresh i Korsikës.

Dihet historikisht se edhe avokati i dëgjuar korsikan, mbrojtës i Gjorgje Dimitrovit, në gjyqin e Laipçigut, De Moro Xhaferi ka qenë nga ky katund arbëresh.

Kjo faktohet nga vetë goja e tij, kur iu përgjigj jurisë franceze: “Unë do të shkoj në Laipçig dhe do të mbroj Gjorgje Dimitrovin. Në qoftë se do të më vrasin, haku do të më merret si arbëresh që jam me origjinë”.

Studiuesi, zoti Auron Tare, shpjegon: në vijim të artikullit “ish-presidenti i Francës, Adolf Thiers”: “Napoleon Buonaparti është arbëresh”.

Të shkruara nga zoti Mexhit Kokalari do të doja të shtoja disa fakte mjaft interesante, të cilat i japin nuanca prejardhjes së një prej kolosëve të historisë botërore, gjeneralit Bonaparti.

Prejardhja e familjes Buonaparte nga krahina e Peloponezitet të Greqisë dhe më saktë nga zona malore e Manit, e banuar kryesisht nga familje arbëreshe të shpërngulura nga zonat shqiptare me ardhjen e turqve është përmendur nga disa personalitete të letrave të kulturës franceze.

Por, dëshmia më interesante vjen nga një aristokrate franceze me origjinë maniote, dukeshja D’Abrantes, lindur në Montpelje me emrin Josephine Permon Stefanopuli de Comene.

Ajo vinte nga një familje me origjinë maniote, e cila për shkak të gjakmarrjeve të shumta me klanet e fuqishme të Manit, vendosi të shpërngulej dhe të vendosej në Korsikë, ashtu si shumë familje të tjera nga Mani, 150 vjet para periudhës së Napoleonit.

Dukeshja D’Abrantes e njihte mjaft mirë gjeneralin Bona-

parti. Ajo bënte pjesë në rrethin e ngushtë të tij, jo pse ishte martuar me një nga gjeneralët më besnikë të Napoleonit, Junotin, por edhe sepse e ëma e saj kishte qenë një kohë të gjatë e dashura e Buonapartit dhe e kishte ndihmuar atë në kohë të vështira të sundimit të tij në Paris.

Dukesha D'Abrantes, e cila më vonë u bë një mbështetëse e flaktë e rojalistëve, ishte ndoshta burimi më i informuar për jetën e gjeneralit në atë kohë, në kujtimet e saj të përmbledhura në 28 vëllime, me titull "Revolucioni, Perandoria dhe restaurimi", ajo formuloi teorinë e pranuar nga historianët e kohës të prejardhjes korsikano-maniote të familjes Bonaparti.

Ishte ajo, e cila deklaroi se mbiemri Bonaparti ishte një italianizim i fjalës greke kalimeros dhe se Bonaparti nuk ishte nga Trevizo, por nga Mani. Gjithashtu, ajo përmend një fakt tjetër mjaft interesant. Gjatë fushatës së Italisë, gjenerali papritmas vizitohet nga dy të dërguar nga beu i Mani. Ky i fundit, duke i kujtuar Napoleonit prejardhjen e tij, i lutej për ndihmë, duke i ofruar gjeneralit mbështetje të plotë të trevës së Peloponezitet, në rast të një sulmi francez në Greqi kundër turqve.

Napoleoni, i cili në atë kohë seriozisht po mendonte për një sulm kundër Perandorisë Otomane në Evropë, ndihma e sundimitarit të së vetmes zonë të lirë në Greqi, ishte mjaft joshëse.

Një lidhje ideale midis Francës dhe Manit

Kështu, i shtyrë dhe nga sentimentalizmi për origjinën e familjes së tij, më 12 termidor të vitit V, ai dha urdhër nga kuarteri i tij në Milano, që Dimo Stephanopuli dhe vëllai i tij, Nikola, të udhëtonin për në Mani.

Të dy vëllezërit Stephanopuli u pritën me mjaft bujë nga Zanet Beu, Beu i Manit, dhe udhëheqësit e tjerë maniotë. Ata qëndruan për disa muaj në këtë krahinë kryengritëse, duke marrë pjesë edhe në një betejë detare kundër flotës së Kapidan Pashës.

Vëllezërit Stephanopulis, gjatë kthimit të tyre në Francë, i sollën gjeneralit besimin e Beut të Manit për besnikëri dhe një

statujë antike, dhuratë nga Zanet Beu, por, gjatë mungesës së tyre, Napoleoni e kishte ndryshuar politikën rreth çështjes turke. Kështu u mbyll kapitulli interesant i gjeneralit me Manin.

Këto dy fakte interesante, që flasin për lidhjet e Napoleonit me Manin, janë përforcuese. Dukeshja D' Abrantes është burim i sugurt, po të marrim parasysh që tezat e saj ishin pranuar nga historianët e kohës.

Gjithashtu, fakt tjetër është që, derisa ishte gjallë gjenerali, nuk e përgënjeshtroi tezën e dukeshës për origjinën e tij, mund të ketë qenë nga zona malore e Manit.

Shqipja dhe Napoleoni

Në qoftë se pranohen shpjegimet e personalitetit të shquar politik dhe historiani francez Adolf Thiers, lind pyetja: Napoleon Bonaparti, a e njihte gjuhën shqipe. Këtë nuk mund ta dimë, pasi nuk kemi dokumente.

Sipas profesorit, lingvistit të shquar Eqerem Çabej: Një nga gjeneralët më besnikë të Napoleon Bonapartit, ka qenë edhe mareshalli Ney; gjeneral me trup të lartë, që në gjatësi ia kalonte shumë Napoleonit. Thuhet se, kur e qortonte Napoleoni Neyn, do t'ja shkurtonte ndryshimin që kishte në trup me të. Këto fjalë, ai i shoqëronte dhe me disa sharje të një gjuhe të huaj, që mareshal Ney dhe shokët nuk e kuptonin.

Cila ishte kjo gjuhë? Për përgjigjen e kësaj pyetjeje mund t' i referoheni edhe veprës së Leo Freundrich, "Gologota Shqiptare", në faqen 37.

Edhe një tjetër pyetje e bren kureshtjen tonë. A e njihte Napoleon Bonaparti historinë e Shqipërisë? Edhe kjo mbetet enigmë për mungesë të dokumenteve.

Megjithëse në hartat topografike, ushtarake të tij, trevat tokësore që shtriheshin qysh nga Sllovenia deri në Detin Jon, i kishte quajtur "Iliri".

Është fakt, që edhe sot në Slloveni, duke u nisur nga ky emërtim i tokave të tyre, sllovenët, mjaft hotele dhe rrugë i kanë emërtuar me fjalën "Iliri", si në Lubjanë etj.

Logjike është të pyetet se a e dinte Napoleon Bonaparti

që shqiptarët kishin zakone të përbashkëta me korsikanët? Kjo nuk mund ta dihet me siguri, megjithatë ka argumente që çojnë në këtë drejtim, sepse nga të dhënat e mbledhura, thuhet se ky perandor i lindur në Korsikë, konkretisht në Ajaccio, e ka ditur se shqiptarët dhe korsikanët kanë zakone të përbashkëta në lidhje me besën, hakmarrjen, mikëpritjen etj. Po të kujtojmë “Vendetta”, Balzak-Mateo Falkoni-Prosper Merime, apo dhe filmin “Barbaxhia” duken të gjasshme këto që po themi.

Buonaparti: Ruhuni nga Ali Pashai –Tepelena

Njëkohësisht, për të mbrojtur përfaqësuesit e tij, si Pukëvilin e të tjerë, në shtetin autonom të pashallëkut shqiptar të Janinës së Ali Pashë Tepelenës, nuk ishin të rastit këshillimet e vazhdueshme që Napoleon Bonaparti i jepte konsullit të vet që të ruhej nga dinakëritë e Aliut, duke i thënë: “Ruaju, edhe në qoftë se nuk ta ka hedhur”.

Si shpjegohen masakrat që kanë kryer forcat franceze në Egjipt, ku midis të masakruarve ka pasur edhe shqiptarë?

Sipas shpjegimeve të profesor Petraq Pepos, historian i njohur, lidhur me ekspeditën e ushtarakëve të gjeneral Napoleonit në Egjipt, mësohet se ushtarët francezë kanë zhvilluar luftime të përgjakshme me vendësit, sidomos në Tabor, gjatë pranverës së vitit 1799.

Gjithashtu, beteja të përgjakshme janë zhvilluar edhe në ujërat territoriale të Egjiptit, si për shembull në afërsi të Abukirit etj. Atje, forcat detare franceze, të komanduara nga admirali Brueys, u ndeshën rreptazi me forcat detare angleze të komanduara nga admirali i dëgjuar Orcio Nelson.

Në të gjitha këto luftime detare u vra dhe admirali francez Brueys. Edhe në luftimet tokësore, francezët pësuan humbje të mëdha në ushtarë, sepse nuk ishin mësuar me terrene të tilla afrikane. Atje u vra edhe gjenerali i dalluar Kleber.

Forcat ushtarake franceze, të egërsuara, me në krye gjeneralin Andreossi, kërkonin me këmbëngulje të arrinin fitoren, duke mos druajtur kështu edhe masakrat masive.

Midis ushtarëve vendës për mbrojtjen e Egjiptit, ka pasur

edhe mjaft luftëtarë shqiptarë, që vazhdonin t'i mbronin me trimëri kështjellat që u ishin besuar.

Komanda ushtarake franceze, me në krye Andreossin, në pamundësi për t'i hedhur në dorë kështjellat me forcën e armëve, u premtoi të rrethuarve, luftëtarëve shqiptarë, si të huaj që ishin, se do t'i linin të lirë të largoheshin së bashku me armët e tyre, mjaft që ata të dorëzonin kështjellat.

Shqiptarët e besuan një gjë të tillë dhe dolën kështu nga kështjellat të armatosur, por gjeneral Andreossi, i preu në besë, i çarmatosi rrugës dhe një pjesë të mirë të tyre e pushkatoi në deltën e Nilit.

Thuhet se Napoleon Bonaparti, kur u vu në dijeni, e dënoi pabesinë e gjeneralit të tij, dhe e përkufizonte këtë fitore me masakër me këto fjalë: "Ushtari francez nuk është mësuar të korrë fitoren mbi kundërshtarët, duke i mashtruar dhe çarmatosur në befasi". Njëkohësisht, këtij gjenerali i mori edhe medaljonin prej gurësh të çmuar që vetë ja kishte dhënë.

Napoleon Bonaparti, me gjithë marrëveshjet e ftohta që kishte me Ali Pashë Tepelenën, më vonë u lidh me një miqësi të ngushtë me të.

Ky perandor i Francës, në kundërshtim me dëshirat e Stambollit, dërgoi në Janinë konsujt e tij. Këtë qytet e quante kryeqytetin e Shqipërisë.

Napoleoni ishte nga të parët që e kuptoi se Ali Pashë Tepelena, çdo ditë e më shumë e largonte pashallëkun e tij nga influenza e Sulltanit, duke e kthyer atë në një shtet autonom shqiptar.

Aliu, sytë ia kishte drejtuar Evropës. Ai pranoi të zbatohet në shtetin e tij legjislacioni frëng, i barazimit, ku myslimanët të kishin të drejta të barabarta me të krishterët.

Franca dërgoi tek Ali Pasha Tepelena specialistë për organizimin e shtetit dhe të ushtrisë, e cila u zgjerua në kohë lufte deri në pesëdhjetë mijë ushtarë.

Napoleoni në Janinë ngriti fonderi për derdhje topash të çdo kalibri, armë të ndryshme si dhe punishte për prodhim baruti.

Franca e pajisi Aliun me anije luftime, organizoi mjetet e komunikacionit dhe rendin me organizatorë të tij. Në pashallëkun e Janinës kudo u vendos qetësia.

Lidhur me miqësinë familjare që ka pasur Napoleon Bonaparti me atë të Ali Pashë Tepelenës, përveç të dhënave gojore, na konkretizohen dhe me orenditë shtëpiake që kemi gjetur në banesën e Myfit Bej Libohovës, konkretisht një servis çaji dhe kafeje, servis blu me germën initiale “N” të Napoleon Bonapartit, si dhe dy piktura me bojë vaji të Ali Pashë Tepelenës me sy bojëqelli të piktorëve të njohur francezë, si Dypre etj.

Këto dhurata të Napoleon Bonapartit, i ishin dhuruar Ali Pashë Tepelenës dhe e motra e tij, Shanishaja, këto dhurata ia ka dhuruar gjyshit të Myfit Bej Libohovës, Sulejman Pashës, me të cilin ishte martuar. Madje edhe varri i motrës së Ali Pashës, Shanishasë, ndodhet në Libohovë.

Flori Bruqi

Posted by FLOART-PRESS @ 4:17 MD 19.3.07

PËR RAMUSHIN

“Dora e Zezë” e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës

(Intervistë me z. Adem Demaçi)

• *Si do ta komentoni vrasjen makabre të vëllait të ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinjt, një skenar, apo rastësi? Kush fshehet pas dorës vrastare?*

Demaçi: Këtu nuk ka rastësi. “Dora e zezë” (*Crna ruka*) serbe, në mënyrë sistematike dhe superprofesioniste është duke ndërhyrë në zhvillimet kosovare duke vrarë, një nga një, çlirimtarët kosovarë dhe duke futur huti e konfuzion në policinë e administratën e UNMIK-ut. Mitrovica e Veriut, ku pushtetin e plotë e kanë sigurimsët e Beogradit, është shndërruar në qendër prej nga, tash sa vjet, po nisin dhe po drejtohen aksionet e tërbuara kundër çlirimtarëve kosovarë, kundër liderëve të partive më të mëdha e, madje, kur e kërkon nevoja, edhe oportuniteti politik i Beogradit, madje kundër serbëve të pafajshëm. Prej nga Serbisë dhe “Crna rukës” ekzekutorët për këto vepra të ndyra? Paj, edhe pas gjashtë vjetësh “liri” nuk është zbuluar asnjë, ama hiç, asnjë bashkëpunëtor i Sigurimit serb nga radhët e shqiptarëve! A ka nevojë të thuhet se UDB-eja, që nga hapat e parë të diktaturës komuniste, kishte me dhjetëra mijëra shqiptarëzinj në shërbim të vetin? Shumica prej tyre, edhe sot janë sistemuar nëpër të gjitha poret e shoqërisë së dezorganizuar e të dezorientuar kosovare. Këtë e kanë thënë hapur dirigjentët e tyre nga Beogradi. Kanë thënë, madje, se agjentët e tyre kanë

depërtuar edhe në mekanizmat e UNMIK-ut dhe prej andej janë duke ndjekur zhvillimet në terren. Tash, si po shihet, ka ardhur koha që edhe të drejtojnë zhvillimet e ngjarjeve në terren. Do të ishte i gjatë vargu i veprimeve të tyre terroriste gjithandej Kosovës, sidomos në dy vjetët e fundit. “Sigurimin e Atdheut” ata e kanë trilluar për të futur konfuzion, por punët i dirigjon, i ndërmerr dhe i kryen, me anën e “mashave shqiptare-kosovare, vetë “Crna ruka”. Por, si nuk zbulohet, a nuk kapet asnjë aktor? Paj, si të zbulohen a të kapen, kur aktorët me të kryer veprat, një herë strehohen nëpër enklavat serbe, pastaj barten legalisht në Mitrovicën veriore, e prej andej largohen nga Kosova dhe vendosen në qendrën e vet në Nish. Nga Nishi shkojnë nëpër pushimoret gjithandej Serbisë! Kjo “lojë”, për “Cërna rukën” është bërë rutinë, lodër fëmijësh, sepse nuk rrezikojnë asgjë. Policia kosovare nuk ka kompetenca, as nuk ka të drejtë qasjeje për të vepruar. Policia e UNMIK-ut, hulumtimet dhe hetimet e veta kriminale i orienton vetëm në drejtim të shqiptarëve, në drejtim të kotë! Prandaj edhe nuk ka rezultate.

• *Cili është opinioni Juaj lidhur me mbajtjen në qeli të Haradinajt? Cili është qëllimi i Hagës me arrestimin e ish-kryeministrit të Kosovës?*

Demaçi: Qëllimi është që të kriminalizohet UÇK-ja, që të demonizohet UÇK-ja, që të barazohen luftëtarët e kryengritësit e lirisë kosovare me vrastarët e robëruesit e Serbisë neofashiste. E pastaj të gjendet “zgjidhja e Solomonit”: as autonomi serbe, as pavarësi kosovare! Krejt kjo mund të përfundojë në një tragjedi të re ballkanike!

• *Çfarë note do t'i vinte Mandela i Kosovës Qeverisë së Bajram Kosumit, ndërsa përflitet se ka njerëz të inkriminuar në kabinetin e tij.*

Demaçi: Z. Bajram Kosumi është burrë i zgjuar, por përgjysmë më pak energjik se sa z. Ramush Haradinaj. Në Kosovë, si pozita, si opozita, të gjithë janë bërë të inkriminuar. Kosova është bërë një “Pazar i pleshtave dhe i fjalëve kuturu”!

• *A është zgjidhje më oportune vendosja e Kosumit kryeministër, ndërsa shpreh pakënaqësinë partia e Thaçit?*

Demaçi: Kjo ishte e vetmja zgjidhje oportune për t’u ar-

dhur paksa era demokraci institucioneve formale të Kosovës.

- *Mendoni se Presidenti Rugova po e menaxhon mirë Kosovën për ta çuar drejt pavarësisë? Në çfarë niveli është bashkëpunimi i partive politike shqiptare; çfarë çalon dhe çfarë kërkohet?*

Demaçi: Z. Rugova nuk e menaxhon fare Kosovën. Kosovën e menaxhon UNMIK-u. Bashkëpunimi i partive politike të Kosovës është në nivelin zero! Zeroja nuk çalon dhe as nuk ke se çfarë të kërkosh nga zeroja!

- *Çfarë ka arritur Forumi Qytetar i Kosovës që Ju drejtoni dhe cili është roli i tij për çështjen e madhe, për pavarësinë e Kosovës?*

Demaçi: Asgjë! Forumi ende është në fazën e organizimit. Grupi nismëtar herë rritet, herë zvogëlohet, por nuk zhduket dhe nuk heq dorë nga ideja e një organizimi të mirëfilltë; kur të vijë koha dhe kur të krijohen rrethanat përkatëse.

- *Çfarë këshille do t'i jepnit politikës shqiptare që ka përjashtuar, thuajse tërësisht, gruan nga konkurrimi për deputete?*

Demaçi: Çfarë ta këshilloj unë Shqipërinë kur as në Kosovë nuk dëgjon njeri këshillat e mia. Si po më duket, si në Kosovë, si në Shqipëri njerëzit po koriten pas parave, por sa për mend të gjithë kanë tepër, madje edhe për të shitur, por s'i blen njeri!

Botuar: 10.08.2005.

<http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/Week-of-Mon-20050808/008420.html>

Hero në luftë - hero në paqe: Ramush Haradinaj

Ndonëse i popullarizuar si ish-kryeministër, ish-komandanti i UÇK-së, unë si bashkëvendës i gjeneral Ramush Haradinajt i mohoj informatat e gazetave sllave, si dhe shumë informata tjera të MUP-it jugosllav që janë informata të rreme nga MUP-i serb, si dhe informatorët dhe bashkëpunëtorët” e komandantit të UÇK-së, z. Ramush Haradinaj, gjoja se gjenerali më trim i UÇK-së, “ka bërë” aktivitete kriminale me pjesëmarrjen e tij në vrasjen e civilëve.

Në Ballkan shpesh thuhet se heroi i një personi është kriminel për personin tjetër. Ky përkrahim nuk do të mund të ishte më i saktë se në përkrahimin e ish-kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj, i cili në mënyrë të dinjitetshme dha dorëheqje me 8 mars 2005, pasi që Tribunali i Hagës lëshoi aktakuzën për krime të luftës kundër tij. Për rrafshin e Dukagjinit, Ramush Haradinaj është hero i modelit klasik – djalë i shkathtë dhe trim nga fshati që bëri vepra të mira duke pasur guximin të luftojë për idealet e tij. Por, për popullatën serbe në Kosovë, Ramush Haradinaj është simbol i dhunës dhe padrejtësisë. Ai konsiderohet si bandit i paskrupullt - vrasës që bëri të mbizotërojë një regjim terrori në Dukagjin, rajonin perëndimor të Republikës së Kosovës në vitet 1998-1999, duke lënë nga pas gjurmë të kufomave civile, sipas informacioneve të MUP-it jugosllavë. Njeriu që do të arrinte të gëzonte respekt në masë të madhe nga ana e shqiptarëve dhe të nxiste hidhërim nga ana e serbëve, ka lindur në fshatin Gllogjan më 3 korrik, 1968, fëmija i dytë nga nëntë fëmijët e familjes së tij. Sikur të gjithë shqiptarët e

Kosovës, të lindur në vitet e gjashtëdhjeta, Ramush Haradinaj vijoi mësimet në shkollën etnikisht të përzier, dhe mësoi të flasë serbo-kroatisht. Pas përfundimit të shkollës së mesme në vitin 1987, ai e kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak në APJ, duke treguar talent të mjaftueshëm ushtarak, gjë që çoi në gradimin e tij si oficer komandant, gjë e rrallë kjo për shqiptarët. Pas ushtrisë, Ramush Haradinaj fillimisht deshi të studionte astronomi në Universitetin e Prishtinës, në atë kohë të udhëhequr nga rektori serb Radivoje Papoviç. Por, ai deklaroi se i ishte pamundësuar një gjë e tillë për shkak se disa nga anëtarët e familjes së tij kishin pasur probleme me autoritetet komuniste në komunën e vogël të Deçanit, rrëzë Alpeve Shqiptare. Në vend të studimit, ai shkoi në Lucern, Zvicër, ku së bashku me xhaxhanë e tij e krijoi një biznes për ndërtim. Gjatë një vizite të tij në Kosovë, në mars të vitit 1991, Ramush Haradinaj u zu në mes të një vale protestash dhe kryengritjesh që po ndodhnin në Kosovë si reagim ndaj një numri të ligjeve antishqiptare të imponuara nga urdhrat e liderit serb Slllobodan Milloseviq. Ramush Haradinaj ishte mbajtur në paraburgim për një natë dhe ishte marrë në pyetje nga policia serbe e MUP-it të Deçanit dhe të Pejës. Pas lirit të tij, ai u kthye në Zvicër ku u paraqit dhe më vonë iu dha azili politik. Në ekzil, Ramush Haradinaj ndiqte me kujdes tmerrin dhe terrorin që ushtronte qSlllobodan Miloseviq për ta serbizuar Kosovën, duke i larguar shqiptarët nga universiteti dhe duke i përzënë ata nga pozitat shtetërore të punës. Ai u inkadrua në Lëvizjen Popullore të Kosovës, LPK, grup radikal i shqiptarëve emigrantë me banim në Zvicër, të cilët qe një kohë ishin duke thirrur shqiptarët të përdorin çdo mjet të mundshëm, përfshirë këtu kryengritjen e armatosur, për të siguruar pavarësinë e krahinës. Gjatë kohës në ekzil, ai u dashurua me një femër finlandeze dhe filloi të jetonte me të. Nga koha në kohë, ai kthehej në Kosovë ilegalisht, duke kaluar nëpër male nga Shqipëria, nganjëherë duke sjellë edhe armë me vete. Në mars të vitit 1997, një varg investimesh mashtruese piramidale tronditën Shqipërinë, duke e sjellë vendin në një gjendje anarkie. Gjersa popullata atje ndërmori një

aksion të gjerë shkatërrimi, duke zbrazur arsenalet e miliona kallashnikovëve, të granatave, minave tokësore, minahedhësve dhe municionit, Ramush Haradinaj fluturoi për në aeroportin e Rinasit ,në Shqipëri dhe filloi grumbullimin e armëve. Ai e dinte se tragjedia në Shqipëri do të mudn të shërbente për pajimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK. Ai mblodhi një grup të njerëzve, duke përfshirë këtu edhe vëllain e tij, Luanin, në aksion të bartjes së armëve përtej kufirit. Në maj të vitit 1997, grupi i Ramush dhe Luan Haradinaj i ngarkuan armët në shpinë dhe kaluan kufirin për në Kosovë. Mirëpo, pak kohë pasi që kaluan kufirin, ata u zunë në pritë nga trupat serbe. Luani u vra heroikisht në përballje me ushtrinë serbe dhe një nga personat tjerë u plagos rëndë. Grupi u tërhoq dhe Ramush Haradinaj e barti trupin e vëllait të tij përtej kufirit për ta varrosur dhe pastaj u kthye në Zvicër. “Kam qenë i humbur pas asaj ngjarjeje,” i tha Ramush Haradinaj mediave më vonë. “Ndjehesha përgjegjës për vdekjen e vëllait tim. Doja të vazhdoja, por nuk mundja gjatë asaj kohe.” Dy muaj më vonë, Haradinajt iu kthye vullneti. Ai u kthye në Shqipëri, kapërceu Alpet shqiptaro-shqiptare prapë për të ardhur në Kosovë dhe e themeloi bazën e tij në fshatin e lindjes në Glllogjan. Ai e shndërroi shtëpinë e familjes së tij në bazë të UÇK-së dhe ndihmoi në ndërtimin e ushtrisë guerile të rajonit të Dukagjinit, duke e transformuar një grup të paorganizuar të djemve të rinj në një forcë që do ta trondiste regjimin serb. Në mars të vitit 1998, gjatë përpjekjeve të tyre për ta eliminuar UÇK-në, trupat serbe ndërmorën një sulm në bazën rebele në Glllogjan, duke përdorur helikopterë dhe makina të blinduara. Duke iu falënderuar një vargu të rastësive fatlume dhe konfuzionit nga ana serbe, grupi e mbijetoi sulmin, edhe pse Ramush Haradinaj u plagos disa herë. Gjatë dy viteve të ardhshme, Ramush Haradinaj do ta humbte edhe vëllanë tjetër dhe disa nga shokët e tij të ngushtë në luftime. Por, gjersa UÇK shndërrohej në një forcë guerile, Ramush Haradinaj e fitoi reputacionin e një luftëtari që nuk i frikësohej asgjëje. Së shpejti ai zhvilloi marrëdhënie me zyrtarët e SHBA-ve, duke u bërë i vlefshëm për ta ushtarakisht.

Mirëpo, edhe pse ai respektohej në mesin e bashkëluftëtarëve të tij dhe konsiderohej i vlefshëm nga amerikanët, ai ngjallte frikë tek secili që guxonte t'i vinte në dyshim veprimet e tij. Sipas skenarëve të MUP-it të Beogradit, gjegjësisht krerëve të MUP-it të Pejës, Deçanit, Prishtinës thuhet se "...njësi i UÇK-së i Ramush Haradinaj ka kidnapuar dhe vrarë 40 civilë serbë, të cilët konsideroheshin të zhdukur në vitin 1998 dhe 1999. Disa nga këto kufoma gjoja janë gjetur në faza të ndryshme të dekompozimit në kanale që derdhen në liqen afër Glogjanit. Trupat e disa civilëve të tjerë janë gjetur në fund të puseve". Gjithashtu, sipas mediave të Beogradit "... supozohet se njësi i Ramush Haradinaj ka vrarë shqiptarë". Në fund të dhjetorit të 2002, vëllai i Ramushit, Dauti, u dënua nga Gjykata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në Pejë) me pesë vjet burgim për pjesëmarrjen e tij në kidnapimin, torturimin dhe vrasjen e katër anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), të cilët ishin rivalë të UÇK-së gjatë konfliktit. Dauti, para 5 muajsh u lirua nga burgu i Dubravës dhe u prit nga bashkëvendësit e tij për herë të dytë si hero i popullit, ngase edhe është hero! Pas luftës, Ramush Haradinaj u zgjodh zv.komandant i Trupave për Mbrojtjen e Kosovës (TMK), forcë kjo e krijuar sipas modelit të Gardës Kombëtare të SHBA-ve. Sidoqoftë, pas një kohe, Haradinaj dha dorëheqje nga posti i tij dhe e themeloi partinë e tij politike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, AAK. I rrjedhshëm në gjuhën frënge dhe angleze, politikani i ri la përshtypje të mira tek zyrtarët e huaj dhe gazetarët, dhe gjersa partitë e tjera politike përqendroheshin kryesisht në çështjen e pavarësisë, Ramush Haradinaj mbështeste rëndësinë e ndërtimit të rrugëve dhe shkollave. Edhe pse shumica e respektonin të kaluarën luftarake të Ramush Haradinaj, partia e tij politike në fillim nuk gëzonte përkrahje të gjerë popullore, dhe mbetej e treta në distancë pas partisë së akademik Ibrahim Rugovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe partisë së liderit të UÇK-së, Hashim Thaçi, Partia Demokratike e Kosovës (PDK). "Ramushi nuk është njeri i politikës," i tha IWPR-së një nga bashkëluftëtarët e tij në vitin 2000, kur

Ramush Haradinaj hyri në skenën politike për herë të parë. “Kur flas me të, mund ta bëj të qesh një minutë, dhe ta bëjë të më vrasë minutën tjetër. Nuk mund të jesh emotiv në politikë.” Në fakt, gjatë garës për zgjedhjet komunale në Kosovë në vitin 2000, temperamentit i Ramush Haradinaj shpesh dilte jashtë kontrollit. Ramush Haradinaj përfundoi në një përlëshje fizike me ushtarët rusë paqeruajtës në një pikë kontrolli. Disa muaj më vonë, ai ndërmoi një veprim politik të gabuar edhe më të madh. Pasi disa nga rivalët e tij nga koha e luftës, familja Musaj, e konfrontuan babanë e tij, duke kërkuar të dinë se ku ishin familjarët e tyre të zhdukur, Ramush Haradinaj u zemërua tej mase. Ai dhe disa nga përkrasitë e tij udhëtuan tek shtëpia e familjes Musa në fshatin Strelcë në ora një të mëngjesit, u ngjitën mureve dhe e konfrontuan familjen. Një shkëmbim zjarri pasoi në vijim, ku u përdorën edhe granata, dhe Ramush Haradinaj përfundoi i plagosur. Pas incidentit, Ramush Haradinaj u bart me helikopter në bazën ushtarake amerikane në Kosovë dhe më vonë u mjekua nga plagët e shkaktuara nga granatat në një spital ushtarak amerikan në Gjermani. Më vonë, zyrtarët amerikanë në Kosovë do të akuzoheshin për ndërhyrjen e tyre në hetimet e OKB-së të incidentit. Në vitet që pasuan, stili i jetës së Ramush Haradinaj shkaktonte ngritje të vetullave në Kosovë. Ai u nda nga partnerja e tij finlandeze, u martua për së dyti dhe u vendos në një shtëpi luksoze në lagjen Arbëria në Prishtinë. Edhe pse shtëpia thuhej t’i ishte dhënë nga miqtë e tij, shume armiq të tij politikë e vështronin një gjë të tillë me zili, ngase vetë Ramushi më vëllezër dhe babanë e tij e ndër-tuan. Ndërkohë, mediat e ndryshme, si, fjala vjen “Koha ditore” e Veton Surroit, shpifte me të madhe “se ai kishte bërë krime lufte dhe ishte i përfshirë në tregtinë e paligjshme të duhanit”. Përkundër komenteve kontroverse të Beogradit, kundërshtarëve të tij politikë, Ramush Haradinaj mbetej personi më i popullarizuar në Rrafshin e Dukagjinit dhe në tërë Kosovë. Biografia e tij, në dy pjesë, në formë të intervistës së zgjatur, u publikua nga bashkëvendësi i tij, publicisti i shquar shqiptar, Bardh Hamza, në “Zëri” të Prishtinës (nga një ndër shtëpitë botuese

më të famshme në Kosovë), dhe ishte ndër librat më të shitur. Në Rrafshin e Dukagjinit, ai gëzonte përkrahje besnike. “Ne kemi njerëz të tjerë për politikë,” thoshin fshatarët e rajonit të Dukagjinit. “Por, nëse serbët kthehen, ne e kemi Ramushin.” Pas zgjedhjeve, AAK hyri në koalicion me partinë në udhëheqje, LDK dhe Ramush Haradinaj u zgjodh kryeministër i Kosovës. Emërimi i tij i zemëroi si serbët, kundërshtarët politikë të tjerë, po ashtu edhe diplomatët perëndimorë, shumica prej të cilëve i bënë thirrje Misionit të OKB-së në Kosovë të pengonin emërimin e tij. Gazeta “The New York Times” kritikoi ashpër emërimin e tij në një editorial. Mirëpo, Soren Jessen-Petersen, shefi i Misionit të OKB-së në Kosovë, refuzoi të intervenojë, duke deklaruar se “Nëse unë do t’i thosha ‘Jo’ këtij emërimi, unë do t’i thosha ‘Jo; demokracisë’”. Sipas të gjitha burimeve, pasi që u emërua, Ramush Haradinaj dëshmoi se ishte një lider efektiv dhe dinamik, duke mbështetur një pilot projekt që i ofronte Kosovës një pavarësi (të kushtëzuar). Më 8 mars 2005, pasi që gjykata për krime të luftës pranë OKB (Hagë) e konfirmoi aktakuzën kundër tij, Ramush Haradinaj e shpalli dorëheqjen e tij prej kryeministri dhe u betua se do të udhëtonte për në Hagë të ndeshje me akuzat e Karla Del Pontes, kundër tij. Gjatë dorëheqjes, Ramush Haradinaj thirri popullin për qetësi dhe apeloj kundër protestave të dhunshme. Por, kur ai do të thirrej të përgjigjej për të kaluarën e tij si komandant i forcave guerile, shumë frikësohen se temperamentin e tij do të dalë në sipërfaqe, gjë që mund të sjellë trazira dhe mund t’i japë fund paqes së brishtë në Kosovë. “Ai mund të jetë në paraburgim nga Tribunali, por përkrahësit e tij vetëm janë duke bërë plane,” thoshin banorët e fshatit tim, Isniqit, në një tubim masiv, kur u burgos Ramushi. Ramushi, gjatë vitit 2007 duhet edhe një herë të përballohet më akuzat e Tribunalit të Hagës, por gjithsesi ai do të lirohet nga aktakuza, ngase gjenerali, guerili dhe heroi i Dukagjinit nuk ka bërë krime lufte, por ka mbrojtur popullin nga soldateska e satrapit dhe kriminelit Slllobodan Millosheviq.

Ramushi – viktimë e situatës (neo)koloniale

Duke drejtuar luftën në ZOD, Ramush Haradinaj fitoi simpatinë e pothuajse gjithë luftëtarëve, madje edhe të kundërshtarëve të tij. Respekti dhe nami i tij u rrit edhe me faktin se të dy vëllezërit e tij, Shkëlzeni dhe Luani, ranë dëshmorë për lirinë e Kosovës, si dhe me faktin se edhe Daut Haradinaj, i vëllai i tij, ishte në mesin e tre luftëtarëve, i cili mori pjesë në paraqitjen e parë publike të UÇK-së.

Janë të gjitha këto arsye pse që herët figura e tij filloi të merrte edhe përmasa të legjendës. Pas punës së shkurtë dhe të suksesshme në TMK, R. Haradinaj u aktivizua në politikë, duke bashkuar rreth vetes parti të ndryshme dhe duke dëshmuar se ishte karizmatik, jo vetëm në luftë, por edhe në politikë.

Si një luftëtar sypatrembur me forcat serbe dhe mercenarët e ndryshëm sllavë, pse jo dhe rusë, ai filloi të bëhej një ankth e makth i mundimshëm i tyre. Qëndrimi i tij burror dhe krenar karshi forcave të KFOR-it rus në Malishevë e bëri këtë ankth edhe më të madh. Por, mbi të gjitha, udhëheqja e tij e shkurtë, por shumë e suksesshme si kryeministër i Kosovës, ishte e padurueshme dhe e frikshme jo vetëm për rusët dhe serbët, por dhe për vetë UNMIK-un. Këtu, mendoj, duhet kërkuar shkakun pse përfaqësuesja e prokurores së Tribunalit të Hagës në Beograd ngriti aktakuzën kundër tij, mbështetur kryesisht në akuza të rreme dhe të pabaza, me anën e të cilave edhe sot e kësaj dite nuk po mund ta fajësojë dhe ta gjykojë.

Me një fjalë, karizma, dhuntia e tij për të udhëhequr, për

të prirë, si në luftë, si në paqe, bëri që ai të jetë viktimë e kësaj situatë të padurueshme (neo)koloniale.

Në fund, lutemi që drejtësia të vihet në vend dhe Ramushi, për të cilin ka aq shumë nevojë Kosova, të kthehet dhe të drejtojë jetën politike në Kosovë.

Abdullah Konushevi

ANTROPOLOGJI

Jakov Milaj dhe raca shqiptare

Do të lexoni sot në bllokun tonë virtual “Floart-Press” një shkrim antropologjik që kohë më parë disa lugetër interneti u sulën si leopardë ndaj meje dhe studiuesit të elitës, Jakov Milajt, tashmë të ndjerë. Këtu do të gjeni disa nga pjesët më të rëndësishme të studiuesit eminent, të njohur me emrin dhe mbiemrin Jakov Milaj, i cili për trashëgimi kulturore dhe shkencore, la librin e tij monumental “Raca shqiptare” (1944, ribotuar më 1997).

Ky libër është mbajtur në hije për më shumë se 50 vjet, dhe i rikthehet publikut shqiptar si punim i njërit nga studiuesit më virtuozë, që është njëherit edhe i pakalueshëm deri më sot ndër shqiptarët në këtë fushë mendimi antropologjik.

Jeta dhe vepra e Jakov Milajt

Jakov Milaj u lind në Fier më 25 mars 1911. Ai u shkollua në Gjimnazin e Shkodrës dhe mbaroi atë si njëri nga nxënësit më të mirë, më 1931.

Si nxënës, Milaj drejtoi Shoqatën Kulturore “BESA SHQIPTARE”. Punoi si mësues në Fier; sekretar komune në nënprefekturën e Kolonjës; më vonë redaktor përgjegjës në organe të ndryshme të shtypit të Tiranës, e sidomos në “Vatra” të Timo Dilos dhe në revistën “Përpyekja shqiptare” të Branko Merxhanit.

Në këtë kohë ka formuar shumë njohje, ku spikat mbi të gjitha, miqësia e madhe me shkrimtarin tonë të madh Migjenin.

Për ata që kanë shfletuar shtypin shqiptar të viteve 1930, është e pamundur që të mos njohin emrin Jakov Milaj, apo inicialet e tij J. M.

Falë erudicionit të tij, ai shkruante në fushën etnografike, antropologjike, gjeografike, historike etj. Më 1934 i përligjet e drejta e studimit në Fakultetin e Veterinarisë pranë Universitetit italian të Torinos.

Përkohësisht, Jakov Milaj ndërpret studimet (1935) dhe kthehet në Fier, ku merr pjesë në Kryengritjen e Fierit.

Dështimi i kësaj kryengritjeje ishte fatal edhe për studentin Milaj. Regjimi i atëhershëm i mbretit Zog e dënon me burgim prej 101 vjetëve.

Pas ndërhyrjes së organizatave të shumta ndërkombëtare, ai falet. Më pas migron nga vendi për në Torino të Italisë për të vazhduar studimet e veterinarisë që i la përgjysmë.

Në ditët e fundit të jetës së poetit tonë të mjerimit - Migjenit, Jakov Milaj, do të jetë pranë tij dhe së motrës në Sanatoriumin e Tore Felices.

Madje, do të ishte ai që do të sillte edhe fjalët e fundit të Migjenit dhe dorëshkrimet e fundit të tij nga spitali.

Në Shqipëri Milaj kthehet në vitin 1939, pasi që kishte doktoruar veterinën në Torino. Jakov Milaj do të punojë në institucionet zyrtare dhe në qeverinë e atëhershme; do të ishte pak muaj edhe Ministër i Bujqësisë dhe i Pyjeve.

Shkak për largimin e tij nga posti i ministrit ishte se Milaj kërkonte që “pyjet e Shqipërisë të shkëputeshin nga kontrolli italian dhe milicia italiane e pyjeve të zëvendësohej me shqiptarë”.

Kuptohet që ministri Jakov Milaj u detyrua të jepte dorëheqjen e tij.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Milaj punoi në Stacionin e Veterinarisë në Durrës, Bilisht, Fier etj.

Regjimi komunist shqiptar e dënoi (1945) Jakov Milajn me 15 vjet burg të rëndë, prej të cilave i vuajti mbi gjashtë vjet burg (1945-1951) dhe katër vjet internim (1951-1955).

Vdiq më 2 janar 1997, në moshën 86-vjeçare. Në kryevep-

rën e tij “Raca shqiptare” Jakov Milaj për herë të parë shkroi për antropologjinë shqiptare.

Vepra ka një karakter të theksuar shkencor, patriotik dhe kombëtar. Në aspektin antropologjik, ky është i pari punim i shkruar mjeshhtërisht, me një gjuhë të pasur dhe të pastër, ku spikat tipi fizik shqiptar dhe ecuria e tij evolutive në rrafsh kombëtar, kanë thënë shkencëtarët e ndryshëm për këtë libër.

Por vetë autori, më mirë se kushdo tjetër, e ka treguar misionin e tij në këtë vepër.

“Qëllimi i hartimit të kësaj vepre ka qenë që të nxjerrë në shesh disa të vërteta, deri sot të panjohura mbi racën tonë dhe t’u japë shkas atyre që ndejnë veten të zotë për t’u marrë pak më tepër më biologji e antropologji.

Përfundimet që ka për të nxjerrë lexuesi nga këto faqe janë të thjeshta dhe ndoshta të njohura intuitivisht prej shumë Shqiptarëve, megjithëse të mohuara prej të huajve dashakëqij: se populli arbëror ka një origjinë të vetme të përbashkët: është anas (autokton) në të gjitha viset ku banon sot; se as midis myslimanëve e kristianëve; as midis Gegvet e Toskvet, nuk ka ndonjë ndryshim racor; e, më në fund, se ndihet nevoja për një politikë shoqërore që të synojë fuqizimin fizik të racës shqiptare”, shkruan Milaj.

Një pasqyrë e shkurtër e hulumtuesve të tjerë

Dihet se të dhënat e para të antropologjisë shqiptare janë të formës përkthuese.

Përkthimin e parë të pamjes fizike e ka bërë F. Pouqueville (1805).

Të dhëna përkthuese antropologjike dhanë edhe J. Pisko (1894), P. Trager-i (1990), E. Durham (1905) si dhe F. Nopça (1912).

Hulumtimet e mirëfillta antropologjike mbi shqiptarët janë bërë nga A. Weisbach (1868), i cili në Stamboll matë 17 meshkuj shqiptarë për të cilët gjeti lartësinë mesatare 1664 mm.

L. Glück (1895) matë 30 shqiptarë kryesisht nga Kosova. A. Haberland dhe V. Lebcelter (1916) matën 106 meshkuj shqiptarë

nga zonat malore dhe 13 nga Fusha e Kosovës.

K. Dronçillov (1921) bëri një punim antropologjik mbi 112 shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore. F. Luschan (1922) bëri matjen e kokës të 130 shqiptarëve me banim në Turqi.

Si punim i plotë mbi antropologjinë e shqiptarëve mund të merren matjet e bëra për 1.067 shqiptarë nga C. S. Coon (1930).

Përveç të dhënave antropologjike, në këtë punim janë pasqyruar dhe faktorët ekzogjenë. Në bazë të të dhënave që mblodhi, Coon-i përshkroi tipin dinarik të shqiptarëve dhe u mundua të shpjegojë prejardhjen e tyre ilire. Zh. Gavrilloviq (1967) bëri disa matje antropologjike të kokës dhe trupit në mostrat e 201 shqiptarëve nga Deçani (Kosovë).

Fillet e para të hulumtimeve antropologjike ndër shqiptarë hasen në dy broshura të shkrimit: Sami Frashri “Njeri” dhe “Përsëri njeri”.

Punim më rëndësi shkencore, si në matje, ashtu edhe në përshkrimet morfologjike të trupit dhe të kokës së popullatës shqiptare të Shqipërisë, është punimi “Gjurmime antropologjike për shqiptarët” nga Aleksandër Dh. Dhimas (1985).

Autori në këtë punim jep të dhëna interesante për karakteristikat fizike të shqiptarëve.

Përveç të dhënave përshkruese të pamjes së jashtme (ngjyra e syve, qepallat, piloziteti trupor, ndërtimi muskolor i trupit, etj) autori jep vlerat e disa matjeve trupore dhe të kokës.

Ndër hulumtuesit e trevës sonë në këtë fushë studimi lypset veçuar dhe hulumtimet e reja në hapësirat antropometrike, lëvizore, fiziologjike nga Prof. dr. sci. Mustafë Aliu (1991), Prof. dr. sci. Hasim Rushiti (1999, 2000, 2001), Prof. dr. sci. Abedin Bahtiri (2004), Prof. dr. Ajvaz Berisha (2002), Mr. sci. Flori Bruqi (2003, 2004, 2005) etj.

JU RRËFEJ PËR RACËN SHQIPTARE (botim i vitit 1945; ribotim 1997) nga prof. dr. Jakov Milaj

Shumë kohë përpara antropologëve, filologëve, poetëve, gjeografëve, historianëve e udhëtarëve të ndryshëm që kanë ka-

luar nëpër Shqipëri, ose që kanë njohur në ndonjë kënd të largët të Perandorisë turke, a të Ballkanit, ndonjë grup Shqiptarësh, nuk kanë përtuar të përshkruajnë sa më mirë që të jetë e mundur tiparet e këtij populli, që bie në sy për madhështi e bukuri.

Si na shihnin të huajt: Ami Boue, si dhe qindra të tjerë që s'po i përmendim, është prekur nga dukja fizike e shqiptarëve. Në veprën e tij "La Turquie d'Europe", (Paris 1842): "ata u ngjasojnë më shumë Grekëve se sa Sllavëve, dhe të kujtojnë tipat më të bukur të malësorëve zviceranë, më fytyrë vezake, më hundën e gjatë e të hequr, me trupin e tyre më shumë të hollë se të trashë e me trajta të hedhura".

Cypren Robert-i, që ka njohur vetëm gegët, në një studim të botuar në "Revue des deux Mondes", thotë se shqiptarët kanë "sy të vegjël, shikim të drejtë e të ngulur, vetulla të holla, hundë të mprehtë, kokë të gjatë, ballë të sheshtë, qafë tepër të gjatë, kraharor të rrumbullakët dhe pjesën tjetër të trupit të thatë, e nervoz".

Nga shkrimtarë të tjerë, dikush thotë se shqiptarët i kanë sytë e shkruar, ose bojë qielli dhe flokët e verdhë e gati të artë; dikush tjetër -Pouqueville-i, p.sh., se sytë i kanë te zinj.

Këto shënime, megjithëse në përgjithësi flasin mirë për ne, qëndrojnë kaq larg njëri-tjetrit sa të bëjnë të besosh se nuk ka një njësi fizike të tipit shqiptar".

Por, studimet më të plota mbi racën tonë, dihet se janë bërë prej shkencëtarëve austriakë, A. Haberlandt e V. Lebzelter; prej Eninger-it dhe studiuesit gjerman Von Luschan dhe prej antropologut zviceran Eugene Pitard.

Dy të parët, gjatë luftës së madhe u mblodhën në Shqipëri-në e pushtuar prej forcave austro-hungareze. Bënë studime mbi një grup vullnetarësh që shërbenin me armë në dorë për Fuqitë Qendrore dhe mbi një numër të vogël civilësh e të burgosurish shqiptarë që ishin kapur prej Serbëve. Janë matur 140 veta, të tërë meshkuj, madhorë, me moshë njëzet vjeç e lart dhe, që të gjithë, më sa duket, të ardhur nga krahinat e Gegërisë.

Studimet e tyre u botuan më 1919 në "Archiv fuer Anthropologie" XVII, me titullin "Zur physischen Anthropologie

der Albanesen”.

Për dallimet fizike, paprekshmërinë e racës, Milaj thotë: “Popujt që kanë pasur të bëjnë me Ilirët gjatë shekujve, kanë qenë kolonizatorë, pushtonjës ushtarakë ose migrantë endacakë. Këta nuk kanë pasur kontakt të barabartë me të gjithë turmën ilirike të përhapur në një trevë kaq të madhe. Por, ndërsa ndrydhja e tyre ka qenë më e fortë për disa fise e vise, ka qenë shumë më e dobët, ose nuk është ndier aspak ndër fise e vise të tjera.

Disa nga këta popuj nuk kanë lënë gjurmë veçse në qytetërim: kurse disa të tjerë kanë lënë shumë gjak ndër fiset e pushtuara.

Vetëm ai grup i Ilirëve, që më vonë u quajt me emrin Shqiptar, qëndroi më i pastërti dhe, ndonëse e ndjeu mjaft ndikesën e qytetërimit të huaj, mbeti gati krejt i paprekur për nga raca.

Raca shqiptare nuk ka nxjerrë vetëm burra të pushkës, por edhe njerëz të mendjes e të shpirtit; filozofë, ligjvënës, burra shteti, shkencëtarë, letrarë, dijetarë, poetë e artistë të mëdhenj.

Numrit të njerëzve të dëgjuar, që njihen si shqiptarë, duhet t’i shtohet një numër tjetër shumë më i madh të panjohurish, që janë mbajtur si pjellë e ndonjë populli tjetër dhe që ne nuk ua dimë emrat.

Kontributin që kjo racë i ka sjellë botës, në përpjesëtim më numrin e me kushtet në të cilat ka jetuar, nuk ka vajtur prapa racave të tjera fqinje, tregon përkundrazi, se paja shpirtërore e saj është e madhe dhe e shumanshme.

Sipas Pittard-it, lartësia trupore mesatare e gegëve është 1.683 mm; ajo e Toskëve 1,673 mm.

Siç shihet, grupi i Gegëve të Dobruxhës jep një lartësi mesatare 1 mm më të vogël nga mesatarja e Glueck-ut, pra gati të barabartë me lartësinë e kosovarëve dhe 10 mm më e ulët nga ajo, që kanë gjetur Haberlandt-i e Lebzelter-i; ndërsa Wniger-i ka vënë re se “midis Gegëve e Toskëve nuk ka asnjë ndryshim në lartësinë e trupit”.

Sikur të krahasojmë shtatin e shqiptarëve me atë të popujve fqinjë, dalin në dritë disa fakte shumë interesante.

Përtej detit Adriatik gjendet një nga zonat me njerëzit më të shkurtër të Evropës. Karta e Biasutt-it, e botuar në vëllimin e parë të veprës "Razze e Populi della Terra", është një pasqyrë e saktë e lartësisë trupore të popullsisë që banojnë matanë bregdetit shqiptar.

Që nga Ankona e gjer në thembër të çizmes italice, e gjithë pjesa qendrore, jugore e ishullore e Gadishullit të Apenineve, përmban njerëz që kanë një lartësi mesatare prej 158 deri në 162,9 cm, pra 6 deri 10 centimetra më të ulët se ajo e Shqiptarëve.

Nga kjo kuptohet se: për sa i përket kësaj veçorie, kryqëzimet midis Shqiptarëve dhe Italianëve gjatë shekujve të kaluar duhet të kenë qenë shumë të kufizuara për të mos thënë se praktikisht nuk kanë ekzistuar fare.

Në lindje të tokës së zënë prej popullit shqiptar gjendet Bullgaria.

E ndan prej saj Maqedonia me njerëz race të përzier, shumica e të cilëve e mbajnë veten për bullgarë.

Bullgarët, sipas Wateff-it, kanë një lartësi mesatare prej 1.665 mm.

Përpjesëtimi i njerëzve të lartë nga ata të krahinave lindore: ai arrin mesatarisht në 1.678 mm, domethënë në një lartësi krejt të barabartë me atë të Shqiptarëve që gjen Pittard-i, ose: 15 milimetra me të ulët nga ajo që na japin Habrelandt-i dhe Lebzelter-i.

Del, pra, në shesh se ata që i thonë vetes maqedonas, duhet të kenë shumë gjak shqiptar dhe, për sa i takon lartësisë mesatare, ndryshojnë mjaft prej bullgarëve të vërtetë", shkruan Jakov Milaj.

Treguesi qefalik dhe veçantitë

Milaj thotë: "Në veri të Shqipërisë etnike ndodhen Serbë, Bosh-

njakë e Malazezë. Që të tre këta popuj kanë trup më të lartë nga Shqiptarët. Për të parët, Deniker jep shifrën mesatare prej 1.709 mm, që mund të shtohet në studime të mëvonshme.

Weissbach-u, në 3.802 boshnjakë që ka matur, ka gjetur si lartësi të mesme 1.726 mm.

Lartësi thuhet të barabartë me këta kanë edhe malazezët.

Në jugun e vendit tonë gjenden grekët, të cilët kanë një lartësi trupi gati të njënjëshme me në: 1.670 mm.

Kjo veçori dhe disa të tjera që do të shohim më vonë, bëjnë të besosh se shumica e grekëve, posaçërisht pjesa perëndimore, janë të një race me shqiptarët, e bile janë shqiptarë që kanë humbur gjuhën dhe nëpërmjet shkollës e kishës, kanë trajtuar një ndjenjë kombëtare që shpirtërisht i ndan prej nesh.

Gjatësia e gjymtyrëve të poshtme, në grupin e matur prej Pittard-it, kalon prej 711 milimetra në 872 milimetra; mesatarisht kapet në 792,6 mm; kjo gjatësi shtohet rregullisht në përpjesëtim më lartësinë trupore.

Raporti mesatar i gjatësisë së shalëve në gjatësinë e përgjithshme të trupit është 47,25.

Shqiptarët kanë pra bustin më të zhvilluar nga të gjithë popujt e Ballkanit; kurse gjymtyrët e tyre, megjithëse të gjata, vijnë pas gjymtyrëve të serbëve e të turqve.

Weninger-i ka gjetur ndër gegë një gjerësi koke që kalon prej 145-172 mm, me frekuenca më të shumta në 147-170 mm; edhe ndër toskë një gjerësi që kalon prej 148-179 mm; me frekuenca më të dendura në 151-171 mm.

Në materialin e studiuar prej tij, është vërtetuar se toskët e kanë kryet më të gjerë nga gegët.

Treguesi qefalik është veçoria antropologjike më e rëndësishme, që bën të dallohet raca shqiptare nga racat e tjera.

Ky tregues është shumë i lartë dhe prandaj vërtetohet se populli i ynë është në përgjithësi shumë kokë-shkurtër.

Për seritë e ndryshme të shqiptarëve që ka matur Pittard-i, treguesi mesatar arrin në 86,4, dhe për atë që ka matur Haberlandt-i e Lebzelter-i, është pak më i ulët 86,14, thotë Jakov

Milaj.

Të tjerët për Milajn?

Ka shumë studiues shqiptarë që e kundërshtojnë veprën e Jakov Milajt.

Fjala vjen, Besnik Pula, në një reagim të tij në forumin “Alb-shkenca.org” dhe në gazetën “Koha ditore”: “Libri ka si paradigmë teoritë tashmë krejt të diskredituara, pseudoshkencore, raciste, që mbështeteshin në ide gjoja evolutive, e që argumentonin epërsinë gjenetike të racës së bardhë karshi grupeve të tjera racore, të legjitimuara “shkencërisht” nga antropologët, në bazë veçanërisht të matjeve të kafkës, veçorive të fytyrës etj, si shenja që zbulonin shkallën e zhvillimit biologjik e kulturor të grupeve njerëzore”. Më pas Pula shkruan: “Këtë histori të pseudoshkencës raciste; e dokumenton dhe diskuton mirë Stephen Jay Gould në librin e tij “The Mismeasure of Man”.

Të njëjtat paradigma teorike bënë që zyrtarë të lartë të shtetit serb në shek. 19 të argumentonin se shqiptarët janë “njerëz më bisht”, duke i përshkruar shqiptarët si popull “primitiv” dhe duke i projektuar mbi shqiptarët konceptet raciste që evropianët kishin zhvilluar në kolonitë e tyre afrikane e aziatike”.

Kjo, sipas Pulës, është pikërisht ajo që shqetëson me tepër se fakti që libri mbështetet mbi baza joshkencore.

Besnik Pula thotë: “Më 1938, Musolini vendosi që ta anashkalonte akademinë italiane dhe angazhoi një student të ri të antropologjisë, Guido Landra, që ta hartojë një platformë shkencore për racizmin italian. Studenti i ri, me bekimin personal të Musolinit, në korrik të atij viti nxori një dokument me emrin “Manifesti i Shkencëtarëve Racialë” (Manifesto degli Scienziasti Razziali), i cili vendosi bazamentin ideologjik për politikën e mëtejshme raciale të regjimit fashist.

Manifesti shpalli italianët “racë nordiko-ariane”; konstatoi se italianët janë “racë e pastër dhe e veçantë”; formuloi definicionin biologjik të racës dhe shpalli raca inferiore çifutët dhe afrikanët.

Aplikimi i teorive raciste përbrenda regjimit fashist italian

përbënte një risi, pasi që deri më 1938 Musolini u kishte rezistuar teorive të racës që promovonte homologu dhe aleati i tij në Gjermani, Adolf Hitleri.

Madje, në një rast, Musolini gjatë një bisede private i kishte përshkruar ato teori si qesharake dhe të pavlefshme.

Diçka e kishte bindur Musolinin që ta ndryshojë mendjen dhe menjëherë pas nxjerrjes së Manifestit, politika e regjimit fashist ndryshoi thelbësisht në raport me kolonitë afrikane dhe çifutët brenda Italisë, duke filluar një politikë persekutimi dhe represioni të haptë ndaj “racave inferiore” në bazë të një ligji racial të nxjerrë nga regjimi në po atë vit.

Tani, kur superioriteti dhe inferioriteti, pastërtia dhe ndotja e racave mund të vërtetohej shkencërisht, ishte e natyrshme që shteti të ndërmernte vendimin dhe kategorizimin e njerëzve në bazë të “esencës” së tyre biologjike dhe gjenetike” etj., etj.

Milaj rreket që të identifikojë prejardhjen e asaj që ky e definon si “racë shqiptare”, ku raca kuptohet si një bazament biologjik dhe gjenetik i shfaqjeve fizike dhe kulturore të një grupi njerëzor.

Për Milajn, shqiptarët nuk përbëjnë vetëm komb kulturor, por edhe një popullatë që veçohet nga një prejardhje e veçantë gjenetike, që i bën shqiptarët të meritojnë cilësimin si “racë”. Milaj, që kishte qenë ministër për bujqësinë në Qeverinë e parë fashiste në Shqipëri, nuk ishte antropolog, por në libër shkruan se ndjehej i cytur që teoritë raciale të gjejnë shprehje edhe në Shqipëri që të kuptohet “në baza shkencore” origjina dhe identiteti shqiptar. Stephen Jay Gould në librin e tij “The Mismeasure of Man” (“Matja e gabuar e njeriut”) hedh dritë mbi bazat false dhe pseudoshkencore të teorive raciale, të nocionit se kultura rrjedh nga biologjia, si dhe të metodave të klasifikimit të grupeve njerëzore në bazë të veçorive trupore (ngjyrës së lëkurës, formës së kafkës etj.).

Dekada të tëra të punës së antropologëve dhe studiuesve të tjerë kanë dëshmuar se teoritë kishin karakter ideologjik e jo shkencor.

Teorinë e vet për “racën shqiptare” Milaj e mbështet pikër-

ishtë në këtë traditë të dështuar të pseudoshkencës mbi racën, me të cilën ai tenton të vërtetojë “pastërtinë” e racës shqiptare dhe t’i vendosë edhe shqiptarët diku brenda hierarkisë së racave që kishin shpikur raciologët evropianë.

(Autori Besnik Pula është kandidat për gradën doktor në sociologji në University of Michigan, SHBA, ku specializon periudhën fashiste në Shqipëri).

Shkrimi të Besnik Pulajt i kundërvihet Kolec Traboini, gazetar, shkrimtar, regjisor dhe publicist i njohur shqiptar nga Bostoni në forumin virtual <http://www.ktraboini.com> dhe në disa forume të tjerë (*Sport-ritmi i zemrës*) me titull “PASI KOLOMBI E KA THYER VEZËN”

Besnik Pulaj bëhet i mençur duke e quajtur Dr. Jakov Milajn racist. Në lidhje me denigrimin absurd dhe tejet cinik që i bën Besnik Pulaj veprës së Dr. Jakov Milajt

“Raca shqiptare” duke e quajtur vepër raciste, shqetësim që e vlerësoj të drejtë, sepse zotëria kritikon në fjalë, flet me një stil gjoja akademik, por ex-catedra, me një fjalor që nuk i shkon për shtati kurrfarë studiuesi sado zemërak të jetë. Duke e shitur vetën si modern, ky tip kritikuesi nuk e kishte për gjë të polemizonte me këdo që kishte frymë nacionaliste, transplantime idesh pa marrë parasysh rrethanat e veçanta që ka një komb e një popull.

Në analiza qoftë historike apo antropologjike, kushdo (duke përfshirë dhe z. Pulaj), mund të ketë vërejtje për një studiues si Jakov Milaj, se koha ka bërë rishkrime; kanë ndodhur ngjarje të mëdha në histori, si Lufta e Dytë Botërore, që në kohën kur u shkrua e u botua kjo vepër nuk kishin dalë plotësisht në dritë. Por, të bësh të mençurin pasi Kolombo e ka thyer vezën, është një absurditet i pashoq. Për të mos thënë idiotësi në fushë të mendimit kritik. Jakov Milaj duhet gjykuar në rrethanat kur akoma nuk diheshin plotësisht ngjarje të tilla si gjenocidi i tmerrshëm ndaj izraelitëve.

E, për më tepër, nuk ka qenë ideja e Jakov Milajt superioriteti i racës shqiptare mbi racat e tjera, por për të zbuluar të veçantën, individualitetin që kishte raca shqiptare, e çfarë nuk

bie ndesh më vlerësimet historike të të huajve që kanë njohur tek shqiptarët cilësi të larta, qoftë si luftëtarë, qoftë në cilësitë morale si besnikëria dhe mikpritja.

Mirëpo, edhe pse disa studiues i bëjnë punët mbrapshtë e mbarë në Kosovë e në Shqipëri, po i mbajnë me bukë gjithandej, e shkrimet e tyre publikohen dhe gjejnë mrekullisht edhe sponsorë ndërkombëtarë të kërkojnë gjilpëra në kashtë. Pra, racizmin shqiptar, që vetëm ndonjë delirant në fushën intelektuale mund ta fantazojë, shkruan Kolec Traboini nga Bostoni/SHBA/.

Ndërsa “kritikuesi” tjetër, Albert Nikolla, në web faqen “Alb-Shkenca.org” datë 13 maj 2005 shkruan:

Personalisht mendoj se njeriu më adept që ka përcaktuar racën tonë me objektivitet është studiuesi kroat më origjinë shqiptare Aleksandër Stipčević, i cili e përcakton kështu racën tonë: Raca shqiptare, ashtu si dhe të gjitha racat e tjera evropiane, janë një produkt i pesë kulturave që kanë kaluar në territoret ilirike, përkatësisht një shartim iliro-grek, iliro-greko-romak, më pas një shartim iliro-romako-bizantin, dhe në fund, një produkt iliro-greko-romano-bizantino-tartar(turk).

Kjo tezë, sipas Albert Nikollës, është shkencore pasi bazohet në elemente të rëndësishme, si pushtimet e herëpashershme të trojeve shqiptare, në lëvizjet dhe migracionin e popullatave të ndryshme në drejtim të Shqipërisë, gjatë gjithë periudhave historike, në ekzistencën e disa tipave antropomologjikë shqiptarë si tipi shqiptar mesdhetar, i shkurtër, brun, me kokë të madhe dhe sy të vegjël; tipi shqiptar me origjinë kelte, i madh me sy blu deri në kafe, dhe më kafkë të madhe e shpatulla të gjera, (sy të mëdhenj) kryesisht në Malësinë e Mbishkodrës dhe në Kosovë, dhe tipi shqiptaro-tartar me trup mbi mesataren; kokë relativisht të vogël, këmbë të shtrembra, flokë të zinj.

Evropa, dhe kryesisht Ballkani, ka qenë një kazan popujsh, dhe nuk ekziston në asnjë vend të Evropës, përfshirë dhe Suedinë, që të ketë një racë të pastër.

Më 26 qershor 2005 “Sport-ritmi i zemrës” z. Enklid Milaj - nga Milanoja, lidhur me temën e shtruar në disa forume dhe revista shkruan:

Teoritë racore apo raciste

Letër e hapur drejtuar Muhamedin Kullashit e Besnik Pulës për komentet mbi librin “Raca shqiptare” të Jakov Milajt:

1. *“Ti, gjysh, do më shumë kosovarët sesa shqiptarët”, i thashë një ditë tim gjyshi, ndërsa shëtisja me të dhe vëreja që përshëndeste me shumë dashamirësi disa njerëz që mbanin qeleshe Kosove.*

Im gjysh më shkuli lehtë veshin e më shpjegoi se “nga veriu i Mitrovicës e deri në jugun e Prevezës, të gjithë ishim shqiptarë”. Dhe pyetjes sime, nëse edhe Gjylja, që ishte aq e zezë, ishte shqiptare - Gjylja ishte një rome që me një thes të madh vinte e lypte në shtëpinë tonë - m’u përgjigj: “A nuk flet shqip, Gjylja?”.

2. *Pas reagimit emotiv ndaj artikujve tuaj, vendosa të rizbuloj gjyshin tim, jo plak 80-vjeçar siç e kisha njohur unë, por si kishte qenë në kohën kur mendoi e shkroi “Racën shqiptare”.*

E, duke qenë se unë nuk jam filozof, pedagog recitimi o doktorant në SHBA (pa specifikuar ku e në çfarë) e nuk mund t’i lejoj vetes të jap gjykime mbi *antropologjinë fizike*, u limitova të hap enciklopedinë *Larousse* të 1923, për të parë sesa larg do të gjendej përcaktimi i *racës* së përdorur prej *racistit* Jakov Milaj nga përcaktimi i kësaj enciklopedie joraciste. Por, për përcaktimin e *racës* që bën të vetin J. Milaj. Për këtë vepër do të ishte më i përshtatshëm përkufizimi i Martial-it, që nuk lë përjashta pajën shpirtërore dhe i jep rëndësi kryesore historisë: *Thirret racë përmbledhja e një popullsie, karakteret psikologjike të së cilës, të fshehura ose të shfaqura (posaçërisht gjuha dhe vizat antropologjike përbëjnë, brenda historisë, një njësi të dalluar* (f. 13/botim i vitit 1944) ishte pothuaj se i njëjtë me ato të *Larousse-it*.

Atëherë, i kënaqur me rezultatin, hapa me ndrojtje një enciklopedi bashkëkohore multimediale, “Rizzoli-Larousse 2001”, me mendimin e induktuar nga ju zotërinj, se pas 60 e kusur vitesh nuk do të gjeja më një përcaktim të termit “racë” për njerëzit.

Por, tekstualisht atje, “Raca” përcaktohej në rendin antropometrik si “term i përdorur shpesh për komoditet klasifikimi,

për të treguar një grup njerëzish që paraqesin një homogjenitet relativ të karaktereve somatikë”.

E atëherë, me më tepër guxim shfletova edhe një enciklopedi amerikane “Encarta 2002”, e cila e përshkruan “Racën” si më poshtë: “Term i përdorur historikisht për të dalluar një popullsi nga një tjetër mbi bazën e elementeve biologjike”.

Të gjithë njerëzit i përkasin species *homo sapiens*. Koncepti i racës rrjedh nga ideja që speciet njerëzore mund të ndahen në grupe të ndryshme biologjike.

Sidoqoftë, shkenca ka provuar që njerëzit nuk mund të ndahen në raca të pastra. Shumë shkencëtarë, sot e hedhin poshtë idenë e racës së ngurtë biologjike dhe e shikojnë njeriun si një proces në vazhdimësi.

Pavarësisht nga kjo, raca persiston si një koncept i fuqishëm social e kultural, që përdoret për të karakterizuar njerëzit në bazë të diferencave fizike të dukshme e të sjelljes. Mora frymë thellë.

Përcaktimi i fjalës “racë” për njerëzimin vazhduaka të merret në konsideratë edhe sot e kësaj dite; nuk është, sigurisht, i njëjtë me atë që përdori, Jakov Milaj mbi 60 vjet më parë, por sidoqoftë nuk qenka herezi e, pavarësisht nga evoluimi i saj, nuk qenka diametralisht i kundërt.

Nga leximet e mëpastajme arrita të kuptoj, që nga një anë ekzistojnë teoritë racore, e në anën tjetër ekzistojnë ato raciste.

Që teoritë racore flasin për tipin, llojin e specien. Që teoritë racore janë shpesh keqkuptuar e keqpërdorur.

Që nga keqpërdorimi i teorive racore ka lindur racizmi. E që “teoritë raciste” flasin për superioritetin e domosdoshëm të një race ndaj një tjetre dhe legjitimojnë shfarosjen e asaj inferiore.

Me këtë *background*, e rilexova librin e Jakov Milajt, por në fund nuk e ndjeva aspak veten t’i përkisja një race më superiore se ajo e serbëve dhe e grekëve, zotërinj, e nuk m’u ringjall asnjë lloj përbuzje për vllëhtë, jevgjit apo romët.

Aq më tepër kjo, kur autori shkruan se “Çështja e racave

superiore dhe e racave inferiore, që është rrahur aq fort dhe vënë në mënyrë gjenerike, nuk ka kuptim” (f. 24, botimi 1944).

Dëshpërimi im ishte i madh kur pashë se Muhamedin Kullashi, nga një anë përmend ndër emrat që kanë frymëzuar “racistin” Jakov Milaj, “racistët” Eugen Fischer, F. Gall, Guenther e G. V. De Lapouge, që autori nuk i citon në librin e vet, nga ana tjetër, harron të shkruajë që “autori racist” ka përmendur në vitin 1944 edhe çifutin Norbert Jokli të vrarë prej nazistëve në vitin 1942 (f. 44, botimi 1944).

Por kritika juaj nuk mbaron me kaq.

Në vazhdim theksoni se “Milaj nuk bën asnjë vërejtje ndaj kësaj politike shfarosëse, veç konstatimit se nuk është e sigurt se do të përfundojë me sukses”.

U habita! Këtë vërejtje, Milaj e ka botuar në janar të 1944, kur nazizmi kishte zaptuar Shqipërinë. Nuk e di ku keni jetuar e sa zemërluan keni qenë ju, Muhamedin Kullashi apo paraardhësit tuaj gjatë diktaturave, por të jeni i sigurt që vënia në dyshim e realizimit të “objektivit madhor”, konsiderohej nga nazizmi si krim, e për këtë ndëshkohej.

E së fundi, harroni qëllimisht, o nuk keni arritur të kuptoni, që Jakov Milaj nuk kishte marrë “racën e pastër” si premisë të punimit të vet, por kishte parapëlqyer të mbetej nxënës i Pittardit, duke e cituar këtë të fundit thuajse 40 herë në veprën e tij.

Është e vërtetë që autori përmend togfjalëshin “racë e pastër”, por e përkufizon këtë togfjalësh duke thënë se “asnjë popull evropian nuk është i pastër nga pikëpamja e racës”.

Luftërat mijëvjeçare midis fiseve, migrimet e popujve prej një vendi në një vend tjetër, përpjekjet e të fuqishmëve për të futur në dorë pasuritë natyrore që zotëronin popujt më të dobët, kanë shkaktuar gjatë shekujve përzierje kaq të shumta racash, sa që sot është e pamundur të flitet për pastërtinë e tyre të plotë. Por se përdorim me këtë kuptim përkufizimin e “racës së pastër”, mund të themi me plot gojën se raca shqiptare është e pastër” (f. 141, botimi 1944).

Për më tepër, ndërsa flet për “racën shqiptare”, Jakov Milaj, jo vetëm nuk mbron ekzistencën e minoriteteve, por arrin

deri aty, sa shkruan që ato “nuk kanë asnjë ndryshim prej tipit dinarik; dallohen prej nesh vetëm për gjuhën”.

Hyjnë në grupin e tyre malazezët, bullgarët, grekët e kuçovllehët” (f. 126/ botimi 1944).

3. *Ndërsa ju, Besnik Pula, pohoni që autori i “Racës shqiptare” ishte fashist, pa i bërë pyetjen vetes çfarë do të thotë të jesh fashist.*

Përgjigjen nuk mund t’ju jap unë zotërinj, por mund ta gjeni në shtypin e kohës, ku Jakov Milaj shkruante herë me emrin e vet e herë me pseudonimin Horus.

Unë vetëm po limitohem t’ju kujtoj që Branko Merxhani, kryeredaktori i revistës “Përpjekja shqiptare”, pas 7 prillit 1939, u largua nga Shqipëria, ndërsa bashkëpunëtori i tij, Jakov Milaj, që u emërua kryeredaktor i revistës pas largimit të Merxhanit, arriti të botojë vetëm një numër të kësaj reviste, se pastaj fashistët ia mbyllën.

Po zotërinj, Jakov Milaj ka qenë ministër i Bujqësisë së qeverisë së Maliq Busbatit në vitin 1943.

Por, para se të njollosni emrat, duhet të paktën të verifikoni se cili ka qenë konteksti historik në të cilin veproi kjo qeveri, cili ishte programi i saj.

Pastaj, për hir të së vërtetës, z. Pula duhet të shkruani se pas tre muajsh, ministri Jakov Milaj dha dorëheqjen.

(A nuk është edhe ky një akt i guximshëm për kohët e fashizmit?)

Dhe motivi i dorëheqjes ishte refuzimi i nënshkrimit të dhënies me koncesion të pyjeve shqiptare italianëve.

Faleni kësaj here Jakov Milajn, zotërinj. Ai si ministër bujqësie nuk mund të bënte më tepër se të emëronte 30 zooteknikë e veterinerë të lartë të shtetit në Kosovën *djerrë, por pjellore*.

E mos harroni se në vitet ’40, dy ishin kampet që ndesheshin me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, nacionalistët, që duke shfrytëzuar situatën e kohës, për herë të parë arritën të shihnin një Shqipëri të shqiptarëve, edhe pse nën hijen e rëndë të fashizmit, e nga ana tjetër, komunistët të themeluar nën kujdesin e Miladin Popoviç, të cilët që në projektet e tyre fillestare donin që kjo e fundit t’i bashkëngjitej shtetit jugosllav.

E mos harroni, zotërinj, nëse jeni seriozë e pragmatikë, që një Shqipëri e shqiptarëve në ato kohë të vështira, ishte e mundur vetëm duke rinunçuar diçka e duke paguar një çmim tepër të madh, d.m.th. duke bërë kompromise me njërin kamp.

A nuk duhet të paguajmë një çmim shumë të lartë e të bëjmë shumë kompromise edhe sot, që komuniteti ndërkombëtar të njohë pavarësinë e Kosovës?

Nuk e di, nëse me fjalët e mia ju kam mbushur mendjen që Jakov Milaj nuk ka qenë fashist e racist në vitet '30 e '40, por di që, në ato vite, shqiptaromadhi Jakov Milaj ishte mik i “malazezit” Migjeni e bujti në shtëpinë e vet në Torino “internacionalistin” Asim Vokshi, që ishte nisur për në Luftën e Spanjës.

4. *Për sa i përket rehabilitimit prej komunizmit, Jakov Milaj nuk ka nevojë për mëshirën e askujt. Jakov Milaj e kishte për nder të ishte lidhur në të njëjtat pranga me “fashistin” At Anton Harapi apo Babri Omarin dhe jo vetëm i kishte falur me kohë persekutuesit e tij, por i mësoi edhe fëmijëve e nipërve të vet të falin, por mos të harrojnë.*

5. *Jakov Milaj e përdori “racën” në librin e tij, jo për të bërë klasifikime raciste (më citoni një fragment në të cilin shkruhet se jemi superior ndaj grekëve e serbëve (f. 126 botimi 1944), por për të bërë një diversifikim. E diversifikimi është pasuri.*

Jakov Milaj e përdori “racën” për të bindur labin kokëfortë, që kosovari është po aq shqiptar sa ai, për t’i thënë shqiptarit të Mitrovicës që himarjoti nuk është grek, për t’i mbushur mendjen të krishterëve me ortodoksë e integralistë, që edhe pse Muhamedin Kullashi e Mehmet Kraja kanë një emër që tingëllon aq turk, sa emri i një turku Stambolli, janë shqiptarë.

Jakov Milaj e përdori “racën” në librin e tij, për t’i thënë shqiptarit “anakronik” të djeshëm e të sotëm, që të ketë besim te vetja e të njohë vetveten në një kuptim të ri. Patjetër, “Raca shqiptare” është një vepër që pasqyron edhe filozofinë, shkencën e terminologjinë e kohës së vet, e të gjitha limitet e saj; që ka një titull që të sjell menjëherë ndërmend “racizmin”; që me relativitetin e kohëve të sotme shumë prej tezave të shkruara në të nuk

janë më bashkëkohore e ndonjë edhe e gabuar.

Për fat të keq, teoritë mbi racën u degjeneruan, u keqpërdorën dhe u shndërruan shpeshherë në racizëm, duke prodhuar tragjedinë më të madhe të shekullit të kaluar.

A mos vallë edhe doktrinat e shenjta si krishterimi e islami-zmi, kur janë keqpërdorur nuk kanë pjellë dhunë?

Sidoqoftë, sado dashakeqës o sipërfaqësor të jeni zotërinj, sado mos ta keni lexuar librin e të keni marrë guximin të gjykoni prej titullit të tij apo parathënies, nuk e keni të drejtën morale të gjeni “racizmin shqiptar aty ku nuk është” e ta radhisni emrin e Jakov Milajt mes atyre që kanë realizuar “shfarosjen e çifutëve”. Ndër reliktet që ndodhen në shtëpinë ku banonte Jakov Milaj, është edhe një “hanuchia”.

Dhuratë, që miqtë çifutë të “racistit” Jakov Milaj, i bënë familjarëve pas vdekjes së këtij të fundit.

6. *Një miku im çam, pasi lexoi shkrimet tuaja këto ditë, më tha: “Për sa kohë kosovarëve u duhet bashkim dhe identitet e ndryshmëri nga serbi, ata e kishin librin ungjill (fjalë të prof. A. Cetës, thënë në Fier, 1992).*

Tani që nevoja e do të hapen e të njihen nga bota e shkelen menjëherë. Jo, - i thashë mikut tim, - nuk e shkelin kosovarët Jakov Milajn, pasi e dinë se, nëse Jakovi do të ishte gjallë e do të kishte edhe më të voglin dyshim, se libri i tij do të bëhej në çfarëdo mënyre pengesë për njohjen e pavarësisë së Kosovës, do të ishte ai i pari që krijesën e vet të viteve '40 do ta kishte braktisur në hauret e harresës”.

7. *Kur nisa t’ju shkruaj këtë letër, isha i tronditur e drubësua se ajo do të dilte thjesht emotive.*

Por tani që e mbarova, vura re se më shumë se unë, ka folur Jakov Milaj.

“I dua kosovarët – i thoshte Jakov Milaj nipave të vet – pasi pa kosovarët, Shqipëria nuk do të ekzistonte”. (Enklidi Milaj është nipi i Jakov Milaj. Enklidi është jurist pranë Studios Legale Internacionale “Lovells”, Milano)

Bleron Baraliu, nga Prishtina publikon më 15 maj 2005 shkrimin në web faqen “Alb-shkence.org”, ku shkruan :

Nga përmbledhja kam mundur të kuptoj vetëm se libri kërkonte të bënte identifikimin statistikor të karakteristikave fizike të Shqiptarëve dhe jo t'i klasifikonte ata si superiorë, apo të klasifikonte ndonjë popull tjetër si inferior.

Motivet e studimeve të tilla nga gjermanët, p.sh., kanë qenë të errëta, por kjo nuk mund të na shfrytëzohet si paragjykim për studime të tjera të kësaj natyre.

Në web faqen Alb-shkenca.org, më datën 21 qershor 2005, Flori Bruqi zhvillon polemikën më titull: “Replikë për shkrimin e B. Pulës etj. në “Alb-shkenca.org” dhe “Koha ditore “. Autori Jakov Milaj në librin e tij “Raca shqiptare” jep të dhëna interesante për karakteristikat fizike të shqiptarëve.

Përveç të dhënave përshkruese të pamjes së jashtme (ngjyra e syve, qepallat, piloziteti trupor, ndërtimi muskolor i trupit, etj.) autori jep vlerat e disa matjeve trupore si dhe të kokës.

Me aplikimin e analizës faktoriale në hulumtimet antropologjike filloi një hulumtim më i suksesshëm i ndërlidhjes dhe ndikimit të ndërsjellë ndërmjet ndryshoreve të matura në të njëjtën hapësirë apo në hapësira të ndryshme antropologjike.

Analiza faktoriale është aplikuar në hulumtimet e shumta ku është trajtuar ndërtimi dhe forma trupore e njeriut (L. Rees, 1950, Milicerowa, 1951, M. Lorr dhe V. Fields, 1954, W. Hammond, 1957).

Me matje antropometrike është marrë A. Skibinska (1970, 1977), Ferenc Bakoni (1968), Josip Babiq (1986), Jan Babiak (1987), Xh. Stevanoviq (1990).etj. Ndër hulumtuesit e trevës sonë (Kosovë) duhet veçuar hulumtimet antropometrike, morfologjike, fiziologjike dhe anatomike të popullatës sonë, si bie fjala, hulumtimet shkencore të prof. dr. sc. Mustafë Aliu (1991 – 2005), prof. dr. sc. Ajvaz Berisha (2002, 2005), prof. dr. Hasim Rushiti (1999-2005), dr. sc. Abedin Bahtiri (2004), mr. sc. Flori Bruqi (2001- 2005), prof. dr. sc. Ibrahim Behluli (1999-2005); prof. dr. sc. Bajram Nura (1999-2005); prof. dr. Hilmi Dautaj (1999-2007); prof. dr. Agim Vela, prof. dr. Hysni Daka, prof. dr. Natyre Karahoda etj., etj.

“Raca shqiptare”, është e mbështetur në hulumtimet e

bëra nga Pittard dhe të tjerë, të sjella më një tab. matjesh cefalike dhe kranimetricke të tre popujve të Siujdhesës Ballkanike: të shqiptarëve, grekëve, sllavëve (serbë dhe bullgarë);

Tab 1. Skema e tipave cefalikë me përqindje (sipas J. Milaj)

POPUJT

1. Brakicefalë - Shqiptarët 79,50% 11,60% 8,90%
2. bC Mezocefalë-Grekët 48,98% 17,24% 33,70%
3. mC Dolikocefalë- Bullgarët 24% 22% 24%
4. dC- Serbët 29,8% 30,70% 39,20%

Siç shihet në këtë tabelë kranimetricke, brakicefalia është shumë e lartë tek shqiptarët, është e lartë tek grekët, por mjaft e ulët tek sllavët (në raport më shqiptarët dhe grekët), kurse dolikocefalia është mjaft e lartë tek sllavët, mesatare tek grekët, kurse shumë e ulët tek shqiptarët.

Brakicefalia e lartë tek grekët ka qenë e vërejtur nga antropologët Pittard, Deniker, Bataglia etj.

Ata shohin brakicefalinë dominante tek grekët që banonin në përendem të maleve Pind (që nga Epiri dhe Etolia deri në Peleponez, hapësira këto më përpara të banuara nga dorët), ndërsa këta antropologë, dolikocefalinë e kanë parë me predominancë të lartë në lindje të vargmaleve Pind deri në Atikë.

Sipas këtyre shkencëtarëve, tek rumunët predominon tipi brakicefal, kurse tek jevgët (ciganët) e këtyre hapësirave predominon dolikocefalia.

Prof. dr. Shefki Sejdiu, si dhe disa antropologë të tjerë të shekullit 19, brakicefalinë e shpjegojnë si cilësi të popujve aziatikë, por Renato Bosuti (sipas nesh dhe Jakov Miljat) si dhe antropologjisë bashkëkohore, rrënjët e brakicefalisë i shohim në Evropë.

Antropologu gjerman L. Swidetzky mendon që alpidët (Keltët) dhe dinaridët (Ilirët) kanë pasur një kalim nga dolikocefalia, pra ka pasur një proces dedolikocefalizmi, përkatësisht brakicefalizmi.

Në skemën e mëposhtme do të rikonstruojmë procesin evolutiv të ndryshimeve cefalike nga shkalla primare e tipit ce-

falik me predominancë dolikocefalike (DC) tek indoevropianët në djepin e tyre, që supozohet të ketë qenë hapësira e Evropës Veri-Lindore e që tani është karakteristikë e popujve nordikë (gjermanë, skandinavë) dhe atyre të Evropës Veri-Lindore (sllavët). Supozohet se ky proces ka qenë i hershëm.

Kalimi i tillë nga dolikocefalia në brakicefali i alpino dinaridëve (keltëve dhe ilirëve) është konfirmuar edhe nga P. Bosch - Gmimpera, antropolog i dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit të shkuar...

Siç kemi shkruar me herët në “Alb-Shkencë”; “Art-Café”, “Floart-Press” etj., sa i përket lartësisë së trupit, sipas matjeve të shkencëtarëve, serbët janë të gjatë deri në mesatare, shqiptarët kanë gjatësi mbi mesatare, kurse grekët kanë gjatësi mesatare të trupit.

Si tek Ilirët, ashtu tash edhe te shqiptarët, tipi dinarid, apo Adriatik, apo Ilirik është dominues si për nga forma e kokës dhe gjatësia e trupit, ashtu edhe për nga ngjyra e lëkurës dhe syve; tek shqiptarët dhe grekët hasen mjaft tipare edhe te tipit Mediteran.

Kjo natyrë antropologjike dinarido-mediterane e shqiptarëve mund të shpjegohet me praninë shumë të hershme të protoshqiptarëve në Ballkan dhe Mediteran.

Sipas shkencëtarit kosovar prof. dr. sc. Shefki Sejdiu, për të kuptuar më mirë karakterin dolikocefalik të nordikëve dhe evropianëve verilindorë, janë flokëverdhë, kurse ata të alpinëve dhe dinaridëve-mezocefalikë dhe brakocefalikë, ndihmon shumë rregulli i Bergmanit, sipas të cilit, qenieve të gjalla për të mbijetuar në hapësirë më klimë të ftohtë u nevojitet një masë më e madhe trupore, por mutatis mutandis, në hapësirat e ngrohta apo në ato me klimë të moderuar, nuk u nevojitet një masë e madhe (mbrojtëse e tillë).

Sipas këtij rregulli, rezulton se populli Kelt dhe ai Ilir, më herët se popujt e tjerë indoevropianë u janë drejtuar hapësirave me klimë më të moderuar dhe më të ngrohtë, të Evropës Qendrore dhe Mesdhetare (Mediteranit).

Ky konstatim mund të përforcohet me faktin se edhe tek francezët, si tek shqiptarët, përveç tipareve Alpiko-Dinaride hasen edhe ato Mesdhetare (Mediterrane).

Në fund, mund të pohohet se shumë ndryshime antropologjiko-morfologjike (tipare të kokës, trupit, ngjyrës së lëkurës dhe syve) janë të kushtëzuar nga faktorë gjeoklimatikë dhe rrethana të tjera sociokulturore, historike, kontaktesh dhe raportesh substrato-adstrato-superstratike etj.

Tek shqiptarët hasen gjithashtu gjurmë të lashta etnokulturore, siç janë kuvada, kulti i diellit, kulti i gjarprit, ritet e vdekjes, si, p.sh., mbyllja e syve të të porsavdekurit nga ndonjë i afërm i tij, rit ky i ngjashëm me atë të italikëve të periudhës romake dhe veprime siç është gjakmarrja, e ngjashme me vendetta-n korzikanë apo me atë malazeze etj.

Në fushë të etnolinguistikës, përveç përdorimit virtual dhe simbolik, sidomos të numrave 3, 7, 9, 12 etj., që mund të hasen edhe tek shumë gjuhë të popujve të hapësirës mesdhetare e më gjerë, tek shqiptarët haset edhe një përdorim emotiv i këtyre numrave.

Të hëngërshin shtatëqind mijë dreqër!. Pas shtatë bjeshkëve/kodrave/maleve.

Nga gjuhët e Ballkanit shqipja është e vetmja gjuhë që akoma ruan gjurmë të sistemit vegesimal, si dyzet ($2 \times 20 = 40$); më përpara, në shqip, për të shprehur nocionet "60" dhe "80", janë përdorur strukturat vegisimale trezet (3×20) dhe katërzet (4×20).

Një logjikë e tillë e formimit të emrave haset edhe në baskishte ($2 \times 20 = 40$); në galishte ($2 \times 20 = 40$); $3 \times 20 = 60$; $4 \times 20 = 80$) në oksitanishte dhe në frëngjishte të vjetër ($3 \times 20 = 60$; $4 \times 20 = 80$; $6 \times 20 = 120$ madje edhe $15 \times 20 = 300$); në frëngjishten e re gjithashtu haset $4 \times 20 = 80$ por edhe emra të tjerë të numrave të ndërtuar mbi këtë bazë për numrin, p.sh. 99 thuhet $4 \times 20 + 10 + 9 = 99$, etj.

Profesori i mirënjohur dr. sci. Shefki Sejdiu shkruan : "Në gjuhën shqipe gjallojnë struktura etnolinguistike, apo më

saktësisht antropolinguistike dhe kulturore që dëshmojnë se, që në lashtësi kanë ekzistuar kontakte të protoshqiptarëve dhe të gjuhës së tyre me popuj, gjuhë dhe kultura paraindoevropiane të Mesdheut’.

Këto gjurmë hetohen tek disa emra të sistemit të farefisnisë si elemente matriarkati, p. sh., tek emri ‘motër’. Dhe në vend të konkludimit; këto gjurmë të lashta antropologjike, etnokulturore, gjuhësore, racore që ndeshen tek shqiptarët, nuk janë sjellë këtu vetëm si fakte të ndara dhe të shpërndara. Përkundrazi, në këtu jemi përpjekur që këto fakte t’i shohim si struktura dhe sisteme (jo) raciste.

Pjesa më e madhe e këtyre elementeve dhe fakteve janë gjurmë dhe dëshmi e kontakteve direkte dhe e një jete në simbiozë, që në kohërat më të lashta, me popujt paraindoevropianë dhe indoevropianë si dhe me kulturat dhe gjuhët e tyre në hapësirat e Mesdheut.

Resume

In this work of anthropology (review and controversy) regarding the work of Jakov Milaj “Raca Shqiptare” (1994 and published in 1997) we highlighted many important informations from this virtuous writer’s life and work. He is one of the best writers in this field of anthropology.

Many scientists’ opinion was that the book “Raca shqiptare” is one of the first works written in a very skilful way, where it was described the physical type of Albanian and its evolution.

There were some interesting controversy discussions on the forum alb-science between May and December 2005, for example: Mr. Sc. Flori Bruqi, Mr. Sc. Besnik Pula, Publisher Kolec Traboini, then Albert Nikolla, Prof. Dr. Shefki Sejdiu, Prof. Dr. Mubamedin Kullashi, Enkelid Milaj, Bleron Baralju etc. who brought many interesting information’s of oldest anthropological, etnocultural, language and racial traces of Albanians of the Balkan Peninsula.

We did not brink them as scattered facts but we tried to gather these interesting date as a structure. These were not racist facts like some said about the work “Raca shqiptare” of Jakov Milaj.

The most of the facts and elements of Jakov Milaj works are traces

witnessed by direct contacts and of a symbiotic life since from the oldest times, from people even before Indo-European and Indo-European as well as their cultures and languages in the Mediterranean area – described on the work of Milaj “Raca Shqiptare”.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Aliu, M. :”Razvoj morfoloških obeležja školske populacije i razlike u tim obeležjima na kronološku dob., Doktorska disertacija, 1992, Sarajevo.
- 2.Božina, M. I. : Morfološke osobine jugoslovenskih naroda, etnoantropološki problemi, knjiga 11, Beograd,1990.
3. Bruqi, Flori :”Delikuenca e të miturve dhe ushtrimet trupore”, Flomed, Prishtinë, botimi 1, 2003 dhe botimi 2, 2004.
4. Bruqi, Flori :”Ndikimi sistematik i ushtrimeve fizike në strukturën e personalitetit të sportistit”, Flomed, 2003, botimi 1, dhe Flomed, 2004, botimi 2.
5. Bruqi, Flori :”Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe josportistë para dhe pas vrapimit 400 metra”, punim magjistrate, Prishtinë, 2005.
6. Bruqi, Flori : “Ndikimi i ushtrimeve trupore në personalitetin e të rinjve”, Prishtinë, 2005, projekt.
7. Bruqi, Flori :”Ndikimi i ushtrimeve trupore në fajshmërinë e adoleshentëve”, Prishtinë, 2005, projekt.
8. Durakovic, M. M. i suradnici :”Morfološka antropometria u sportu”, Zagreb, 1995.
9. Milaj, Jakov :”Raca Shqiptare”, Tiranë, 1945 dhe 1997.
10. Materiale të shfrytëzuara të polemikave të autorit Flori Bruqi , të zhvilluara në forumet virtuale “Art-Cafe”, “Alb-shkenca.org” dhe “Sport-ritmi i zemrës” (maj-dhjetor 2005).

(Për shkrimin kritik në fjalë janë shfrytëzuar disertacionet e ndryshme shkencore si ato të: prof.dr. Hasim Rushitit, prof.dr. Ajvaz Berisha.) prof. dr. Sadik Krasniqit dhe shumë punime të botuara në forume, revista dhe gazeta, për çka u jam mirënjohës autorëve).

POLITIKĚ

Arvanitasit, Çamëria, Epiri i Veriut dhe gjendja sot

Fatkeqësisht, ritmet e përshpejtuara të jetës, (sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur njerëzit i përfshiu paniku si sot, jetojnë e gëzojnë të lumtur, ndërsa nesër mund t'i përfshijë me milionë brenda ditës - vdekja me krahët e saj). Nga dita në ditë e kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë njeriun më të pangopur dhe të etur të gëzuar çdo çast jete.

Doemos në vendin tonë, periudha e gjatë e diktaturës së egër, e shpërfytyroi edhe më njeriun nga ana karakteriale duke e transformuar atë në një qenie, e cila tashmë nuk shikon se ku shkel pa lé kë edhe çka nëpërkëmb!

Gjatë kësaj analize nuk i kam vënë vetes detyrë të trajtoj amoralitetin e udhëheqësve diktatorë komunistë, të cilët i shpërfytyruan popujt e tyre nga ana karakteriale. Gjithashtu, nuk kam asnjë synim të mërzi lexuesin duke i shërbyer në tavolinë fakte, sa të panumërta e të ngatërruara historike. Qëllimi im është që, mbështetur fluturimthi mbi një rrjedhë historike faktesh, të rikujtojmë se si erdhi dhe u tkurr Epiri Shqiptar, i nisur nga interesat e fuqive të mëdha dhe në dëmin tonë.

Nga ana tjetër, të ballafaqohen bëmat e atij njeriu të ashtuquajtur të ri socialist, krejtësisht të pa moral, me bëmat e patriotëve të mirëfilltë, që u quajtën tradhtarë nga diktatorët komunistë. E, doemos, edhe qëllimi i fundmë i kësaj analize është të bindemi se u duhet thënë ndal veprimeve antikombëtare të këtyre pjellave hibride të diktaturës komuniste dhe të vazhdohet vepra e atyre patriotëve që, për integritetin e Shqipërisë

me Kosovë edhe Çamëri, morën guximin të nëpërkëmbnin edhe vetë popullariteti i tyre personal!

Me kaç besoj se u përcaktua shtrirja dhe caqet e kësaj analize. Në vazhdim, nuk kam si të mos e falënderoj paraprakisht nga zemra lexuesin e vëmendshëm të këtyre radhëve. Fundja, së bashku me lexuesin, do të përshkojmë shkurtimisht hullinë e ngjarjeve historike; do të shqyrtojmë gjendjen bashkëkohore si edhe do të përpiqemi të japim dhe përfundime se si duhet vepruar në të ardhmen, mbështetur mbi të vërtetat historike, për t'i vendosur ato në vend të drejtë.

Rishikim retrospektiv historik

Çështja kryesore që na intereson konkretisht për Çamët është sqarimi i situatës së periudhës kur filloi copëzimi i Perandorisë Osmane. Nuk do të hyjmë në diskutime akademike që na fusin në mjegullnajën e historisë së lashtësisë. Do t'i shmangim pyetjet retorike nëse ilirët ishin trashëgimtarë të Pellazgëve të lashtë, e, si rrjedhojë, nëse edhe vetë shqiptarët janë trashëgimtarë të tyre autoktonë në Greqi, apo jo.

Gjithashtu kalimthi, po i referohemi pohimeve më të reja, si ai i mësuesit të përmendur të shkollës së famshme të Jenosit, (e cila shkëlqeu gjatë shek. XVI dhe XVII), Jenadhiosit, i cili kishte arritur në përfundimin: “ Arvanitasit, ose albanët, ose shqiptarët, janë përfaqësuesit më autentikë të Ilirisë pellazge“. Por, duke iu referuar së shkuarës së afërt, të cilën drejtuesit e shtetit grek sot as që e përfillin fare, duam të theksojmë se heronjtë e kryengritjes kundër pushtetit otoman, që u quajt Kryengritja Kombëtare Greke e viteve 1821 që shkaktoi fitoren e pavarësisë Greqisë, ishin në masën 90 % arvanitas ! Këtë më së miri e vërtetojnë dokumentet e nisura me 23 gusht 1821, nga përfaqësuesi grek Ipsilanti, aleatëve arvanitas myslimanë për kontributin e tyre në fitoret e Revolucionit Grek, duke i quajtur pasardhës të heronjve tanë paraardhës. E nuk kaluan shumë vjet më pas, dhe pasardhësit e heronjve paraardhës, porse me të shpejtë u transformuan në turkoshqiptarë, arvanitas e nofka përçmuese të tjera.

Lidhur me heronjtë e 1821-s, kam një dëshmi personale të priftit katolik të ritit bizantin, arbëreshit të nderuar Antonio Bellushi. Ai i a ka pohuar vetë Baba Rexheb-it në Teqënë e Tij këtu në Detroit, se kishte qëmtuar dhe gjetur 803 ngulime arvanitase në Greqi, dhe me atë rast na recitoi këngën, (të botuar prej tij tek revista Lidhja që ia dhuroi Babait), që këndohet në Korint e cila thotë :

*Kjo gjuha arbërishte
Është gjuhë trimërishte,
E flit Navarboj Mjauli,
Boçari si dhe i gjith'Suli !*

Heronjtë legjendarë të Kryengritjes Kombëtare Greke nuk kanë qenë kush tjetër por Mjaulët, Xhavellët, Boçarët, Bubulinët e Ndretë me gjithë Kanarët me shokë, (listë e pafund)! Kryengritjes greke, dinamizmin dhe trimërinë e pashoqe ia dhanë vetëm arvanitasit! Por, nuk kaluan shumë vjet, e grekët vunë gjene në fis, (danajtë e pabesë), dhe bënë, dhe vazhdojnë të bëjnë çmos, jo vetëm t'ua mohojnë arvanitasve qenien e tyre shqiptare, po edhe t'ua çrrënjosin me dhunë çdo trashëgimí arvanitase! Në këtë drejtim, hapi më i rëndësishëm ishte lufta që iu bë gjuhës shqipe duke e dënuar me ostracizëm shkollën shqipe!

Gjatë kësaj vazhde, është interesant edhe pohimi tjetër që na bëri Urata Antonio Bellusci, i cili na tregonte se tek po rrugëtonte më këmbë në Greqi, nga njëra qendër arvanitase tek tjetra, takon rrugës një kalimtar, që i drejtohet me shqipen e tij arbëreshe dhe e pyet se sa larg ndodhej fshati "X", vend-ngulim arvanitas. Kalimtari i përgjigjet po shqip dhe i thotë se ai vetë ishte nga ai fshat dhe se e kishte të kotë urata që kërkonte ngulim fisesh shqiptare atje, sepse atje nuk kishte të tillë. Sipas tij, ata ishin të gjithë grekër e, duke mërmëritur më vete, qe larguar. E prifti, tejet i mërziur, e ndiqte me lot hidhërimi në sy arvanitasin renegat, tek i cili trysnía greke ia arriti qëllimit të saj!

Rikujtojmë tashti çastet kulmore që nga shpallja e pavarësisë greke, ku rolin themelor e luajtën trimat arvanitas, e deri në ditët tona.

Pavarësinë nga Perandoria Osmane, Greqia e realizoi në vitin 1829. Që nga ajo ditë ajo veproi, zyrtarisht ndaj fuqive të mëdha me dinakëri, kurse ndaj kombeve fqinje me pabesinë karakteristike të fiseve danaje, e gjithashtu me dhunë e me krime të pashembullta duke zaptuar toka sterë edhe ishuj të shumtë me pangopësinë e një përbindëshi gjatë një gjysmë qindvjeçari.

Por, pikësynimi obsesiv i saj ishte Epiri, i cili, me limanet, tokat dhe kullotat e tij, ishte shtylla kurrizore e shqiptarëve. Shqiptarët më përpara vdisnin se sa ua lëshonin grekëve Janinën, Prevezën, Artën etj. Komitetet e Lidhjes Shqiptare kishin lëshuar kushtrimin nga mbledhja e tyre në Konaqet e Abedin Pasha Dinos në Prevezë, ku morën vendimin të mblidhnin një ushtri prej 30.000 burrash e të mos e lejonin kursesi shtrirjen e ushtrisë greke në Epir. Gjatë muajve prill, maj e qershor 1879, dërgatat shqiptare kontaktuan në kryeqytetet kryesore evropiane qeveritarët vendës dhe u dorëzonin memorandume për t'ua bërë të qartë palëkundëshmërinë e shqiptarëve për t'u dalë zot të drejtave të tyre.

De Rada, në krye të arbëreshëve, nga ana tjetër, punonte me ndjenjë të lartë kombëtare me diplomacinë italiane. Por doemos, veç interesave grabitqare greke, në fushën e lojës diplomatike, rëndësi të madhe kishin interesat e fuqive të mëdha, të cilat, nga njëra anë donin dobësimin deri në shkatërrim të Perandorisë Osmane, dhe nga ana tjetër, kërkonin të ruanin ndikime sa më të fuqishme të shteteve të tyre në fushën e shahut të Evropës Qendrore e Juglindore.

Në vazhdim po i paraqis lexuesit, si në kaleidoskop, pohime e qëndrime sa të pahijshme dhe po aq kuptimplote, se si fuqitë e mëdha kanë luajtur me fatet e kombeve, që ne të shtjellojmë sot problemin Çamëri.

Imoraliteti politik ndaj Çamërisë

Do të duken tejet kundërthënëse pohimet ose pozicionimet e Bizmarkut të gjithëfuqishëm, por faktet janë kokëforta. Ishte ai që si mjeshtër aleancash dhe kundëraleancash që e mbanin, mori përsipër barrën e ndërmjetësit suprem mes fuqive të mëdha, si

Anglia dhe Austro-Hungaria, nga njëra anë, dhe Rusia e Franca nga ana tjetër. Kështu më 15 janar 1877, Bismarck-u e pranoi në parim krijimin e shtetit të pavarur Shqiptar. Kurse në verën e po atij viti, (vetëm gjashtë muaj më vonë), gjatë luftës ruso – turke, Bismarck-u, si edhe ministri anglez i Punëve të Jashtme, Derby, i propozuan Francesco Crispi-t që Italia të pushtonte Shqipërinë. Të keni parasysh katër vilajetet e Shqipërisë: të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës, nëse Austro – Hungaria do të ishte në gjendje të merrte Bosnjën.

Mirëpo Crispi, farkëtari i bashkimit të Italisë, nuk e pranoi këtë ofertë, (në kurrizin e shqiptarëve). Arsyet ishin dy: nga njëra anë, mbase gjaku i tij me prejardhje shqiptare, nuk ia lejonte këtë tradhti, e nga ana tjetër ai nuk donte telashe eventuale as me Austro – Hungarinë.

Vinin e iknin kryeministra e ministra Punësh të Jashtme në Angli dhe Francë, si Lordi Beaconsfield, e pas tij Lordi Gladston, ose Grandvill-i me gjithë Waddingtonin, herë më liberalë e herë më konservatorë, që po ashtu ndërronin pozicionimet e tyre ndaj shqiptarëve dhe ndaj të plotfuqishmit Bizmark! Në mesin e qershorit të vitit 1880, Konferenca e Ambasadorëve vendos që t'i jepej Greqisë gjysma e Çamërisë e të mbyllej problemi. Greqia po fluturonte nga gëzimi. Edhe Bizmarku nuk e kundërshtoi.

Mirëpo, në atë kohë, ministër i Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane qe emëruar Abedin Pasha Dinua (patrioti i madh Çam), e kështu, me këmbënguljen e tij u hodh poshtë ky propozim. Po Greqia ç'bënte gjatë kësaj kohe? Jepte e merrte me dinakëri me ambasadorët e Fuqive të Mëdha. Erdhi kështu edhe shkurti i vitit 1881. Bizmarku, gjykatësi suprem, hedh idenë që Greqisë të mos i jepej Epiri por në vendin e tij ajo të merrte ishullin e Kretës! Mbeti disa muaj pezull ky propozim, dhe vetëm kur më 24 maj 1881 u vendos që Greqisë t'i jepej në Epir vetëm qyteti i Artës me gjithë rrethe. Dhe prapë Bismarck-u e miratoi këtë variant.

Nga ky rishikim e rikujtim, krejtësisht fluturimthi, ashtu siç janë zhvilluar kongreset, mbledhje ambasadorësh, e gjith-ashtu edhe konferenca ndërkombëtare ku është luajtur me fatet

e Çamërisë dhe popullit çam autokton, marr lejen të nxjerr një përfundim :

Ligjet e këtyre fuqive të mëdha ia kanë prerë dorën hajdutit që vidhte një dele për t'ua siguruar ushqimin fëmijëve të tij. Po t'ua hiqje madhësitë atyre kongreseve e konferencave, a nuk u duheshin prerë kokat atyre që i jepnin të drejtën e më të fortit - vetes së tyre të grabitnin territore të tëra ?

U përqendrova rreth këtyre fakteve sa kuptimplote aq dhe të pahijshme, (që t'i shmangem një fjalori banal), për t'i rikujtuar lexuesit se si Fuqitë e Mëdha asnjëherë dhe për asnjë çast nuk kanë menduar për interesat kombëtare të kombeve të tjera. Jo zotërinj. Gjithsecila fuqi e madhe, përveç interesave të veta, ka shikuar dhe mbrojtur! E kjo është brazda përgjatë së cilës vazhdon e zhvillohet historia si edhe trajtohen interesat e kombeve! Para se të vazhdoj më poshtë dua të nënvizoj një moment, të cilin duhet pasur mirë parasysh nga e kaluara historike: Askush nuk të mbron interesat e tua po nuk u përputhën ato edhe me të tija. A jemi të zot t'i shfrytëzojmë rastet? (Duhet mbajtur mirë parasysh rastin e Kosovës). Gomarin nga balta e nxjerr vetëm i zoti, (pavarësisht se me ndihmën e të tjerëve)!

Gjatë kësaj linjeje arsyetimi, do të sjell një shembull shumë kuptimplotë, i cili nuk ka nevojë për asnjë koment. Sipas studiuesit me famë botërore, Franz Bop, gjeneralit francez Xhentili, Napoleon Buonaparti i dërgoi një letër ku theksonte: “Është në interesin e Republikës, që Ali Pashë Tepelena të mposhtë të gjithë rivalët e tij që të bëhet i aftë t'i shërbejë Republikës”. I mbështetur në gjithë faktet dhe dokumentet e studiuara të asaj kohe, historiani Edwin Jacques pastaj nxjerr përfundimin: “Lojën e dinakërisë, Ali Pashai e dinte fort mirë. Në marrëdhëniet e tij me Francën ai nuk synonte t'i bënte shërbime Republikës Franceze, por që kjo e fundit t'i shërbente atij”.

E tashti, në vazhden e gjithë këtyre vendimeve – zhvendimeve, herë pro e herë kundër interesave tona kombëtare, vjen edhe Konferenca e Londrës e Ambasadorëve që e njohu më 29 korrik 1913 Shqipërinë Shtet Sovran. Mirëpo, qeverisjen e shtetit ia njohën një princi të caktuar nga Fuqitë e Mëdha dhe

një Komisioni Ndërkombëtar me gjashtë anëtarë, (nga një prej çdo fuqie të madhe dhe një shqiptari). Këtë e vendosën fuqitë evropiane. Kurse Ministri Amerikan në Greqi, Williams, i cili përfaqësonte një fuqi të madhe, të paineresuar në pazarllëqet e evropianëve, qe shprehur lidhur me këtë zgjidhje : “Një mrekullí e paaftësisë. Një skemë absolutisht e papajtueshme .Një lëmsh gjërash të paqëndrueshme! Gjatë muajit gusht, 1913, Konferenca e Ambasadorëve ngriti një Komision Ndërkombëtar për kufijtë. Djallëzía greke kishte arritur të përpunonte aq shumë opinionin e ligjvënësve evropianë, sa që atyre ua kishte mbushur mendjen se ç’ishte popullatë ortodokse, ishte greke, kurse ajo myslimane ishte shqiptare. Mirëpo, pjesëtari austriak i komisionit, zoti Bilinski, nuk qe i bindur për këtë punë dhe i ftoi kolegët e tij të bënin një vizitë në një shkollë greke në Korçë. Në oborrin e shkollës ai hodhi një grusht me monedha e fëmijët grekë harruan të flisnin greqisht, dhe për t’i kapur monedhat flisnin e bërtisnin shqip, në gjuhën e tyre vërtet amtare! Edhe në shkollën e Ersekës, përfaqësuesi austriak Bilinski përdori të njëjtin kurth ndaj fëmijëve grekë, dhe rezultati qe po ai i shkollës korçare! Mirëpo, sondazhet dora-dorës dhe bindjet e komisionit as i merrte kush parasysh. Vendimi lidhur me kufijtë e Shqipërisë u zgjat dhe u bë tërkuzë, sepse meazalla se binin në ujdí përfaqësuesit e Austrisë dhe të Italisë nga njëra anë, dhe ata të Francës e Ruisë, nga ana tjetër. Kështu frenat e ndërmjetësisë i mori në dorë ministri i Punëve të Jashtme Britanike Sir Eduard Grey i cili ndikoi që kufiri shqiptar i jugut të caktohej në zyrat e Institutit Gjeografik të Firencës!(?) Rezultati?

Më 17 dhjetor 1913 nënshkruhet protokollin i ashtuquajtur i Firencës, ku gjysma e territoreve të banuara nga shqiptarë autoktonë të mirëfilltë mbeti jashtë kufijve të Shtetit Shqiptar! Ç’paturpësi! Iu la Greqisë e gjithë Çamëria me qytetet e saj: Filati, Paramithía, Margëllëçi, Parga, Gumenica e Preveza që banoheshin 100 % nga shqiptarë myslimanë, ku edhe ortodoksët i ruanin të pastra ndjenjat kombëtare! Pale më Janina, e cila kishte qenë qendra e Toskërisë në të gjitha kohët! Ai vendim i padrejtë ishte për të ulëritur tek dihej mirëfilli se Kosturi dhe

Nestrami në Mesjetë, kishin qenë pjesë e principatës së Muza-kajve! O Zot, ç'padrejtësi!

Këto të dhëna historike lidhur me shkëputjen e Çamërisë si truall i populluar në masën 98% nga shqiptarë puro autoktonë dhe aneksimi i saj Greqisë, u qëmtuan vetëm maja – maja që lexuesi i këtyre radhëve të krijojë idenë e përgjithshme të kësaj padrejtësie të skajshme. Me këtë rast i lutem lexuesit të ndjek me vëmendje edhe një dokument që do t'i paraqis, ku del në pah se si Shqipërinë e sakrifikuan dhe e viktimizuan me gjak të ftohtë Fuqitë e Mëdha vetëm që të ruanin interesat dhe drejtpeshimin ndërmjet tyre.

Më 12 gusht të vitit 1913, në Dhomën e Komunave londineze, iu bë një interpelancë ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Sir Edward Grey-t. Ja edhe fjalët e tij: “Jam i bindur se, kur të dihen të gjitha, ky vendim do të kritikohet me të drejtë nga shumë anë, prej çdo njeriu që e njih vendin dhe që e shikon çështjen vetëm nga pikëpamja e popullsisë së tij. Por, duhet të kemi parasysh se, në bisedimet rreth kufijve të Shqipërisë, qëllimi kryesor ishte që të mos hapej konflikt midis Fuqive të Mëdha. Prandaj, në qoftë se marrëveshja mbi Shqipërinë u arrit duke mbajtur harmoninë ndërmjet Fuqive të Mëdha, mund të themi se ka qenë një sukses i plotë për interesin jetësor të paqes në Evropë”.

Me këtë shfaqësim moral, Sir Edward Grey mendoi se kreu një mision sa të vështirë e po aq edhe delikat lidhur me shuarje tensionesh politike në atë pjesë të Evropës së quajtur Gadishulli Ballkanik. Mirëpo, ç'la prapa ai ndërmjetësim politik; sa i padrejtë - po aq edhe kriminal ndaj kombit shqiptar, nuk qe krijim baraspeshe qoftë edhe artificiale. Ajo padrejtësi e ushtruar me të drejtën e më të fortit, i sendërtoi premisat që Gadishulli Ballkanik të transformohej në një fuçi baruti. Nga ana tjetër, përkëdhelja që i u bë sedrës së sëmure greke, të etur për lavdërinë e humbur të dikurshme, qe edhe preludi i një vazhde dhune, krimesh edhe gjaku të derdhur pafund, ku mijëra fantazma të viktimave fëmijë, pleq, gra dhe burra shqiptarë do ta kenë ndjekur dhe vazhdojnë ta ndjekin si mallkim shpirtin

e arkitektit të asaj skëterre tokësore, Sir Edward Grey-n, edhe në jetën e pëртејme!

Grekët në vazhdën e rrugës së krimeve

I dhanë Greqisë ishujt e detit Egjë, e ata nuk u kënaqën. I dhanë edhe Çamërinë me 50.000 banorë etnikë shqiptarë, e sërishmi grekët donin më shumë. Ia aneksuan gjithashtu edhe Vilajetin e Janinës me gjithë 500.000 banorët e saj ku vetëm 100.000 ishin greqishtfolës (ndonëse edhe ata me ndjenja shqiptare). Me një fjalë, të gjitha ato që grekët artificialisht i kishin emërtuar Epiri i Jugut, sipas Megalidhesë (idesë së madhëstisë greke). Dhe prapë danajtë, çakejtë e Ballkanit, ishin të pakënaqur nga Fuqitë e Mëdha: e donin Epirin të tërë, Korçën e Gjirokastrën pa lënë jashtë as Vlorën!(?) Nuk kishin faj grekët, ndaj ata mirëfilli e dinin se rrallë, shumë rrallë e drejta pajtohet me politikën! Pikërisht nga ky këndvështrim ata e kërkonin edhe Vlorën si pjesë të Epirit Veriut, ndonëse ajo kafshatë, ishin të bindur, që për baraspeshë në mes Fuqive të Mëdha, dihej se i ishte lënë Italisë. E ç'taktikë ndoqën atëherë grekët?

Zyrtarisht, kryeministri Venizellos shpalli tërheqjen e trupave greke, e për këtë veprim e vuri në dijeni edhe Konferencën e Ambasadorëve. Kësisoj edhe ministri i Punëve të Jashtme Anglez, Sir E. Grey shfaqti konsideratën e tij. Por, nga ana tjetër ushtarët grekë, duke i hequr shenjat dalluese të uniformës së tyre, u bashkuan edhe me bandat e terroristëve grekë të liruar nga burgu i Kretës qëllimisht, e të maskuar si “Detashmente të Krishtera”; në gjithë zonën e Korçës e Gjirokastrës veç zjarr, dhunë dhe krime nga më të pashembullta përdorën ata. E tmerruan popullsinë shqiptare! Qindra fshatra dogjën (për të qenë të saktë, 314 ishin ata). Mijëra qenë viktimat burra, gra, pleq e fëmijë! Po sjell këtu tekstin autentik se ç'tha në Dhomën e Lordëve të Londrës Markezi i Lansdowne lidhur me kasaphanën që po bënin grekët ndaj shqiptarëve: “Është e pamundur të ekzagjerohen mizoritë që po kryejnë bandat greke në Shqipërinë e Jugut. Këto banda përbëhen nga ushtarë grekë të lënë mbrapa, mbasi ushtria greke zyrtarisht u largua nga ato vise. Ata nuk i

kanë ndërruar as uniformat, por vetëm i kanë shqepur spaletat dhe çdo shenjë identifikimi. Shqiptarët po i vrasin me duart e tyre gratë dhe fëmijët që të mos i lenë të bien në duart e grekëve. Grekët kanë shkatërruar fshat pas fshati që të mbulojnë gjurmët e mizorisë së tyre!”

E ftoj lexuesin të mos mërzitet tek i paraqis, ndonëse shumë fluturimthi, dokument autentike të asaj kohe.

Para Dhomës Komunave koloneli Aubrey Herbert bëri denoncimin: “Unë akuzoj Qeverinë Greke si nxitëse të veprimëve që sollën këto mjerime. Dyert e burgut të Janinës nuk mund të çelshin aksidentalisht. Kush tjetër veç qeverisë i armatosi kriminelët që dolën së andejmi? Kush i nxiti andartët e Kretës të shkojnë poshtë e përpjetë duke vrarë e duke prerë? Prapë, Qeveria Greke. Kush ka bërë për vite me radhë një propagandë gjithë vrerë? Qeveria Greke ...”

E mbasi të gjitha këto të vërteta të përbindshme u sollën në sipërfaqe nga personalitete të huaja, si reagoi i caktuari si arbitër dhe ndërmjetës suprem, Sir Edward Grey? Nga dokument të kohës rezulton se ai tha: ”Duhet pasur parasysh se kasapi i shqiptarëve, koloneli Dulis, është përjashtuar nga lista e oficerëve të ushtrisë greke. Si pasojë, qeveria nuk mund të quhet përgjegjëse për veprimet e tij.”

Dhe mllëfi ynë nuk ka se si të ketë kufij tek lexojmë se si ky diplomat i shquar i Britanisë së Madhe, i cili duhej të ishte indinjuar në kulm nga ç’dëgjoi rreth krimeve greke në Dhomat e Lordëve, si edhe të Komunave, tregon se i ishte drejtuar shumë ashpër, sipas tij, kryeministrit, zotit Venizellos: “Informatat mbi ngjarjet e Shqipërisë së Jugut që më janë dukur si të besueshme, ia kam transmetuar Qeverisë Greke. Gjithashtu i kam vënë në dukje zotit Venizellos, se ai vetë, jam i bindur se dëshiron sinqerisht që këto punë të mos ngjasin, por me që janë kryer nga grekë sado të papërgjegjshëm, efekti i tyre në opinionin e jashtëm nuk ka se si të jetë i favorshëm.”

Besoj se ngjall kureshtje të mësohet se cili ishte qëndrimi aspak diplomatik i Venizellosit në Parlamentin e Athinës, tek shprehej gjithë krenari :

“Vetëm një gabim kolosal dhe trashanik do të shkaktonte shkëputjen e Epirit të Veriut prej Greqisë, tashti e tutje !”

Nuk më mbetet se ç'të shtoj, veçse t'i rikujtoj lexuesit se gjatë kohës që diplomacia evropiane merrej me vendime e kundërvendime, si edhe me telegrame diplomatike, përgjet e kufomave dhe gërmadhat e banesave ishin provat e gjalla se si e kishin katandisur grekët të ashtuquajturin e tyre, Epirin e Veriut! Dhuna e tmerrshme dhe shpërnguljet masive nga Çamëria, me gjithë Vilajetin e Janinës, e gjithashtu edhe krimet e djegiet e përbindshme në zonat e Korçës dhe Gjirokastrës, provonin dukshëm dhe pagabueshëm se ato krahina, sa të gjera dhe të populluara vetëm nga shqiptarë, çdo gjë mund të ishin, por jo territore greke !

Strategjia e re greke dhe aktiviteti i patriotëve tanë

Kongresi i Berlinit i 1878-ës që pikënisja nga ku Greqia filloi zyrtarisht edhe me këmbëngulje të kërkonte aneksimin e krahinave që ajo i quajti Epiri grek. Mbasi territorialisht ajo zhvati aq sa deshi, me përjashtimin e Korçës dhe të Gjirokastrës, krahina të cilat i bëri tokë të djegur, iu kthye tashti taktikës së re, të spastronte edhe Greqinë nga shqiptarët. Nuk ishin pak por bëhej fjalë për dhjetëra e dhjetëra mijëra myslimanë, kryesisht të Çamërisë që ajo, e marrë vesh me Turqinë, donte t'i niste të popullonin tokat e Anadollit e që andej të merrte greko – ortodoksët e t'i sillte në pronat çame. Bisedimet u zhvilluan me 14 maj 1914, në mes ambasadorit turk në Athinë, Galip Beut dhe kryeministrit grek, Venizellos. Kurse me elementin shqiptar të besimit ortodoks, grekët kishin bindjen se do ta asimilonin me anën e fesë dhe atë të shkollave greke. Lidhur me këtë, masat ishin marrë me kohë. Në shkollat e ortodoksëve të gjitha lëndët zhvilloheshin në gjuhën greke. Tekstet e historisë dhe të letërsisë ishin të përshkuar nga një urrejtje e skajshme kundër myslimanëve. Djallëzia greke nuk njihte kufij.

Në Kushtetutën e vitit 1911 Parlamenti Grek kishte parashikuar, në pikën 17, reformën agrare të shoqëruar edhe me një sërë aktesh nënligjore. Qëllimi i fundmë i reformës agrare ishte të goditeshin si pronarët e mëdhenj ashtu edhe të mesmit

e deri tek të vegjlit çamë! Me këto akte nënligjore grekët i paralizuan pronarët çamë duke ua ngrirë pronat dhe çifligjet në dorë, (Roberto Morozzo della Rocca – Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944). Dy aktet nënligjore që morën fuqí e që paraqisnin poshtërsinë e skajshme greke për t'i shpronësuar shqiptarët, ishin ai me të cilin u ndalohej shitja e tokës dhe që u quajt me emrin apollotriosis (tjetërsim), si edhe ai me të cilin u konfiskohej toka dhe që u quajt *enigoistasis*, (“Drita”, Gjirokastër – 28 nëntor 1923 si edhe H. Isufi-Politika greke për dëbimin e popullsisë çame). Të lidhura këto masa edhe me terrorin e egër të ushtruar nga bandat e hierolitëve ndaj pronarëve çamë, praktikisht popullata çame nuk i shihte më vetes rrugëdalje jete në Greqi veç të ikte në Anadollin e largët, ose të strehohej në Atdheun Mëmë, në Shqipëri.

Janë të panumërt dokumentet dhe korrespondenca e patriotëve shqiptarë ku denonconin Lidhjen e Kombeve, Konferencat e ndryshme ndërkombëtare dhe qeveritë e Fuqive të Mëdha për veprimet antiligjore dhe kriminale të qeverisë greke, por të gjitha binin, pak a shumë, në vesh të shurdhër.

Sa për të treguar se cila ishte fryma e atyre viteve rreth problemit çam, që konsiderohej se mund të zgjidhej në rrugën e së drejtës, po citojmë një dokument tipik të asaj kohe (nxjerrë nga dokumentet e AQSH “Dokumente për Çamërinë 1912 – 1939”) ku me datën 3 dhjetor 1922, z. Mehmet Konica, pasi ka kontaktuar, (sipas udhëzimeve të ministrit të Punëve të Jashtme, z. Pandeli Evangjeli) deputetët e Parlamentit Anglez duke u kërkuar ndihmë për zgjidhjen e problemit çam, vë në dijeni, duke i dërguar një kabllogram, edhe gazetës Associated Press të New Yorkut. Me një fjalë patriotët shqiptarë bënë përpjekje të mëdha të sensibilizohej problemi çam në gjithë opinionin botëror të asaj kohe.

Zoti Ali Këlcyra, i paraqet Këshillit Kombëtar të Parlamentit Shqiptar me 18 dhjetor 1922 në mbledhjen e tij të 98-të, (sipas “Dokumente për Çamërinë 1912-1939 të AQSH), një kërkesë të prerë që me Greqinë, pavarësisht nga diplomacia teorike e fqinjësisë së mirë, të protestohet rreptë lidhur me vuaj-

tjet që u shkaktohen dhe shtrëngesat që u bëheshin vëllezërve çamë në tokat e tyre në Greqi. Kurse Bahri Omari, i kërkon Kryesisë së Parlamentit (po aty në dokumentet e AQSH), t'u dërgohen telegrame gjithë parlamenteve të botës, e doemos përfshirë edhe atë grek, që të ndalohen menjëherë përndjekjet ndaj popullsisë çame autoktone në viset e saja!

Gjatë viteve 1923–1925 u dëbuan nga Çamëria 30.400 çamër të besimit mysliman, si edhe 30.000 shqiptarë myslimanë të tjerë nga krahina e Janinës dhe nga Kosturi, Follorina e Grebenéja !

Po të studiohen dokumentet nxjerrë dhe botuar nga fondi i AQSH “Dokumente për Çamërinë 1912-1939”, ka një mori syresh, ku z. Mit'hat Frashri, herë si Ambasador i Shqipërisë në Athinë, ose si i dërguar i Qeverisë Shqiptare në Asambleenë e IV-të të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, i drejtohet z. Erik Drummond, sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, me kërkesa të fuqishme lidhur me shkeljen e të drejtave të çamëve që Qeveria Greke i kishte katandisur në gjendje të mjerueshme.

Mes morisë së dokumenteve të AQSH qëmtojmë V. 1923, D. 203, f. 47, ku Prefekti i Gjirokastrës, z. Kolë Tromara, tërheq vëmendjen se si Qeveria Greke mbas dhunës e terrorit të egër ndaj popullsisë myslimane çame, ka filluar e përdor dinakërinë e saj duke u munduar t'i bind çamët të shkojnë në Anadollin Turke. Për këtë ai bashkëngjit shumë dokumente me dëshmi, shkruar nga çamë atdhetarë që i denonconte z. Kolë Tromara veprimet e palës greke.

Sa për një kujtesë lexuesit, autorët e këtyre dokumenteve që qëmtuam dhe sollëm si shembuj përpjekjesh të skajshme të këtyre patriotëve shqiptarë, që çështjen çame e kishin për zemër po aq sa edhe çështjen kosovare, se u dhimbsej Shqipëria, e për të do të jepnin jetën e tyre pa një e pa dy, pjesa më e madhe e tyre u dënuan me vdekje si tradhtarë, kush në mungesë e kush me pushkatim nga diktatura komuniste !

Mësime për t'u nxjerrë nga historia

Pavarësisht se në mënyrë shumë skematike, por mendoj se paraqitja e gjendjes së trojeve dhe ngulimeve të popullatës autoktone shqiptare në atë që sot quhet hinterlandi grek, (thellësi e territorit të sotëm të Greqisë), i kanë rikujtuar lexuesit atë pjesë historie, e cila vazhdon dhe është një plagë e hapur e kombit tonë!

Nga ana tjetër, duhet të jetë bindur lexuesi se në kuadrin e politikave ndërshtetërore nuk ekziston e drejta virtuale, por vetëm interesat, herë të ngushta e herë me qitje më të largët të shteteve më të fuqishëm! Kur interesat e tyre përputheshin me tonat, na dukej sikur po na i përkrahnin të drejtat tona legjitime. Sapo interesat tona fillonin e binin sadopak ndesh me interesat e tyre, sado anësore që të ishin ato, ata e harronin drejtësinë dhe fillonin e shikonin problemet nëpërmjet syzeve të interesave të tyre. Ky kuadër lexohet qartas nga e kaluara jo shumë e largët e mesit të shekullit të XIX-të, dhe pastaj vazhdimisht gjatë gjysmës së parë të shekullit të XX-të dhe ndriçon plotësisht vetë periudha gati gjysmëshekullore e diktaturës komuniste. Enver Hoxha, përveç që ishte numri një i vendit tonë, fillimisht i harroi premtimet jugosllave mbi plebishitin kosovar të pasluftës, e në vazhdim pranoi edhe të pabërën, që Jugosllavia të na gëlltiste si republikë të VII-të të sajën, (për ç'gjë AQSH ka plot dokumentet përkatëse). Kjo periudhë përkon me dhunën e egër, me pushkatimet në masë të atdhetarëve intelektualë të shquar si edhe klerikëve. Në vazhdim Shqipëria u bë vasale e B. S. e porsa ky i fundit kërkoi përtëritje në udhëheqje, valë e re pushkatimesh, këtë herë nga radhët e bashkëpunëtorëve ushtarakë e kolegëve më të afërt të diktatorit. Vijuam gjatë viteve, duke u vëllazëruar me Kinën. Na përdori Kina si zëdhënësin lehës të saj në OKB për aq kohë sa iu nevojitëm dhe na sakrifikoi si leckë kur aleancat perspektive të saja ranë ndesh me interesin personal të diktatorit E. Hoxha. E, përsëri, valë pushkatimesh në Shqipëri; këtë herë nga radhët e specialistëve që po e sabotonin ekonominë.

Po me problemin çam si u ballafaqua diktatori shqiptar?

Për të nuk kish se si të ekzistonte ai problem, derisa për t'i marrë me të mirë fqinjët jugorë anekënd fshatrave minoritare, lejoi

hapjen e shkollave greke. Po nuk mjaftoi kjo, edhe Lljako Vima (Zëri i Popullit) botohej për ta në greqisht. E të mbetej me kaq, hallall mund të thoshte ndokush. Solidariteti fqinjëmirë shkoi deri atje sa që minoritare e kishim edhe zv/kryetaren e Presidiumit të Kuvendit Popullor, shoqen Vitorí Çurri, pa le edhe zv/kryetar i Gjykatës së Lartë u pa e arsyeshme të emërohej i nderuari Sofokli Krongo !(?)

Gjatë kësaj brazde, analiza e veprimeve të politikanëve të mëdhenj të Fuqive të Mëdha ndaj Shqipërisë, çonte ujë vetëm në mullirin e tyre. Gjithashtu edhe politika e vetë diktatorit të Shqipërisë, me gjithë lakenjtë që e rrethonin, duke u mbyllur në guaskën e tyre veç të kishin pushtet mbi popullin, (pa interesat e kombit nuk kishin asnjë rëndësi), ishte vënia e interesit të ngushtë personal përmbi interesat kombëtare.

Tashti e ngushtojmë rrethin dhe vijmë konkretisht në ditët tona. Vendi ynë doli papritmas nga rrethi i çeliktë i izolimit, ku e kishte futur diktatura e kuqe. Është e qartë se nga njëra anë mungonin drejtuesit e gjithashtu atyre vetë, të improvizuar drejtues u mungonte përvoja. Vërshuan nga jashtë konsulentë e mashtrues, sipërmarrës dhe shkatërrues, financierë dhe grabitës. Kësisoj, demokracia e brishtë shqiptare po mundohej të merrte revanin e saj mes pengesash të panumërta. Interesi personal i nëpërkëmbur për gjysmë shekulli, tek të ndershmit e frenonte veten nga normat e moralit, (aty ku ato ishin ruajtur si atavizma). Ndryshe ngjiste me të paskrupulltit. Ata Zot e kishin paranë e moralin. As nuk dinin se ku e kishte folenë. Kësisoj e në ato kushte, është e qartë se do të lulëzonin edhe elementet vendës, të cilët nuk stepeshin t'i shisnin edhe gratë e tyre veç për pushtet ! Kush doli mbi sipërfaqe në atë ujë të turbulluar që ishte Shqipëria ? Ata elementë që deri dje ishin simboli i njeriut të ri socialist: pjellat e deformuara të regjimit të përmbysur, që nuk shikonin as se ku edhe mbi kë shkelnin! Këta e krijuan situatën e 1997-ës. Këta ishin ata që me premtimin e kthimit kreditorëve të parave të piramidave, me të marrë pushtetin, lumenjtë e parasë likuide të firmave piramidale i kanalizuan drejt bankave greke që pas 1997-ës mbinë si kërpudhat mbas shiut në Shqipëri !

Por edhe radiot greke, shumë të interesuara se ç'bëhej në Shqipëri, për çdo natë tkurrjen e pushtetit qeveritar drejt Tiranës e njoftonin bujshëm u çlirua Gjirokastra, u çlirua Tepelena, u çlirua edhe Vlora, e kjo jepej me haré të madhe fill në vazhdim të krimit të egër që u bë ndaj atyre oficerëve të rinj të SHIK-ut, Lekës dhe Besnikut, që nuk qëlluan me armë ... dhe u masakruan në mënyrë barbare!

Pale paratë që u shpërndau Greqia keqbërësve që filluan e dogjën shkolla dhe shkatërruan banka gjatë asaj periudhe çmendurie masive!

Kur kasta e re e drejtuesve të sotëm të Shqipërisë erdhi në pushtet dhe gjeti edhe hallvë mbi revaní, kryesimin e Kishës Ortodokse Autoqefale nga ana e “Fortlumturisë Tij” Anastas Janullatosit, i cili si aktivist me përvojë të madhe, ua lehtësoi hap pas hapi bashkëpunimin tejet të mirëkuptueshëm me qeverinë e Greqisë, doemos padyshim në favorin e interesave kombëtare shqiptare !(?)

Strategjitë më të fundit greke

I hedhim tashti një sy të shpejtë taktikave greke. E kërkonin ata me ashk Epirin si të tyrin përgjatë gjysmës së shekullit të XIX-të. Dogjën e shkretuan Korçën, si dhe Gjirokastrën me rrethe të tyre, dhe kur panë se nuk ua njihte njeri të ashtuquajturin Vorio – Epir, ndërruan edhe taktika.

Ata zyrtarisht pranonin gjoja se do të çelnin shkolla shqipe në Çamëri, por nga ana tjetër, duke shkelur me të dyja këmbët vendimet e Lidhjes së Kombeve, asnjë e tillë nuk u lejua të hapej dhe patriotët e mësuesit e parë tanë, si Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi me shokë, u përndoqën aq sa edhe Mitropoliti i Kosturit Fillareti i “mallkoi shkronjat shqipe!”

Nga ana tjetër, më 20 janar 1923, Konferenca e Lozanës kishte marrë vendim kategorik që asnjë familje myslimane shqiptare të mos shpërngulej në kuadrin e shkëmbimeve të ndërsjella të popullatave greko – turke. Kurse qeveria e Greqisë zhvendosi me dhunë dhjetëra mijëra banorë myslimanë nga Çamëria, të cilët Turqia i dërgoi ta popullonin Anadollin!

Disa herë, kryeministra grekë janë shprehur formalisht se nuk ekziston më gjendje lufte në mes dy shteteve tona; kurse Parlamenti i Greqisë, i cili është organi legjislativ që e ka i vetëm të drejtën ta heqë gjendjen e luftës me Shqipërinë, kurrë nuk e ka abroguar atë ligj. Shembull konkret është fakti se ndërtesa e Ambasadës Shqiptare në Athinë, që ka qenë pronë shqiptare, vazhdon e është mall i konfiskuar nga shteti grek dhe ambasada jonë e ka selinë gjetiu! Kurse Qeveria Shqiptare hesht edhe gëlltit.

Me nismën e “Fortlumturisë”, Kryepeshkopit grek të Shqipërisë Janullatosit, njëra pas tjetrës po ndërtohen kisha ortodokse në Shqipëri, me tendencë zhvendosjeje të ndërtimit të tyre drejt veriut. Ç’qëndrim mban qeveria jonë? Për hir të marrëdhënieve miqësore me fqinjët sërish hesht! Kurse në Greqi, ndihma e shtetit grek për emigrantët tanë është tejet e madhe e miqësore: një të ndërruar ata fenë edhe emrin, e janë të lirë, pa i penguar kurrkush, të ndjekin meshat në kishat greke!

Po kështu edhe për shkollimin e fëmijëve shqiptarë në Greqi: pse të krijohen telashe e të ngrihen shkolla shqipe në Greqi? Asnjëri nuk i pengon mijërat e fëmijëve shqiptarë të shkollohen në shkollat greke. E doemos edhe qeveria jonë, në shenjë mirëkuptimi të ndërsjellë, e mirëpriti ngritjen e shkollës greke në Korçë!

Dhe kulmin e mirësjelljes sonë e treguan Presidenti dhe Kryeministri ynë, që as e luajtën qerpikun kur Presidenti i Greqisë ua tha në sy, publikisht, se tashmë nuk ekziston problemi çam! E, si t’ia bënin ata? Mikut në shtëpinë tonë t’i silleshin si harbutër? Jo, kjo nuk do t’u kishte pasur hije!

E, doemos kjo mënyrë të vepruari nga të dyja palët nuk ka se si të mos na e kujtojë kolosin e mendimit filozofik mistik, Hirësinë e Tij, Baba Rexhebin, i cili nuk pushonte së përsërituri se : Nuk ka më të madh armik të njeriut se sa egoizmi i tij. E kur ky egoizëm gllabëron drejtues fatësh kombesh, ata bëhen rrezik për vetë njerëzimin!

Është e qartë se në kuadër njerëzimi, udhëheqësit e sotëm shqiptarë në pushtet, nuk arrijnë të luajnë ndonjë rol. Por, nëpër-

këmbjen e interesave kombëtare ndaj atyre personale, e kanë arritur plotësisht. E, natyrshëm lind pyetja: Deri kur do t'i durojë populli këto thithëlopa që dora-dorës po i shesin interesat e kombit? A ka turp më të madh që në kongresin e tyre të fundit i referohen me krenari bëmave të tyre përgjatë vitit 1997, vit i cili e shkatërroi nga themelet shtetin tonë?

Botuar: 27.11.2005.

<http://floart.blogspot.com/2005/11/arvanitasit-amria-epiri-i-veriut-dbe.html>

A ka “Intifadë” shqiptare në Iliridë?

Përplasjet e vazhdueshme mes shqiptarëve dhe maqedonasve, shpeshherë të dhunshme, janë krahasuar nga disa media ndërkombëtare me dy Intifadat Palestineze të vitit 1987-1993 dhe 2000, që ndodhen në Izrael.

Dy arsyet më të mundshme qëndrojnë midis natyrës së dhunshme e marrëdhënieve mes dy etnive ballkanase, ose paqartësitë nga mediat ndërkombëtare në trajtimin e këtij konflikti.

Megjithatë, Sam Vankin, ish-këshilltari ekonomik për qeverinë maqedonase, i sheh të dyja arsyet si një demonstrim të hapur injorance mbi “dy zonat dhe katër personalitetet politike” të përfshira.

Vankin shpjegon se maqedonasit, duke qenë komb i vogël, shpesh kanë rënë pre e pikëpamjeve keqdashëse të shteteve fqinje si Bullgaria, të cilët e shohin maqedonishten si një version provincial e qesharak të gjuhës bullgare.

Ndërsa Greqia që përbën dhe fuqinë investuese më të madhe në ekonominë maqedonase i konsiderojnë maqedonasit pushtues sllavë.

Serbët janë të bindur se maqedonasit janë serbë të vendosur në pjesën jugore të Serbisë; por nëse këto teza që vënë në pikëpyetje identitetin e maqedonasve, shërbejnë thjesht për politikë ekspansioniste të shteteve në fjalë, mbetet ende për t'u parë.

Dhe shumë natyrshëm, Sam Vankin ngre pyetjen: Kujt i duhen armiq të në Ballkan, nëse fqinjët mund ta kryejnë atë punë?

Krejt natyrshëm, maqedonasit janë shumë të ndërgjegjshëm ndaj rrezikut që këto interpretime mbi identitetin e tyre mund të kenë ndaj integritetit tokësor prej 25 mijë km², në anën tyre të historisë dhe pa dyshim, gjuhën e tyre - maqedonishten.

Fatkeqësisht, të tria këto shqetësime janë shkrirë në një kërcënim të vetëm, që sipas maqedonasve vjen nga shqiptarët.

Statistikat flasin për 25% të popullsisë të përbërë nga etnia shqiptare, por që po t'u shtosh zhvillimet e dhjetëvjeçarit të fundit, si shqiptarët e riatdhesuar, lindjet dhe censura të mundshme që mund të kenë pësuar këto shifra, vlera rritet në 33 %.

Dhe kjo është mase e dukshme kudo në Maqedoni, shqiptarët gjenden kudo, veçanërisht në pjesën perëndimore të vendit në kufi me Kosovën.

Mirëqenia e tyre e tejkalon atë të bashkatdhetarëve të tyre që jetojnë në Shqipëri e Kosovë, por të qenit një minoritet bën që ata të bien viktimë e komenteve raciste dhe diskriminimeve të formave të ndryshme, sidomos në edukim dhe punësim.

Gratë në komunitetin shqiptar parapëlqejnë të mos punojnë, për shkak të normave zakonore dhe për shkak të obligimeve që kanë ndaj familjes.

Por, duke konsideruar këta faktorë, papunësia mes shqiptarëve në Maqedoni është më e madhe se ajo mes maqedonasve dhe arrin vlerat 25-30%.

Në mënyrë të paevitueshme, këto politika diskriminuese shkaktojnë pakënaqësi mes shqiptarëve, veçanërisht mes intelektualëve dhe atyre me edukim të lartë, dhe e gjithë kjo në natyrën ballkanase shndërrohet në nacionalizëm ekstrem dhe armë, jo domosdoshmërisht me këtë rend, shprehet Sam Vankin.

E gjithë kjo përshkallëzohet dhe më tej kur shqiptarët në Maqedoni zgjedhin të valëvisin flamurin shqiptar në vend të atij maqedonas në festimet zyrtare.

Këto fakte flasin hapur se një pjesë e minoritetit shqiptar në Maqedoni, vazhdon të ushqejë ëndrrën për një Iliridë, pjesë e së cilës të jetë dhe Maqedonia perëndimore.

Shekuj të tërë marrëdhëniesh “miqësore” mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, nuk e kanë ndaluar këtë të fundit të ndërtojë një imazh stereotip për shqiptarët, si të zhytur në aktivitete të nduarnduarshme dhe me tendenca për t’u veçuar nga pjesa tjetër e komunitetit.

Në krahun tjetër, shqiptarët e Iliridës, shohin situatën edhe më shumë kur insistojnë se “terrori shtetëror” i ushtruar mbi ta është një fenomen normal, më shumë se sa raste sporadike të keqtrajtimit nga policia maqedonase.

Është më se e dukshme se ku i ka rrënjët debati shumë-vjeçar mbi çështjen e gjuhës shqipe dhe përdorimit të saj në institucionet e arsimit të lartë të shqiptarëve në Maqedoni.

Pala maqedonase i sheh këto kërkesa si fillimi i fundit të tyre si komb, dhe nuk heziton të ofrojë si shembull rastin e Kosovës.

Në fillim ishin kërkesat më se të zakonshme dhe të arsyeshme në lidhje me respektimin e Konventës së të Drejtave të Njeriut dhe çështjet në lidhje me punësimin, edukimin dhe shëndetin. Më pas vijuan njësi ushtarake, UÇK, të ndjekur me mbështetje nga Fuqitë Perëndimore për të arritur një kompromis për t’i akorduar shqiptarëve të Iliridës të drejta civile legjitime. Në fund erdhi NATO.

Kjo pjesë e historisë e shtyn Maqedoninë të mendojë se shqiptarët në Maqedoni (Iliridë) do të ndjekin të njëjtën taktikë dhe në pjesën Perëndimore si dhe në pjesë të tjera të Serbisë.

Me sa duket, maqedonasit duket se besojnë më shumë në vizionin e një Shqipërie të Madhe, sesa vetë Shqiptarët.

Por, më shumë se besim, mund të jetë frikë për të parandaluar një tjetër ndërhyrje ushtarake në përkrahje të shqiptarëve.

Por, e ashtuquajtura “intifada shqiptaro-maqedonase” nuk është për çështjen e një Shqipërie të Madhe, sa është për pikëpamjet ekspansioniste; është sheshazi e qartë që është një simbiozë mes një idealizmi të tepruar dhe realiteti krejt të ndryshëm.

Rezistenca është në dorë të një grupi të përzier me ish-anëtarë nga UÇK si dhe studentë me ndjenja të forta patriotizmi, kryesisht kosovarë, por dhe shqiptarë të Iliridës.

Ata kanë gjetur mbështetje logjistike të gjerë nga banorët e zonës, si në spitale, armë, ushqim etj.

Kjo revoltë tregon hapur se në lojë tashmë nuk janë vetëm çështja e të drejtave, por dhe çështje politike dhe ekonomike të shqiptarëve të Iliridës.

Më të rezervuar ndaj kësaj situatë duken ata shqiptarë që nuk janë anëtarë të partisë shqiptare në fuqi, dhe duket se një fuqi e tretë politike është formuar për të mbështetur këtë pjesë të Iliridës.

Ish anëtarët e UÇK-së e kanë gjetur veten te papunë, ose të punësuar për pak më shumë se asgjë, ndërsa aktiviteti kriminal është marrë përsipër nga vetë shqiptarët e Shqipërisë.

Por, do të ishte e padrejtë të thuhej se në lojë janë vetëm arsye financiare; shumë shqiptarë në Iliridë janë të lodhur e të zhgënjyer nga pushteti i shumicës sllave dhe *një intifadë e mundshme* do të ishte më shumë për të shprehur të gjitha këto pakënaqësi.

Deri tani, duket se kjo revoltë nuk ka gjetur mbështetje të gjerë mes njerëzve të thjeshtë dhe drejtuesve politikë, për vetë arsyen se do dëmtonte tej mase ekonominë.

Duke përjashtuar dr. Sali Berishën e dr. Ibrahim Rugovën, të cilët i fituan zgjedhjet e fundit, politikanët e Shqipërisë, të Kosovës dhe Maqedonisë i kanë dënuar këto episode dhune të politikës megalomane të FYROM-istëve të konvertuar në “demokratë”.

Por, mungesa e një mesazhi të qartë ndaj autoriteteve maqedonase sugjeron një konsensus në heshtje me zhvillimet në rajonin e trazuar...

Sam Vankin i përshkroi përpjekjet e palës maqedonase për të plotësuar disa nga kërkesat e minoritetit shqiptar, si një ironi të madhe; DPA, partia shqiptare, është një nga elementet më të rëndësishme dhe stabile të një koalicioni të paqëndrueshëm.

Vankin gjithashtu u shpreh se përfaqësues nga komuniteti shqiptar janë prezentë në Qeverinë Maqedonase, dhe çështja e përdorimit të gjuhës shqipe në institucione arsimore është drejt një rezolute të pëlqyeshme.

Ndoshta është për këto arsye që Maqedonia është kapur në befasi pavarësisht nga paralajmërimet e shumta.

Por, kërkesa e çështjes shqiptare mbetet e patundur, për të fituar statusin e një kombi përbrenda një federate apo konfederate.

Në të njëjtën kohë, nuk është aq naive sa mund të duket; terminologjia daton më 1946, dhe 1974, kur Kushtetuta e ish-Federatës Jugosllave(1974) njohu të drejtën e një shteti përbërës të një konfederate për vetëqeverisje dhe ekzistencë të pakërcënuar.

Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë

Albin Kurti u lind më 24 mars 1975 në Prishtinë. Shkollën fillore (1981-1989) dhe shkollën e mesme (1989-1993) e përfundoi në Prishtinë me rezultate shembullore. Në vitin akademik 1993/94, Albin Kurti, filloi studimet dhe i kreu ato në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës. Në gusht të vitit 1997, Albin hyri në Unionin e Pavarur të studentëve të Universitetit të Prishtinës si anëtar i kryesisë së Unionit me detyrë për marrëdhëniet me jashtë. Albini ishte gjithashtu njëri ndër organizatorët e protestave paqësore të studentëve të UP për lirim të objekteve shkollore, të cilat mbaheshin nga profesorët dhe studentët serbë. Albini, së bashku me kryesinë e UPSUP, organizuan protesta paqësore të studentëve më 1 tetor 1997, 29 tetor 1999, 30 dhjetor 1997 dhe 13 mars 1998. Gjatë kësaj kohe ishte ftuar në disa takime në Uashington DC, New York, Burksel, Kopenhagë dhe në Parlamentin Evropian në Strasburg me qëllim që të informonte komunitetin botërorë rreth kërkesës së ARSYESHME të studentëve. Albini, gjithashtu, është takuar edhe me personalitete të larta të politikës së jashtme botërore, si Robin Cook (ish-ministër i jashtëm i Britanisë së Madhe), Kluas Kinkel (ish-ministër i jashtëm i Gjermanisë), Huber Vedrine (ministër i jashtëm i Francës), Robert Gelbard (ish-përfaqësues special i Presidentit Klinton për Ballkanin) dhe me ambasadorët dhe përfaqësuesit e ambasadave të vendeve perëndimore, të cilët ishin të akredituara në Beograd. Në gusht të vitit 1999, Albini filloi të punonte

në Zyrën e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së Adem Demaçi, ku shërbente si përkthyes. Në fillim të marsit të vitit 1999, Albini ndërpreu të gjitha aktivitetet në UPSUP dhe pranë Zyrës së Përfaqësuesit Politik të UÇK-së për të vazhduar studimet e tij në universitet. Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s, Albini qëndroi në Prishtinë, kur policia serbe e arrestoi atë me 27 prill 1999 dhe deri me 1 maj u mbajt në burgun e Prishtinës. Më 2 maj u transferua në burgun e Lipjanit, ku ai qëndroi deri më 10 qershor. Gjatë kësaj kohe u torturua barbarisht. Albini u akuzua për takimin me Richard Holbrooke, të cilin, në të vërtetë, kurrë nuk e takoi dhe për takimin me Christopher Hill. Më 10 qershor, Albini dhe shumë shqiptarë të tjerë të burgosur u transferuan nga burgun e Lipjanit (Kosovë) në burgjet serbe. Më 12 qershor Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq informoi që Albini mbahej në burgun e Pozharevcit. Në Gjykatën e Qarkut në Nish, e cila mori kompetencën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, u mbajt gjykimi kundër Albin Kurtit, njërit prej udhëheqësve të studentëve shqiptarë, i cili ishte burgosur më 27 prill 1999, në Prishtinë.

Në fillim të gjyqimit Albin Kurti deklaroi se është shtetas i Republikës së Kosovës, se nuk e pranon këtë gjykatë, por vetëm gjykatën e popullit të vet, se nuk do të përgjigjet në pyetjet e gjykatës dhe se refuzon avokatin. Në aktakuzë theksohet se Albin Kurti “gjatë vitit 1998, ka marrë pjesë në krijimin e bandës, e cila ka qenë në përbërje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” dhe se ka marrë pjesë në “negociatat për këmbimin e policëve në Dragobil e Likoc”, se ka “qenë anëtar ilegal i Kryesisë së Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës” dhe “sekretar i përfaqësuesit politik të UÇK-së – z. Adem Demaçi”. Gjatë këtij procesi gjyqësor, Albin Kurti, midis të tjerash, ka thënë se si anëtar i Kryesisë së Unionit të Pavarur të Studentëve dhe si kryetar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të këtij Unioni ka organizuar demonstratat e studentëve, “që kishin për synim pavarësinë e Kosovës dhe marrjen e Universitetit, si dhe kthimin e studentëve dhe profesorëve shqiptarë”. Sipas fjalëve të Albinit, qëllimi i demonstratave ka

qenë “pavarësia e Kosovës dhe lufta kundër regjimit serb, i cili me forca policore e ka pushtuar Kosovën dhe ka ushtruar dhunë ndaj shqiptarëve”. Albin Kurti po ashtu ka deklaruar para gjykatës se është e vërtetë se ka qenë sekretar i përfaqësuesit politik të UÇK-së, z. Adem Demaçi, dhe se këtë e ka bërë për shkak të admirimit dhe respektit ndaj tij dhe për ta përkrahur dhe paraqitur politikën e UÇK-së” për realizimin e qëllimit të shenjtë - Pavarësisë së Kosovës dhe çlirimit të shqiptarëve nga regjimi okupues fashist i Slllobodan Millosheviqit. Albin Kurti u dënua me 15 vjet dhe pas ardhjes së Koshtunicës në pushtet u lirua. Më 10 shkurt të këtij viti u paraburgos nga njësitë speciale të SHPK-së dhe UNMIK-ut për demonstratat e sotme të Lëvizjes “Vetëvendosja”.

[http://news.albemigrant.com/index.php?subaction=showfull&id=1178966131-
&archive=1179710499&start_from=&ucat=2&](http://news.albemigrant.com/index.php?subaction=showfull&id=1178966131-
&archive=1179710499&start_from=&ucat=2&)

Nder, respekt dhe krenari për Albin Kurtin

Akademik prof. dr. sci. Namik Shehu, sekretar ekzekutiv i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-amerikane shkruan:

I nderuar Zoti Flori!

Më lejoni që nëpërmjet Jush të përshëndes me dashuri shokun, mikun dhe njeriun Tuaj më të dashur z. *Albin Kurtin*, atdhetarin e shquar të popullit të Kosovës.

Nder, respekt dhe krenari për birin heroik të popullit shqiptar të Kosovës, për trimin sypatrembur dhe mbrojtësin e të drejtave të pamohueshme të popullit të vet, guximtarit dhe sokolit të rinisë kosovare trime, djalit të Kosovës heroike *ALBIN KURTIT*; që mbron me dinjitet dhe me meritë *Pavarësinë dhe sovranitetin e vendit të vet*.

Me rastin e lirim të T'ij nga "*robëria e lirisë*" i urojmë atij shëndet, jetë të gjatë dhe sukseset e mëtejshme, në vazhdimin e veprës së tij madhore, të drejtë dhe atdhetare.

Familjes së z. Albin Kurtit i dërgoj përshëndetje dhe falënderimet më të ngrohta dhe bujare, për edukimin e djalit të tyre me atdhetarizëm të lartë.

Përshëndes Popullin martir të Kosovës dhe i uroj Kosovës sa me shpejt *pavarësi dhe shtet të lirë dhe sovran*.

Me respekt dhe konsideratë.

Bashkëatdhetari Juaj, Namik M. Shehu

New York, 12 maj 2007

Botuar :<http://vudi.multiply.com/journal/item/161>

Le të mbetet Doktor shëruesi i njerëzve, nderi i të gjithë shqiptarëve!

Historia, kjo portë e madhe e Jetës, gjithmonë është e hapur për cilindo që kërkon të zërë vend në të.

Të hysh në Histori dhe të bëhesh pjesëtar i saj mjafton të jesh njeri me kulturë, të kesh humanizëm, shpirt të gjerë, t'u japësh shpresë, dashuri dhe, këto i kanë mjekët. Këtë më mirë se kushdo tjetër e dinë pacientë të ndryshëm, ata, që i mbajnë sytë nga sytë e mjekut.

Zemra e mjekut, sikur të kishte mundësi të ndahej në aq copa të shumta sa është edhe numri i pacientëve nuk do kishte mundësi t'i shkonte çdo pacienti, e megjithatë, ata, pacientët e shëruar mbajnë me vete një pjesë zemër mjeku, sepse mjeku, për vetë profesionin e tij human që ka, bashkë me zbulimin dhe shërimin e sëmundjes të japë edhe një pjesë zemre nga zemra e tij.

Një zemër të ngrohtë mjeku e mbante me vete për vite me radhë edhe një ish pacient i ardhur kohët e fundit në Nju-Jork.

Një burrë i moshuar nga Shqipëria kishte ardhur për vizitë tek vajza e tij këtu në Nju-Jork.

Quhet Yzeir Neziri.

Pasi njihemi rastësisht, ku ishim ftuar në një gëzim familjar që na kishte ftuar një bashkatdhetari yni dhe, kur mëson qytetin

tim ku unë jam lindur dhe rritur, çohet e më përçafon, sikur të ishim miq të vjetër, ose sikur ai të ishte borxhli ndaj meje.

- "Po ti qenke nga qyteti i doktor Namikut, more trim"! - më thotë.

E kuptova se për cilin doktor e kishte fjalën, duke e pohuar.

- Si e kam doktorin? - ishte pyetja e tij e parë.

- Doktori është mirë, e ke këtu, jeton në Nju-Jork, - i them.

Unë, sikur t'i kisha dhënë një sihariq të shumëpritur. Që nga ai çast u bëmë "miq" dhe, pothuajse tërë kohën e kaluam me bisedën për doktorin, duke u harruar për çfarë ishim mbledhur.

- "Ah, male, male, që nuk takoheni me njëri tjetrin, ndërsa ne njerëzit, njeriu patjetër do takohet me njeriun një ditë, more mik"! - tha zotëria i moshuar...

Në fund lamë një ditë me zotin Yzeir Neziri: ditën dhe orën t'i shkonim në shtëpi Doktor Namikut për ta takuar, duke thyer edhe rregullat e jetës, pa e njoftuar. Kjo ishte dëshira e zotërisë, t'i bënte surprizë vajtjen në shtëpi dhe takimin me doktorin.

Gjatë vizitës në shtëpinë e Doktor Namikut dhe në bisedën që patëm, unë mësova shumë më shumë se ç'dija për atë njeri.

Doktor Namik Shehu!

Doktor i nderuar kardiolog, shkencëtar, profesor, bir i qytetit të Beratit që u lind dhe u rrit në atë qytet. Një jetë të tërë në shërbim të njerëzve jo vetëm të qytetit të tij, por edhe të qytetarëve të tjerë nga e gjithë Shqipëria.

Doktor i aftë në profesionin e tij dhe i palodhur në punë, që gjithë jetën e tij ia kushtoi jo vetëm shërbimit shëndetësor, por edhe leximit, literaturës, kërkimit, studimit në fushën e mjekësisë, shkencës.

Doktor Namiku gjatë gjithë karrierës së tij si mjek, nuk mund të rrinte i qetë duke iu gëzuar mbajtjes së diplomës: "Shkëlqyer".

Puna studimore e shkencore ishte etja e tij për t'u ulur me

orë të tërë mbi libra, për të gjetur atë, bërthamën e re të frytit që mjekësia shqiptare duhet të jepte.

Në vitin 1980 mbron disertacionin për gradë shkencore, Kandidat i Shkencave Mjekësore me temë: “Presioni arterial dhe hipertensioni arterial thelbësor”, 150 faqe.

Në vitin 1984 merr titullin: “ Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor, ndërsa në vitin 1994 laureohet me gradën shkencore: “Doktor i Shkencave Mjekësore”

Portreti i Doktor Namik Shehut është i gjerë dhe i larmishëm, sa të shkruhet në një faqe gazete nuk mjafton para gjithë aktivitetit të tij shumëvjeçar si doktor.

Doktor Namiku ka qenë anëtar i këshillit shkencor të Ministrisë në vitin 1971, kryetar i shoqatave të mjekëve në Berat gjatë viteve 1971-1994, ndihmësgjyqtar për shumë vjet, kryetar i shoqatës Shqipëri - Turqi për Beratin dhe nënkryetar i kësaj shoqate si republikë në vitet 1991 – 1997. Ka qenë edhe anëtar i Shoqatës Evropiane të Kardiologëve dhe të Dhembjes së Kokës nga viti 1992.

Doktor Namik Shehu është dekoruar disa herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me “Urdhrin në Shërbim të Mirë të Popullit”, ndërsa nga Instituti Amerikan i Biografive me titullin: “American Medal of Honour”.

Dr. Namiku gjatë gjithë jetës së tij nuk i është ndarë asnjëherë punës kërkimore-shkencore nëpërmjet kurseve të kualifikimit pasuniversitar, disertacioneve për gradë shkencore e deri në referencat e studimet shkencore që kapin mijëra faqe të daktilografuara.

Ka botuar disa monografi në fushën e shëndetësisë: Veprimet anësore në antibiotiko terapi dhe presioni arterial, hipertensioni patologjik dhe mjekimi.

Në vitin 1983 ka botuar monografinë me bashkautor: “ Reumatizmi artikular akut dhe pasojat e tij” me një vëllim prej 208 faqe.

Ka bërë përkthime dhe përshtatje. Ka botuar artikuj në revistat “Shëndetësia Popullore”, “Buletini i UT-së”, “Seria e Shkencave Mjekësore”, “Punime Neuro-Psikiatrike”, “Punime Neurologjike” e shumë të tjera.

Për probleme të shëndetit ka mbajtur disa referate dhe është folur edhe në RTSH.

Ka mbajtur referate brenda dhe jashtë Shqipërisë, në 30 sesione dhe konferenca shkencore.

Në vitin 1993 në Pavia të Italisë: “In Congresso Nazionale di Cardio-Neurologia”, si dhe në Liezh të Belgjikës në vitin 1994.

Qyteti i Beratit si dhe qytetet e tjerë fqinjë kanë pasur fatin të kenë mjekë të aftë si Doktor Namik Shehu, i cili ka punuar përkrah mjekëve të tjerë të aftë, që kanë një emër nderi në Mjekësinë Shqiptare si: Maksut Dërrasa, Pandeli Çina, Lluka Muço, Ymer Dishnica e shumë të tjerë.

Dr. Namik Shehu jeton prej tetë vjetësh me familjen e tij në SHBA, Nju-Jork, i cili gëzon të dy nënshtetësitë, shqiptare dhe amerikane.

Edhe këtu Dr. Namiku ka ushtruar veprimtarinë e tij si mjek, duke punuar vullnetarisht në spitalin “Lenox Hill Hospital” në Manhattan.

Është Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në Nju-Jork.

Ka marrë pjesë në takime të shpeshta me ambasadorin e misionit të Shqipërisë pranë OKB -së, ka pasur takim me mjaft interes me ambasadorin e Shqipërisë në Uashington për probleme të akademisë dhe në interes të Kombit Shqiptar.

ç. *Fatos Tarifa*

Kryetari i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane prof. dr. Skënder Kodra është shprehur: “Dr. Namik Shehu është një personalitet shkencor dhe një person i devotshëm dhe i aftë në kryerjen e detyrës, ndërsa Kryetari i Akademisë së Shkencave në Shqipëri, prof. dr. Ylli Popa është shprehur: “Nëpërmjet Doktor Namik Shehut i uroj suksese Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane”.

Vitin e kaluar, në muajin maj, dr. Namiku festoi në qytetin e tij, në Berat, 70-vjetorin e lindjes, bashkë me shumë shok, miq, të afërm të doktorit, nga të cilët, dhurata më e bukur për dr. Namikun ishte respekti dhe mikpritja, që qyteti dhe qytetarët

e tij i rezervuan këtij njeriu të nderuar, ndërsa vetë doktori nga ana e tij mallin dhe mungesën disaveçare do ta shuante duke iu bërë një dhuratë tepër e çmueshme për qytetin dhe qytetarët e tij; atë mungesë disaveçare do t'ua shuante mallin, duke i dhuruar edhe ai vetë një dhuratë tepër të çmueshme për qytetin dhe qytetarët e tij librin: “Berati, mjekësia nëpër shekuj”.

Për kontributin e lartë që dr. Namik Shehu ka dhënë për popullin dhe shëndetësinë, Bashkia e qytetit e Beratit e ka nderuar me titullin: “Intelektual i shquar i qytetit të Beratit”.

Dr. Namik Shehu është i martuar me mësuesen e nderuar, zonjën Engjëllushe Shehu (Dyrmishi), me të cilën kanë lindur edhe tre fëmijë.

S’ka si të ndodhë ndryshe, kur nga një pemë e shëndoshë detyrimisht që do dalin edhe fryte të shëndosha.

Teuta, vajza e tyre e madhe është inxhinieri e rrymave të ulëta, Eriani, djali i tyre është mjek, po aq i pasionuar sa edhe i ati, si dhe vajza tjetër, Loanda, farmacistë, ku ka fituar edhe titullin “Doktore në Farmaci”.

Duke u njohur me udhën e bukur, të gjatë e të vështirë, në të cilën ka ecur gjatë gjithë jetës së tij si njeri, mjek, drejtues, doktor, shkencëtar dhe për kontributin e tij të madh që ka dhënë, doktor Namik Shehu mbetet shembull i një njeriu, nga i cili kemi ç’të mësojmë e të mburremi me të.

Le të mbetet doktor Namik Shehu njeriu i thjeshtë, nderi i Beratit, i beratasve, i gjithë shqiptarëve kudo që janë dhe të gjithë ne të bashkohemi njëzëri duke i uruar: “Jetë të gjatë, lumturi familjare, dhe shembull për brezat e rinj”.

Interviste me Doktor Namik Shehu

- *Dr. Namiku! unë dëshiroj ta filloj intervistën me ju me pyetjen e pare: Mund të na thoni ju lutem, kush është Dr. Namik Shehu?*

- Jam një intelektual i përkushtuar ndaj humanizmit, i lindur në qytetin e bardhë e të ndritur, në qytetin e lashtë 2400 vjeçar, në qytetin e legjendave të Dodonës dhe Tomorit, në Berat. Kam udhëtuar në tri kontinente. Në Evropë, Azi dhe Amerikë, ku

më është dhënë mundësia të shfaq aftësitë e mia, nëpërmjet disa gjuhëve të huaja, si pedagog, mjek, kardiolog, drejtues, kryetar shoqate dhe sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave Shqiptaro-Amerikane në Nju-Jork. Mbetem i përbetuar ndaj Mjekësisë, duke i kushtuar një jetë të tërë, mbi 40 vjeçare.

• *Si ju lindi dëshira për të vazhduar për Mjekësi?*

- Pyetja juaj, zoti Simsia, me zgjon impresione emocionale. Mos të na duket si çudi se dëshirat e jetës së njerëzve u lindkan shpesh në fëmijëri, siç ka ndodhur edhe me mua. Isha 12 vjeç kur u sëmura në Kampin e pushimit të pionierëve në Vlorë dhe u shtrova urgjent në spital. Më mjekonte një mjek italian, i cili u thotë prindërve të mi se sëmundjen e përballoi fiziku i tij i fortë. Që atëherë më lindi dëshira për t'u bërë mjek, zot i vetvetes si dhe kënaqësia ime për t'i shërbyer popullit tim.

• *Pasi mbaruat studimet për mjekësi, ju jeni nga ata studentë që mbani diplomën "Shkëlqyer". Dëshironi të thoni, ndonjë mbresë, p.sh., nga vitet studentore?*

- Për t'u formuar si mjek më kanë ndihmuar një kompleks prirjesh. Pasioni, durimi, dëshira për të studiuar, aftësia vetjake, memoria. Në bankat e shkollës kujtoj me emocion anatomicën, ku dr. J. Koliqi vinte vetëm notën 2, por kur unë mora notën 5, në provim u befusua gjithë klasën. Në fletoren e matematikës prof. A. Bazhdari theksonte: "Nxënës që meriton të lavdërohet", kurse në praktikë mjeku bullgar me mësoi funksionin lumbar. Në institut akoma i kam të freskëta mbresat nga provimet e shtetit të kirurgjisë, ku prof. Dvinjanjenoi thoshte: "Po më duket se jam me studentët e Moskës", sepse ne i përgjigjeshim rusisht. Më ka emocionuar gjithashtu surpriza, kur nga caktimi në Roskovec më emëruan pedagog në Tiranë. Eh, mbresat janë aq të shumta sa me duhet t'i përmbledh në një libër të tërë me vete, zoti Simsia. Si mjek pedagog kujtimet më rrjedhin si lumi Osum, midis 360 nxënësve të mi dhe shfletimit të fletoreve të notave të tyre. Edhe sot ndjehem i privilegjuar dhe krenar me ata, si nga rezultatet, arritjet dhe për respektin që kanë pasur ndaj meje. Ata u bënë ministra, dekanë, prof. doktorë dhe specialistë të shquar.

- *Ju keni shërbyer për vite me radhe pa u lodhur, jo vetëm në qytetin tuaj, Berat, por edhe në qytete të tjera, si në Kuçovë apo edhe në Skrapar, ku keni qenë edhe drejtor i spitalit të Çorovodës. Si ndjehet doktor Namiku sot, kur kujton ato vite shërbimi mes qytetarëve të ndryshëm?*

- Zoti Simsia! Po me fisnikëron me këtë pyetje, duke më bërë të lumtur, krenar dhe të rinuar. (Sytë i mbushen me lot, e ka të vështirë të vazhdojë të flasë). Nuk e mendoja që me pyetjet e tua të me çojë në vitet e hershme të rinise sime, në ato vitet e hovit të madh dhe të vrullshëm të veprimtarive të mia, ku sakrifica jonë kishte sukseset dhe kënaqësinë profesionale, të shoqëruara me përshëndetjet e të sëmurëve të mi. Skrapari shquhet për mikpritje dhe bujari, siç me priti edhe mua në ato vite, ku unë i fala rininë time. Isha i vetëm që duhet të përballloja gjithçka. Atje kam kryer Trakeotominë, e para në rang Republike. Kam ushtruar mikrokirurgjinë duke aplikuar raush narkozën. Kam bërë punksion lumbar në një fëmijë gjashtë muajsh me konvulsione, që sot punon si infermier në Berat. Kam kryer autopsi në majë të kodrës. Në Kuçovë punoja pa orar dhe vonë në mbrëmje kthehesha në shtëpi në Berat. Në atë kohe më zgjodhën edhe anëtar të Këshillit Popullor të Qytetit, ndërsa emërimin në Berat e konsideroj fat shkollë dhe përvojë të madhe. Atje u specializova si kardiolog. Atje gjeta lumturinë e shpirtit e të familjes sime, bashkëshorten time Engjëllushe Dyrmishi, mësuese e Historisë, Gjeografisë, me të cilën krijova dhe familjen time. Sigurisht, po aty mora respektin, lavdinë, përshëndetjet e bashkëqytetarëve dhe pacientëve të mi, që i kujtoj me mall dhe i nderoj.

- *Doktor, mund të na thoni në mënyrë të përmbledhur për punën tuaj kërkimore e shkencore si dhe referatat dhe konferencat shkencore që ju keni mbajtur brenda dhe jashtë Shqipërisë?*

- Puna studimore e shkencore për mua mbetet pjesa më kryesore e veprimtarisë. Është filluar herët, qysh në vitet studentore me një punim EKG, u vazhdua pa ndërprerje për vite me radhe me studime, sidomos në fushën e kardiologjisë. Kam bërë punime mbi infarktën e miokardit. Kam studiuar vlerat normale të PA në rrethin e Beratit, duke përcaktuar

normat e saj, të ngjashme me studimet në Pavia të Italisë. Aktivitetin tim shkencor e kam konkretizuar nëpërmjet artikujve shkencorë. Referate e kumtesa, përktihme me botime dhe me katër monografi. Kam mbajtur 30 referate e kumtesa në 30 sesione, konferenca e kongrese brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veprimtaria ime shkencore është përgjithësuar me marrje titujsh e gradash shkencore.

- *Doktor! Para pak ditësh ju provuat një ndjenjë emocionante të shoqëruar me një surprizë. Takimi me një ish-pacientin tuaj, që, sigurisht edhe ndoshta e kishit harruar, sepse numri i tyre është i shumtë. Mund të na flisni pak për mbresat dhe emocionet që patët gjatë atij takimi?*

- Shembulli që përmendni ju, zoti Simsia, përbën një nga rastet e shumta e serioze që ka kërkuar dhënien e ndihmës mjekësore dhe ndërhyrjen kirurgjikale në zemër në një kohë sa më të shpejtë. Një i sëmurë i tillë, si zoti Yzeir Neziri, di të vlerësojë mjekësinë dhe mjekun, edhe pse ka kaluar shumë kohë. Ai i ka bërë vend mjekut në mendje dhe në zemrën e tij tashmë të shëruar. Takimi im me të pas një kohe të gjatë ishte një surprizë e kthyer në përmallim, kënaqësi dhe respekt. U gëzova që pashe ish të sëmurin tim, tani të shëruar në vend të huaj, por dhe u kënaqa se mora një shpërblim moral e shpirtëror.

- *Jeni dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me titull: "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" si dhe me gradën shkencore: "Doktor i Shkencave", gjithashtu dhe me një titull të lartë edhe këtu në SHBA, "American Medal of Honor". Ky është një nder që ju bëhet jo vetëm juve, por edhe neve, gjithë shqiptareve. Mund të na thoni diçka?*

- Marrjen e dekorimeve, titujve apo gradave shkencore i çmoj dhe i konsideroj si një shpërblim dhe nder që i është bërë punës sime, si edhe ndihmesës që i kam dhënë popullit dhe të sëmurëve, njëkohësisht i vlerësoj si nxitës dhe inkurajim për veprimtaritë e mia të mëtejshme. Këtij qëllimi i shërben edhe akordimi i titullit: American Medal of Honor dhënë nga një institucion prestigjioz me emër në botë, siç është Instituti Amerikan i Biografive. Ai vlerësoi kontributin e punës sime si intelektual, përfaqësues i qytetit tim Beratit dhe kombit tim shqiptar, radhitur krahas intelektualëve të tjerë të kombësive

të ndryshme. Si i tille, mua më mbetet obligim dhe detyrë e vazhdueshme të punoj dhe të angazhohem më shume për të kontribuar sado pak për popullin dhe kombin tim.

- *Jeni sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në Nju-Jork. Si po ecën aktiviteti juaj në këtë Akademi?*

- Akademia e Shkencave Shqiptaro-Amerikane në Nju-Jork ka si qëllim që si një tempull i dijes dhe i kulturës të kontribuojë sa më shumë për ti shërbyer popullit dhe interesave të kombit tonë. Veprimtaria e Akademisë sonë ka qenë e gjithanshme dhe me aktivitete të ndryshme. Janë bërë mbi 25 takime, mbledhje kryesish dhe ansamble, ku janë shtruar probleme për zgjidhje.. Është shkëmbyer përvojë e Akademisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesve tanë. Pranë Akademisë sonë ekziston organi i saj, revista “Dituria”, ku unë jam anëtar i stafit dhe kam shkruar artikuj të ndryshëm shkencorë e problematikë. Akademia jonë ka zhvilluar në vitin 2004 një konferencë shkencore mbi unitetin në diasporën tonë dhe ka në programin e saj të bejë një aktivitet të gjerë me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

- *Keni pasur takime me dy ambasadorët tanë në Nju-Jork dhe Washington. Çfarë keni biseduar konkretisht?*

Në veprimtarinë e gjithanshëm të akademisë sonë përfshihet edhe bashkëpunimi dhe takimet e mia me ambasadorët e vendit tonë, Shqipërisë në SHBA Me z. Fatos Tarifa kemi pasur një takim zyrtar në selinë e ambasadës sonë në Washington. Takimi dhe diskutimet u përqendruan rreth një bashkëpunimi më të ngushtë për të kontribuar në interes të kombit tonë dhe të Diasporës Shqiptare në Amerike. Me ambasadorin e misionit të Shqipërisë në OKB me seli në NY. z. Agim Nesho bashkëpunimi ka qenë më i hershëm. Ai ka marrë pjesë në Konventën e parë të akademisë sonë. Kam bërë takime dhe biseda me rastin e përvjetorit të Ditës së Pavarësisë së vendit tonë më 28 Nëntor. Dëshiroj që bashkëpunimet të jenë më të shpeshta dhe më frytdhënëse.

- *Doktor, Ju në fillim të bisedës thoni se keni udhëtuar në tri kontinente. Mund të na thoni diçka, ju lutem, edhe për kontinentin aziatik? Si e keni manifestuar dhe çfarë përshtypjesh keni?*

- Përshtypjet e mia për kontinentin aziatik do t'i shpreh nëpërmjet njohjes dhe vizitës që kam bërë në Republikën Turke. Ato mbeten kujtime të paharruara, mjaft mbresëlënëse, impresionuese dhe mjaft prekëse. Në vitin 1991 u formua shoqata miqësore Shqipëri-Turqi si republikë dhe si degë e qytetit të Beratit. Unë isha kryetar i saj. Aktivitetet e shoqatës sonë kanë qenë të shumta dhe të larmishme. Kemi bërë mbi 50 takime në Ambasadën e Republikës Turke në Tiranë, duke e kthyer atë si shtëpi të dytë, siç është shprehur ambasadori Z:Medin Ornekol. Qyteti i Beratit është binjakëzuar me qytetin turk Safran Belu dhe për këtë janë shkëmbyer delegacione. Kjo ka bërë që në mars të vitit 1993 të vinte në Berat një delegacion i Bashkisë së Safran Belusë i kryesuar nga kryetari Mustafa Eren. Po në këtë vit, një grup artistësh të qytetit tonë morëm pjesë në festivalin e qarkut të Sofran Belusë, ku u dha një koncert që u pëlqye shumë. Në vitin 1994, me anëtarët e shoqatës sonë shkua në Safran Belu, duke bërë një turne nëpër Turqi për 16 ditë, ku kemi vizituar qytete me të vërtetë të larmishëm si: Stamboll, Ankara, Bursë, Gemlik, Izmir, Çanakala, duke përshkuar tri dete: Detin e Zi, Marmara dhe Egje. Për mua ishte në veçanti një kënaqësi e madhe se pas 70 vjetësh ndarjesh me njerëzit e mi u takova dhe u njoha me kushërinjtë e mi në Gemlik, si dhe me miq e shokë të tjerë, ku vazhdojmë të kemi lidhje dhe korrespondencë të rregullt.

- *Doktor, vitin e kaluar ju festuat në qytetin tuaj, në Berat, 70-vjetorin e lindjes, ku edhe i dhuruat qytetit dhe qytetarëve tuaj librin "Berati, mjekësia në shekuj". Çfarë mbresash ju la një përvjetor i tillë dhe si u prit ky libër atje?*

- Në një përvjetor të tillë në vendlindjen tënde mbresat, kujtimet dhe përshtypjet mbeten të paharruara, shumë të ndjeshme dhe mjaft të gëzueshme. Ai përvjetor për mua dhe familjen time do mbetet një nder, krenari dhe kënaqësi që më dhanë miqtë, shokët, kolegët, bashkatdhetarët. Vlerën asaj ceremonie

ia rriti edhe dhurimi dhe promovimi i librit tim kushtuar mjekësisë së Beratit nëpër shekuj, i cili u prit dhe u vlerësua shumë, duke e bërë pronë të bibliotekës së qytetit dhe të spitalit. E ndjej për detyrë të falënderoj gjithë pjesëmarrësit, përfaqësuesit e bashkisë, popullin tim të Beratit, të Skraparit, të Kuçovës etj. U mbetem përherë borxhli bashkëqytetareve të mi, duke u uruar atyre dritë dhe lumturi.

- *Ju faleminderit doktor. Edhe unë, sigurisht edhe lexuesit, ju falënderojmë për këto çaste që rezervuat për të na dhënë këtë intervistë aq interesante. Ju urojmë edhe ne gjithashtu juve, jetë të gjatë, dritë dhe mbarësi.*

Pandeli Simsia.

Mirupafshim në Kosovën e lirë!

Nga Mr. sci. Flori Bruqi, Prishtinë

Gospodin Pavle, një peshkop i kishës ortodokse serbe, i vendosur në Pashallëkun e Beogradit, më origjinën e tij të dyshimtë thotë se *Kosova është djep i Serbisë* dhe i fton të gjitha kishat ortodokse botërore t'i kundërvihen Grupit të Kontaktit për Kosovën e pavarur.

Ky matuf serb, me akademikët, politikanët, gjeneralët, paramilitarët serbë lëre që e kallën Kosovën (1997-1999), por tash këta harbutë kërkojnë ta kthejnë Kosovën në gjirin e tyre serb.

“Kishat Serbe” janë kisha katolike-shqiptare, të ndërtuara nga vetë shqiptarët, për këto ka shumë fakte arkeologjike, historike, biblike pikërisht nga BIBLA, sipas “Dhjatës së re” me titullin *Krishti shembull i vetëmohimit* në kapitullin 15 vargu 19, shumë mirë thuhet në të gjitha gjuhët e botës ku predikohet dhe lexohet *BIBLA*, ky libër hyjnor dhe se *Dishepulli Pal*, sjell lajmin e mirë për *Mesinë*, nga *Jeruzalemi* e gjer në *Iliri*.

Pra, në vargun biblik 19 decidivisht shkruan “me fuqi shenjash dhe çudish, me fuqi të Frymës së Perëndisë; kështu, prej Jerusalemit e përçark dhe gjer në Iliri, kam kryer shërbimin e ungjillit të Krishtit”.

Pra, shqiptarët u ungjillëzuan qysh në fillim të krishterimit.

Nëse nisemi nga faktet historike, pikërisht kur behët fjalë për Kosovën, dihet historikisht se serbët janë një popull ardhacak (shekullit VII pas erës së re), në truallin Ilirik. Serbët që ishin paganë filluan të pagëzohesh të krishterë.

Më vonë ata filluan të vjedhin (vjelin) kulturën e popullatës autoktone.

Për të mos u zgjeruar aq shumë në historinë tonë, Gospodin Pavle, i preferojmë që argumentet mitike të “tyre”, fjala vjen për *Luftën e Kosovës(1389)*, që s’ishte fitore e serbëve, dhe se *Milosh Obiliqi* “i tyre” ishte një trim nga Kopiliqi i Drenicës me emrin *Milosh Nikol Kopiliqi*.

Ashtu si ndodhi edhe me Mileshin, njashtu na ndodhi edhe me shumë kisha shqiptare, u bënë më dhunë serbe (*Kisha e Deçanit, Pejës, Graçanicës, Llaushës* etj).

Nëse ky farë Gospodin Pavle dëshiron të mësojë më shumë se kush janë shqiptarët, le t’i gjurmojë të dhënat arkivore të Raguzës, Romës, Jerusalemit, Stambollit etj. dhe do ta gjejë të vërtetën e këtij populli endacak të ardhur nga Karpatet.

Për t’i dëshmuar se kush janë shqiptarët Gosp.Pavles , gjen-eralëve, politikanëve etj. të tij ja po i sjellim për lexuesit e Floart-Pres-it (www.bruqi.com), webit www.dervina.com, gazetës në webin www.ndryshe.com etj ca argumente të tjera se kush janë eruditët e tjerë shqiptarë që dëshmojnë prejardhjen tonë.

Më së miri këto gjëra Pavle mund t’i gjejë në shkrimet e *A. Parduqit, Gjin Gjon Gazulit, Marin Barletit, Gjon Buzukut, Gjon Francez Albanit, Frang Bardhit* etj...

Assesi nuk duhet anashkuar edhe përkthyesin e BIBLËS, të madhin *Shën Jeronimin*, që njihet në tërë botën.

Vallë, a thua ky Gospodin Pavle me sejmënë të tij e lexojnë dhe predikojnë ndonjëherë “Biblen”?!

Në fund i themi atij dhe të tjerëve që mendojnë si ai: **MIRUPAFSHIM NË KOSOVËN E LIRË 2008!!!**

<http://flori-press.blogspot.com>

<http://floart.blogspot.com>

A do të ketë një “Nuremberg Shqiptar” për komunistët dhe krimet e tyre

Shqipëria, i vetmi vend në Evropën Juglindore që nuk u ka hyrë asnjë ferrë në këmbë komunistëve për krimet e tyre. Me sa duket, komunistët shqiptarë u treguan më të shkakthtë për të ndërruar lëkurën rozë-e-blu dhe për t'u infiltruar e degjeneruar një herë e mirë në të ashtuquajturën demokraci shqiptare.

Kush do të paguajë për krimet e komunisteve shqiptarë për plot 50 vjet, kur përveç pasojave katastrofike ekonomike, pati mbi 5300 të pushkatuar; nga këta: 300 gra dhe rreth 200,000 njerëz u internuan direkt ose indirekt.

Çifutët edhe pas më shumë se 60 vjetëve nuk po lënë vrimë pa ndjekur persekutorët e tyre, për të shpague atë që bënë ndaj popullit të tyre, kurse shqiptaret mjaftohen me sloganin “Bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës”.

Kush do të garantojë pastërtinë e Demokracisë Shqiptare në vitet në vazhdim?! Me qindra kriminelë komunistë enden të lirë dhe të majmure nga kapitalizmi që ata nuk donin ta shikonin e ta dëgjonin, dhe për këtë fjalë ata kanë ekzekutuar me gjyqe dhe pa gjyqe mijëra njerëz, por edhe ajkën intelektuale dhe patriotike, më të pastërten e historisë shqiptare. Kush do t'i shpjerë në ferr këta kriminelë?!

Ata që kryen terrorin komunist janë me shumë qindra, dhe këtu është lista e krerëve kryesorë e sistemit kriminal komunist, që akuzohen për vrasje, ekzekutime direkte dhe gjenocid mbi

popullin shqiptar.

“U trondita kur zbrita në Shqipëri, pashë një vend ku pasojat e diktaturës mund të krahasohen vetëm me Kamboxhian”, tha Jevtushenko.

Në marsin e vitit 1993, gazeta “Ringjallja”, organ i Shoqatës së të persekutuarve dhe të të dënuarve politikë të Tiranës, ka botuar një listë me 185 emra, të cilët i akuzon se kanë ushtruar terror, dhunë dhe kanë dënuar për motive politike gjatë viteve 1945-1990 rreth 10.000 familje. Personat që përmban lista e botuar në gazetën “Ringjallja”, mund t’i ndajmë, pas mendimit tonë, në disa kategori:

1. *Funksionarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si: Koçi Xoxe, Nesti Kerenxhi, Mehmet Shehu, Kadri Hasbiu, Feqor Shehu, Hekuran Isai, Simon Stefani, Vaskë Koleci, Miballaq Ziçishti etj.*
2. *Prokurorë dhe gjykatës që kanë gjykuar për motive politike, si: Bedri Spahiu, Aranit Çela, Faik Minarolli, Ago Çela, Mit’hat Goskova, Llazji Polena, Dhori Panariti, Sotir Qirjaqi, etj.*
3. *Hetues për çështje politike, që kanë ushtruar tortura gjatë procesit hetimor, si: Nevzat Haznedari, Avram Koja, Myftar Tare, Dilaver Bregasi, Muço Saliu etj.*
4. *Shefa Sigurimi, në qendër dhe në rrethe, që kanë ushtruar dhunë e tortura, si: Banush Goxhaj, Besim Selita, Dhosi Progrid, Petrit Hakani, Lilo Zeneli, Qatip Dervishi, Kopi Niko, Zoi Themeli, Halim Xhelo, Hilmi Seiti, Gjolek Aliu, Nuri Çakerri, Mehdi Bushati.*
5. *Komandantë burgjesh dhe kampesh me punë të detyruar me të burgosur politikë, që kanë ushtruar dhunë dhe tortura gjatë ushtrimit të detyrës, si: Tasi Marko, Besnik Çomo, Beqir Baja, Çelo Arrza, Bajram Korvafaj, Janaq Karapataqi, Vangjel Rrëmbeci, Niko Kolitari, Qamil Mane, Haxhi Pela, Haxhi Gora, Beqir Liço, Hazbi Lamçe, Burhan Beqari etj.*

I bashkëngjisim kësaj liste edhe emra të tjerë, të denoncuar në gazetën “Liria” dhe në shtypin demokratik të kohës.

Botuar më: 17 shtator 2005

<http://floart.blogspot.com/2005/09/do-te-kete-nuremberg-shqiptar-per.html>

Kryqëzata e tetë

Të dbëna mbi gjeopolitikën dhe gjeostrategjinë në Lindjen e Mesme pas luftës së tretë të Gjirit

Angazhimi ushtarak 2003 i forcave të SHBA dhe Britanisë së Madhe në luftën e 3-të Gjirit për të rrëzuar regjimin Baath të Sadam Huseinit ka shkaktuar në mbarë botën shqetësime politike në lidhje me shkaqet e luftës dhe mënyrën e zhvillimit të saj. Gjithashtu ka qenë shkak më tepër për destabilizimin e Lindjes së Mesme sesa për zgjidhjen e problemeve të shumta në këtë zonë. Para se gjithash dërgimi i qëllimshëm misionar dhe fundamentalizmi shkaktuan një shtim masiv të dhunës dhe sollën pikëpamje të reja në politikën botërore të periudhës pas luftës. Ky shpjegim i ri, i cili tek ne mendohej që nga rilindja si i tejkalar, fetarisht i motivuar, intolerant dhe ushtarak i fundamentalizmit, po mbahet nga presidenti G. Bush dhe shtabi i tij në një këndvështrim perëndimor-krishterë. Po ashtu dhe nga shtete si IRANI, Libia, palestinezët dhe Al Kaida e Hamasi në suazat e një lufte të shenjtë kundër jobesimtarëve amerikanë dhe atyre çifutë.

Ky fenomen ka nevojë të studiohet nga afër për nga pikëpamja gjeopolitike-strategjike.

Kryqëzatat e mesjetës

Shtatë kryqëzatat e mesjetës ishin të ushtrive të krishtera evropiane, nga Evropa e mesme dhe perëndimore, në lindjen e afërt dhe në Afrikën veriore. Për qëllim kishin të çlironin qytetet e shenjta krishtere nga jobesimtarët. Në kundërshtim të plotë me

arabët tolerantë, të cilët kërkonin vetëm një taksë për person për pelegrinët e krishterë që i vizitonin ato qytete, ushtarët me prejardhje fisnore turke dhe selxhuke i ndaluan plotësisht ato dhe kështu u paralizua edhe tregtia në Lindje. Myslimanët “idhujtarë” dhe jehudët “vrasës të Krishtit”, ishin për 200 vjet me radhë armiku më i madh i perëndimit edhe pse të dy ishin pjesëtarë të feve monotheiste. Njëkohësisht, kalorësit e krishterë përpiqeshin në veri të Spanjës e në jug të Francës të dëbonin ushtrinë arabe nga Gadishulli Iberik. Të tria kryqëzatat e para ishin të suksesshme për evropianët, sepse u arrit marrja e Jerusalemit dhe krijimi aty i një mbretërie të krishterë. Mbreti gjerman dhe dinastia e Habsburgeve e emërtonin veten “Mbreti i Jerusalemit” për të arsyetuar kështu të drejtat krishtere mbi Palestinën. Për shkak të reliefit dhe vështirësive në furnizim, u pushtuan vetëm brigjet palestineze, provincat bizantine në Liban dhe në Azinë e vogël dhe Tripoli, Edesa dhe Antiokia. Gjeopolitikisht, ishin këto kolonitë e para evropiane dhe paraprijësit ideologjikë të kolonializmit të mëvonshëm në kohën e zbulimeve të reja.

Duke filluar nga e 4-ta deri tek e 7-ta, kryqëzatat karakterizohen me mosmarrëveshje të brendshme dhe sulme të shumta. Kështu, Kostandinopoja e atëhershme, më 1204 u pushtua dhe u shkatërrua nga kalorësit e kryqit. Që atëherë ndarja mes kishës perëndimore latine dhe asaj lindore ortodokse është aktuale. Me çlirimin e fortesave të kryqtarëve në brigjet e Palestinës, më 1291, nga ana e myslimanëve përfunduan kryqëzatat. Por, ato patën pasoja të mëdha. Për Evropën pozitive ishte kontakti kulturor, me që dituritë e vjetra të arabëve i shërbyen asaj si bazament për epokën e rilindjes.

Efekt tjetër pozitiv ishte zgjerimi i pamjes gjeografike të botës si dhe i diturive natyrore, përfshirë edhe mjekësinë, zhvillimin i tregtisë së largët, artit, kulturës dhe kërkimeve universale, që kanë rrënjët tek kryqëzatat. Përkundrazi, as arabët e as turqit nuk u morën me gjuhën, kulturën dhe organizimin ushtarak të sulmuesve. Në sytë e Lindjes, kryqtarët, pa marrë parasysh se cilit konfesion i takonin, ishin të paarsimuar, të pakultivuar moralisht, dhe një grup vrasësish brutalë.

Ky opinion ishte i bazuar në masakrën e kryqtarëve ndaj pjesës më të madhe të popullsisë arabe, jehude apo krishtere ortodokse në pushtimin e Jerusalemit, më 1099. U pre e u masakrua pa marrë parasysh moshën e gjininë, dhe qyteti u shkatërrua totalisht. Ndërsa kur u riçlirua Jerusalemi nga myslimanët nën komandën e Salaudin Ejubit, iu u fal jeta të gjithë të krishterëve të qytetit dhe nuk pati shkatërrime masive.

Shikuar nga pikëpamja ushtarake, ishte takimi i parë direkt i dy ushtrive me kultura të ndryshme. Për kalorësit evropianë u hap një shesh i ri luftimi. Ecjet ishin të gjata, furnizimi ishte i vështirë, nëpërmjet Italisë, dhe mungesat në personel ishin të mëdha. Kalorësit e armatosur mirë ndihmoheshin dhe nga këmbësoria dhe teknikisht ishin më mirë se sa armata myslimane. Por në aspektin numerik, rezervistët myslimanë ishin më tepër. Fortifikatat e qyteteve të mbrojtura mirë ishin vështirë të merreshin nga ana e myslimanëve. Por, ato kishin pikën e dobët furnizimin me ujë dhe të tjera. Si rrjedhojë, ato ranë njëra pas tjetres nga tradhtia, mendjemadhësia dhe mungesa e unitetit në radhët e ushtarakëve të lartë. Asgjësimi total i një ushtrie kryqtare në shkretëtirën e Sirisë, tek “Brirët e hatimi” me 04. 07. 1187, u bë kthesa vendimtare e luftës. Bilanci total ishte asgjësues. Me gjithë humbjet e mëdha, nuk u sigurua hyrja e lirë afatgjate në qytetet e shenjta të krishterimit dhe nuk u pengua përhapja e Islamit. Përkundrazi islami u përhap në rrugën e tregtisë tokësore e detare dhe në Evropë, deri tek portat e Vjenës; në Azi, deri tek kufijtë e Kinës; në Indi, Indonezi dhe Afrikë. Sot, kryqëzatat e nisura me sinodin e Klementit, nën drejtimin e papës Urban II, më 1095, shikohen me sy kritikë për shkak të mungesës së tolerancës fetare dhe të krimeve të kryera në emër të Jezu Krishtit. Për këtë sjellje të gabuar të kishës u kërkuar falje nga ana e Papa Gjon Palit të dytë, në vitin 2000.

Kryqëzata e 8-të

Në këtë kohë, sërish po bëhet reklamë dhe propagandë për një kryqëzatë, por kësaj radhe jo nga katedralet kishtare, por nga ekrani i televizionit dhe agjencitë e lajmeve dhe mediat. Tony Blair për herë të parë, gjatë luftës në Ballkan, dhe presidenti amerikan, Bush, pas atentatit të 11 shtatorit 2001, përdorën etiketën “kryqëzatë”. Kësaj here kundër terrorit, duke e nxjerrë atë nga arka e historisë së kalbur. Nga qarqet e qeveritare haptazi u etiketuan grupimet dhe shtetet islame si aksi i të së keqes. Pas pasojave të konsiderueshme të këtij etiketimi, në të gjitha zonat islame, ky (etiketim) u transformua në luftë kundër terrorit. Por, dëmi që shkaktoi ky etiketim, mbeti dhe po shpërndahet me sukses nga kundërshtarët e prezencës ushtarake perëndimore. Edhe skena e vjetër nga mesjeta u kopjua: këtu mbretëria e dritës, demokracia, ekonomia e lirë e tregut (duke përfshirë disponimin e pakufishëm tek rezervat e naftës)- atje mbretëria e errësirës, e barbarëve, e shtypjes së ekonomisë shtetërore. Kryqëzata e 8-të, duke filluar me marshimin në Irak 21 mars 2003, në kuadrin e luftës së tretë të gjirit, po kryhet prapë nga një aleancë shtetesh perëndimore, të quajtura shtete të krishtera, por për herë të parë, jo nën drejtimin evropian, por nën atë të SHBA. në botën islame automatikisht zgjohen reflekset mbrojtëse që mund të shndërrohen në zjarr të përgjithshëm. Pastaj, jo pa të drejtë frikësohen: Irani, Siria, Libani, Libia, nga një sulm ushtarak i SHBA nën pretekstin e lirisë, e lidhur me demokratizimin, me forcë, të stilit perëndimor dhe me rregullat e neokolonializmit në organizimin pas luftës. Trajtimi i SHBA ndaj popullsisë myslimane (edhe asaj brenda SHBA) shkaktoi një refuzim internacional të luftës në Irak. Dhe tek dy grupet e mëdha popullore të Irakut, kurdët në veri dhe shitët në jug, gëzimi për lirin nga regjimi i S. Huseinit është mjaft i kufizuar.

Nxijtja për kryengritje pas luftës së dytë të gjirit, dhe nga ana tjetër ndihma e vogël e SHBA, përbën një arsye më tepër për skepticizëm. Gjithashtu, përfytyrimet e një shteti të ZOTIT që kanë shitët, sipas modelit iranian, janë shumë larg nga ato perëndimore për qeverisje demokratike pas luftës. Koha e gjatë që po u duhet amerikanëve për të vendosur rregull e qetësi, si

dhe për të ndërtuar infrastrukturën civile, e cila shikuar nga pikëpamja ushtarake, u shkatërrua pa nevojë, bën që ky aksion ushtarak të shikohet më tepër si një pushtim se sa një çlirim nga ana e shumicës së irakianëve. Sulmi i 11 shtatorit 2001 dhe Intifada palestineze kundër Izraelit (turizmi i Izraelit dhe jeta civile ka pësuar shumë prej intifadës) nxitën fuqishëm heroizmin e atentateve vetëvrasëse (fakt i lidhur dhe me ndihmat për familjet e lëna pas, dikur nga Iraku e sot nga Irani e Siria) dhe nxitën një solidarizim atipik për krejt zonat islame.

Prapaskena ideologjike

Pas rënies së Paktit të Varshavës dhe Bashkimit Sovjetik, perëndimit i humbi figura e armikut «të dashur». Në kërkim të armikut të ri, me qëllim që të justifikohet politika e armatimit, erdhi në skenën politike libri gjeopolitik i Samuel Huntington «Përplasja e Civilizimeve». Ngjashëm si para 70 vjetëve, kur teoria gjeopolitike e Karl dhe Albrecht Haushoferit u keqpërdor nga nacionalsocialistët (në Gjermani sh.r.) ashtu tezat e Huntingtonit ishin justifikimi politik i kryqëzatës së re.

Mes tjerash Huntington parashikon dhe një përplasje të kulturës krishtero-perëndimore me atë islame.

Por as pikëpamja ekonomike, as edhe ajo politike nuk e justifikojnë këtë kryqëzatë. Kjo, sepse qëllimet politike nuk mund të arrihen në praktikë me një luftë të «pastër» teknologjike, por do të shkaktojnë gjakderdhje e mundime për një pjesë të gjerë të popullsisë. Mirëpo, kjo gjakderdhje e ky mundim nuk na ofrohet ne nëpërmjet ekranit televiziv.

Prapaskena gjeostrategjike

Kryqëzata e 8-të është, si dhe ato pararendëse, e dominuar nga interesat ekonomike. Teoria e kundërshtarëve të kësaj lufte të 3-të të Gjirit se: kjo luftë i shërben vetëm furnizimit të SHBA me pasuritë nëntokësore (nafta, etj) nuk mund të mos konsiderohet plotësisht e drejtë. Vetëm 3% të importit të lëndëve nëntokësore tani vijnë nga Iraku, ndërsa SHBA, që para luftës, me 56% ishin

partneri kryesor tregtar i Irakut (përkundër embargos së KB). Në import. rolin kryesor e luante Franca. Vetëkuptohet se lufta për gazin natyror po ashpërsohet, siç tematizoi ish-punonjësi i CIA-s, Guy F. Comso, në Qendrën për studime strategjike ndërkombëtare në mars të vitit 2001.

Rritja e nevojës botërore për energji, sidomos në vende si Kina, do të sjell probleme serioze, nëse krejt rezervat e Gjirit, përfshirë dhe ato të Irakut, nuk do të jenë të gatshme për përdorim.

Me që furnizuesi më i madh i SHBA, Arabia Saudite, është bërë një partner jo i sigurt (shkak për këtë është politika proizraelite e SHBA), e vetmja mënyrë sigurimi do të ishte një goditje e shpejtë, e suksesshme në Irak.

Vaji e gazi natyror janë pasuritë më të rëndësishme të Irakut. Me 15,1 miliarda tonë (10.8% të rezervave botërore) Iraku zë vendin e dytë pas Arabisë Saudite. Këto pasuri gjenden në dy zona; në veri në Kirkuk: 45 milionë tonë në vit, dhe në jug Rumaila veriore me 38 milionë tonë në vit, kurse Rumaila jugore me 25 milionë tonë në vit. Eksportimi i gazit e vajit kryhet nëpërmjet stacioneve Al Fao, Chor al amajja dhe Mina el Bekr me kapacitet 60-80 milionë tonë në vit. Rrjeti i tubacioneve për transport përfshin 4500 km për vajin, 1360 km për gazin, 725 km për produkte të tjera. Tubacioni kryesor me kapacitet 55 milionë tonë në vit, kalon nga Kirkuk nëpër Ceyhan deri në brigjet e Turqisë, në Mesdhe.

Me keqardhje e zemërim, e gjithë bota e civilizuar pa se si në kaosin e luftës, u shkatërruan e u plaçkitën monumente të kulturës duke mos u mbrojtur nga trupat amerikane, edhe pse duhej të mbroheshin. Përkundrazi trupat amerikane mbrojtën me shumë kujdes e efikasitet infrastrukturën e vajit. Këso lloje kontradiktash e forcojnë tezën e atyre që pohojnë se “interesat për vaj janë kryesoret”. Kështu aktiviteti i politikës së jashtme, me vendosjen e bazave; me agresionin ndaj Afganistanit e sulmimin e Irakut, plotësojnë mozaikun e SHBA në lidhje me qëllimet e saj në Lindjen e Mesme për shfrytëzimin e vajit dhe të tregut. Për riparimin, modernizimin apo hapjen e pikave të

reja të naftës, janë të interesuara shumë firma amerikane dhe të aleateve, gjë e cila do të sjell lënien pas dore të firmave gjermane e franceze që gjenden në Irak. Po ashtu, industria e armatimit, që për çdo luftë fiton impulse të reja, nuk duhet nënvlerësuar si faktor ekonomik, politik e psikologjik në SHBA. Por, realizimi i një lufte ekonomike në kornizat e një kryqëzate të 8-të, me mjete ushtarake me qëllim plotësimi të interesave nacionale dhe imponim të tregut të lirë, është me të vërtetë imperializëm dhe Manchester-kapitalizëm.

Prapavija gjeopolitike

Pas rënies së Paktit të Varshavës, mbeten SHBA forca e vetme ushtarake, pasi që vendet e tjera të zhvilluara nuk posedojnë kualitetin dhe kuantitetin e forcave amerikane. Parulla e teoritikut ushtarak Karl von Klauzevitz se “lufta nuk është vetëm se vazhdim i politikës me mjete të tjera” u etiketua si shfaqje e cinizmit ushtarak pas luftës së 2-të botërore. Por në këtë kohë që po jetojmë, SHBA po përdor politikën e “anijeve me topa” të shekullit të 18-të duke u paraqitur si polic botëror me ndihmën e luftanijeve dhe teknologjisë për të imponuar pikëpamjet e saja politike. Nëse aksione të tilla do të merreshin kundër diktatorëve dhe për sigurimin e të drejtave apo të paqes, ato do të ishin më shumë se të mirëpritura. Mirëpo, problemet fillojnë kur ky mirëkuptim nuk ekziston si në rastin e luftës së 3-të të Irakut. Kjo do të ishte më saktë - tentim për vendosje hegjemonie dhe imperializëm i pashpirt që duhet të kundërshtohet ashpër.

Veçanërisht, bota arabe është shumë e ndjeshme dhe e ndjen veten, ashtu si më përpara, të shtypur, të plaçkitur, dhe të përçarë nga perëndimi. Po kështu, as refuzimi i dhunës nga ana e Evropës së “vjetër” nuk solli ndonjë përmirësim në bashkëjetesën paqësore mes kombeve. Kështu jo befasisht shtohen zërat kundër kësaj kryqëzate.

I vetmi shtet, i cili me të drejtë është ndier i rrezikuar në sigurinë e tij nga rrëgjimi i Irakut, është shteti i Izraelit. Raketat skud të Irakut mund ta arrinin lehtë Izraelin si në rastin e luftës së 2-të Gjirit. Të koordinuara me koka atomike apo biologjike,

këto lloj raketash paraqisnin një rrezik ekzistencial për Izraelin. Siç dihet tash më historikisht, SHBA është e vetmja forcë për Izraelin në mjedisin “armiçësor” në të cilin ndodhet ky vend. Për forcën mbrojtëse dhe bashkësinë ndërkombëtare, është e dëshirueshme që të vendoset paqja dhe të eliminohen kërcënimet në lindje. Por, një kryqëzatë e 8-të, përdorimi i forcës ushtarake, është me siguri mjeti më i keq dhe më i papërshtatshëm për të arritur këtë qëllim.

Përkundrazi, bazat ushtarake të marinës dhe ato ajrore të SHBA në rajonin e Gjirit dhe në Azinë e mesme shikohen me dyshim nga shumica e myslimanëve si “qendra të kryqëzatatave të reja krishtere”. Kjo gjë u paraqit dhe para pak kohesh në Afganistan, nga drejtuesit e atjeshëm të fiseve pashtune. Kështu që brigada evropiane që gjendet në Afganistan, për të mbrojtur qeverinë e papranuar nga populli, është e ulur në një fuçi baruti. Refuzimi i vendosjes së trupave amerikane pati si rrjedhojë dhe në Saudi atentate kundër tre blloqeve banimi të perëndimorëve, gjë e cila e arriti qëllimin politik. Pas këtyre akteve SHBA e zvogëluan ndjeshëm praninë e tyre ushtarake në Saudi, veprim ky i cili mund të inkurajojë dhe atentate të tjera. Një nga problemet e mëdha politike është dhe ai kurd, i cili solli një ashpërsim të marrëdhënieve Turqi-SHBA para luftës së 3-të të Gjirit. Shtypja, diskriminimi i këtij populli të vendosur e të sprovuar me vuajtje, është e papranueshme dhe e pazgjydhshme me luftën e Gjirit.

Shkaku kryesor i luftës, e që ishte asgjësimi i armëve të shkatërrimit masiv, që gjendeshin në Irak sipas burimeve të fshehta amerikane, si dhe lidhja me Al Kaidan, as nuk u vërtetuan dhe as nuk u gjet asnjë fakt për to. Këtë e deklaruan vetë inspektorët e OKB-së që ishin të ngarkuar me këtë detyrë. Kështu pra lufta e 3-te e Gjirit u realizua kundër të Drejtave të Popujve, të drejta këto, që është ndërkombëtarisht e vlefshme. Kjo e drejtë u thye nga një vend që dëshiron të paraqitet si “model i demokracisë” për të tjerët, pra SHBA-të.

Një gjë tjetër u paraqit para pak kohësh nga ana e shkrimtarit amerikan Norman Mailer: Lufta për ujin në rajonin e

Lindjes së Mesme. Që sipas tij ka rëndësi strategjike për Izraelin. Duke parë çështjen nga ky këndvështrim, ka kuptim bashkëpunimi, tani më disa vjeçar mes Turqisë dhe Izraelit për projektin e Anatólisë së Jugut, ku dihet se ka rezerva të mëdha të ujit. Problem paraqet vetëm siguria e furnizimit me ujë nga Siria e Libani. Kështu, kryqëzata e 8-te është edhe një luftë për shpërndarjen lëndës burimore të ujit.

Si përfundim, zgjidhja e problemit palestinez është burim konflikti, të cilin SHBA duan patjetër ta zgjidhin me planin “Harta e rrugës”. Por, ka reagime kundërshtuese nga të dyja palët në konflikt, sepse një gjë e tillë kundërshton plotësisht mentalitetin lindor, ku shpesh njihen më tepër ligjet e pazarit. Si rrjedhojë janë shpesh izraelitët ata që vuajnë pasojat e një politike të dështuar perëndimore në çështjen palestineze. Arabët në ndërkohë janë shumë të ndjeshëm dhe e shohin shtetin izraelit si një bazë imperialiste të Perëndimit në zemrën e Arabisë, bazë kjo që vazhdimisht sponsorizohet dhe ndihmohet. Po ashtu, përgjigjja e ashpër e Izraelit ndaj intifadës palestineze nuk ka sjellë ndonjë ndryshim të qëndrimit perëndimor ndaj Izraelit, ashtu që për arabët tashmë është e qartë: ai që është mik i Izraelit dhe politikës jehude, është njëkohësisht armik i arabëve. Palestinezët e dinë tashmë se, sikur të kishte Palestina pasuri nëntokësore (vaj apo gaz) Perëndimi do të hidhej me të shpejtë në ndihmë të saj, si në rastin e Kuvajtit.

Opinionin arab për favorizimin perëndimor ndaj Izraelit mund të formulohet kështu: Izraeli shtyp palestinezët, Perëndimi e mbron Izraelin si rezultat; pra, Perëndimi i shtyp palestinezët. Sikur politika perëndimore të ishte pak më e ekuilibruar (e drejtë) në lidhje me Lindjen e Mesme, ndoshta nuk do të ishte Izraeli armiku më i madh i arabëve. Por kjo gjë aktualisht shikohet me nënçmim nga Perëndimi.

Artikulli i shkëputur nga “Österreichische Militärische Zeitschrift” 5 / 2003. (Revista ushtarake austriake) gusht, 2003

Titulli në origjinal: “Der 8. Kreuzzug - Zur Geopolitik und Geostrategie des Vorderen Orient nach dem 3. Golfkrieg”-Gerhard L. Fasching

Autori: Gerhard L. Fasching

Lindi më 1940; mbaroi më 1963 Akademinë Ushtarake Tereziane në Vjenë, studimet e tjera për Gjeografi, Gjeologji dhe shkencë politike i mbaroi në Grac e Salzburg. 1974-1975 fiton bursë passtudimore nga këshilli kërkimor evropian në Cyrih dhe që prej atëherë është aktivizuar si kërkues e mësues në universitetet e Salzburgut, Insbrukut, Gracit, Klagenfurtit dhe Vjenës. 1980-1993 ishte kryetar i entit gjeografik në ministrinë austriake të mbrojtjes. Prej 1995 teknik civil-këshilltar, inxhinier për gjeografinë dhe specialist ligjor me certifikatë.

Botuar: 3.11.2005.

<http://floart.blogspot.com/2005/11/kryqzata-e-tet-t-dhna-mbi-gjeopolitiken.html>

SPIUNAZH

Agjencitë Greke dhe Sigurimi i Fshehtë i Shtetit Shqiptar

Ish-oficeri i Sigurimit të Shtetit, Bekim Budo, në librin e tij “Shërbimi i fshehtë” pasqyron një dosje interesante të një agjenti grek me pseudonim Papastrati, arrestuar nga shërbimi i fshehtë shqiptar në vitin 1971. Sipas librit të Budos, interesant është fakti se në vazhdimësi agjencitë greke zhvillonte veprimtarinë e saj në Shqipërinë e Jugut dhe kishte në dispozicion informatorë të frytshëm, tejet të përgatitur. Në vitet ’70-të, Sigurimi i Shtetit Shqiptar kishte rënë në gjurmët e kësaj veprimtarie dhe arriti të kapte, falë një kombinimi të përsosur, Papastratin, përgatitur në shkollën e spiunazhit të vendit fqinjë, i cili tregon përpara hetuesve se si ishte vënë në shërbim të grekëve. Kontaktet e tij të para, thuhet në libër, ishin bërë me gjeneralin grek, Vasil Mellaj, që kishte qenë komandant divizioni i trupave greke në Gjirokastrë, e me të e kishte njohur patrioti i tij nga Dervişani, V. Shahini, i cili kishte spiunuar me kohë.

Gjenerali drejtonte dhe një zyrë të shërbimit të fshehtë të zbulimit ushtarak grek “Alfa&Dhio”. Megjithatë, sipas dokumenteve të hetimit të Papastratit, gjenerali grek kishte marrë informacion për agjentin, duke pasur edhe lidhjet e tij të afërta në Shqipëri dhe Greqi, P. Kotokon, O. Anastasjadhin. Pas verifikimit, gjenerali urdhëroi S. Vllahon dhe P. Kotokon të krijonin organizatën antishqiptare MAVI (Metopo Apoleftikon Vorio&Epirotiku), në kryesinë e së cilës u caktua edhe

Papastrati së bashku me V. Shahinin e J. Diamantin, të njohur për ndjenjat filogreke dhe tepër aktiv në veprimtarinë e tyre praktike për aneksimin e trojeve shqiptare. Gjenerali grek e kishte porositur agjentin që të riaktivizonte agjiturën e vjetër dhe të bënte rekrutime të reja, sidomos nga radhët e minoritetit, grekofilëve, grekofonëve, si dhe nga radhët e studentëve dhe nxënësve shqiptarë që studionin ose që kishin kryer studimet në shkollat greke.

Agjuntura kryesore kishte për detyrë organizimin e grupeve agjenturore, të cilat do të ishin bërthama të të rezidenturave në përputhje me situatat agjenturore dhe politike. Kur isha duke përgatitur një leksion për studentët e Akademisë së Policisë, mora leje për të hulumtuar në dosjet operative, ku ishin regjistruar dëshmi agjentësh dhe informacione të tjera të rëndësishme spiunazhi. Mbaj mend se në njëërën prej këtyre dosjeve, ministri Kol Bib Mirakaj, njëherazi edhe sekretar i Partisë Kombëtare Fashiste shqiptare, i dërgon Ministrisë së Arsimit një shkresë rezervate me nr. 3329, datë 11 korrik 1942, lidhur me aktivitetin e shërbimit të fshehtë grek dhe qarqeve shoviniste të vendit fqinjë. Mirakaj i përgjigjej një shkresë të Ministrisë së Arsimit nr. 390 datë 15.4.1942/ XX rezervate dhe një tjetër shkresë të ministrisë së tij nr. 2669/Pol. 27/D/84 Res, që kishin informacion lidhur me listat emërore të mësuesve grekofonë të qarkut të Gjirokastrës, bashkë me informatat përkatëse të marra pjesërisht nga sekretarët politikë dhe nga KK e MM.

Listat që i bashkëngjiteshin këtij dokumenti ishin grumbulluar nga shërbimi i fshehtë i mbretit Zog, nga shërbimi i fshehtë diplomatik dhe nga sekretarët politikë të Partisë Fashiste, të cilët mbaheshin në lidhje agjiture e zbulim-kundërzbulimi. Në këto lista bie në sy numri i madh i mësuesve, të cilët kishin studiuar për mësuesi në shkollat greke dhe ishin të shpërndarë në 163 shkolla të Shqipërisë së Jugut, mësimet e të cilave ishin në gjuhën greke, që përbënin dyfishin e shkollave në gjuhën turke po në këto territore.

Në karakteristikat pranë emrit të secilit mësues, janë shënuar shkurtimisht qëndrimet e tyre në raport me qeverinë e Zo-

gut, ndjenjat shoviniste, si dhe në raport me ndjenjat kombëtare. Predominojnë karakteristikat pozitive të tyre në këto raporte në masën prej rreth 70 për qind. Nga konstatimi në dosje, vura re se problemi ishte më i thellë dhe nuk ishte marrë sa duhet në konsideratë sinjali i alarmit i dhënë nga konsulli i Janinës, Xhemal Frashëri, i cili midis të tjerave theksonte: “Shkolla e Vellasit, e cila dirigjohet nga dhespoti i Janinës, Spiridhoni, një armik i rreptë i Shqipërisë, është ngritur vetëm e vetëm për të përgatitur me kulturë dhe me ndjenja greke rininë e fshatrave grekofonë të Prefekturës së Gjirokastrës, me anë të propagandës helmuese për të arritur qëllimin kryesor satanik, i cili është bashkimi i të ashtuquajturit Vorio-Epir me Epirin. Po nuk morëm masa të rrepta, them me bindje se shkolla në Vellas do të jetë varri i Gjirokastrës”. Nga materialet e tjera të hulumtuara është mjaft afër realitetit të ngjarjeve që bënë të mundur krijimin dhe pompimin e “Megalli Idesë”, apo idesë së madhe, një rrëfim i një agjenti potent grek me pseudonimin Papastrati, i cili përfaqëson tipikisht në mënyrë të koncentruar një veprimtari sa armiqësorë ndaj vendit tonë, aq edhe përbuzëse ndaj Shqipërisë. Në letrën informative të Ministrisë së Arsimit shkruhet: “Është interesante të theksojmë se ky rrëfim është edhe një sintezë e një veprimtarie për më shumë se një shekull e shovenëve, përfaqësues ekstremistë të një nacionalizmi absurd në dëm të një vendi tepër paqësor e miqësor, i cili historikisht ka dhënë një ndihmesë të madhe me anë të komunitetit shqiptar në Greqi, arvanitasve, si Kollokotroni, Karaiskaqis, Bubulina e Boçari, të cilët ishin edhe protagonistë kryesorë të revolucionit grek të vitit 1821, gjë që edhe në historinë moderne të këtij vendi ky kontribut mohohet padrejtësisht. Kundër këtij vendi autokton, fqinjë prej mijëra vjetësh, pas fitimit të pavarësisë, qarqe të caktuara shovene, megalomane dhe aventuriere, në vitin 1867, krijuan organizatën “Vllazëria Qendrore Kulturore”, si dhe klubin “Sillogun vorio-epirot”, të cilat, shkallë-shkallë, do të përbënin bazën e organizatës famëkeqe QEVA (Komiteti Qendror i Përpjekjeve Vorio-Epirote), duke marrë dhe pëlqimin e Patriarkanës së Stambollit. Në krye të kësaj organizate do të vendosej lunxhioti, Kristaq Zografi.

Më 6 qershor 1888, krijohet në Greqi nga Dhimitër Boçari, shoqëria “I vllamidhes Allvani Vllamet” - “Vëllezërit shqiptarë” me një platformë kundër kombit shqiptar për pengimin e gjuhës së shkruar shqipe në alfabetin latin mbi bazën e një strategjie, që kishte qëllim kryesor helenizimin e popullsisë së Shqipërisë së Jugut dhe më gjerë me një propagandë që mbivlerësonte dukshëm kulturën greke, duke nënçmuar kulturën shqiptare”. Shërbimi i fshehtë i qeverisë së asaj kohe njoftonte për një marrëveshje të fshehtë midis Patriarkanës së Stambollit me qeverinë greke, ku u vendos që myslimanët e Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe të Shqipërisë të konsideroheshin turq, ndërsa shqiptarët ortodoksë të konvertoheshin në helenë dhe të administroheshin nga Greqia, pasi shqiptarëve u mohohej kategorikisht aftësia shtetformuese, edhe pse historikisht kishin dhënë prova, madje edhe në Greqi, duke i dhënë asaj jo pak, por rreth 20 kryeministra qysh nga Miauli, Kanari, Kryeziu e deri dhe vetë Lefter Venizellosin, të cilët ishin të gjithë arvanitas, pa bërë fjalë këtu se edhe presidenti i parë grek, Pavlo Kondurjoti, dhe presidenti tjetër, Theodoros Pangallos, ishin me origjinë shqiptare dhe në mjediset miqësore e familjare komunikonin në gjuhën shqipe.

Nga letrat që ndodheshin në Arkivin e Ministrisë së Brendshme, në dosjen e agentit grek Papastrati, mësohet se “Megali-idea” dhe të tjera synime të tyre, amplifikon akoma më shumë dhe bëhen shpejt udhëheqje për veprim në marrëdhëniet e mëvonshme me shtetin tonë, me të cilin qysh pas 28 nëntorit 1912 kishin filluar kontradiktat e mprehta dhe diplomacia e saj mori orientime të qarta nga qeveria greke për sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për gjoja të drejtën e saj për aneksimin e Epirit të Veriut, të konsideruar prej tyre si tokë greke dhe duke u munduar ta justifikonin dhe argumentonin historikisht, sidomos me ekzistencën e minoritetit grek në trojet tona autoktone.

Këto kontradikta shpërthyen kur Konferenca e Ambasadorëve më 8 gusht 1913 përcaktoi kufijtë e Shqipërisë. Edhe pse kufijtë e vendosur nga komisionerët e huaj anglo-francezë dhe italianë kishin lënë jashtë tyre troje të konsiderueshme të

populluara nga shqiptarë autoktonë, grekët dhe një pjesë e mësuesve grekofonë kishin përgatitur, veç të tjerave, nxënësit e shkollave greke të paraqiteshin para tyre, duke u prezantuar si grekë, duke thënë se “Ego ime Elinas” (Unë jam grek) etj. Në të njëjtën kohë, ata provokojnë Konferencën e Korfuzit më 1913, e cila në vendimet e majit 1914, i vuri kushte qeverisë shqiptare për të zbatuar një plan special për minoritetin dhe Vorio-Epirin, në mënyrë që ajo të ishte në çdo kohë prezente në këto treva, si dhe t’i kishte fillimisht nën kujdestari, probleme që ai i ngriti në forume ndërkombëtare e deri në Konferencën e Firences në vitin 1921. Por, siç e dimë nga historia, planet e grekëve u bënë pa hanxhinë.

Kongresi i Lushnjës dhe lufta e Vlorës bënë të mundur legalisht, që marrëveshja Titoni-Venizellos për ndarjen e Shqipërisë të mbetej në letër dhe të zbatohet ilegalisht nga shërbimet e fshehta të këtyre vendeve për t’i bërë fakte të kryera në të ardhmen.

Pikërisht këtë e rrëfen më së miri agjenti potent grek, Papastrati. Në materialet e hetuesisë së asaj kohe shkruhet: “Në Tiranë, në zyrat e hetuesisë u paraqit agjenti grek me pseudonim Papastrati, më 22 shkurt 1971, që për shkak të statusit të tij, të themi special dhe të veçantë, e mori në pyetje zëvendës drejtori i Drejtorisë së Hetuesisë. Agjenti grek vazhdoi rrëfimin e aktivitetit të tij në shërbim të zbulimit grek. Mes të tjerash, ai thotë se: “Pasi mbarova arsimin e mesëm në Zozimea Skoli, vazhdova arsimin e lartë në Athinë, për Mësuesi, të cilin e mbarova me rezultate të larta. Ndërkohë, bashkë me dy bashkëfshatarët e mi nga Klishari, ishim anëtarësuar në Sillogun Vorio-Epirot, me qendër në Athinë, ku në një nga mbledhjet e radhës, kryetari i tij, Kristaq Zografo, që më ka mbetur në kujtesë, na foli për perspektivën tashmë të hapur me pëlqimin e qeverisë greke dhe të Patriarkanës së Stambollit, që t’i përvisheshim punës për aneksimin e Vorio-Epirit, që sipas tij, ato ishin toka greke qysh në lashtësi dhe se e kishin amanet nga të parët që ëndrën e tyre ta bënë realitet sa më shpejt. Pasi që ishin krijuar të gjitha kushtet, ishin mënjeluar të gjitha pengesat dhe jo vetëm

kaq, gjithnjë sipas Kristaqit, ishte marrë pëlqimi i vetë vendeve vendimmarrëse kryesore të Evropës, Angli - Francë - Itali. Nuk kam pse ta fsheh, u entuziazmova për faktin, sepse Shqipëria në atë kohë ishte një vend tërësisht anadollak, tepër i prapambetur, pa kulturë dhe intelektualë; sëmundjet bënin kërdrinë; pa alfabet, pa gjuhë të shkruar, pa shkolla, dhe mendoja në atë kohë së me Greqinë dhe kujdestarinë e saj, Shqipëria do të shkonte përpara në arsim, kulturë, rimëkëmbje etj”.

Dora-dorës Papastrati ishte bërë një nga përkrahësit kryesorë të Zografos. Më tej ai dëshmon: “Në këto aktivitete jam njohur edhe me patriotin tim nga Dervicani, Vasil Shahinin, i cili, mesa duket, më kishte studiuar me kohë dhe më rekomandoi te gjenerali grek, Vasil Mellaj, i cili kishte qenë komandant divizioni i trupave greke në Gjirokastër dhe që drejtonte dhe një zyrë të shërbimit të fshehtë të zbulimit ushtarak grek, “Alfa-Dhio”. Gjeneralit i pëlqeva qysh në fillim për njohuritë e mia, për historinë e kulturën helene, jo vetëm atë moderne, por edhe për lashtësinë, çka me vonë krijoi besim të plotë, duke pyetur edhe për lidhje të tij të afërta në Shqipëri dhe Greqi, sidomos Pandelejmon Kotokon, Orest Anastasjadhin, e të tjerë. siç e mora vesh më vonë prej tyre. Kështu, gjenerali urdhëron Spiridhon Vllahon dhe Pandelejmon Kotokon të krijojnë organizatën antishqiptare MAVI (Metopo Apolefterikon Vorio-Epirotiku), në kryesinë e së cilës u caktova edhe unë së bashku me Vasil Shahinin e Jani Diamantin, tashmë të njohur për ndjenjat filogreke dhe tepër aktiv në veprimtarinë e tyre praktike për aneksimin e trojeve shqiptare”.

Rekrutimi

Gjenerali, në një nga takimet e shpeshta me të, i kishte shprehur konsideratën e tij dhe të shefit kryesor të zbulimit grek, emrin e të cilit ai nuk e mësoi kurrë. Po ky njeri i vuri detyrën e fshehtë të merrej në të ardhmen me organizimin cilësor të rrjetit agenturor të zbulimit grek në Shqipëri. Në fillim kreu një kurs të përshpejtuar për të njohur elementet fillestare të zbulimit, lidhjeve, ndërlihdjes, kodeve, grumbullimit dhe seleksionimit

të informacioneve etj. Më vonë, pasi u krijua organi kryesor i centralizuar i informacionit QIPE (Qendriqi Ipriesias Pliroforion Edhallas), Papastrati bëri kursin e plotë të zbulimit dhe u kamuflua pas organizatës MAVI, e cila, sipas orientimit i formuloi detyrat kryesore legale, që ishte pengimi me çdo kusht i pjesëmarrjes së minoritetit në Luftën Nacionalçlirimtare, si dhe detyrën kryesore ilegale, që ishte futja me kombinacion në këtë lëvizje dhe në ushtrinë e saj të agjentëve grekë, me qëllim që ata të bënin karrierë dhe do t'u shërbenin në të ardhmen për realizimin e planeve të tyre, gjoja për çlirimin një herë e përgjithmonë të Vorio-Epirit.

Papastrati dëshmon: “Pas krijimit të MAVI-t u hodhëm në Shqipëri dhe krijuam komitetet vorio-epirote me anëtarë: Andon Qirjaqin, Misto Papadhimën, Dhimitër Mestakulin, Lefter Guvelin, Jorgo Zoton, Gligor Labovitin etj., të cilëve u vumë detyra të qarta se do ta fillonin me propagandë dhe se tri hallkat kryesore të punës sonë: kleri, shkolla dhe shtypi, të cilat do të ndihmoheshin fuqimisht nga shtypi grek, do të paraprinin gazetat Ipsokratikon Mellon dhe Vorioepirotikon Agonos, të cilat kishin detyrë kryesore të krijonin armiqësi midis dy feve kryesore, asaj myslimane dhe ortodokse, pasi e quanin të tejkaluar kohën kur këto dy fe bashkëjetonin në harmoni, çka ishte pengesë e madhe për realizimin e detyrave tona. Ia konkretizua detyrat dhespotit të Janinës, Spiridhoni, i ishte vënë detyrë të rekrutonte sa më shumë nxënës për të vazhduar shkollën e Vellas, gjë për të cilën kishte marrë nga qeveria greke fonde të posaçme. Ndërsa Pandelejmon Kotoko kishte marrë detyrë të punonte me klerikët ortodoksë shqiptarë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin rekrutuar nga zbulimi grek, Asfalia, shërbimet e fshehta të Korofillaqisë dhe të policisë qytetëse Astinomia Poleos, siç ishin Papu Jorgji Taci nga Leshnica, Papu Jani Dashi nga Cuka dhe Papu Foti Zisi nga Gjirokastra. Pyetjes për aktivizimin e agjunkturës së vjetër të zbulimit grek, si dhe rekrutimin e agjunkturës së re, kryeagjenti Papastrati i ishte përgjigjur: “Gjenerali Vasil Mellaj na kishte porositur për riaktivizimin e agjunkturës së vjetër krahas rekrutimeve të reja që do të bënim sidomos nga radhët

e minoritetit, grekofilëve, grekofonëve, si dhe nga radhët e studentëve dhe nxënësve shqiptarë që studionin ose që kishin kryer studimet në shkollat greke. Kështu, agjentura kryesore kishte për detyrë organizimin e grupeve agjenturore, të cilat do të ishin bërthama të të rezidenturave në përputhje me situatat agjenturore dhe politike. Konkretisht, Vasil Shahini do të punonte me disa kategori të caktuara si me tregtarë, mësues grekofonë dhe kryepleq, duke riaktivizuar sidomos Gligor Kicatin nga Poliçani, Jani Foton po aty, doktor Ilia Zërin nga Sopiku, doktor Sokrat Bozhori nga Terihati, Andon Qirjaqin nga Glina, doktor Telhma Labovitin nga Gjirokastra, Dhimitër Mastakulin nga Kakodhiqi, Jorgo Zërin nga Dhuvjani etj. Gjithashtu, gjenerali na kujtonte shpesh përvojën e demonstratave dhe protestave masive pranë Lidhjes së Kombeve”.

Hetimi

Në pyetjen se si e argumentonte Papastrati mbështetjen e qeverisë greke për organizatën MAVI, si dhe për QEVA-n, ai dha këtë shpjegim. “Në mbledhjet tona kryesore, ku do të diskutoheshin probleme të rëndësishme për hapat e mëtejme që do të merrnim, asistonin rregullisht dy deputetë grekë, Traidhili dhe Villjara, të cilët na përcillnin orientimet dhe direktivat kryesore të qeverisë greke për këto probleme. Konkretisht më kujtohet se, ndryshe nga gjenerali Mellaj, na porosisnin të nxisnim sa më shumë nxënës dhe studentë për të vazhduar shkollat greke si në Vellas, Voshtinë Zosimeja, në Athinë etj. Nga ana tjetër, ata shtronin me forcë nevojën e furnizimit me kontingjente të reja të rinisë greke “Metaksa”, me degë të saj në Shqipërinë e Jugut. Madje, ata insistonin mos të kurseheshin fondet që na ishin vënë në dispozicion.

Mësuesit e sapoemëruar merrnin 200 franga në muaj dhe organizatorët e rinisë monarkiste “Metaksa” të shpërbleheshin me honorarë. Nga ana tjetër, gjenerali porosishte për të kaluar në krijimin e formacioneve ushtarake dhe rolin kryesor do ta luante QEVA dhe silogjet vorio-epirote, duke mënjanuar gabimet e bëra në të kaluarën, në kohën kur si rrjedhojë e kundërsulmit

të çetave shqiptare në zonën e Kurveleshit, në trevën e Vurgut, dhjetëra familje 300 minoritarësh u larguan për në Korfuz dhe gjetkë dhe u detyruam që t' i kthenim. Jo se vërtet kishim krizë ushqimesh e buke, siç pretenduam, por minoritarët tanë do të qëndrojnë atje te tokat e tyre, theksonte gjenerali Mellaj, çka na lehtëson mjaft punën tonë për aneksimin e Vorio-Epirit. Këto porosi për ne ishin detyra dhe që u përpoqëm t' i realizonim, sidomos gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. “Pyetjes se ku konsistonte aktiviteti dopiorol i këtij agjenti, Papastrati iu përgjigj: “Jam rekrutuar edhe nga zbulimi shqiptar, i cili mesa duket ishte në dijeni të aktivitetit tim të mëparshëm dhe më mbante në lidhje. Së fundi, dhe vetë ish-kryetari i degës së Gjirokastrës, nënkoloneli Manol M, gjë që më lehtësoi shumë për kryerjen e detyrave të mia, duke më mundësuar realizimin e takimeve me agjentët kryesorë që kisha në lidhje, që nga Gjirokastra në Vlorë, e deri në Durrës. Ishim në periudhën kur aktiviteti ynë po kalonte në fazën e riorganizimit, pra, kalimit në rrugë të vogla agjenturore, në çeta dhe formacione luftarake të gërshetuara me ngritjen e rezidenturave agjenturore sidomos në qytetet e mëdha në Gjirokastër, Vlorë, Lushnjë e deri në Durrës. Mirëpo, kuadrot kryesorë të zbulimit të Zervës na kërkonin me ngulm për të futur në Lëvizjen Nacionalçlirimtare kuadrot tona agjenturore. Nga ana tjetër, drejtuesit kryesorë të Partisë greke EDE (Bashkimi Demokrat i Oficerëve Grekë), kishin filluar të riaktivizonin Partinë Arqiomarksiste greke, ku Avjazi kërkonte me çdo kusht të riafirmonte si forcë kryesore në Epirin e Veriut, i nxitur nga lobi grek në Amerikë, i cili do të krijonte më vonë Konfederatën Panhelenike Greke, e cila sponsorizohej nga milionerët grekë, Patriakana e Stambollit, kisha autoqefale greke e deri tek Onazis miliarderi i flotës tregtare greke. Në këtë vështrim, aktiviteti im ka qenë shumëplanësh dhe dopiorol. Informatat që i raportoja Sigurimit shqiptar, në përgjithësi ishin dizinformacione, me qëllim që ata të merreshin me problemet në radhët e tyre dhe të largoheshin sa më shumë nga agjentura jonë, organizimi ynë dhe nga kontingjentet tona. Menjëherë pas konferencës së Pezës erdhi udhëzimi mbi krijimin e këshillave vorio-epirotë,

si dhe çetave të armatosura me platformë gjoja për të luftuar pushtuesit italianë dhe më vonë ata gjermanë. Kështu krijuam çetën e Dhrovjanit me komandantë Lefter Guvelin e Jorgo Zoton, çetën e Thimio Lolit e të Kristo Pilos, të cilët i hodhën në luftë kundër batalionit partizan “Çamëria”, duke bërë një gabim të rëndë dhe nuk zbatuam porositë e gjeneralit Mellaj. Pas Luftës Nacionalçlirimtare, meqenëse qeveria shqiptare dhe ushtria e saj po hynte në punët tona të brendshme, ne kishim marrë detyrë të kalonim në veprime më të organizuara. Grupet e vogla agjenturore do t’i kthenim në rezistenca, duke i dhënë një vend të veçantë kishës ortodokse, e cila do të kishte një rol të rëndësishëm në punën tonë. Këtë veprimtari do ta shtrinim deri në qytetin e Durrësit, duke e shoqëruar me propagandë kundër shtetit shqiptar, pamundësinë e tij për të qeverisur vendin, si dhe të dënonim kudo edhe në forumet ndërkombëtare diskriminimin që i bënin ata minoritetit grek dhe në përgjithësi krahinave tona të Vorio-Epirit. Detyra kryesore jona në këtë periudhë ishte që të krijonim një gjendje pasigurie dhe anarkie, duke e shoqëruar me provokacione në kufi, me qëllim krijimin e kushteve për një ndërhyrje të armatosur, duke plotësuar kushtet e misionit sekret “Front i hapët”, i cili do të kombinohej në luftën e grupeve ushtarake që do të futeshin nëpërmjet kufirit, gjë për të cilën ishte marrë edhe pëlqimi i organeve të shërbi-meve sekrete italiane, të cilat nga ana e tyre po përgatitnin në Bari të Italisë grupe agjenturore për t’u futur në Shqipëri nëpërmjet kufirit shqiptaro-grek, që drejtoheshin nga koloneli i zbulimit italian De Agostini dhe që quhej Fronti i Mbyllur.

Për provokacionin e gushtit, pyetjes së bërë nga hetuesi lidhur me dështimin e provokacioneve ushtarake të 2 gushtit 1949, Papastrati u përgjigj: “Provokacionet e 2 gushtit i konsideruam jo një dështim. Përkundrazi, si një fillim i një veprimtarie më të koordinuar. Ishte më shumë një matje e pulsit dhe nëse do të kishim mbështetjen e madhe të vorio-epirotëve tanë, gjë që bëri dhe të gjallëroheshin tej mase aktivitetet tona të silogjeve, të Qevës, Onashit, të Konfederatës Panhelenike, si dhe presioneve që ne bënim herë pas here në Lidhjen e Kombeve. Peshkopi

Serafino, me zgjuarsi porosiste se dita nuk do të ishte e largët kur kombit tonë do t' i njihej, me hir apo me pahir, për të marrë Vorio-Epirin, gjë për të cilën kishim edhe ndihmën e pakursyer të qeverisë greke, të Parlamentit, i cili do ta ruante me fanatizëm ligjin e luftës ndaj Shqipërisë. Ne kishim mbështetje të pakursyer nga lobi ynë në Amerikë. Pastaj arrestimet e shumta që ju bëtë sidomos nga kombësia greke, të grupeve të Papa Harallamb Shtupit nga Grava, grupi i Papajan Dashit nga Çuka, etj., shtuan urrejtjen ndaj shtetit tuaj dhe u shtuan radhët e njerëzve tanë që kërkonin të drejtat e tyre për t' u bashkuar me atdheun e tyre.

Botuar:01.05.2006.<http://www.shqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=655>

Kush janë agjentët me influencë në Kosovë

(Shkruan analisti ushtarak dhe autori i librit “Armët dhe Lufta” FADIL KAJTAZI)

Aktualisht, në Kosovë veprojnë agjencitë influente të shteteve që i duan të mirën Kosovës dhe të atyre shteteve që kanë qëllim armiqësor ndaj Kosovës. Ndër këto agjencitë më e rrezikshmja është ajo serbe. Gjatë historisë së njerëzimit përmes logjikës së shërbimeve sekrete, janë realizuar veprime të cilat nuk kanë mundur t'i realizojnë ushtri të tëra. Sinonim i kësaj është i ashtuquajti Kali i Trojës (Ilionit), përmes të cilit grekët mbërritën ta pushtojnë qytetin e fortifikuar, të cilin me luftë nuk arritën ta pushtonin dot, edhe pse dhjetë vjet me radhë e kishin mbajtur të rrethuar. Edhe sot, historianë të shumtë kanë dilema se si trojanët ranë në karremin e servitur nga grekët (Odiseja)? Në “Iliadë”, Homeri përshkruan kohë pas kohe veprime zbuluese të ndërmarra nga ushtria greke, por nuk flet për asnjë moment për një shërbim të centralizuar, i cili merret me këtë punë. Vetë akti i sajimit të mashtrimit mund ta vërtetojë ekzistencën e një shërbimi zbulues, i cili me kalimin e viteve, me sa duket ka arritur të ngjitet shumë lart në strukturat komanduese të ushtrisë së Priamit. Pushtimi i Trojës nuk ka ndodhur për faktin se grekët e ndërtonin një kalë të drunjtë dhe atë e lanë jashtë mureve të qytetit. Grekët edhe më parë kanë mundur të ndërtojnë turma kuajsh të drunjtë, por ata do të kishin mbetur jashtë mureve të qytetit sikur dikush me influencë nga radhët e strukturave udhëheqëse trojane të mos

kishte urdhëruar futjen e tyre brenda. Kështu, vetëm futja e dhjetëra ushtarëve sa ka zënë brendia e kalit të drunjtë nuk do të kishte paraqitur ndonjë problem për sigurinë e qytetit, sikur dikush me influencë nga udhëheqja trojane të mos e sabotonte shërbimin e zbulimit, i cili e kishte për detyrë t'i përcillte aktivitetet e ushtrisë greke gjatë tërheqjes. Siç duket pas vdekjes së Hektorit, Priamit plak i kishin dalë nga dora shumë gjëra dhe në hierarkinë e tij shtetërore. Grekët kishin rekrutuar njerëz me influencë dhe e kishin bërë atë që të merrte vendime të gabuara. Agjentura influente është në veprim. Shprehja “agjunkturë influente” bëhet e njohur së pari nga një fjalim i shefit të KGB-së, Vladimir Kluçkov, mbajtur para deputetëve të Sovjetit Suprem më 17 qershor të vitit 1991. Kluçkov, duke iu referuar një dokumenti të cilin KGB-ja ia dërgonte Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BRSS-së më 24 qershor të vitit 1977, para deputetëve sovjetikë i prezanton përmasat e rrezikut të shkatërrimit të shtetit sovjetik nga “Plani i CIA-s për rekrutimin e agjunkturës influente nga radhët e qytetarëve sovjetikë”. Në kuadër të debateve se si u shkatërrua perandoria sovjetike, shumë analistë këtë ia atribuojnë aksioneve sekrete të CIA-s, në radhë të parë e potencojnë veprimtarinë e agjunkturës influente, e cila duke qenë në vendet kyçe, e ka sabotuar funksionimin e sistemit shtetëror në të gjitha segmentet, e veçanërisht në atë ekonomik dhe politik. Në këtë kuadër, sot e kësaj dite “perestrojka” e Gorbaçovit, e cila merret si paraprijëse e shkatërrimit të shtetit sovjetik, shikohet si projekt i prodhuar nga agjentura influente e rekrutuar nga CIA.

Kush janë agjentët influentë? Agjenti influent nuk do të thotë të jetë njeriu i parë i një shteti. Janë raste të rralla në histori kur njeriu i parë i një shteti ka arritur që të rekrutohet nga shërbimi armik. Agjentët me influencë, zakonisht i përkasin nivelit të dytë ose të tretë në institucione drejtuese, ku shërbimi armik e bën lojën e vet në mënyrë të heshtur dhe pa u hetuar. Kjo do të thotë se ata janë persona, të cilët me autoritetin e tyre politik (nganjëherë edhe ekonomik) ndikojnë te personat vendimarrës në marrjen e vendimeve të gabuara, të cilët shkojnë në dobi

të armikut. Zhvillimi i kësaj veprimtarie nuk mund të ndodhë i veçuar. Ajo do një përfshirje të gjithanshme, e cila gjithsesi duhet të ketë mbështetje mediale. Veprimi i gjithanshëm në fushata të këtilla të sofistikuara, mbërrin që me vete të marrë edhe shumë persona, të cilët pa vetëdije futen në këtë lojë, por që janë influentë në rrethin ku jetojnë dhe veprojnë. Nëse vetëm pak shikojmë nga e kaluara jonë jo e largët, sigurisht se do të na kujtohen veprimet e agjencurës influente serbe, e cila në gjysmën e dytë të viteve nëntëdhjeta provonte që shqiptarët e Kosovës t'i fuste në kuadër të sistemit jugosllav të administrimit. Aktualisht, në Kosovë veprojnë agjencurat influente të shteteve që ia duan të mirën Kosovës dhe të atyre shteteve që kanë qëllim armiqësor ndaj Kosovës. Ndër këto agjencura, më e rrezikshmja është ajo serbe, e cila është instaluar gjithandej dhe herë pas here, nga mbështetja e paqëllimtë e disa mediave, Kosovës i shkakton dëme të papara. Le ta marrim vetëm një segment, atë të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK). Sipas publikimeve të bëra, personi i autorizuar për rekrutim, sistematizim dhe gradim në kuadër të SHPK-së, ka kërkuar azil politik në Angli dhe ka pranuar se ka qenë agjent i shërbimit serb (BIA). Deri sot, nuk është bërë publike asnjëherë nga organet e specializuara të SHPK-së, se cili është dëmi që ky person i ka shkaktuar këtij shërbimi. Nga dëmet më të mëdha që mund të ketë shkaktuar ky person është mënjanimi i personave intelektualë nga strukturat komanduese të SHPK-së dhe instalimi i rrjetit të tij në këto struktura, ku për pasojë kemi një zbulueshmëri shumë të ulët të krimeve nga SHPK. Është e pakuptueshme se si në kuadër të SHPK-së gradohen pjesëtarë, të cilët e kanë të dyshimtë diplomën e shkollës së mesme, ndërsa mbeten pa grada inxhinierët, ekonomistët, juristët. Kjo më së miri e vërteton praninë e agjencurës influente në këtë institucion, por edhe në institucionet tjera. Secili që ia do të mirën Kosovës, le të shikojë se kë ka afër tij!

**Aktivitetet kriminale të shtyra nga shërbimet
sekrete armiqësore në Kosovë**

Për momentin, veprimtaria agjenturore e Serbisë në drejtim të Kosovës bëhet përmes dy agjencive të cilat janë riorganizuar pas vitit 2002. E para është BIA (Agjencia Informative dhe e Sigurisë, e cila është resor qeveritar që kontrollohet nga qeveria dhe parlamenti. E dyta është VBA (Agjencia Ushtarake e Sigurisë) e cila është në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Bashkësisë Shtetërore Serbi – Mali i Zi. Aktiviteti kriminal është fenomen i cili shoqërinë njerëzore e përcjell që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Molla e ndaluar e Ademit është tregimi fetar i cili përcakton më së miri tre dimensionet që e karakterizojnë krimin si fenomen shoqëror. Së pari, pra kemi dimensionin historik të lindjes së krimit. Përmes këtij tregimi përcaktohet se krimi lindi njëkohësisht me njeriun dhe se është brenda natyrës së tij. Së dyti dimensionin e natyrës njerëzore si qenie kureshtare, lakmitare dhe e prirë që për kënaqjen e orekseve të tij, pa zgjedhur mjetet dhe kohën, të shkojë deri në ekstremitet. Dhe dimensionin e tretë të këtij tregimi, më së miri përcakton definicionin e krimit, d.m.th. atë se krim është çdo gjë që është e ndaluar pavarësisht se ajo nganjëherë mund të jetë edhe mollë. Lufta e organizuar kundër krimit ka gjenezën e vet që kur shoqëria njerëzore filloi të organizohet, pra, thënë më thjesht që kur lindi shteti si institucion administrativ i popujve apo kombeve. Në kuadër të kësaj, të gjithë pajtohen me atë se: krim është çdo gjë që është e ndaluar me ligj (pas lindjes së shtetit), mirëpo gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore, kriteret për atë se çka duhet të konsiderohet krim, kanë qenë të pa standardizuara dhe kanë ndryshuar varësisht prej epokës historike, natyrës së regjimeve shoqërore, faktorëve ekonomikë, socialë etj. Për ilustrim po përmend faktin se: në mesjetë krim është konsideruar argumentimi shkencor i fenomeneve natyrore dhe shoqërore kurse sanksionet kanë qenë të tmerrshme. Ose në hapësirat tona dhe përreth nesh (gjatë kohës së komunizmit), shumë aktivitete shoqërore që sot zhvillohen janë konsideruar krim. Manifestimi i krimit në hapësirat kosovare shfaqet në dy forma. Në formë të krimit të organizuar dhe në formë të krimeve ordinere. Këto aktivitete kriminale, të manifestuara në format e sipër përmendura janë

karakteristike nga fakti se bazohen në disa aktivitete të cilat, falë rrethanave që mbretërojnë në hapësirat tona (gjendja ekonomike, infrastruktura ligjore, joefikasiteti i duhur i organeve të ndjekjes dhe gjyqësore), kanë terren të përshtatshëm të zhvillimit të tyre dhe janë burim permanent i destabilizimit të gjendjes së sigurisë. Motivimi kryesor i veprimit kriminal, i manifestuar në format e sipërpërmendura bazohet në: 1. *Aktivitetet e motivuara me arsyetim politik, ku si pretekst zakonisht merren ngjarjet historike, përkatësitë ideologjike, fetare dhe etnike*, 2. *Aktivitetet e motivuara nga shërbimet sekrete të vendeve të treta të cilat kanë qëllim armiqësor ndaj Kosovës*; 3. *Aktivitetet e motivuara me arsyetim të përfitimit material*.

Në këtë shkrim do të përqendrohemi në aktivitetet kriminale të motivuara nga shërbimet sekrete të vendeve të cilat kanë qëllim armiqësor ndaj Kosovës dhe konsideroj se që nga viti 1999, ato kanë pasur ndikim dhe do të vazhdojnë të kenë edhe në të ardhmen për sigurinë e përgjithshme në hapësirat tona. Vlen të theksohet fakti se në Kosovë, veprimtaria kriminale e shërbimeve të huaja sekrete nuk është e ndaluar me ligj dhe de-jure, nga ne, kjo veprimtari nuk mundet të quhet krim apo antiligjore, mirëpo besoj që de-fakto të gjithë pajtohemi se kjo veprimtari është antikosovare dhe e kriminalizuar, dhe se meriton qasje nga ky pikëvështrim. Siguria në Kosovën e tanishme dhe në atë të pas pavarësisë në njëfarë mase do të varet nga qasja që do të ketë Serbia ndaj saj. Kjo kryesisht do të lidhet me atë se cila klasë politike do të qeverisë Serbinë në të ardhmen dhe se, sa do të jetë e integruar në organizmat euro-atlantikë. Një Serbi me një klasë politike ekstreme dhe e lënë jashtë strukturave euro-atlantike, do të jetë burim permanent i rrezikimit të gjendjes së sigurisë në Kosovë dhe rajon. Klasa politike që qeveris Serbinë, aktualisht është e impenjuar thellë në zgjidhjen në favor të saj të statusit përfundimtar të Kosovës. Ky impenjim, edhe pse nuk ka rezultuar pozitivisht, deri sot është permanent dhe shtrihet në shumë fusha, ku më e ndjeshmja është ajo e veprimtarisë agenturore në drejtim të Kosovës. Veprimtaria e shërbimeve sekrete serbe në drejtim të vendeve të Ballkanit ka një parahistori. Ajo fillon në vitin 1908 kur në Prokuple (në jug

të Serbisë) dhe nën drejtimin e kolonelit Dragutin Dimitrieviq Apisit dhe kapitenit Tankosiq, formohet kampi për stërvitjen e çetnikëve. Po nga ky kamp (nga kuadrot që kanë udhëhequr këtë kamp, është përgatitur edhe Atentati i Sarajevës i 28 qershorit 1914 i cili çoi në fillimin e Luftës së Parë Botërore) ka filluar të bëhet planifikimi dhe zhvillimi i veprimtarisë agjenturore në drejtim të tokave shqiptare, të cilat në atë kohë ishin nën Perandorinë Osmane. Që nga kjo kohë e deri sot, nuk ka pushuar së vepruari veprimtaria agjenturore e shërbimeve serbe në drejtim të Kosovës, e cila veprimtari fatkeqësisht ka qenë ofensive, çka do të thotë se është shoqëruar me akte të mprehta, të cilat, përpos që kanë ndikuar keq në zhvillimin e jetës sonë shoqërore, kanë lënduar shumë familje kosovare. Për momentin, veprimtaria agjenturore e Serbisë në drejtim të Kosovës bëhet përmes dy agjencive që janë riorganizuar pas vitit 2002. E para është BIA (Agjencia Informativë dhe e Sigurisë) e cila është resor qeveritar që kontrollohet nga qeveria dhe parlamenti. E dyta është VBA (Agjencia Ushtarake e Sigurisë) e cila është në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Bashkësisë Shtetërore Serbi – Mali i Zi. Që të dyja këto agjenci, edhe pas reformimit, kanë në dispozicion të gjithë infrastrukturën agjenturore të paraardhësve të tyre RDB-së, KOS-it dhe Drejtorisë së Dytë të Shtabit të Përgjithshëm të APJ. Kjo u mundëson atyre që për momentin të jenë ndër agjencitë që disponojnë infrastrukturë të mjaftueshme për destabilizimin e Kosovës dhe rajonit. Rrethanat që kanë mbretëruar në Kosovën e para vitit 1999, kanë mundësuar që në fillim OZNA, pastaj UDB e më vonë SDB dhe KOS, e së fundi RDB, të rekrutojnë agjentë përmes të cilëve bukur shumë është kontrolluar jeta shoqërore tek ne. Pa dashur të spekulojmë me të dhënën e përfolur shumë se serbet disponojnë rreth 25 mijë bashkëpunëtorë në Kosovë, por duke analizuar të dhënat e bëra publike, prapë na del një shifër e lartë e pranisë së agjunkturës serbe këtu tek ne, e cila për qytetarët dhe institucionet e Kosovës, mendoj se duhet të jetë shqetësuese. Nëse merret e saktë e dhëna e bërë publike në vitin 1988 nga Sekretariati i Punëve të Brendshme të Kosovës

se: “Deri në vitin 1985 nga Shërbimi i Sigurimit Shtetëror (SDB) janë trajtuar rreth 500 mijë qytetarë të Kosovës” kjo nuk do koment. Nëse nga ky trajtim, SDB ka arritur të rekrutojë vetëm një për qind, ne na del që çdo i katërqindti banor i Kosovës është bashkëpunëtor i shërbimeve serbe. Këtu nuk duhet harruar mundësinë e rekrutimit të bashkëpunëtorëve nga shërbimi i armatës jugosllave (KOS-i dhe Drejtoria e Dytë pranë SHP të APJ) si dhe bashkëpunëtorët vullnetarë. Për vrojtuesin e kujdesshëm, prania e agjencurës serbe në radhët tona ka qenë më se e dukshme. Pa hyrë në atë se si janë zbuluar grupet ilegale para vitit 1981, zbulimi i veprimtarisë ilegale pas viteve të nëntëdhjeta flet shumë. Duke filluar që nga grupi i Gjakovës, pastaj Ministria e Mbrojtjes dhe e Brendshme e Republikës së Kosovës, zbulimi i grupit të Nait Hasanit, vrasja në pritë e Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut, flasin për prezencën e shërbimit serb në vendet më të ndjeshme të aktiviteteve tona të rezistencës ilegale, të cilat pa dyshim nuk kanë përfshirë vetëm Kosovën, por gjithë hapësirën ku shqiptarët kanë zhvilluar aktivitetet politik. Mendoj që, vetëm këto ngjarje dëshmojnë: nëse jo për praninë e agjencurës masive serbe në radhët tona, për një kualitative po se po. Vrasjet enigmatike të figurave politike të Kosovës dhe veprimet e tjera të mprehta, të cilat kohë pas kohe skajshmërisht kanë rrezikuar gjendjen e sigurisë, tej mase kanë reflektuar në stabilitetin politik dhe në prishjen e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Mendoj se në një pjesë të tyre është e involvuar agjencura serbe pasi që Qeveria e Serbisë është e bindur se e vetmja rrugë për rimarrjen e sërishme të Kosovës është nëse ajo destabilizohet (vietnamizohet – futja e shqiptarëve në konflikt me bashkësinë ndërkombëtare), dhe në fazën gjatë bisedimeve për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, duhet pritur një intensifikim të këtyre aksioneve.

Të paktë janë politikanët, gazetarët, dhe analistët që këtë fenomen e kanë analizuar nga ky prizëm. Menjëherë pas çdo akti, në të dyja kampet rivale politike, në media, dhe nga gazetarë “të pavarur” janë gjetur persona, të cilët, me apo pa vetëdije,

kanë mjegulluar edhe më shumë gjendjen dhe rrallë herë analizat shkuan deri në fund. Zakonisht ato kanë mbetur në nivelin që do të shtonte edhe më tej hendekun e ndarjes mes forcave politike dhe në rastin e volitshëm do të iniciohte një përshkallëzim të gjendjes në shkallë më të gjerë.

Aksionet e lagura

Të gjitha aktet e ndodhura deri tani, e që kanë rrezikuar stabilitetin e Kosovës, janë kryer sipas formulës së “aksioneve të lagura”, në të cilat gjithmonë kryesi i aksionit dhe porositiësi mbeten të pazbuluar. Vetë literatura e bërë publike nga veteranë të shërbimeve serbe flet se si këto shërbime kanë pasur sektorë të specializuar për planifikim dhe kryerje të këtyre aksioneve, u gjatë Luftës së ftohtë, ato janë kryer në vendet perëndimore dhe nuk është arritur asnjëherë të dokumentohet prania e shërbimeve serbe në këto ngjarje. Gjëja më e rëndësishme në këto aksione është që ai të kryhet në mënyrë që të mos lihet as edhe dyshimi më i vogël për atë se kush është organizatori. Gjatë Luftës së Ftohtë, shërbimi jugosllav (SDB) ka arritur që përmes këtyre aksioneve të eliminojë disidentët në vendet perëndimore (kryesisht të emigracionit shqiptar dhe kroat). Këtyre aksioneve në radhë të parë u paraprinte taktika e krijimit të fraksioneve brenda organizatave politike, të cilat krijoheshin përmes agjenturës influente; pastaj, kur ndodhnin eliminimet, ato përmes agjentëve influentë prapë mjegulloheshin dhe mbeleshin si qerim hesapesh përbrenda organizatës. Teknikisht, kryerja e këtyre aksioneve bëhet në dy mënyra: e para, përmes agjenturës, shërbimi grumbullon të dhëna për gjendjen në terren dhe pas analizës piketon viktimën. Në aksion angazhohet një ekip i specializuar, i cili përmes rrugëve të ndryshme nga baza (në këtë rast Serbia) dërgohet në vendin e ngjarjes dhe realizon aksionin. Këto aksione ndërmerren ndaj objektivave ku garantohet tërheqja pa problem e ekipit. E dyta, kryerja e aksionit bëhet përmes agjentit rezident. Kjo është mënyra më e mirë për kryerjen e aksioneve “të lagura”. Agjenti rezident (në këtë rast i shërbimit serb, me përkatësi etnike shqiptare, i

cili mund të jetë me gradë shkencore ose pa të, i dëshmuar në “çështjen kombëtare”, “gazetar i varur apo i pavarur”, i futur në ndonjë organizatë politike ose jashtë saj), rreth vetes grumbullon zakonisht pjesën më revolucionare të kombit, e cila pa vetëdije i vihet atij në shërbim dhe është e gatshme për sakrificë sublimë. Në njërën anë, ai përmes këtyre personave kontrollon të gjitha aktivitetet që bëhen në dëm të padronit për kë punon, kurse në anën tjetër organizon aksione të mprehta (vrasje, sabotime, vendosje të bombave etj) të cilat i porosit në emër të patriotizmit. Edhe po u zbuluan kryesit e drejtpërdrejtë, ata do të dalin se janë persona pa formim të mjaftueshëm intelektual, do t’i përkasin kësaj apo asaj vije politike, por që kanë dashur të kryejnë një shërbim në “dobi” të kombit. Për momentin se kush janë ata nuk dihet. Në një fazë të caktuar ata do të zbulohen dhe natyrisht, kur për këtë do të ketë nevojë Serbia. Kjo do të ndodhë kur shërbimi serb mendon se ne jemi në një pikë kritike ku mjafton një shkëndijë e vogël për të degraduar gjërat këtu. Pa pasur ndonjë fakt të veprimeve operative të bëra nga organet legjitime të sigurisë në Kosovë (SHPK, policia e UNMIK-ut, KFOR-i) por vetëm nga pozita e vrojtuesit të thjeshtë, përpos atyre që u thanë më lart, mund të nxirren edhe argumente të tjera të cilat e vërtetojnë praninë e shërbimit serb në aktet e pa ndriçuara në Kosovë. Së pari, po të shikohet gjeografia ku ndodhin më së shumti aktet e mprehta, ajo i përket territorit i cili nuk është i banuar me serbë (rrafshi i Dukagjinit). Kjo bëhet për të eliminuar çdo dyshim të pranisë së tyre në këto akte. Së dyti, po të shikohet koha kur ndodhin, ato zakonisht lidhen me ndonjë mbledhje në nivel ndërkombëtar për Kosovën apo me ndonjë vizitë të ndonjë personaliteti ndërkombëtar në Kosovë. Ndër rastet e tilla po veçojmë: vendosja e eksplozivit në një kishë ortodokse në Burim gjatë konferencës së KS të OKB ku debatohej për Kosovën; atentati ndaj Presidentit Ibrahim Rugova gjatë vizitës së Solanës; rasti i fundit i sulmit të autobusit në Sharr gjatë vizitës së ministrit të mbrojtjes së Gjermanisë në Prizren etj. Edhe pas pavarësisë së Kosovës, për një kohë të gjatë gjendja e sigurisë do të vazhdojë të jetë e brishtë për

shkak të aktiviteteve të shërbimeve serbe këtu. Se për sa kohë do të vazhdojë kjo gjendje, kjo lidhet me shumë gjëra që do të zhvillohen në Kosovë dhe përreth saj, mirëpo mënyra më e mirë për t'i parandaluar ato është kur ne arrimë të konsolidohemi dhe krijojmë institucione të mirëfillta të sigurisë, puna e të cilave përcaktohet me ligj.

Spiunazhi - të dish që më parë se ç'do të ndodhë

Udhëheqësit e zotë dhe strategët e mençur veprojnë dhe fitojnë, kryejnë heroizma që ua kalojnë të tjerëve, sepse gjithçka e kanë ditur që më parë. Të diturit që më parë, nuk merret nga zotët dhe demonët, nuk merret as me hamendje, as me të përngjarë e as me çfarëdo llogaritje. Njohja e gjendjes së kundërshtarit mund të merret vetëm me anë të njerëzve. Nevoja e njeriut për t'i parashikuar ngjarjet që do të ndodhin, është e vjetër sa vetë njeriu. Qysh në parahistori, te bashkësitë njerëzore primitive, kanë ekzistuar parashikues të kohës së ndodhive shoqërore dhe fatit individual, kurse në kohërat e më vonshme të antikitetit, personat të cilët merreshin me parashikimin e gjërave fituan një rëndësi të veçantë. Ata i hasim pranë çdo oborri mbretëror me emërtime të ndryshme si orakuj, magjistarë, astrologë, etj. Gjatë gjithë antikitetit dhe Mesjetës, parashikuesit e ngjarjeve apo fatit, i hasim që nga Mikena, në Maqedoni tek Leka i Madh, mbreti Pirro i Epirit, në Bizant, në Perandorinë Osmane etj. Mbretërit, personalitetet politike dhe ushtarake, para çdo veprimi të tyre, konsultoheshin me parashikuesit e tyre dhe shpesh ndodhte që vendimi për të ndërmarrë ndonjë veprim, qoftë ushtarak apo tjetër, ndikohej nga këshilla e orakullit, magjistarit apo astrologut. Këto këshilla dhe parashikime kishin të bënin vetëm me parashikimin e fatit dhe kurrësi me ndonjë informacion paraprak mbi fenomenet apo ngjarjet. Përkundër faktit se gjatë gjithë antikitetit dhe mesjetës prania e parashikuesve të fatit apo ngjarjeve ishte prezente, tendencat për të krijuar shërbime të specializuara, të cilat merreshin me grumbullimin dhe përpunimin e informacioneve me karakter politik dhe ushtarak, vërehet shumë herët. Të gjitha

ndërmarrjet dhe fushatat e mëdha ushtarake të antikitetit bazoheshin kryesisht mbi informacionet grumbulluara në rrugë të ndryshme operative. Njëra ndër doktrinat më të vjetra ushtarake, e cila ka mbetur e shkruar deri në ditët e sotme është ajo e kinezit Sun Xu, për të cilën mendohet se i takon periudhës së shekullit IV-III, para erës së re. Kjo doktrinë ushtarake, e cila për nga aktualiteti i mendimit ushtarak është e aplikueshme edhe sot, përbëhet prej 13 kapitujsh. Kapitulli i fundit bën fjalë për organizimin e shërbimeve të zbulimit dhe mban titullin “Disa mënyra të përdorimit të agjentëve sekretë”. Ky kapitull, është njëri prej dokumenteve më të vjetra që njeh njerëzimi deri më sot dhe që bën fjalë për organizimin e shërbimeve zbuluese. Në këtë kapitull, fillimisht bëhet fjalë për rëndësinë që kanë shërbimet e zbulimit për një shtet apo popull. Sun Xu, organizimin e shërbimit të zbulimit e justifikon në versët 3 dhe 4 ku thotë: “Udhëheqësit e zotë dhe strategët e mençur veprojnë dhe fitojnë, kryejnë heroizma që ua kalojnë të tjerëve, sepse gjithçka e kanë ditur që më parë. Të diturit që më parë, nuk merret nga zotët dhe demonët, nuk merret as me hamendje, as me të përngjarë, e as me çfarëdo përlllogaritje. Njohja e gjendjes së kundërshtarit mund të merret vetëm me anë të njerëzve.” Sipas Sun Xusë, shërbimi i zbulimit duhet organizuar mbi bazën e strukturës së më poshtme: informimin e jashtëm, të bazuar kryesisht nga personat e rekrutuar nga radhët e kundërshtarit, të cilët janë: spiunët e vendit të rekrutuar nga banorë të rëndomtë, spiunë të brendshëm të rekrutuar nga radhët e zyrtarëve të shtetit, kundërspiunët të rekrutuar nga radhët e spiunëve kundërshtarë. Si dhe kundër informimin të përbërë prej njerëzve nga radhët vetjake të cilët ai i quan spiunë të humbur dhe spiunë që kthehen. Duke e vlerësuar lart rolin e njeriut (spiunit) që ka ai në zbulim, në versin e 8 ai thotë: “Prandaj, për ushtrinë (shtetin, kombin) nuk ka gjë më të vlefshme se sa spiunët, nuk ka shpërblim më të madh se sa spiunët, nuk ka punë më sekrete se sa spiunazhi. Pa zotëruar dituri të përkryera nuk mund të përdorësh spiunët; pa pasur humanizëm dhe drejtësi nuk mund të përdorësh spiunët; pa pasur mprehtësi dhe aftësi

depërtuese nuk mund të marrësh nga spiunët rezultat të vërtetë. Mprehtësi! Mprehtësi! Nuk ka asgjë për të cilën të mos përdorësh spiunët”. Ajo që e bën këtë kapitull shumë aktual është fakti se kinezi i vjetër vëren se shërbimi i zbulimit duhet organizuar në mënyrë të centralizuar dhe të ketë karakter inteligjent. Me pak nuanca, të gjitha shërbimet e zbulimit që nga antikiteti e deri në ditët e sotme janë të organizuara mbi modelin e Sun Xusë. Agjencia Qendrore e Zbulimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, CIA, është krijuar pas Luftës së Dytë Botërore më vitin 1946 me urdhër të presidentit Truman. CIA, është pasardhëse e OSS e krijuar para Luftës së Dytë Botërore. Rolin e shërbimit kundërinformativ në SHBA e ka FBI, e cila është e organizuar brenda kufijve të SHBA-së. Në SHBA, ka të organizuara edhe disa agjenci të cilat merren me grumbullimin dhe përpunimin e informacionit me karakter të ndryshëm, e i cili vlerësohet i rëndësishëm për sigurinë e SHBA-ve. Ndër më të njohurat janë: DIA, agjencia informative ushtarake dhe NSA, Agjencia e Sigurisë Nacionale. Prej themelimit e deri në fillim të viteve të nëntëdhjeta, CIA së bashku me shërbimet e tjera aleate, ishin njëra nga shtyllat kryesore në luftë kundër ekspansionit komunist drejt perëndimit. Qëllimi i themelimit të saj ishte që të zbulojë dhe parandalojë veprimtarinë anti-SHBA, kudo që zhvillohet ajo në rruzullin tokësor. Qëllimin e krijimit të CIA-së më së miri e justifikon njëri ndër oficerët më të vjetër të saj Rishars Helms, i cili thotë se : “CIA u projektua për të parandaluar një Pearl Harbor tjetër” Në fakt, qëllimi i kongresit të SHBA-ve ishte që të ketë një institucion ku i gjithë informacioni i fituar përmes rrugëve të ndryshme, të përqendrohet në një vend, në mënyrë që ai të përpunohet dhe analizohet dhe të bëhet informimi i organeve shtetërore, në mënyrë që ato me kohë të ndërmarrin masa. Pearl Harbor është një pjesë e errët e historisë së SHBA-ve, për arsye se, edhe pse segmente të caktuara të qeverisë amerikane dispononin informacionin për sulmin japonez në këtë bazë amerikane në Paqësor, ato nuk ditën ta administrojnë këtë informacion dhe ndodhi ajo që ndodhi. Gjatë punës së vet për gjithë kohën sa zg-

jati lufta e ftohtë, CIA, me dështime të kohëpaskohshme, arriti që t'i bëjë ballë veprimtarisë ofensive të KGB dhe shërbimeve satelite të saj. Ndonëse tani bëhen spekulime se gjatë luftës së ftohtë KGB ishte më e suksesshme, kjo nuk mund të merret si e saktë nga shkak se gjatë tërë luftës së ftohtë, numri i agjentëve të zbuluar ka qenë po thuaj i barabartë në të dyja anët, ndërkohë që ai i atyre të pa zbuluar dhe që sot janë plakur nuk dihet. Nga vetë fakti se gjatë luftës së ftohtë SHBA-të kanë pasur informacion të bollshëm për atë se ç'po ndodhte në kampin komunist, flet mjaft për efikasitetin e këtij shërbimi. Suksesi i CIA-s gjatë luftës së ftohtë mundë t'i atribuohet një parimi bazë, i cili është kryesori në punën e shërbimeve të zbulimit dhe të cilit CIA i është përmbytur. Ky parim është: të qenit prezent në vendin ku projektohen të gjitha aktivitetet kundër teje. Se CIA ka përmbytur këtë parim, më së miri e shpjegon Villiam Colby, udhëheqës i CIA-së gjatë viteve 1973 – 76, i cili thotë se: “gjithnjë mendoja se objektivi kryesor i CIA-së ka qenë të futej në Kremlin dhe jo të bëjë lojëra më KGB-në.” Të arriturat teknologjike, gjatë kësaj kohe janë përdorur më tepër si mjete ndihmëse apo si mjete fiksuese. Kurse përpunimi dhe vërtetimi i materialeve është bërë në rrugë operative përmes agjentëve të infiltruar në radhët e kundërshtarit. Këtë më së miri e ilustron shembulli i krizës së raketave kubane. Në qoftë se amerikanet nuk do të dispononin informacion të grumbulluar paraprakisht në rrugë operative (nga agjenti O. Penkovski) për raketat SS-4, me siguri se nuk do të arrinin të bënin deshifrimin e tyre nga fotografitë e marra nga aeroplanët U-2. Pas luftës së ftohtë, krerët e CIA-s filluan t'i kushtojnë një vëmendje të shtuar aktiviteteve terroriste. Ndonëse edhe gjatë luftës së ftohtë aktivitetet terroriste kanë qenë të pranishme, ato më të theksuara ishin në vendet evropiane. Për shkak se në masën më të madhe ato kanë qenë të sponsorizuara nga BRSS, dhe të organizuara nga KGB, efikasiteti i tyre nuk ka qenë i madh nga shkak se këto dy segmente monitoroheshin nga afër prej CIA-s dhe shërbimeve përëndimore. Bile aktivitetet terroriste në ShBA thuaj se kanë qenë të pa pranishme. Ekzistojnë dyshime se

kreun e terrorizmit botëror e ka kontrolluar CIA, përmes terroristit të njohur Iliç Sançez Ramirez, i cili në fillim të viteve të nëntëdhjeta është arrestuar nga francezët dhe ende mbahet në burg pa u gjykuar. Aktivitetet terroriste të grupeve ekstreme islamike nuk kanë qenë në masë të madhe të përcjella nga CIA, nga shkak se gjatë luftës së ftohtë këto grupe nuk kishin potencial organizativ për të bërë akte terroriste të përmasave të mëdha. Këto grupe në këtë kohë ishin në fazën e konsolidimit organizativ, shpirtëror dhe material. Aktivitetet e tyre gjatë kësaj kohe ishin shumë transparente dhe hetoheshin shpejt. Pas rënies së BRSS, ShBA-të sikur u liruan nga një barrë e rëndë dhe aktivitetin e shërbimeve të zbulimit e reduktuan dukshëm. Reduktimet më të mëdha janë bërë në pakësimin e njerëzve apo agjentëve në terren. Gjatë kësaj periudhe, CIA filloi të mbështetet kryesisht në grumbullimin e informacionit në mënyrë elektronike nga satelitët përgjues në hapësirë dhe në formën analitike të të studiuarit të fenomeneve. Rasti i 11 shatorit më së miri flet se si ka dështuar teknologjia karshi organizimeve klasike që ka bërë Osama bin Ladeni. Edhe pse CIA me kohë e kishte fiksuar aktivitetin terrorist në rritje të bin Ladenit, ata ose i kanë besuar së tepërmi teknologjisë dhe kanë injoruar tej mase faktin se duhet të kenë njeriun e tyre në mes të Alkaidës, ose për shkak të organizimit të përsosur të kundërzbulimit të Alkaidës, CIA nuk ka mundur të infiltrohet.

Botuar: 15.03.2006

<http://www.shqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=197>

GJUHË, LETËRSI

Origjina e gjuhës shqipe

(Polemikë rreth një shkrimi të Albert Nikollës në alb-shkencë)

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, ku futen gjuhët indoiranike, greqishtja, gjuhët romane, gjuhët sllave, gjuhët gjermane, etj.

Ajo formon një degë të veçantë në këtë familje gjuhësore dhe nuk ka ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjërën prej gjuhëve të sotme indoevropiane.

Karakteri indoevropian i shqipes, përkatësia e saj në familjen gjuhësore indoevropiane, u arrit të përcaktohej e të vërtetohej që nga mesi i shekullit XIX, në sajë të studimeve të gjuhësisë historike krahasuese.

Ishte sidomos merita e njërit prej themeluesve kryesorë të këtij drejtimi gjuhësor, dijetarit të njohur gjerman Franz Bopp, që vërtetoi me metoda shkencore përkatësinë e gjuhës shqipe në familjen gjuhësore indoevropiane. F Bopp i kushtoi këtij problemi një vepër të veçantë me titull “Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen”, botuar në vitin 1854.

Në ndarjen e gjuhëve indoevropiane në dy grupe: në gjuhë lindore ose satem dhe në gjuhë perëndimore ose kentum, shqipja shkon me gjuhët lindore (satem), bashkë me gjuhët indoiranike, gjuhët balto-sllave dhe armenishten.

Origjina

Problemi i origjinës së gjuhës shqipe është një nga problemet shumë të debatuar të shkencës gjuhësore. Ajo e ka burimin, pa

dyschim, prej njëres nga gjuhët e lashta të Gadishullit të Ballkanit, ilirishtes ose trakishtes.

Në literaturën gjuhësore qarkullojnë dy teza themelore për origjinën e shqipes: teza e origjinës ilire dhe teza e origjinës trakase. Teza ilire ka gjetur mbështetje më të gjerë historike dhe gjuhësore. Ajo është formuar që në shekullin XVIII në rrethet e historianëve.

Përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, e bëri historiani suedez Hans Erich Thunmann në veprën e tij “Underschuchunger liber di Geschichte der Östlichen europäischen Völker”, Leipzig 1774.

Ai, duke u mbështetur në burime historike latine e bizantine dhe në të dhëna gjuhësore e onomastike, arriti në përfundimin se shqiptarët janë vazhduesit autoktonë të popullsisë së lashtë ilire, e cila nuk u romanizua siç ndodhi me popullsinë trako-dake, paraardhëse të rumunëve.

Teza e origjinës ilire të shqiptarëve është mbështetur nga albanologu i mirënjohur austriak Johann George von Hahn në veprën e tij Albanesische Studien, publikuar më 1854. Që nga ajo kohë deri në ditët tona, një varg dijetarësh të shquar historianë, arkeologë e gjuhëtarë, kanë sjellë duke plotësuar njeri tjetrin, një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore, që mbështesin tezën e origjinës dhe të shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga këto argumente themelore, janë:

1. *Shqiptarët banojnë sot në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar fise ilire; nga ana tjetër në burimet historike nuk njihet ndonjë emigrim i shqiptarëve nga vise të tjera për t'u vendosur në trojet e sotme.*
2. *Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra sendesh, fisesh, emra njerëzish, glosa, etj., që janë njohur si ilire, gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.*
3. *Format e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krabasunara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë zhvilluar sipas rregullave të fonetikës historike të shqipes, d.m.th kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.*

4. *Marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten, tregojnë se shqipja është formuar dhe është zhvilluar në fqinjësi me këto dy gjuhë këtu në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.*
5. *Të dhënat arkeologjike dhe ato të kulturës materiale e shpirtërore, dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë te shqiptarët e sotëm.*

Nga të gjithë këto argumente, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur, rezulton se teza e origjinës ilire e gjuhës shqipe, është teza më e mbështetur nga ana historike dhe gjuhësore.

Fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe

Shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV, ashtu si rumanishtja.

Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, është ajo që quhet “Formula e pagëzimit”, e vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në gjuhën shqipe “Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit”, që gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht nga Kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut.

Pal Engjëlli, gjatë një vizite në Mat, vuri re çrregullime në punë të ushtrimit të fesë dhe me këtë rast, ai la me shkrim disa porosi dhe udhëzime për klerin katolik, ndër të cilat edhe formulën e mësipërme, të cilën mund ta përdornin prindërit për të pagëzuar fëmijët e tyre, në rastet kur nuk kishin mundësi t’i dërgonin në kishë, ose kur nuk kishte prift. Formula është shkruar me alfabetin latin dhe në dialektin e veriut (gegërisht).

“Formula e pagëzimit” është gjetur në Bibliotekën Laurentiana të Milanos nga historiani i njohur rumun Nikolla Jorga dhe është botuar prej tij në vitin 1915 në “Notes et extraits pour servir l’histoire des croisades au XV siecle IV, 1915”.

Më pas, një botim filologjik të këtij dokumenti, bashkë me riprodhimin fotografik të tij, e bëri filologu francez Mario Rognes në “Recherches sur les anciens textes albanais”, Paris 1932.

Dokumenti i dytë, i shkruar në gjuhën shqipe është Fjalor-thi i Arnold von Harfit, i vitit 1496. Udhëtari gjerman Arnold

von harf, nga fshati i Këlnit, në vjeshtë të vitit 1496, ndërmoi një udhëtim pelegrinazhi për në “vendet e shenjta”. Gjatë udhëtimit kaloi edhe nëpër vendin tonë, gjatë bregdetit, duke u ndalur në Ulqin, Durrës e Sazan dhe për nevoja praktike të rrugës shënoi 26 fjalë, 8 shprehje dhe numërorët 1 deri më 10 dhe 100 e 1000, duke i shoqëruar me përkthimin gjermanisht. Ky Fjalorth u botua për herë të parë më 1860 në Këln, nga E.von Grote.

I fundit të shekullit XV ose i fillimit të shekullit XVI është edhe një tekst tjetër i shkruar në gjuhën shqipe dhe i gjendur brenda një dorëshkrimi grek të shekullit XIV në Bibliotekën Ambrosiana të Milanos. Teksti përmban pjesë të përkthyer nga Ungjilli i Shën Mateut, etj. Ai është shkruar në dialektin e jugut dhe me alfabet grek. Ky tekst i shqipes i shkruar, njihet në literaturën shqiptare me emrin “Ungjilli i Pashkëve”. Këto dokumente nuk kanë ndonjë vlerë letrare, por paraqesin interes për historinë e gjuhës së shkruar shqipe. Shqipja, që në fillimet e shkrimit të saj, dëshmohet e shkruar në të dy dialektet, në dialektin e veriut (gegërisht) dhe në alfabetin e jugut (toskërisht), si dhe me dy alfabete, me alfabetin latin dhe me alfabetin grek, gjë që tregon se kultura shqiptare ishte njëkohësisht nën ndikimin e kulturës latine dhe të kulturës greko-bizantine.

Libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është “Meshari” i Gjon Buzikut, i vitit 1555, i cili shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare. Nga ky libër, na ka arritur vetëm një kopje, që ruhet në Bibliotekën e Vatikanit. Libri përmban 220 faqe, të shkruara në dy shtylla. “Meshari” i Gjon Buzikut është përkthimi në shqip i pjesëve kryesore të liturgjisë katolike, ai përmban meshat e të kremteve kryesore të vitit, komente të librit të lutjeve, copa nga Ungjilli dhe pjesë të ritualit dhe të katekizmit. Pra, ai përmban pjesët që i duheshin meshtarit në praktikën e përditshme të shërbimeve fetare. Duket qartë, se kemi të bëjmë me një nismë të autorit, me një përpjekje të tij, për të futur gjuhën shqipe në shërbimet fetare katolike. Pra, edhe për gjuhën shqipe, ashtu si për shumë gjuhë të tjera, periudha letrare e saj nis me përkthime tekstesh fetare.

Libri i parë në gjuhën shqipe, “Meshari” i Gjon Buzukut, u zbulua për herë të parë në Romë nga njeri prej shkrimtarëve të veriut, Gjon Nikollë Kazazi.

Por libri humbi përsëri dhe u rizbulua më 1909 nga peshkopi Pal Skeroi, gjurmues dhe studiues i teksteve të vjetra. Në vitin 1930, studiuesi nga Shkodra Justin Rrota vajti në Romë, bëri tri fotokopje të librit dhe i solli në Shqipëri. Në vitin 1968 libri u botua i transliteruar dhe i transkriptuar, i pajisur me shënime kritike dhe me një studim të gjerë hyrës nga gjuhëtari i shquar, prof. E. Çabej. Në mënyrë të pavarur, tekstin e Buzukut, e pati transkriptuar edhe studiuesi N.Resuli.

“Meshari” i Gjon Buzukut është shkruar në gegërishten veriore (veriperëndimore), me alfabet latin, të plotësuar me disa shkronja të veçanta. Libri ka një fjalor relativisht të pasur dhe ortografi e forma gramatikore përgjithësisht të stabilizuara, çka dëshmon për ekzistencën e një tradite të mëparshme të të shkruarit të shqipes. Prof. Eqrem Çabej, që ishte marrë gjerësisht me veprën e Gjon Buzukut, ka arritur në përfundimin, se gjuha e saj “nuk është një arë fare e papunuar”.

“Duke e shkruar me një vështrim më objektiv këtë tekst – pohon ai – nga gjuha e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë dhe nga mënyra, me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft konsekuente e shkrimit, arrin të bindet njeriu, se në Shqipëri ka qenë formuar që më parë, së paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike”. Kjo tezë, sipas autorit, gjen mbështetje edhe nga gjendja kulturore e Shqipërisë mesjetare; “shkalla e kulturës së popullit shqiptar në atë kohë nuk ka qenë ndryshe nga ajo e vendeve përreth, sidomos e atyre të brigjeve të Adriatikut”.

Për një traditë të shkrimit të shqipes para shekullit XV, flasin edhe disa dëshmi të tjera të tërthorta.

Kleriku francez Gurllauame Adae (1270-1341), i cili shërbeu për shumë kohë (1324-1341), si Kryepeshkopi i Tivarit dhe pati mundësi t’i njihnte mirë shqiptarët, në një relacion me titull “Directorium ad passagium faciendum ad terram sanctam”, dërguar mbretit të Francës Filipit VI, Valua, studiuuan ndër të tjera: “Sado që shqiptarët kanë një gjuhë të ndryshme nga lati-

nishtja, prapëseprapë, ata kanë në përdorim dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën latine”. Pra, ky autor flet për libra në gjuhën e shqiptarëve, duke dhënë kështu një dëshmi se shqipja ka qenë shkruar para shekullit XV.

Edhe humanisti i shquar Marin Barleti, në veprën e tij “De obsi dione scodrensi” (Mbi rrethimin shkodran), botuar në Venedik, më 1504, duke folur për qytetin e Shkodrës, bën fjalë për fragmente të shkruara in vernacula lingua, d.m.th në gjuhën e vendit, të cilat flasin për rindërtimin e qytetit të Shkodrës.

Këto dëshmi të G. Aadae dhe të M. Barletit, dy njohës të mirë të shqiptarëve dhe të vendit të tyre, janë në pajtim edhe me të dhënat historike për këtë periudhë, të cilat flasin për një nivel ekonomik e kulturor të zhvilluar të viseve shqiptare në shekullin XIV dhe në fillim të shekullit XV. Në atë periudhë, në veri dhe në jug të Shqipërisë, lulëzuan ekonomikisht Durësi, Kruja, Berati, Vlora, të cilat u bënë qendra të rëndësishme tregtare, zejtare dhe kulturore.

Këto janë dëshmi që e bëjnë të besueshme ekzistencën e një tradite më të hershme shkrimi të shqipes, megjithatë, deri sa kërkimet të mos kenë nxjerre në dritë ndonjë libër tjetër, “Meshari” i Gjon Buzukut do të vijojë të mbetet libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe dhe vepra e parë e letërsisë shqiptare.

Në shekullin XVI i ka fillimet edhe letërsia në gjuhën shqipe tek arbëreshët e Italisë. Vepra e parë e letërsisë arbëreshe në gjuhën shqipe dhe vepra e dytë për nga vjetërsia është ajo e priftit arbëresh Lekë Matrenga “E mbesuame e kërshterë”, e botuar në vitin 1592. Është një libër i vogël me 28 faqe, përkthim i një katekizmi. Libri është shkruar në dialektin e jugut, me alfabet latin, plotësuar me disa shkronja të veçanta për të paraqitur ato tinguj të shqipes, që nuk i ka latinishtja.

Një zhvillim më të madh njohu lëvrimi i gjuhës shqipe në shekullin XVII, nën penën e një vargu autorësh, si Pjetër Budi, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani, të cilët nuk bënë vetëm përkthime, por shkruan edhe vepra origjinale. Frang Bardhi, në vitin 1635, hartoi të parin fjalor, “Fjalorin latinisht-shqip”, me të cilin mund të thuhet, se zë fill shkenca gjuhësore shqiptare.

Gjatë Rilindjes Kombëtare, në shekullin XIX, në kushte të reja historike, lëvrimi dhe përparimi i gjuhës shqipe hyri në një etapë të re. Në këtë periudhë u bënë përpjekje të vetëdijshme për të ndërtuar një gjuhë letrare kombëtare, standardizimi i së cilës u arrit në shekullin XX.

Dialektet e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, dialektin e veriut ose gegërishten dhe dialektin e jugut ose toskërishten. Kufiri natyror që i ndan në vija të përgjithshme këto dialekte, është lumi i Shkumbinit, që kalon nëpër Elbasan, në Shqipërinë e mesme. Në anën e djathtë të Shkumbinit shtrihet dialekti verior (gegërishtja), në anën e majtë të tij, dialekti jugor (toskërishtja).

Dallimet midis dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha, folësit e tyre kuptohen pa vështirësi njeri me tjetrin. Megjithatë, ekzistojnë disa dallime në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore e në leksik, nga të cilët më kryesorët janë: dialekti i veriut ka zanore gojore dhe hundore, kurse dialekti i jugut, vetëm zanore gojore; togut *ua* të toskërishtes, gegërishtja i përgjigjet me togun *ue* (grua ~ grue); togut nistor *va-* të toskërishtes, gegërishtja i përgjigjet me *vo-* (vatër ~ votër); *â*-së hundore të theksuar të gegërishtes, toskërishtja i përgjigjet me *ë* të theksuar (nânë ~ nënë).

Dialekti i jugut ka dukurinë e rotacizmit (kthimin e *n*-së ndërzanore në *r* (ranë ~ rërë), që në gegërisht mungon; në toskërisht, grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, etj. ruhen të plota, kurse në gegërisht, janë asimiluar në *m*, *n*, (mbush ~ mush, vend ~ ven). Në sistemin morfologjik, dialekti i veriut ka formën e paskajores së tipit *me punue*, kurse toskërishtja në vend të saj, përdor lidhoren *të punoj*. Forma e pjesores në toskërisht, del **me** mbaresë, kurse në gegërisht, pa mbaresë (*kapur* ~ *kapë*), etj. Dialekti i jugut ka format e së ardhmes: *do të punoj* dhe *kam për të punuar*, ndërsa dialekti I veriut përveç formave të mësipërme ka formën *kam me punue*.

Shqipja standarde

Formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar (gjuha standarde), si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, ka qenë një proces i gjatë, që ka filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i saj hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare.

Ne vitin 1824 Naum Veqilharxhi filloi punën për te krijuar alfabetin shqip dhe ne vitin 1844 dhe 1845 u botua “Evetar”-i. Vaqilharxhi ishte i pari që shprehu qëllimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare nëpërmjet traktatit të tij, parathënies së “Evetr”-it të parë dhe shumë shkrimeve të tjera. Në programin e Rilindjes, mësimi dhe lëvrimi i gjuhës amtare, përpjekjet për pasurimin e saj dhe pastrimin nga fjalët e huaja dhe të panevojëshme, zinin një vend qendror. Gjatë kësaj periudhe, u zhvillua një veprimtari e gjerë letrare, kulturore dhe gjuhësore.

Në vitin 1879, u krijua “Shoqata e të shtypurit shkronja shqip”, që i dha një shtysë të re kësaj veprimtarie. U hartuan gramatikat e para me synime normative dhe u bë hapi i parë për hartimin e një fjalori kombëtar i gjuhës shqipe, që është “Fjalori i Gjuhës Shqipe” i Kostandin Kristoforidhit, i botuar pas vdekjes së autorit, më 1904.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, u arrit të përvijoheshin dy variante letrare, varianti letrar jugor dhe varianti letrar verior. U bënë gjithashtu, përpjekje për afrimin e këtyre varianteve dhe për njësimin e gjuhës letrare. Detyra e parë që duhej zgjedhur, ishte njësimi i alfabetit. Deri atëherë, shqipja ishte shkruar në disa alfabete: alfabeti latin, alfabeti grek, alfabeti turko-arab dhe alfabete të veçanta. Këtë detyrë e zgjidhi Kongresi i Manastirit më 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908, në qytetin e Manastirit. Ne këtë Kongres, pas shumë diskutimesh, u vendos që të përdorej një alfabet i ri, i mbështetur tërësisht në alfabetin latin, i plotësuar me nëntë digrame (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh), dhe me dy shkronja me shenja diakritike (ç, ë), është alfabeti që ka edhe sot në përdorim gjuha shqipe. Kongresi e la të lire edhe përdorimin e alfabetit të Stambollit, që kishte mjaft përhapje, por koha i lëshoi vendin alfabetit të ri, që u paraqit në Kongres, pra alfabetit të sotëm.

Një hap tjetër për njësimin e gjuhës letrare shqipe, bëri “Komisioni letrar shqip”, që u mbledh në Shkodër në vitin 1916. Komisioni nënvizoi si detyrë themelore lëvrimin e gjuhës letrare shqipe dhe zhvillimin e letërsisë shqiptare. Ky komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, vlerësoi variantin letrar të mesëm, si një urë në mes toskërishtes dhe gegërishtes dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e tij, të cilat ndikuan në njësimin e shqipes së shkruar.

Vendimet e Komisionit letrar shqip për gjuhën letrare e për drejtshkrimin e saj, u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe vijuan të zbatoheshin deri në Luftën e Dytë Botërore.

Pas Luftës së dytë Botërore, puna për njësimin e gjuhës letrare kombëtare (gjuhës standarde) dhe të drejtshkrimit të saj, nisi të organizohet nga Instituti i Shkencave. U krijuan komisione të posaçme për hartimin e projekteve të drejtshkrimit. Kështu, u hartuan disa projekte në vitet 1948, 1951, 1953 e 1956. U organizuan gjithashtu, dy konferenca shkencore në vitin 1952, për të diskutuar për problemin e gjuhës letrare.

Me 1967, u botua nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, projekti i ri “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”. Ky projekt filloi të zbatohet në të gjithë hapësirën shqiptare, në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë dhe në Mal të Zi. Ndërkohë, përpjekje për njësimin e gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj, bëheshin edhe në Kosovë.

Në vitin 1968, u mbledh Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila, e udhëhequr nga parimi “një komb-një gjuhë letrare”, vendosi që projekti i ortografisë i vitit 1968, posa të miratohej e të merrte formën zyrtare në Republikën e Shqipërisë, do të zbatohet edhe në Kosovë. Vendimet e kësaj Konsulte kanë qenë me rëndësi të jashtëzakonshme për njësimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe.

Projekti “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes” i vitit 1967, pas një diskutimi publik, ai u paraqit për diskutim në Kongresin

e Drejtshkrimit të Shqipërisë, që u mbledh në Tiranë, në vitin 1972, i cili ka hyrë në historinë e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, si Kongresi i njësimimit të gjuhës letrare kombëtare.

Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipërisë, në të cilin morën pjesë delegatë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë, nga Kosova, nga Maqedonia dhe nga Mali i Zi dhe nga arbëreshet e Italisë, pasi analizoi të gjithë punën e bërë deri atëherë për njësimin e gjuhës letrare, miratoi një rezolutë, në të cilën përveç të tjerash, pohohet se “populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar”.

Gjuha letrare kombëtare e njësuar (gjuha standarde), mbështetet kryesisht në variantin letrar të jugut, sidomos në sistemin fonetik por në të janë integruar edhe elemente të variantit letrar të veriut.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit, janë botuar një varg vepra të rëndësishme, që kodifikojnë normat e gjuhës standarde, siç janë “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), “Fjalori i gjuhës së sotme letrare (1980), Fjalori i shqipërisë së sotme (1984), Fjalori Drejtshkrimor i gjuhës shqipe (1976), Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I Morfologjia (1995), II Sintaksa (1997).

Veçori tipologjike të shqipërisë së sotme standarde

Nga ana strukturore, paraqitet sot si një gjuhë sintetiko-analitike, me një mbizotërim të tipareve sintetike dhe me një prirje drejt analitizmit. Një pjesë e mirë e tipareve të saj fonetike dhe gramatikore, janë të trashëguara nga një periudhë e lashtë indoevropiane, një pjesë tjetër janë zhvillime të mëvonshme. Shqipja ka sot një sistem fonologjik të vetin, që përbëhet nga shtatë fonema zanore dhe 29 fonema bashkëtingëllore. Shkruhet me alfabet latin të caktuar në vitin 1908 në Kongresin e Manastirit.

Alfabeti i shqipërisë ka 36 shkronja, nga të cilat 25 janë të thjeshta (a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, k, l, m, n, o, p, q, r, s, t, u, v, x, y, z), 9 janë digrame (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) dhe 2 me shkronja diakritike (ë, ç).

Shqipja ka theks intensiteti dhe përgjithësisht të palëvizshëm gjate fleksionit. Në shumicën e rasteve, sidomos në

sistemin emëror, theksi bie në rrokjen e parafundit.

Shqipja ka një sistem të zhvilluar (të pasur) formash gramatikore, ka një sistem lakimi binar: lakimin e shquar dhe të pashquar, ruan ende mirë format rasore (ka pesë rasa), sistemin prej tri gjinish (mashkullore, femërore dhe asnjane), kjo e fundit po shkon drejt zhdukjes, mbahet vetëm në një kategori të veçantë emrash foljorë, të tipit: të shkruarit, të menduarit, etj.

Sistemi emëror ka trajtë të shquar dhe të pashquar dhe për pasojë, edhe lakim të shquar e të pashquar; nyja shquese është e prapavendosur si në rumanisht dhe në bullgarisht; ka nyje të përparme te emrat në rasën gjinore (*i, e malit*) dhe te mbiemrat e nyjshëm (*i mirë, i vogël* etj.), te emrat asnjane të tipit të folurit, etj. Përveç fleksionit me mbaresa të veçanta, shqipja njih edhe fleksionin e brendshëm (*dash ~ desh, marr ~ merr*); ka dy tipa strukturorë mbiemrash të ngjashëm (*i madh, i ndershëm*) dhe të panyjshëm (*trim, besnik*). Te numërorët përdor kryesisht sistemin decimal (*dhjetë, tridhjetë, pesëdhjetë*), por ruan edhe sistemin vegjisimal (*njëzet, dyzet*); numërorët e përberë nga 11-19, formohen duke vënë numrin e njësheve përpara, parafjalën *mbë* dhe pastaj dhjetëshet (*njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë*, etj) si në rumanisht dhe në gjuhët sllave.

Shqipja ka një sistem të pasur formash mënyrore dhe kohore, një pjesë të e cilave janë të trashëguara nga një periudhë e hershme, një pjesë janë kryer gjatë evolucionit të saj historik. Folja ka gjashtë mënyra; (dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore, urdhërore) dhe tri forma të pashtjelluara (pjesore, paskajore dhe përcjellore). Koha e ardhshme ndërtohet në mënyrë analitike, me dy forma: me *do* + lidhore (do të punoj) dhe me foljen ndihmëse kam + paskajore (kam për të punuar).

Rendi i fjalëve në fjali është përgjithësisht i lirë, por më i zakonshëm është rendi *subjekt+verb+objekt*.

Leksiku i gjuhës shqipe përbëhet prej disa shtresash. Një shtresë të veçantë përbëjnë fjalët me burim vendas, të trashëguar nga një periudhë e lashtë indoevropiane (ditë, natë, dimër, motër, zëri, etj.), ose të formuara më vonë, me mjete të shqipes (ditor, dimëror, i përnatshëm).

Një shtresë tjetër, përbëjnë fjalët e huazuara nga gjuhë të tjera, si pasojë e kontakteve të popullit shqiptar me popuj të tjerë gjatë shekujve. Fjalët e huazuara kanë hyrë nga greqishtja, greqishtja e vjetër dh e re, nga latinishtja dhe gjuhët romane, nga sllavishtja dhe nga turqishtja. Shqipja, me gjithë huazimet e shumta, ka ruajtur origjinalitetin e saj, si gjuhë e veçantë indo-evropiane.

Përhapja e gjuhës shqipe

Shqipja flitet sot nga më se gjashtë milionë vetë në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Kosovës Lindore, si dhe në viset e Çamërisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe në shqiptarë të mërguar në viset e ndryshme të botës para Luftës së Dytë Botërore dhe në këtë dhjetëvjeçar in e fundit.

Gjuha shqipe mësohet dhe studiohet në disa universitete dhe qendra albanologjike në bote, si në Paris, Romë, Napoli, Kozencë, Plermo, Leningrad, Pekin, München, Bukuresht, Selanik, Sofje etj.

Studimet për gjuhën shqipe

Gjuha dhe kultura e shqiptarëve, lashtësia dhe karakteri origjinal i tyre, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të huaj dhe shqiptarë që në shekullin XVIII dhe më parë. Në mënyrë të veçantë, gjuha, historia dhe kultura e shqiptarëve, tërhoqi vëmendjen e botës gjermane. Me të u mor edhe një filozof i madh, siç ishte Gotfrid Vilhelm Lerbntiz, që punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare. Ai mendonte, se studimi krahasues i gjuhëve ishte themelor për të ndërtuar një histori universale të botës, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar atë. Në disa letra, qe ai i shkruante një bibliotekari të Bibliotekës Mbretërore të Berlinit, në fillim të shekullit XVIII, shprehet edhe për natyrën dhe prejardhjen e gjuhës shqipe dhe pas disa luhatjeve, arriti në përfundimin, se shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë.

Megjithatë, studimet shkencore për gjuhën shqipe, si dhe për shumë gjuhë të tjera, nisën pas lindjes së gjuhësisë historike-krahasuese nga mesi i shekullit XIX. Një nga themeluesit e kësaj gjuhësie, dijetari gjerman Franz Bopp, arriti të provonte që në vitin 1854, se shqipja bënte pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe se zinte një vend të veçantë në këtë familje gjuhësore. Pas tij, studiues të tjerë, si G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokli, studiuin aspekte të ndryshme të leksikut dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. G. Meyer do të hartonte që në vitin 1891 një Fjalor etimologjik të Gjuhës shqipe (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strasburg 1891), i pari fjalor i këtij lloji për shqipen. Përveç këtyre, një varg i madh gjuhëtarësh të huaj, si F. Miklosich, G. Weigand, C. Tagliavini, St. Man, E. Hamp, A. Desnickaja, H. Ölberg, H. Mihaescu, W. Fiedler, O. Bucholtz, M. Huld, G. B. Pellegrini, etj. kanë dhënë kontribute të shënuara për studimin e historisë së gjuhës shqipe, të problemeve që lidhen me prejardhjen e saj, me etimologjinë, fonetikën dhe gramatikën historike, si edhe në studimin e gjendjes së sotme të shqipes.

Ndërkohë, krahas studimeve për gjuhën shqipe të albanologëve të huaj, lindi dhe u zhvillua edhe gjuhësia shqiptare. Ajo i ka fillimet e saj që në shekullin XVII, kur Frang Bardhi botoi të parin fjalor të gjuhës shqipe “*Dictionarium Latino-Epiroticum*” (1635). Gjatë Rilindjes Kombëtare u botuan disa gramatika të gjuhës shqipe. Kështu, në vitin 1864, Dhimitër Kamarda, një nga arbëreshët e Italisë, botoi veprën “*Saggio della grammatica comparata sulla lingua albanese*”, Livorno 1864, vëll.II “*L’Apendice al saggio dalla grammatica comparata sulla lingua albanese*”, Prato 1866. Më 1882, Kostandin Kristoforidhi botoi “*Gramatikën e gjuhës shqipe*” dhe më 1806, Sami Frashëri botoi “*Shkronjëtoren e gjuhës shqipe*”, dy vepra gjuhësore të rëndësishme të shekullit XIX për gramatologjinë e gjuhës shqipe. Nga fundi i shekullit XIX, Kostandin Kristoforidhi përgatiti edhe një “*Fjalor të gjuhës shqipe*”, i cili u botua në vitin 1904 dhe përbën veprën më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare, që u botua para Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1909, botohet Fjalori i shoqërisë “*Bashkimi*”.

Pas shpalljes së Pavarësisë, u botuan një varg gramatikash dhe fjalorë dygjuhësh, për të plotësuar nevojat e shkollës dhe të kulturës kombëtare. Në fushën e gramatikës u shqua sidomos Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani.

Aleksandër Xhuvani (1880-1961)

Kreu studimet e larta në Universitetin e Athinës. Veprimtaria e tij për studimin e gjuhës shqipe dhe arsimin kombëtar, e nisi që gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Bëri një punë të madhe për pajisjen e shkollës sonë me tekste të gjuhës shqipe, të letërsisë, të pedagogjisë dhe të psikologjisë.

Drejtoi e punoi për hartimin e udhëzuesve drejtshkrimorë në vitet 1949, 1951, 1954, 1956.

Pati një veprimtari të gjerë në fushën e pastërtisë së gjuhës shqipe e të pasurimit të saj dhe botoi veprën “Për pastërtinë e gjuhës shqipe” (1956). Bashkëpunoi me profesorin Eqrem Çabej, për hartimin e veprave “Parashtesat” (1956) dhe “Prapashtesat e gjuhës shqipe” (1962), trajtesa themelore në fushën e fjalëformimit të gjuhës shqipe. Botoi dhe një varg punimesh monografike për pjesoren, paskajoren dhe parafjalët e gjuhës shqipe. Ai ishte njohës i mirë dhe mbledhës i pasionuar i visarit leksikor të gjuhës së popullit. Fjalët dhe shprehjet e mbledhura, u botuan pjesërisht pas vdekjes, në formën e një fjalori. Përgatiti një botim të dytë të “Fjalorit të gjuhës shqipe” të Kristoforidhit (1961).

Vepra e plotë e tij, e projektuar në disa vëllime, ende nuk është botuar. Në vitin 1980 është botuar vëllimi i parë.

Një zhvillim më të madh njohu gjuhësia shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX, kur u krijuan edhe institucione shkencore të specializuara, si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës dhe Akademia e Shkencave, Universiteti i Shkodrës, më vonë, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Tetovës, etj. Gjatë kësaj periudhe, u hartuan një varg veprash përgjithësuese nga fusha të ndryshme të gjuhësisë. Në fushën e leksikologjisë dhe të leksikografisë, përveç studime leksikologjike, u hartuan edhe

një varg fjalorësh të gjuhës shqipe dhe fjalori dygjuhësh, nga të cilët, më kryesorët janë: “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954), “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976), “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), etj. Kohët e fundit kanë dalë edhe “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (2000) dhe “Fjalor frazeologjik ballkanik” (1999).

Në fushën e dialektologjisë është bërë përshkrimi e studimi i të gjithë të folurave të shqipes dhe është hartuar “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”, një vepër madhore që pritet të dalë së shpejti nga shtypi.

Është bërë gjithashtu, studimi i fonetikës dhe i strukturave gramatikore të gjuhës shqipe përmes studimeve të veçanta dhe përmes gramatikave të ndryshme, niveleve të ndryshme, nga të cilat, më e plota është “Gramatika e gjuhës shqipe” I Morfologjia (1995), II Sintaksa (1997), hartuar nga Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, me kryeredaktor Mahir Domin.

Një vend të gjerë në studimet gjuhësore të këtij gjysmëshekulli, kanë zënë problemet e historisë së gjuhës shqipe, problemet e etnogjenezës së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, të etimologjisë, të fonetikës dhe të gramatikës historike, etj. Disa nga veprat themelore në këto fusha janë: “Studime etimologjike në fushë të shqipes” në 7 vëllime, nga E. Çabej; “Meshari” i Gjon Buzukut (E. Çabej); “Gramatika historike e gjuhës shqipe” (Sh. Demiraj); “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” (Sh. Demiraj); “Gjuhësia ballkanike” (Sh. Demiraj), etj.

Eqrem Çabej (1908-1980)

Studjuesi më i shquar i historisë së gjuhës shqipe dhe një nga personalitetet më në zë të kulturës shqiptare. Pasi bëri studimet e para në vendlindje (Gjirokastër), studimet e larta i kreu në Austri, në fushën e gjuhësisë së krahasuar indoevropiane. Pas mbarimit të studimeve, kthehet në atdhe dhe fillon veprimtarinë shkencore e arsimore në vitet ’30 të këtij shekulli dhe punoi në këto fusha për një gjysmë shekulli, duke lënë një trashëgimi të

pasur shkencore.

Eqrem Çabej solli dhe zbatoi në gjuhësinë shqiptare metodat dhe arritjet shkencore të gjuhësisë evropiane, duke kontribuar shumë në ngritjen e nivelit shkencor të studimeve gjuhësore shqiptare. Eqrem Çabej punoi shumë në disa fusha të dijes, por u shqua sidomos në fushën e historisë së gjuhës, në trajtimin e problemeve të origjinës së gjuhës shqipe, të autoktonisë së shqiptarëve e të etimologjisë dhe të filologjisë së teksteve të vjetra.

Veprat themelore të tij janë: “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, në shtatë vëllime, I “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”, II “Fonetikë historike” (1958), “Meshari i Gjon Buzukut” (1968), “Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes” (1944).

Ai është bashkautor edhe në një varg veprash në fushën e gjuhës së sotme, siç janë: “Fjalor i gjuhës shqipe” (1954), “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (1972), “Fjalori drejtshkrimor”.

Përveç veprave, ai ka botuar një varg studimesh në revista shkencore brenda e jashtë vendit dhe ka mbajtur dhjetëra referate e kumtesa në kongrese e konferenca kombëtare e ndërkombëtare, të cilat kanë bërë të njohura arritjet e gjuhësisë shqiptare në botë, duke rritur kështu prestigjin e saj. Veprat e prof. Eqrem Çabej janë botuar në tetë vëllime, në Prishtinë, me titullin “Studime gjuhësore”.

Me veprimtarinë e shumanshme shkencore e me nivel të lartë, Eqrem Çabej ndriçoi shumë probleme të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, duke argumentuar lashtësinë dhe origjinën ilire të saj, vitalitetin e saj ndër shekuj dhe marrëdhëniet me gjuhët dhe kulturat e popujve të tjerë.

Gjatë kësaj periudhe, gjuhësia shqiptare zgjidhi edhe problemin e gjuhës shqipe letrare kombëtare, të njësuar me çështjet teorike të së cilës është marrë veçanërisht prof. Androkli Kostallari.

Në kuadrin e punës që është bërë në fushën e gjuhësisë normative dhe të kulturës së gjuhës, janë hartuar dhe një

numër i madh fjalorësh terminologjikë për degë të ndryshme të shkencës e të teknikës. Përveç veprave të shumta që janë botuar në fushën e gjuhësisë, veprimtaria e gjuhësisë studimore e studiuesve shqiptarë pasqyrohet në botimin e disa revistave shkencore, nga të cilat më kryesoret sot, janë: “Studime filologjike” (Tiranë); “Gjuha shqipe” (Prishtinë); “Studia albanica” (Tiranë); “Jehona” (Shkup); etj.

Studime të rëndësishme mbi gjuhën shqipe janë bërë nga gjuhëtarë në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, ku janë botuar një numër i konsiderueshëm veprash mbi historinë e gjuhës shqipe, fonetikën, gramatikën, leksikun etj. Prof. Idriz Ajeti shquhet për kontributin e veçantë që ka dhënë në këtë fushë.

Kontribut të veçantë për gjuhën shqipe kanë dhënë një numër i madh i shqiptareve të vendosur në Itali, të njohur si “Arbëresh”.

Disa nga figurat më të shquara të gjuhësisë shqiptare të këtyre dy shekujve të fundit, janë: Dhimitër Kamarda (arbëresh i Italisë), Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Selman Riza, Kostaq Cipo, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Androkli Kostallari, Idriz Ajeti, Isa Bajçinca, Shyqri Galica, Ahmet Kelmendi, Ramiz Kelmendi, Sabri Hamiti, Bajram Berisha-Mehmetaj etj.

Botuar: 14.05.2005.

<http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/Week-of-Mon-20050711/008084.html>

Censura dhe shterpësia letrare

Dua ta filloj fjalën time duke cituar një thënie të Niçes për objektivitetin, e cila, në një farë mënyre, do të jetë lajtmotivi i ideve që do të shtjelloj: “Objektivitet – sipas Niçes - do të thotë mungesë personaliteti, mungesë vullneti, mungesë dashurie.” (Vullneti për Fuqi) Duke pasur parasysh se vijmë nga një trashëgimi kulturore në të cilën është folur aq shumë për “të vërtetën objektive” që buron vetëm nga materializmi dialektik dhe historik, apo edhe sot, kur përdoret shpesh për të cilësuar qëndrime sa më “të ekuilibruara” apo “të paanshme”, kam frikë se shumëkujt mund t’i tingëllojë paradoksal apo i pakuptueshëm ky pohim....

Por, brenda tij ka një të vërtetë të rëndësishme. E vërteta e tij qëndron në atë se në shumë zgjedhje e gjykime që bën njeriu në jetë, ashtu sikurse edhe në krijimtarinë letrare dhe artistike, apo gjykimet dhe vlerësimet për të, nuk mund të bëhet fjalë për të vërteta objektive, por, përkundrazi, për të vërteta që kanë të bëjnë me përvojat e me formimin e individit, - edhe më fort kur bëhet fjalë për krijuesit, - pra, me ato që Niçe i quan “personalitet”, “vullnet” “dashuri”, pa të cilat vështirë të kuptohet identiteti i njeriut ose njeriu si subjekt.

Do t’i kthehem dhe rikthehem këtij citimi, por më së pari dua të them se e përmenda atë për të bërë të qartë se jam i vetëdijshëm se çka do të them nuk do t’i pëlqejë shumë të pranishmëve. Por, nga ana tjetër kërkoj prej tyre mirëkuptimin e nisur nga ideja se ato që do të them janë pjesë e personalitetit, vullnetit dhe dashurive të mia. Dhe ata që do të mendojë se po u

shkel disa të vërteta që i quajnë aq të padiskutueshme sa u japin epitetin “objektive”, i ftoj të reflektojnë më thellë për origjinën e këtij “objektiviteti”. Përse druaj se nuk do t’u pëlqejnë shumicës së të pranishmëve? Pasi që bëhet fjalë për të kaluarën letrare komuniste në Shqipëri, - ashtu sikurse edhe për krejt këtë krijimtari përgjithësisht, vlerësimi është se pavarësisht se aty ka pasur edhe mjaft kompromise me pushtetin, ajo ka vlerë të padiskutueshme. Sot, për arsye se pushtetin kulturor e ka po ajo kategori që e ka pasur gjatë periudhës komuniste, shumica e krijuesve të asaj kohe merr tituj e nderime që nga “mjeshtër i punës” e deri tek “nderi i kombit”, pikërisht për veprën e kryer në atë kohë. Madje edhe emrin shkrimtar e gëzojnë të plotë vetëm ata që e kanë marrë këtë emër nga Lidhja e dikurshme e shkrimtarëve dhe artistëve, ndërkohë që ata shkrimtarë që u persekutuan qysh në krye të herës nga regjimi, ose që nuk pranuan t’i shërbejnë atij regjimi, janë thuajse të harruar. Veçanërisht suksesi i veprës së Kadaresë, për të përkujtuar përkthyesin e të cilit nga shqipja në frëngjisht jemi këtu, është ajo që ka shërbyer si alibi e këtij qëndrimi. E pra, gjithë duke u mbështetur në avokatinë e Niçes, do të mbaj disa qëndrime shumë më të ashpra ndaj asaj letërsie. Dhe jo për arsye që lidhen thjeshtë me të kaluarën, por më fort me të tashmen. Ngase e konsideroj dramatike që ne as nuk na shkon ndërmend ta shtrojmë çështjen e së kaluarës në atë frymë me të cilën na ngacmoi kolegu rumun Calinescu, kur na tregoi se, kur e pyetën shkrimorin dhe disidentin rumun Andrea Pleshu “si ka mundësi që keni mbijetuar?” ai u përgjigj: “kësaj pyetjeje preferoj t’i përgjigjem me një tjetër pyetje “vallë, a kemi mbijetuar vërtet?”. Kur shoh se çfarë deformimesh e shtrembërimesh karakteriale ka pësuar individi shqiptar, e megjithatë, tek ne nuk diskutohet se cilat mund të kenë qenë shtrembërimet që kemi pësuar nga regjimi, përkundrazi, të gjithë konsiderojnë veten të mbijetuar, madje me merita, e kam vështirë të them se kemi mbijetuar. E kam vështirë të them se kemi mbijetuar, kur shoh se e vetmja gjë që bëjmë është eksteriorizimi i së keqes duke i gjetur fajet dhe përgjegjësitë vetëm dhe vetëm jashtë vetes. E kam vështirë të them se kemi mbijetuar kur shoh se sa pak po i

përgjigjet krijimtaria në përgjithësi, dhe letërsia në veçanti, kësaj drame që lidhet fort, sa me të kaluarën aq edhe me kohën që po jetojmë.

Përkundrazi, ne kemi shenja të dukshme të një vdekjeje morale dhe shpirtërore. Prandaj dhe fjala ime, në thelb, do të synojë të shpjegojë një aspekt të kësaj vdekjeje: shterpësinë letrare. Thënë ndryshe, do të rrekem të shpjegoj se përse diktaturat ideologjike si ajo që kaluam, janë të dënuara, sikundër thotë Heminguej për fashizmin, me shterpësi letrare e cila le një trashëgim shterpë, d.m.th. një letërsi të paaftë për të lindur letërsi. Censura censuron ata që pranojnë të censurohen. Është e vetëkuptueshme se, kur flasim për censurën, nuk bëhet fjalë për krijimtarinë që bën njeriu kur u beson atyre që shkruan, qofshin këto edhe gjëra të futura në kokën e tij nga propaganda komuniste. Raporti me censurën fillon kur shkrimtari bëhet i vetëdijshëm se ka gjëra që ai i sheh, i ndjen e mendon ato nuk mund t'i thotë dhe se ka të tjera që është i shtrënguar t'i thotë, ndonëse nuk beson tek to. Një moment i tillë ndërgjegjësimi, krijuesit në përgjithësi i ka ndarë në këto kategori – (nëse do ta thjeshtësonim pak këtë fenomen): në ata që në këtë situatë kanë preferuar të ndjekin thënien e Danillo Kishit: “Kur nuk e thua dot të vërtetën, hesht!” (e këtu do të fusja Kutelin, Poradecin, Kokonën e të tjerë shkrimtarë që pas ardhjes së komunizmit u morën vetëm me përkthime.) Në kategorinë ku, për fat të mirë apo të keq, kam bërë pjesë edhe vetë: kategoria e atyre që gjithë pa hequr dorë nga nevoja për të shkruar, në vend se të mendonin për botim, iu futën letërsisë së sirtarëve, dhe në ata që janë ilustrim i thënies tjetër që na citoi Calinesku: “censura censuron vetëm ata që pranojnë të censurohen”, me të cilët shoqëria jonë ka qenë e mbushur, fatkeqësisht, plot e përplot. Kuptohet kategoria e tretë është shumë komplekse. Aty hyjnë që nga shërbëtorët e paskrupull të propagandës deri tek ata që i kanë hyrë punës së nënshtrimit para censurës me plot kontradikta të brendshme. Këtu dua të debatoj pikërisht me këta të fundit, duke iu referuar debateve që kam pasur me ata më të sofistikuarit syresh. Ja disa argumente të rëndësishme që kam

dëgjuar të përdoren në emër të justifikimit të vazhdimit të krijimtarisë së tyre: Vepra mund të përmbajë edhe gjëra të pavërteta, kompromise me ideologjinë dhe propagandën, por megjithatë, mes tyre mund të ndërpusësh të vërteta që të rrezatojnë ashtu dhe aq sa t'i kompensojnë kompromiset. Lidhur me këtë thirrjet në ndihmë edhe Brehti (eseja “Pesë vështirësitë për të shkruar të vërtetën”, veçanërisht pika 5 ku ai flet për dinakërinë për të thënë të vërtetën.) Po ashtu, lidhur me “dinakërinë”, një nga argumentet më i përdorur, është edhe ai i letërsisë me “ambiguitete” që i referohet kryesisht një pjese të veprave të Kadaresë. Kësisoj, sipas kësaj teorie, heshtja, mosbotimi për një shkrimtar ka vlerë vetëm si bojkot, por mund të arrish gjëra edhe më të mira për shoqërinë duke botuar, duke arritur që proverbi “fjala është argjend - heshtja flori” në këtë rast të bëjë inversion. E dyta: të shkruash “bukur” një poezi për dashurinë, fjala vjen, është një temë e përjetshme e artit; ose, të shkruash mbi natyrën prozë e poezi, apo mbi tema historike, kjo është e mundshme edhe në kushtet e diktaturës dhe mund të jetë vërtetëthënëse ngase e përmbush gjithësi misionin e artit. Në mbrojtje të krijimtarisë së asaj kohe sillen edhe përkthimet e veprave me vlerë që lejohej të përktheheshin nga regjimi, e që në njëfarë kuptimi konsiderohen si kontribut letrar. Përgjithësisht në ambientin tonë kjo mbrojtje bëhet me kaq bindje sa ata që i mbrojnë këto teza nuk e vënë as në diskutim se kush i kundërshton e kush e ka gabim, ka humbur objektivitetin.

Dhe kuptohet, siç e thashë edhe më sipër: sukcesi i veprës së Kadaresë, përkthyer nga Vrioni në Francë është një gur i rëndë në favor të këtij “objektiviteti”. Censura të shpie në shterpësi letrare. Do të përpiqem të shtjelloj pse “subjektiviteti” im nuk pajtohen me këto argumente duke këmbëngulur që pranimi i censurës të shpie në shterpësi letrare. Sidomos në një regjim si ky yni, ku rolin e censurës e kishte zënë autocensura në një shkallë të tillë sa, sikurse dëshmuar edhe kumtuesit para meje, veçanërisht Ardian Klosi, në tërë përvojën e tyre të gjatë redaksionale, në morinë e librave që kanë kaluar nëpër duar, mund të veçonin vetëm dy-tre libra që kanë pasur “probleme” për

redaktorët e Shtëpisë Botuese Naim Frashri. Do ta ndaj analizën time në tre aspekte.

1. Autori dhe publiku

Brehti në dramën e tij të njohur “Galileu”, ka një moment në të cilin autori (personazh) i thotë personazhit Galileo: po si është e mundur që ti pranove të mohoje vetveten kur the se bota nuk rrotullohet? Përgjigjja e Galileut është: po unë e bëra këtë sepse kështu do të vazhdoja të bëja punët e tjera që bëra, shpikjet e tjera. Dhe autori i përgjigjet: po mirë, për çfarë kishte më shumë nevojë asokohe njerëzimi, për kurajën tënde për të thënë të vërtetën apo për shpikjet e tua që, edhe sikur të mos i bëje ti, do t’i bënte një tjetër? Problemi i raportit të autorit me publikun të cilit i drejtohet, është shumë kompleks, por nuk mund të mos veçohen disa çështje, ndër të cilat e para ka të bëjë me të qenit i vërtetë, qoftë kjo një e vërtetë e jashtme, kur bëhet fjalë për shembull për letërsi dokumentare, dhe qoftë kjo një e vërtetë e brendshme e autorit. Diktatura kishte standardizuar ose “objektivizuar” disa “të vërteta” që duhet të bëheshin të të gjithëve, duke filluar që nga kuptimi i botës e deri tek interpretimi i realiteteve konkrete, madje imponimi i kësaj të vërtete përjashtonte ndërtimin e të vërtetave individuale. Njeriu duke u parë vetëm si produkt i kushteve shoqërore, kishte karakteristikat e shtresës së cilës i përkiste dhe vetëm kaq. Madje deri edhe dashuria ishte e standardizuar: Ajo duhej të vihej pas dashurisë për Atdheun, Partisë dhe shokut Enver. Letërsia e asaj kohe paguhej nga Partia pikërisht për të përhapur këto të vërteta të standardizuara.

Pra, autori ishte thjeshtë një ilustrues i cili, madje, në njëfarë kuptimi nuk duhej të kishte të vërteta të tjera, të vetat. Edhe temat historike, tek të cilat mendohet se mund të kishte më shumë liri, janë përshkruar tejmbanë nga aspekti tjetër i ideologjisë, nacionalizmi – edhe ai i përdorur si mjet pushteti dhe shtypjeje të individualitetit, prandaj dhe të lirisë.

Nuk është nevoja të përmend këtu krijimtarinë e pafundme, më saktë të vetmen, me këto tematika. Aq e vërtetë është

kjo, sa po të bësh analizën e veprave të krijuara nga pikëpamje kronologjike, do të vësh re se ato kanë ndjekur fushatat e ndryshme propagandistike, problematikën që ka ngritur partia dhe Enver Hoxha në vite: luftën kundër kulakëve, kapitalizmit, revizionizmit, luftën kundër burokratizmit, luftën kundër zakoneve prapanike, luftën kundër liberalizmit, etj., shoqëruar me lajtmotivet e përjetshme të glorifikimit të luftës nacional-çlirimtare, të ndërtimit të socializmit, dashurisë për Partinë, Enverin, ushtrinë, bujqësinë, qenin e kufirit etj.. Nëse mund të thuhet se ka pasur gjithsesi një lloj individualiteti tek njerëzit e asaj kohë, kjo më shumë sesa krijimtarisë së soc-realizmit i dedikohet mundësive dhe kontakteve të tjera, qoftë nëpërmjet përkthimeve, qoftë nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit.

Masa e madhe që është ushqyer vetëm me krijimtarinë socrealiste ka pësuar një lavazh truri sistematik. Në këtë proces kemi një pseudokrijues që, nëpërmjet censurës dhe autocensurës, e zhvesh gjithnjë e më shumë veten nga të vërtetat e tij, nëse i ka ato, ose që nuk i zhvillon ato. Pra, një pseudokrijues që në vend së të shpreh e zhvillojë personalitetin, vullnetin dhe dashuritë e tij, bëhet gjithnjë e më shumë instrument.

Nga ana tjetër, në saje të kësaj pune, kemi një publik i cili nuk ndihmohet nga autori të ndërtojë këto instrumente, por që pëson një lavazh truri nga vepra në vepër duke u shndërruar kështu në qenie pa individualitet, personalitetet, pa vullnetin dhe pa dashuritë e veta. Kësisoj, për t'u kthyer tek tezat e atyre që flasin për dinakërinë, çështja në këto kushte shtrohet: a ishte e mundur të thuhej e vërteta duke bërë njëkohësisht këtë detyrë të madhe për gënjeshtren. Sipas meje diktatura kishte zhvilluar një instinkt të fortë për të kontrolluar se si dhe sa i shërbehej të vërtetave të saj, dhe as lejonte të vihej në peshë puna për të dalluar se nga anonte peshorja: në interesin e të vërtetave të saj, apo në interesin e të vërtetave kundër saj.

Këtë kontroll ajo e ushtronte pikërisht nëpërmjet censurës dhe autocensurës. Ata që duan të kapen tek ndonjë ambiguitet i veprës, apo tek ndonjë frazë a paragraf që ua ka hequr censura për të dëshmuar se kanë punuar në emër të ndonjë të vërtete

tjetër nga ajo e standardizuar, shëmbëlajnë me ata që kërkojnë të kapen për një fije kashte në një det gënjeshtre ku mbytej e vërteta. Në fakt, ambiguiteti si vlerë e veprave letrare nuk duhet kuptuar kurrsesi si krahasvendosje e së vërtetës me gënjeshtren, por si shumëplanimetri e së vërtetës. Pra, si një thellim tek ajo; si një shprehje në letërsi e asaj që thotë Oscar Wilde se “e vërteta rrallë herë është e pastër dhe kurrë e thjeshtë”.

2. Karakteri i veprës në vetvete

Çështja e vërtetësisë së veprës shtrohet edhe nga një pikëpamje tjetër, më pak morale dhe më shumë estetike: a mund autori me vetëdije të pranojë një përzierje të së vërtetës me gënjeshtren, të së bukurës me të shëmtuarën, pa menduar se po e cenon veprën artistikisht? Një krijim i patjetërsuar nga censura, ka për karakteristikë kryesore koherencën, organicitetin e vet. Nga përvoja ime krijuese mund të them se një instinkt i thellë më ka bërë të ndjeja një reaksion të fuqishëm - ashtu si ai i flakjes së një trupi të huaj - ndaj çdo transplantimi në veprën time të organeve të huaja me qëllim kompromisi, mbijetese politike. Megjithatë, nuk mund të mohohet se ndër këta krijues ka pasur më të talentuar dhe më pak të talentuar. Edhe diktatura kishte shijet e veta. Fakti që Kadareja ka fituar për shembull shumicën e konkurseve të rëndësishme letrare që çelte ajo dhe që u zgjodh për tu promovuar në Francë nga regjimi, e provon këtë. Diktatura kërkonte t'i shërbehej asaj me sa më shumë talent. Çështja atëherë shtrohet: a përbëjnë këto vepra vlera të mirëfillta estetike që dalin përtej përmbajtjes së tyre ideologjike, madje që janë sa më të bukura, sa më koherente, dhe të jenë me frymën ideologjike që kanë dashur të përçojnë? Kjo për mua mbetet një çështje ku mund të ketë mendime të ndryshme. Personalisht e kam të vështirë të shijoj estetikisht një vepër që më thotë gënjeshtër të bukura.

Gjithsesi ngulmoj se një vepër e tillë mund të lindet vetëm kur autori është brenda ideologjisë. Pra, beson në atë dhe frymëzohet prej saj. Madje, me këtë rast do të shtoja se nuk ekziston mungesa e lirisë për ta interpretuar realitetin nga

të tjera pikëpamje, ndaj dhe në ato të censurës. Jemi në rastin e krijuesve që janë mbështetur në krijimtarinë e tyre në një sistem të vetëm pikëpamjesh; disa prej tyre shumë të mëdhenj si p.sh. Dante.

Edhe Neruda ka bërë poemë për Stalinin dhe askush nuk dyshon se ai e ka bërë këtë për ndonjë përfitim apo servilizëm, por thjeshtë se ai ishte simbol i asaj çka ai besonte pa e njohur. Dhe prapë, problemi shtrohet: a mund të flitet për vlera estetike për një vepër që hyjnizon një diktator si Stalini apo Hitleri apo Enver Hoxha? Çështja shtrohet: a mundet lexuesi, edhe kur gjykon estetikisht, të çlirohet nga njohjet që ka për këta personazhe? Edhe këtu vijmë përsëri tek thënia e Niçes: se kurrsesi leximet nuk mund të kryhen jashtë një konteksti të caktuar që ka të bëjë me formimin e lexuesit, me personalitetin dhe dashuritë e tij.

3. Autori dhe vetvetja, shtysat e tij krijuese (ose pse shkruan autori?)

Problemi më i rëndësishëm që shtron nënshtrimi ndaj censurës, lidhet edhe me atë se përse shkruan një shkrimtar? Pra, cilat janë shtysat e brendshme që e shtyjnë të krijojë? Mendoj se shkaku i shterpësisë letrare në një regjim fashist duhet kërkuar fort në mekanizmin më të thellë e më thelbësor të artit që nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me raportet etike autor - publik, por edhe me raportet autor - vepër arti, me raportet qendër gjeneruese e krijimtarisë - krijim artistik, çfarë më duket se ka të bëjë, fundja, me shkoqitjen e asaj për çfarë i shërben psikologjikisht vepra e artit krijuesit të saj.

Sipas meje, po të tentojmë t'i hyjmë sa më thellë shkakut të shterpësisë në një diktaturë ideologjike, nuk duhet të ndalemi thjesht e vetëm në atë që "s'mund të shkruash dot të vërtetën". Puna është se kur flitet për një krijues që tashmë është i vetëdijshëm se ndodhet nën kontrollin e censurës, që supozohet se ndjehet nën presionin e saj, atëherë, për t'i shkruar sa më thellë shkakut të shterpësisë, më duket se duhet të nisemi nga mendimi që edhe kur shkruajmë diçka që mund të jetë afresk

i një realiteti historik, është imagjinata me rrënjët e përshkuara thellë në inkoshientin tonë, që përfton quid-in e quajtur art, se, edhe në këtë rast - që është më i miri përsa i përket mundësisë për të shkruar e botuar të vërtetën - vepra gjithsesi do të jetë e populluar botërisht dhe padukshmërisht me fantazmat e inkoshientit.

Frojdi thotë se fantazia është atribut i njeriut të pakënaqur; se dëshirat e paplotësuara e largojnë artistin nga realiteti dhe i a përqendrojnë libidonë/vëmendjen tek krijimi i objektit të imagjinuar fantastik. Sipas këtij koncepti, aq më i mbarsur potencialisht me krijimtari, duhet të jetë diktatura si një regjim vullnetshtypës. Mos vallë gabon Heminguei? Jo, sepse “çlirimi” për të cilin flet Frojdi është i lidhur ngushtë me reaksionin ndaj forcës represive, në kuptimin që edhe në nivelin e inkoshientit energjia e impulseve instinktive do të përqendrohet kundër saj, po të kemi parasysh se gjithnjë një vepër e fuqishme ka buruar nga një energji e fuqishme instinktesh. Pra, do të kemi një sendërtim artistik të fuqishëm atëherë, dhe vetëm atëherë kur do të tentojmë të sendërtojmë artistikisht konfliktin tonë më të fuqishëm emocional, pasi regjimi i diktaturës ideologjike, me politikën e tij represive dhe depersonalizuese, dashur e pa dashur t’i përqendrojë energjitë instinktive kundër tij. Kjo do të përftojë, po qe se do të përpiqem të shprehem artistikisht, edhe në rastin kur simbolika e autorit do të zgjidhet nga një material historik apo mitologjik; një rezonancë aktuale ashtu dhe aq të fortë sa që edhe censura më idioteske dhe më injorante, do t’i shquante “fantazmat kundërshtare”. Prandaj dhe nuk do ta lejonte botimin. Kurse më anë tjetër, nëse, për t’i shpëtuar kësaj, autori do t’i drejtohet trajtimit të temave jashtë këtij konflikti, vështirë të arrihet një vepër e fuqishme. Sepse shqetësimet më të qenësishme të autorit nuk do të kenë të bëjnë me temën. Romani Pallati i Ëndrrave, i Kadaresë, është libri më fatlum sipas meje, i autorit ku njëherësh “fantazmat kundërshtare” ndaj regjimit kanë mundur të dalin, ndonëse autori, për t’u mbrojtur, ka ikur në një kohë tjetër, atë otomane dhe ka qenë korrekt me regjimin përsa i përket pjesës nacionaliste në libër ku shqiptarët

e perandorisë i ngre më lartë se turqit.

Prandaj ngulmoj se i vetmi shpëtim në këtë rast për të shprehur këtë konflikt, është letërsia e sirtarëve shembulli më heroik i së cilës është Kasëm Trebeshina. Por, vazhdimi në një kohë të gjatë i një krijimtarie që nuk shpreson të shohë dritën e botimit është një punë e vështirë që mund të vijë duke u topitur me vitet, pasi mungesa e kontaktit me lexuesin dhe me kritikën mund ta demotivojë një autor sado të pasionuar të jetë ai. Le dur desir de durer- “Le dur desir de durer” - përgjigjet Paul Eluari ndaj pyetjes pse shkruan – çka lidhet me një shtysë të brendshme të autorit për të mposhtur ankthet e vdekjes për të lënë gjurmët e ekzistencës së tij. Por, a mundet një autor të mendojë se po fiton përjetësinë duke thënë gënjeshtër që nuk mund t’i rezistojnë kohës? Po ashtu problemi i “Le dur desir de durer” lidhet ngushtë edhe me atë se cilit lexues i drejtohet autori. Sepse, mbijetesa e një autori sigurohet pikërisht falë vlerave të veprës së tij që e bëjnë atë të lexohet edhe në kohët kur autori nuk jeton më. Autori i drejtohet njëherësh një lexuesi bashkëkohës dhe një lexuesi të së ardhmes. Ai i drejtohet një lexuesi mendjemprehtë dhe të ditur, por edhe një lexuesi injorant. Kjo e bën edhe më të koklavitur problemin. Lexuesi që kërkon të manipulohet dhe lexuesi mendjemprehtë, nuk janë e njëjta gjë. Kur unë isha i ri, kujtoj se kam pasur një dashuri të madhe për poema të Kadaresë apo Agollit, që i dedikoheshin Partisë së Punës; sepse asokohe e doja edhe partinë. Problemi është kur nuk e do më partinë a mund ta duash përsëri poezinë e shkruar “bukur” për të. Me syrin e tanishëm – në rastin më të mirë i vlerësoj si naive edhe veprat edhe autorët edhe lexuesin që kam qenë atëherë.

Lidhur me shtysat krijuese ka dhe shpjegime të tjera që kanë të bëjnë shumë më pak me nevojën që shpreh Elyari; dhe shumë më tepër me një nevojë të brendshme për të krijuar instinktin konstruktivist të njeriut: “krijoj ashtu siç këndon zogu apo siç ndërton bleta”. Pra, me faktin që njeriu e ka kreativitetin substancë të shpirtit të tij, e që, nga një pikëpamje psikanalitike konsiderohet si “korolar i erosit”. Mirëpo ky lloj kreativiteti

është i lidhur ngushtë me qenien e njeriut të lirë. Krijimi artistik, si çlirim i energjive krijuese në një sistem të lirë, në një shoqëri jo alienuese, si korolar i erosit, do të ishte tjetër, po, krejt tjetër gjë. Arti i krijuar në diktaturë, nën presionin e censurës, vetëm këngë e lirë nuk mund të ishte, vetëm art i pastër, jashtë çdo funksioni tjetër. Nuk mund të ishte sepse diktatura nuk paguante për këtë lloj arti. Madje e dënonte atë.

Diktatura e kthente krijuesin nga artisti në artizan, nëse me këtë të fundit do të kuptojmë një zanatçi që punon me porosinë e atij që e paguan. Pra, përse i përket këtij lloj arti, afërmendsh që një diktaturë ideologjike, që i përcaktonte temat varësisht nga nevojat e propagandës së saj, ishte tejet më shterpëzonjëse. Shterpësia dhe e sotmja, kur flitet për shterpësi letrare, kuptohet një letërsi që nuk është e aftë të lind një letërsi tjetër. Ja pse mendoj se censura e djeshme, si faktor shterpëzues, duhet diskutuar lidhur ngushtë me problemet e krijimtarisë së të sotmes. Sipas mendimit tim, njëri nga dëmet më të mëdha të socrealizmit ka qenë pengimi i krijimit të personaliteteve dhe individualiteteve, sa të autorëve aq edhe të lexuesve: ajo që gjetkë e kam quajtur “kultura e manipulimi i simulimit” – që krijon modele për të imituar dhe jo instrumente për të ndërtuar personalitetin, vullnetin dhe dashurinë tënde.

Mjafton të kesh parasysh se sa pak personazhe vërtet të gjalla, të besueshme, ka krijuar ajo letërsi për shkak se ishte e angazhuar në krijimin e modeleve që tipizonin pozitivisht punëtorin, fshatarin, komisarin dhe, negativisht, kulakun, borgjezin, priftin.

Thuhej se vetëm personazhet negativë nganjëherë dilnin më të qëlluar sepse atje autori kishte dorë më të lirë. Por, edhe ata ndërtoheshin tek e fundit sipas logjikës manikiniste: të bardhës dhe të zezës ideologjike. Në krijimtarinë tonë socrealiste edhe fëmija i një borgjezi do të ishte domosdoshmërisht personazh negativ, në kundërshtim me fëmijët e punëtorëve apo revolucionarëve. Kemi të bëjmë pra me një rreth vicioz, ku autori nuk nxirrte apo nuk zhvillonte dot asgjë nga vetvetja individuale dhe lexuesi merrte prej tij modelet e stisura e bajate të këtyre

personazheve. Kuptohet se një gjysmë shekulli komunikimi të tillë: shkrimtar - lexues nuk mund të mos ketë lënë pasoja të rënda përsa i përket mungesës së kulturës së ndërtimit të individualitetit në shoqërinë shqiptare.

Kjo mungesë individualiteti, ose më saktë, e instrumenteve për ta krijuar e zhvilluar atë, ndjehet fort edhe në krijimtarinë e sotme e më gjerë në shoqëri. Vazhdojmë të jetojmë ende në shoqërinë ku njeriu nuk ka mësuar të krijojë subjektivitetin e vet. Vakuumi i lënë kësaj nga “objektiviteti” socrealist; mungesa e instrumenteve për të ndërtuar individualitetin, shpesh ka bërë që të vërehet një humbje orientimi, i cili ka sjellë fenomenin e zëvendësimit të së vërtetës objektive soc-realiste me të vërteta të tjera “objektive” që merren si modele të padiskutueshme. Shpeshherë vendin e atij “objektiviteti” të modeleve soc-realiste e zënë modelet perëndimorë; pra: imitimi në këtë rast i perëndimore qe pranohet objektivisht si vlerë, për shkak të autoritetit që i jepet së jashtmi, pa u tretur në subjektivitetin e autorit. Kjo pjell imitim që është një formë e shterpësisë që vërehet aq shumë sot. Në thelb, ai është shprehje e paaftësisë për të krijuar një kulturë që t’i përgjigjet realitetit që jetojmë – e vetmja kulturë e vërtetë, me origjinalitet dhe personalitet.

Jusuf Vrioni si “dëm”

Një aspekt tjetër i mungesës së kësaj kulture të vërtetë është ai që do ta quaja: Jusuf Vrioni si “dëm”. Siç thashë, vakuumi i lënë nga rënia e sistemit të vlerave socrealiste ka bërë që kriteri kryesor i vlerësimit të mbetet vlerësimi i bërë së jashtmi. Kjo ka bërë që një pjesë e mirë e krijimtarisë të mos synojë t’i drejtohet publikut shqiptar më së pari, por që të krijojë duke pasur parasysh publikun e huaj dhe mundësinë e një suksesi atje. (Këtu nuk duhet injoruar edhe aspekti komercial). Një orientim i tillë, pas mendimit tim, sjell një motivim të mbrapshtë, pseudokulturor; një tjetërsim të krijimtarisë, sepse deformon si zgjedhjen e tematikës, ashtu edhe trajtimin e saj. (Mjafton të kujtoj kërkesën e lexuesit perëndimor për ekzotiken shqiptare, se sa shumë është trajtuar tema e gjakmarrjes p.sh. Apo edhe

superbollëkun e bunkerëve në krijimtarinë tonë si një çudi shqiptare.). Një aspekt i tjetërsimit që sjell ky orientim i shkrimtarit apo krijuesit në përgjithësi drejt shkesit jashtë dhe autoriteti që të jep ky sukses, është edhe tjetërsimi i rolit të krijuesit në shoqëri. Në vend se të shërbejë si një qenie më e ndjeshme, më e mprehtë, që komunikon me publikun e tij përvojat, shqetësimet dhe ndjeshmërinë e veta; një krijues që vështrohet nga publiku si krenari identifikuese, shërben për t'i dhënë lexuesit atë që do ta quaja identiteti i munguar individual. Një raport i tillë me krijuesin bën që lexuesi, në vend se të rritet nëpërmjet shkrimtarit, mbetet në rolin e atij që William Reich e quan “njeri i vogël” i cili “sa më pak i kupton gjërat aq më shumë i beson ato” e që “krenohet me gjeneralët e vet dhe jo me veten e tij”. (Për të ilustruar idenë, po tregoj një rast që ka të bëjë me një përvojë timen. Para disa kohësh kërkoi të më takonte një person që kishte qenë në një kurs post-universitar në Londër. Kërkoi të më takonte sepse në një nga leksionet, profesoresha kishte hyrë në klasë duke pyetur se kush ishte shqiptar mes tyre. Pasi ajo ishte prezantuar si e vetmja shqiptare mes një morie studentësh, ajo kishte thënë se atë leksion do ta mbante duke komentuar një ese timin “Privatësia në totalitarizëm”, botuar në një revistë amerikane, e cila, sipas saj, ishte një nga esetë më të bukura që kishte lexuar mbi privatësinë në regjimet totalitare. I vetmi koment që dëgjova unë nga studentja për atë moment ishte se sa krenare ishte ndjerë ajo mes studentëve të tjerë të huaj në ato çaste – dhe pa dyshim kjo më duket një gjë njerëzore - por asgjë nuk dëgjova prej saj lidhur me ato që kisha shkruar në atë tekst, e ishin komentuar – çka më duket se është vlera e parë dhe kryesore e tekstit dhe kënaqësia më e madhe për një autor.)

Pse e lidha këtë çështje me fjalën “dëmi” Vrioni. Sepse mendoj se modeli i suksesit dhe i autoritetit që ushtron Kadareja, nisur nga sukcesi i tij jashtë shtetit, ka çuar shumë tek ky motivim pseudokulturor i krijuesve shqiptarë që lidhet edhe me kërkesën e gjetjes së një përkthyesi për të pasur sukses jashtë shtetit. Kuptohet, nuk dua të fajësoj Vrionin këtu, por nuk mund të rri pa thënë se edhe fakti që këto takime kushtuar përkthimit

marrin emrin Jusuf Vrioni, janë reflektim i kësaj problematike. Sepse është zgjedhur emri i një përkthyesi që ka përkthyer nga shqipja në frëngjisht dhe jo nga gjuhët e huaja në shqip. Sipas konceptit që u përpoqa të shtjelloj më lart, nëse do të organizoheshin takime dedikuara përkthimit, e do të duhej t'u vihej atyre një emër, unë do t'i quaja takimet Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Gjon Shllaku, Petro Zheji etj., etj.

Pra, duke venë emra përkthyesish që i kanë shërbyer më shumë kulturës shqiptare nëpërmjet sjelljes në shqip të kryeveprave të pavdekshme të letërsisë botërore, madje duke refuzuar të merren me krijimtarinë socrealiste.

Janë ata dhe vepra e tyre, sipas mendimit tim, që kanë ndikuar më shumë se kushdo që njeriu shqiptar të mbijetojë në diktaturë. Të gjithë, nëse mund të themi se kemi mbijetuar, e që letrat shqipe të mund të mos mbeten sterile.

Botuar:02.05.2006.

<http://www.shqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=667>

Lavdia e de Radës

Një qind e pesëdhjetë vjet më parë lindi De Rada dhe një qind e tridhjetë vjet më parë u shkrua «Milosao». Letërsia e re shqipe, kultura e re shqiptare në përgjithësi, po mbushin një shekull e gjysmë.

Vërtet përpara, që nga Buzuku, shkrimtarë patriotë, në kohët më të errëta e më të egra, e kishin vënë pendën përkrah pushkës në Shqipëri, e kishin bërë shqipen me libra të shtypura dhe mjet qëndrese e lufte. Mendimtarë si Kavalioti kishin përhapur idetë e iluminizmit dhe krijuan vatra të lulëzuara kulture. Prapë, që të lindte një letërsi e re, e cila të shpaloste fletën e madhe të frymëzimit dhe të fluturonte me idealet e kohëve të reja, duhej pritur De Rada dhe duhej pritur «Milosaoja».

Poeti, sa për Shqipërinë, aq edhe për vete, e shkroi atë vargun e tij të famshëm, - «erdhi dit' e Arbrit». Erdhi dita e Shqipërisë, sepse shpresat që pat ngjallur krijimi i dy shteteve shqiptare, njëri në Veri e tjetri në Jug, nga Bushatllinjtë dhe Ali Pasha, ato shpresa nuk u varrosën me shkatërrimin e atyre dy shteteve nga Turqia, po u përtërinë me idetë e reja të çlirimit kombëtar, që tek arbëreshët frymëzonin Zef Krispin apo Engjëll Mashin, ndërsa në Shqipëri hidhnin në veprim Dhaskal Todhrin apo Naum Veçilharxhin. Në ballë të lëvizjes për përmbysjen e absolutizmit në Italinë Jugore ishin edhe arbëreshët, dhe këta patën heronjtë e dëshmorët e tyre në atë lëvizje. Kështu edhe në ballë të luftërave për çlirimin e Ballkanit nga Turqia ishin edhe shqiptarët, që patën gjithashtu heronjtë e dëshmorët e tyre në ato lufta.

De Rada qe pjellë e kësaj gjendjeje revolucionare në Itali

dhe Turqi, tek arbëreshët e ndër shqiptarë. «Milosaoja», që shpalli më 1836 se dita e Shqipërisë erdhi, prej atij zjarri të madh u mbryjt, aty e mori dritën dhe nisi t'i ndriçojë letërsisë sonë udhën e re. Dhe jo vetëm kaq. Me «Milosaon» kemi të parën kryevepër të letërsisë shqipe.

Pa dashur të nënçmojmë rezultatet e arritura në përpjekjen poetike shqiptare përmes krijimeve të Nezimëve apo Varibobave, s'mund të mos vëmë re menjëherë ndryshimin kolosal midis krijimtarisë së tyre dhe asaj të De Radës. Tek njëra palë, Lindja me artificializmat dhe brendinë e mykur të një vjershërie, të cilën aty-këtu e shpëton frymëzimi nga jeta bashkëkohëse, po që sidoqoftë ndrydh edhe talentet më të sigurta, si Nezimin vetë. Nga ana tjetër, epigonizmi ndaj letërsisë mistike dhe provinciale italiane, që nuk e ndihmon talentin të shkojë larg, qoftë ky edhe talenti i Varibobës. Ishte bota feudale e Lindjes dhe e Perëndimit, me mentalitetin e Kuranit dhe të Ungjillit, me ikonografinë e saj stereotipa e klishe, që përpiqej diç të përdorë edhe ngjyrat realiste, po që s'kuptonte sa duhej dhe pastaj si duhej të zhdukte zgjyrën e shekujve. Shqipja e shkruar, pak e ndjente veten të zonjën për mendime të larta. Ajo ndjehej e fortë «për mallkime, nëm' e të shara», qesëndis Variboba. Edhe pse në shend se po shkruhej, - «Divan, kush pat folur shqip?» pyet veten krenar Nezimi, se pandeh të jetë ai i pari që po e hedh shqipen mbi kartë, - ajo mbytej në një pellg të madh fjalësh turke, arabe, persiane, pa të cilat i duhej se nuk mund të bëhet «insan» (njerëzore!). Kënga e popullit, me magjinë e saj, ndonëse pat tërhequr disa të ditur e në mes tyre edhe ndonjë poet, si Filja, nuk u çmua si një burim ku të fladitej zana shqiptare.

De Rada, me temat dhe idetë e tij të reja, duke u mbështetur te «rapsoditë» që ai mblodhi e botoi me aq dashuri, bëri kthesën, kapërcimin e madh në të ardhmen. Si heroi i përrallës, ai kishte veshur çizmet magjike, me të cilat do të kërcente nga mesjeta në kohët moderne. Vepra e tij, që nga «Milosaoja», shqoi menjëherë, në horizontin e letërsisë shqipe, si një flamur apo si një monument që po ngrihej. Dhe vërtet ajo, me këngët e «Sera-

fina Topisë» (1839), të «Skanderbegut të pafanë» (1872-84), të «Pasqyrës së një jete njerëzore» (1898), u çua si një monument vigan në fushën e poezisë shqipe dhe u bë objekt admirimi, jo vetëm ndër arbëreshë e shqiptarë, por edhe në Evropë. Letërsia shqipe tregoi kështu origjinalitetin e vet midis shoqeve.

Atë e ngjatjetuan Lamartini e Hygoi, Mistrali e Tomazeu, Majeri e Buholci, duke i uruar një të ardhme të shkëlqyer, që ajo nuk vonoi ta ketë.

Kjo e ardhme e pat nismën një dite të gëzuar 29 nëntori, në Maki, me qiellin e kaltër lart dhe detin e kaltër poshtë, mbi ato kodrina përherë të gjelbëruara, midis ullinjve, me tingujt e këmborëve, - dhe tej, matanë detit, me Shqipërinë e paharrueshme, atdheun e të parëve, atdheun e Skënderbeut, që sflitej, po nuk epej, që shkelej, po ngrinte kokën, që arbëreshët e kujtonin me dhembje, në skamin e tyre të zi, në vuajtjet e tyre tek «dheu lëti», «dheu i huaj». Dhe vitet shkuan...

De Rada, ndonëse jetoj gati një shekull dhe vërdoi gati tre çerek shekulli, me libra, gazeta, mësim, konferenca, me ç'pati në dorë, i varfër, i përndjekur, i pafat, nuk e pa dot lirinë për të cilën u shkri. Shqipëria u bë, po një Shqipëri e përgjysmuar, që sa mezi mbahej më këmbë, së cilës ia ronitnin mushkëritë po ato lëngata dhe ia pinin gjakun po ato shushunja. Një Shqipëri, që edhe De Radën vetë, birin e saj më të madh të mërgimeve tragjike, gati s'e njohu dot!

E si mund ta njihnin De Radën më se dy milion shqiptarët që s'dinin të këndojnë shqip dhe të tjerët që sa mezi gërvishtnin pendën mbi letër? Kush njohu ndonjë copëz të veprave të tij, sigurisht u mahnit, po si të njihje më shumë? Ndër ata që e njohën më mirë, i cili tregoi se vepra e tij ishte ushqyer me gjak arbëresh dhe në luftë, për ta bërë arbëreshin që ta dallojë veten fort në dhe të huaj dhe të përpiqet për çlirimin e dheut të gjyshërve, ta mbrojë edhe kundër oreksit të lubisë së re, imperializmit italian? Sa ishin ata që ia bënë të njohura këto popullit, këto dhe të tjera, në kohën kur, tinëzisht apo me bujë, fashizmi italian përgatitej të gllabëronte Shqipërinë? Po, sigurisht, pati mësues e letrarë syçelë e të guximshëm, që u përpoqën të tregojnë se si De Rada

ishte gjithmonë aktual, sikundër ishte gjithmonë aktuale çështja e shpëtimit të atdheut. Por ata qenë pak. Emri i De Radës ishte i nderuar, veçse vepra e tij fare pak e njohur. De Rada, me jetën e tij prej luftëtari të madh të Rilindjes kombëtare, me këngët e tij prej artisti të ndritur, mbeti në terr, siç mbetën në terr shumë e shumë vlera shqiptare.

Ai tani mban emrin e «Mësuesit të popullit». Ky emër i ka hije ndoshta më fort se asnjë tjetër. Po, mësues, mësues i popullit, për të shtjelluar të kaluarën e lavdishme në sy të gjeneratave të reja, për të njohur e çmuar vetitë e rralla stërgjyshore, për të gjetur udhën e çlirimit, udhë ku qe heroizëm të prijë. Jeta e De Radës, vepra e tij, qenë jeta dhe vepra e një heroi të mendimit. Jeta dhe vepra e tij qenë shembull i durimit e i besimit, që përcjell çështjet e drejta të popujve, i sakrificës, pa të cilën këto çështje nuk triumfojnë...

1964.

1) Botohet me ndonjë shkurtim.

Të zbulosh një këngë popullore mbi Skënderbeun, është sikur të gjesh një thesar nga më të rrallët. Ai mbeti i pavdekshëm në kujtesën e brezëve. Legjenda e tij u rrit, u zbukurua, u bë e madhërishtme. Po këngët, të cilat ia thuri populli që herët dhe që u dëgjuan në Shqipëri gjer aty nga fillimi i shek. XIX, u zhdukën. Mbledhja e folklorit nisi vonë tek ne. Përveç ndonjë grimëze, e cila merr vlerë vetëm sepse ruan emrin e heroit, këngë të moçme mbi Skënderbeun nuk arritën të mblidhen në Shqipëri. Shumë qenë ata që i kërkuan më kot.

Më kujtohet se me çfarë emocioni jam takuar një ditë të vitit 1949 me Inxh. Jovan Adamin, që sapo kishte zbuluar një këngë popullore mbi Skënderbeun. Gëzimi i shokëve folkloristë, shkrimtarë e historianë, ishte i madh për atë zbulim të papritur. Po kur njohëm vargjet që inxhinieri kishte mbledhur nga një këngëtar në Krujë, kur vëmë e i mblodhëm sërish vetë, na doli një krijim i ri popullor, i cili zor të ishte më i moçëm se shekulli ynë.

Po tek arbëreshët? Edhe atje nuk janë ruajtur këngët e

lashta popullore mbi heroin. Këngët që botoi De Rada me shokë, janë krijime popullore apo savante në stil popullor, të shek. XVIII ose të pjesës së parë të shek. XIX. Në këtë përfundim kemi arritur ne, gjatë një studimi që botuam sot e dymbëdhjetë vjet dhe gjatë kërkimesh të reja që bëmë më pas.

Ne s'e kemi humbur shpresën, se mund të gjendet ndonjë këngë e lashtë popullore mbi Skënderbeun. Dhe ja këto ditë, rasti e sollë që, duke shfletuar shtypin arbëresh të Italisë, të hasim një këngë, për të cilën nuk dimë të jetë bërë tjetërherë fjalë.

Më 1753, 39 familje shkodrane, të udhëhequra nga një farë Anton Remani, kapërcyen detin dhe dolën në Ankona. Pasi u sollën ca kohë nëpër Itali, gjer poshtë në Napoli, ato u vendosën në krahinën e Lacios, në veri të Romës, pranë qytetit të vogël Montefiascone dhe liqenit Bolsena, në fshatrat Pianina dhe Iskia di Kastro. Avokati arbëresh, Nino Keta, që na flet për këto dy koloni më 1926 (v. gazetën «Cronache italo-albanese», Palermo 20 maj, fq. 4), thotë se nuk di më njeri shqip në ato fshatra. E fundit ishte një plakë e martuar në familjen Mida dhe prej fisit Remani. Të dy këta emra dëshmojnë se shqiptarët e Lacios ishin vërtet nga Shkodra ose rrethi i saj.

Plaka Mida mbante mend edhe një këngë mbi Skënderbeun, të cilën Keta e boton në përkthimin italisht të M. Puçinit. Ç'u bë origjinali shqip dhe kush e mblodhi këngën prej gojës së plakës, që nuk rronte më 1926? Keta nuk thotë asgjë. Ne jemi të detyruar të kënaqemi me përkthimin italisht që ai boton dhe ta kujtojmë me mirënjohje shërbimin e tij, po edhe me keqardhje që nuk shtiu në dorë origjinalin, të cilin, po ta kishte pasur, ai pa dyshim do ta botonte.

A është një krijim popullor kjo këngë? A ka qenë sjellë në Itali nga Shqipëria, apo u krijua atje? Nuk dimë ç'të themi. Aty jeton kujtimi i shtrenjtë i Skënderbeut, i gjallëruar nga një frymëzim jo i zakonshëm. Aty jeton edhe kujtimi i Shkodrës, sepse flitet për një liqen.

Vargjet e përshtatjes sonë shqipe janë po aq të zbehta, sa edhe ato të përkthimit italisht gati në prozë. Po ato do t'i sjellin gëzim lexuesit, në këtë muaj festash, muaj në të cilin çojmë

mendjen jo vetëm tek epikeja e re e Partisë sonë, po edhe tek epikeja shekullore shqiptare, veçanërisht tek ajo e Skënderbeut. Dhe, ashtu si e ka thënë Naimi, «Skënderbeu është gjallë», ai është shpirti heroik i popullit të vet.

*Mos të trembi nata, djalë?
Yjtë lart, që na vështrojnë,
prej frike nuk drithërojnë,
as nga ndonjë dhembë e shkretë.*

*Trim mbi trima, Skënderbeu, -
vaj! ç'u bë sot pallë e larë
dhe zemr' e çelikutë? vaj! -
s'desh t'ja dinte nëpër terr.*

*Mbi dorinë e tij rrebesh,
digjte si rrufe armiqte
dhe liqeni dridhërohej,
dridhërohej, ngrinte valë.*

*Dridhëronin yjtë, djalë,
jo prej frike, as prej dhembë:
u jip dritë e shpirt kreshniku.
Dhe kur yjtë i puthte agimi,
zbebeshin prej gëzimit, djalë.*

1961

Pas betejës

Lufta filloi si heshtur e pa u ndjerë. Në fillim me ca zëra pëshpëritës nëpër tavolina me ndonjë filxhan kafeje përpara. Pastaj më mirë, më me bujë e dhunë, gjersa arriti kulmin me goditje grushtesh, karrigesh, shishesh bosh. Shkurt, u bë një kasaphanë e vërtetë.

Kaq subjekti i tregimit, apo më saktë, i qindra ngjarjeve me horro, që i lexojmë nëpër libra, që i shfaqim ekraneve. Dhe dihet “deux ex machina” e tyre. Pas dhjetëra plagësh heroik krye-

sor puth e pshëm partneren...

Por unë nuk e kam fjalën për këto fakte të njohura e të stërnjohura. Sepse shumë prej tyre luhen në realitet, madje jo larg tej deteve a matanë dherave, por brenda këtyre kilometrave katrore të vendit tim. Mua më ka brejtur gjithmonë fillimfundi i këtyre horroreve, që herë pompohen, herë pushtojnë jo vetëm ekranet, por edhe gazetat me titujt bombastikë, madje edhe xhamat e ndonjë godine, që shërbejnë si objekte shënimi me llastiqe nga të vegjlit nga zero deri në njëmijë muaj. Në qeverira nxitohet menjëherë që të bëhet parada e sukseseve madhështore me kaq apo aq për qind dhe nga ana tjetër ngrihen tarifat e kontributeve, (fjalë ndërkombëtare kjo), sikur bota po pasurohet e sidomos punonjësit e thjeshtë dhe nëpunësit.

Pas çdo beteje shiten trimëritë e luftës dhe të bëmave të prijësve, madje thuren epope të tëra të tipit homerik për të lënduar e shpalosur vitalitetin e vetes. Se janë prijësit ata që kanë fuqi të jashtëzakonshme.

Lufta e Trojës zgjati dhjetë vjet, por jehona e saj ka dy anë: një që duket dhe një që shpiku Kalin e Trojës. Megjithatë prijësit ishin gjysmëperëndi, të pathyeshëm, të vdekshëm, por viganë, trima e dinakë, tradhtarë e spiunë, mashtrues e gënjeshtarë. Se është e pamundur prijësi të jetë i kulluar.

Ndryshe nuk do të shpikeshin luftërat.

Për çudi, në lojën e shahut, ushtari i thjeshtë mund të bëhet mbret, jo se lëviz një kuti përpara (ai prapa s'kthehet), por sepse ha anash.

Kalorësit, oficerët, kalatë, mbretëresha, mbreti dredhojnë, ecin përpara, prapa, nga të jetë ana e betejës.

I gjori ushtar duhet të mbajë edhe flamurin në atë sulm të tipit jeniçer, pilot vdekjeje, kamikaz dhe e kap shpata, shigjeta, plumbi. Që flamuri të mos mbetet bosh, nxitojnë oficerët, kalorësit dhe s'pushojnë së rrahuri gjoksin për trimëritë e tyre të jashtëzakonshme. Këta flamurtarë pas beteje nuk i duroj dot jo fizikisht, por për gjuhën e gjatë që ngre kala mburrjesh të tipit “doni më për Belulin?”

Unë ta rregullova, - u hodh njëri nga shefat e mi.

Ta rregullova unë, - tjetri më futi krahun.

- Ehu, - shtoi tjetri andej nga fundi, - sa kohë keisha që i lutesha shëfit për të të rregulluar ty.

Ore, - ua prita, - nuk po di kujt t'ia jap kafënë më përpara. Ata varën veshët e shtrembëruan noçkat. Kaq qe beteja ime.

Flamuri mbeti pa flamurtarë, sepse asnjëri prej tyre nuk mori pjesë në betejë si ushtar i thjeshtë.

- Pas beteje të gjithë bëhen trima e flamurtarë, - thashë më vete dhe ua ktheva shpinën.

Koha

Koha ecën me diell, me shi. Ecën e nuk ndalet. Jetojmë në këtë kohë, jemi pjesë e saj. Koha, djepi ynë. Sa i vogël njeriu para kohës së madhe! Koha ekziston edhe pa orën time, edhe pa tiktakun e saj. Orën e shpika unë, që t'i ha kohës kohën. S'ka orar zyrtar që mat kohën. Se edhe koha korruptohet.

Dhe ajo është shitur në kohët moderne.

Sa kohë na ka ikur! Nuk e di kohën para Krijimit, në fillesën e saj. U desh një qendër që koha të vërtitej rreth saj. Dielli kryeperëndia. Ai lëviz rreth vetes. Koha e tokës brenda këtij rrethi. E toka erdhi deri në ditët tona. Nga qeliza e parë deri te njeriu. Nga njëqelizori te njeriu-uzinë moderne.

Por koha ecën. Ne mundohemi ta ndjekim pas. Si pleqtë. Ka edhe që ecin mbrapsht. Ndryshe do të mbeteshin pa binjakë siamezë gaforret. Se edhe ato ecin mbrapsht. Thonë nga frika. Po ne, pse ecim vetëm mbrapsht? Kemi kaq kohë që ecim, pa ditur ku na shpjen këmbët. Koka na sillet rrotull. Mos vallë instinkti për të mos e ndjekur kohën? E ndjekim pa ditur se një ditë do të na lërë pas. Nga ankthi i fundit të pashmangshëm, ndërrojmë drejtim. Ndoshta na harron. Por ajo nuk harron kurrë. Harrohemi ne me ecjet prej gaforreje.

Koha, djepi dhe varri ynë. Koha, dashuria dhe fatkeqësia jonë. Prapë ligji i të kundërtave, që lëvrin në një hapësirë ku luajnë djepi dhe varri, gëzimi dhe hidhërimi, dashuria dhe urrejti. Më jepni një çast lumturie. E di që nuk është fushë me lule. Ai nuk vjen vetë. E mira do kërkuar. E keqja vjen pa ftuar.

Ne nuk e dimë ku është e mira, ku e keqja. Të mirën ia bëjmë botës, të keqen vetes. Kot nuk thonë koka bën, koka pëson. Të duash jetën do të thotë të duash kohën. Qindra orë, minuta, sekonda shkërmoqim me duart tona e pastaj s'na mbetet gjë tjetër veç aheve e uheve, që na vishen si rrobë trishtimi e brengje. Të isha edhe një herë i ri.

- *Po kur qe i ri, çfarë bëre?*

Ironi therëse që më dogji veshët. U pendova për atë që thashë. Se s'më ka faj njeri për kohën e vvarë kot.

E dua kohën. S'ka nevojë aspër ideologjizma, as për postulate, aforizma, horoskopë, por shtrydhje e kohës. Ah, pimë kohën, tavernave. Hidh kupa e puth çupa... Qejf, qejfli, qejflinjtë. Sarhoshët e kodoshët, të velurit nuk dinë si ta shtyjnë kohën. Na iku koha konferencave të shtypit. Qëllimi? Si ta frenojmë kohën. Por koha s'kthehet. Më sa kthehet lumi nga deti në burim.

Njeriu e ka kohën në dorë. Kohën e tij, kuptohet. O e frenon, o e shpejton.

E frenon me ecjet prej gaforreje. E shpejton me fluturimin e shqiponjave.

Ndryshe humbet dashuria për kohën. Ose koha të bëhet varr. Ose varri të harrohet. Kujdes, se të shkon qeni te guri i varrit. Kohë që ecën, ecën e pastër si loti, si vesa e mëngjesit...

Botuar: 13.09.2005,

<http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/Week-of-Mon-20050912/008869.html>

Branko Merxhani - ky emër i harruar i gazetarisë shqiptare

Emri i Branko Merxhanit, është mbuluar tashmë nga pluhuri i harresës. Harrim ky që ka kapluar sa atje - këtu, të shkuarën e gazetarisë shqiptare. Të gjithë, e sidomos brezi i ri mediatik, kujtojmë se gazetaria bëhet vetëm tani, në kohën tonë, nga gishtërinjtë tanë mbi tastierat e kompjuterëve të shtrenjtë....

Në fakt, gazetaria shqiptare ka një të shkuar të larmishme me anët e saj pozitive e negative, nga e cila mund të mësojmë shumë, të mësojmë që të rinjtë e apasionuar pas këtij profesioni të vështirë, të mos bien në gabimet që kanë rënë të parët. Branko Merxhani ka qenë ndër penat më të mprehta në vitet 30-të në Shqipëri. Ai doli në skenë si gazetar dhe si publicist më 1929 kur hodhi në publik idenë e neoshqiptarizmit, një lëvizje që synonte një zhvillim kulturor të vendit, larg politikës. Studiuesi i njohur Robert Elsie shkruan për të: “Merxhani e paraqiti neoshqiptarizmin në vitin 1929 në gazetën gjirokastrite “Demokratia” dhe në vitin 1930 në revistën “Neo-Shqiptarizmi”.

Neoshqiptarizmi e kishte për bazë nacionalizmin ideologjik. Në formën e mirëfilltë, ishte një lëvizje kulturore dhe jo politike. Në fjalët e Branko Merxhanit: “Politikë s’ka! Vetëm kulturë!”. Me kohë, Neoshqiptarizmi u bë një kundërpeshë e ideologjisë më të politizuar socialiste dhe internacionalizmit të majtë. Kështu Branko Merxhani, mendoi të ndryshonte edhe faqen e gazetarisë shqiptare, duke u shfaqur aty me një frymë idealiste. Në vitet `30, ai themeloi dhe punoi në disa organe

të shtypit si “Koha e Re”, “ABC”, “Përpyekja Shqiptare” etj. Në “Përpyekja Shqiptare” janë botuar edhe shumë shkrime dhe studime albanologjike nga studiuesit e asaj kohe. Emrin e Branko Merxhanit e hasim shpesh në librin e botuar kohët e fundit të Petro Markos, “Retë dhe Gurët” (Intervistë me Vetveten). Në vitin 1935 ai i shkruan një letër Petro Markos ku i thotë të kthehet në atdhe, sepse do botonin një gazetë të re. Petro Marko do ta tregojë Merxhanin edhe si një humanist dhe shok të përkushtuar; “Brankoja u tregua me mua shumë i dashur”, duke vënë në dukje shpirtin e mirë të këtij intelektual. Shkrimtari Petro Marko dhe Branko Merxhani bashkëpunuan për një kohë të gjatë në ato vite, ndërsa mes tyre u përjetuan edhe mos-përputhje mbi mendimet në lidhje me regjimin e Ahmet Zogut. Në vitin 1936, ata botuan së bashku revistën ABC, e cila u shtyp në dhjetë mijë kopje, tirazhi më i madh i asaj kohe. Petro Marko thoshte: “Brankoja shoqërohej më shumë me personalitetet e sidomos me Mehmet Konicën, që ishte një ndër këshilltarët e mbretit për problemet ballkanike. Brankoja kishte një karakter të fortë, ishte i ndershëm, patriot, idealist dhe gjykonte thellë për çdo çështje kombëtare”. Ai radhitet ndër emra si Nebil Çika, Timo Dilo, Islam Vrioni, Mihal Sherko, Vasil Xhaçka, Kostë Çekrezi, Harilla Bakalli, Vangjel Koça, Ernest Koliqi, Kristo Floqi etj, një brez intelektualësh që punuan brenda dhe jashtë Shqipërisë, për krijimin e identitetit tonë kombëtar. Branko Merxhani, megjithëse ishte diplomuar në Stambollin majtist të Mustafa Qemalit, kishte përqaftuar idetë djathtiste, dhe ndonëse mik me një sërë komunistësh të orëve të para (përfshirë këtu edhe Petro Markon), ai arrinte të jetonte atë të që e konsideronte si idealin e tij. Ai shprehej: “Unë jam demokrat, idealist dhe Tajari (Zavalani) më lufton. Unë dua një Shqipëri demokratike, si atë të Nolit, si atë të Turqisë së Mustafa Qemalit, por Tajari dhe shokët e tij më quajnë armik. Pse? Sepse unë sipas mendimit tim, kërkoj një zhvillim të shoqërisë ku të kenë vend edhe komunistët edhe të gjithë patriotët dhe antifashistët. Nuk më pëlqejnë polemikat që shpien ujë te mul-liri i përçarjes, ashtu siç i pëlqen Zogut”. Sipas Petro Markos,

Branko Merxhani shprehej “ne jemi vagabondët e historisë”, duke treguar se klasa intelektuale e asaj kohe kishte ende shumë për të bërë për këtë vend, ndërsa një pjesë e saj nuk ishte në dijeni, ose nuk donte të ishte në dijeni të përgjegjësive së të qenit intelektual i këtij populli. Ai në atë kohë shkruan edhe artikullin e njohur “Pse nuk jam Marksist”, duke shpalosur mendimet e tij demokratike dhe përparimtare. Pas këtij shkrimi ai u nda nga Petro Marko, dhe vazhdoi i vetëm në rrugën e tij. Në vitin 1938 Ahmet Zogu e mbylli edhe “Përpyekjen shqiptare”, dhe Branko Merxhani u detyrua të lere Tiranën dhe të shkojë në Athinë. Duke mos gjetur mjedis të botonte, ai mori rrugën drejt Stambollit, vendit ku kishte studiuar. Por edhe në Turqi, ai nuk e gjeti atë që kërkonte, pasi në atë kohë kishte shpërthyer Lufta e Dytë Botërore. Sipas albanologut të njohur prof. Nexhip Allpan (me banim në Turqi), Branko Merxhani, ishte ndër brezin e ri të shqiptarëve që shkëlqyen në shtypin turk. Ai kishte një penë të fortë dhe turqishten e zotëronte në mënyrë të përkryer. Gjatë luftës ai mbrojti dhe shkroi shumë mirë për lëvizjen nacional-çlirimtare. Por asnjëherë nuk devijoi nga pikëpamjet e tij liberal-demokrate, dhe u mundua të qëndronte asnjëherë duke parë tablonë politike të Tiranës mbas çlirimit. Sipas prof. Nexhip Alpan-it, ai punoi për shumë vjet në gazetata kryesore turke, *Tan* (Agimi), *Yeni Gazete* (Gazeta e Re), *Günaydin* (Mirmëngjes) apo *Hurriyet* (Liria), kjo e fundit ndër më të lexuarat aktualisht në Turqi. Ai bënte komente dhe përkthime rreth gjeopolitikës, ballkanologjisë dhe rolit të Turqisë në Ballkan, dhe e trajtoi shumë herë e shumë gjerë Shqipërinë në shkrimet tij. Sipas Nexhip Alpanit, ai kishte një aftësi të shkëlqyer analizimi, dhe një shembull i tillë është edhe artikulli i tij “Shqipëria dhe përpjekjet e saj për zhvillimin ekonomik”, botuar në *Yeni Gazete* në datat 16-21 korrik 1970. Ai që i detyruar të qëndronte larg atdheut deri në ditën e fundit të jetës së tij.

Që nga viti 1938 deri më 1981, ai ushqeu dëshirën për t’u kthyer në atdhe, porse duke ditur gjithë konjunkturën e politikës në Tiranë, ai e dinte ç’do ta priste nëse kthehej në vendin e shtrydhur nën putrën e komunistëve; aq më tepër që ai nuk ushqente

mendime të tilla. Branko Merxhani vdiq i vetmuar në shtëpinë e tij të varfër në rrethinat e Stambollit, dhe ngaqë nuk kishte asnjë familjar, tani nuk i dihet as varri i tij. Është koha t'i nderojmë këta pionierë të gazetarisë shqiptare, të cilët i paraprinë asaj që sot e trumbetojmë me të madhe, lirisë së shtypit dhe detyrës së shtypit në të mirë të opinionit, në të mirë të demokracisë dhe zhvillimit të këtij vendi. Është koha ta nderojmë Branko Merxhanin, këtë figurë të nderuar të gazetarisë shqiptare.

Ismail Kadare

Një prej romaneve të hershme të Ismail Kadaresë është “Kronikë në gur”. Ndryshe nga letërsia e deriatëherëshme për Luftën Antifashiste, e karakterizuar nga dy kampe personazhesh - partizanë e pushtues - ky roman solli një imazh më të ndërlikuar të saj, ku ndërthuren fate ushtrish të huaja të pakteve të ndryshme kundërshtarë, fate shtresash të ndryshme brenda për brenda tyre, fate të njerëzve të lidhur vullnetarisht me rezistencën ose të mobilizuar prej komandës, fate të indiferentëve, të sehirxhinjve dhe të kundërshtarëve.

Që lufta ishte një kohë mjaft më e ndërlikuar se ajo që shërbehej prej një tradite letrare skematike; kjo mund të shihet edhe në fatin e një familjeje qytetare në vendin e “kronikës në gur”, ku konflikti hyn brenda saj, duke ia tronditur regjimin tradicional. Me këtë roman I. Kadare pasuroi temën e Luftës Antifashiste, duke sjellë një shikim prej fëmije për evokimin e ngjarjeve të saj. Rrëfimi në veten e fëmijës, në veten e personazhit që evokon fëmijërinë e autorit, me “pafajësinë” e vet, megjithëse i ka dhënë romanit njëfarë karakteri autobiografik, njëherësh e ka mbrojtur atë prej qëndrimit të kritikës.

Duke qenë vështirimi prej fëmije një vështirim thelbësor në roman, lexuesi e ka të vështirë të dallojë se ku fillon koncepti i arsyetuar i saj e ku mbaron të konceptuarit si lojë.

Në studimin “Subversion kundër konformizmit”, një studiuës ka këmbëngulur se romani “Kronikë në gur” është një vepër hyjnzuese e Luftës Antifashiste, një “roman komisarësh”, dhe se përpjekja e autorit për të hyrë në lëkurën e fëmijërisë së vet nuk është gjë tjetër veçse një procedim letrar për të mbuluar

konformizmin. Përkundër këtij mendimi, shumica e studiuesve bashkohen në vlerësimin se “Kronikë në gur” është një vepër atipike në pikëpamjen metodologjike, e shkruar me një liri që tejkalonte kufizimin ideologjik dhe vlerësimin e partishëm për luftën.

Sipas një pjese të studiuesve, “Kronikë në gur”, duke pasur këtë vështrim, në fakt sjell tek lexuesi një përjasje psikanalitike frojdiste rreth luftës, ose jetës së qytetit në kohë lufte. “Kronikë në gur” është një prozë me subjekt të reduktuar, gjë jo fort e përshtatshme nga pikëpamja teorike për një letërsi të orientuar.

Me këtë vepër Kadare bëri përpjekjen e parë për t’i dhënë vlerë letrare të zakonshmes, të rëndomtës, madje të shëmtuarës dhe absurdes. “Kronikë në gur” është një vepër e përshkuar nga grotesku. Vështrimi i luftës me sytë e fëmijës i ka dhënë mundësi autorit që t’i shohë ngjarjet dhe personazhet e saj pa ndonjë partishmëri të dukshme.

“Kronikë në gur” përmban vlera të rëndësishme të një letërsie të mirëfilltë etnografike. Tradita e kësaj letërsie në qytetin e Gjirokastrës është më e hershme, ajo afirmohet mirë me botimet e Musine Kokalarit në vitet ’40, sidomos me “Siç më thosh nënua plakë” dhe “Sa u tunt jeta”. Etnografizmi në romanin e Kadaresë u jep edhe mjediseve një cilësi jotipike, ndryshe prej kërkesave të rrepta të metodës së realizmit socialist.

Flori Bruqi

<http://lajme.dervina.com/?sberbimi=lajme&lajmi=3617-2479:854>

Umberto Eco

Umberto Eco me romanin «Flaka misterioze e mbretëreshës Loana» ka bërë autobiografinë e ilustruar të postmodernës evropiane. A mund ta finalizonte dikush tjetër një projekt të tillë më mirë se i urti gjenial nga Piemonti?

Mbreti i citateve, detektivi i epokave dhe kirurgu i shenjave e gjuhës, Umberto Eco në romanin e tij më të ri «Flaka misterioze e mbretëreshës Loana» nuk na merr me vete për të zbuluar ndonjë murg vrasës brenda murreve të kishave mesjetare e as nuk na detyron të deshifrojmë pergamenat e pluhurosura bashkë me Baudolinon për të identifikuar vrasësin e perandorit Friedrich Barbarosa, kësaj radhe ai na fton t'i bëjmë një ekskursion gjeografisë së Unit të tij. Atij Uni nëpërmjet të cilit mund të mësojmë jo vetëm intimitete biografike të autorit, por edhe të të ashtuquajturës postmodernë vetë. Nëse si lexues kemi dilema me atë se çka në roman është reale e çka joreale, atëherë mund të shërbehemi me ilustrimet që shoqërojnë tekstin – kështu oferta e autorit.

Tashmë siç është bërë zakon, nuk shkoi as një muaj pas botimit të origjinalit në italishte «La misteriosa fiamma della regina Loana», romani u botua edhe në shumicën e gjuhëve të tjera perëndimore. Falë kolonisë jo të vogël të lexuesve të Ekos, në çdo vend, kulturë e gjuhë botuesit janë të sigurt se firma e këtij autori është profitabile dhe nuk çajnë kokën më gjithaq me shushuritjet e lektorëve dhe kritikës. Përderisa kritika karshi romaneve të tij si «Emri i trëndafilit», «Baudolino» etj, ishte e ndarë në dy pole agresive (njëra palë asgjësuese e tjetra të bën

të vjellësh nga përulja e tepruar para këpucëve të lustruara të shkrintarit italian) kësaj here vërehet një ballafaqim më syçelë, më i argumentuar dhe më i angazhuar në deshifrimin e botës së komplikuar të autorit bestseller.

Në romanin e parafundit (dhe të tjerët) ishin të rralla skenat dhe imazhet nëpërmjet të cilave mund të hynim në sferën intime të krijuesit, botën e tij, madje edhe kur mendonim të kemi triumfuar e kemi dekoduar ngjashmërinë e tipareve të Baudo-linës me Econ pas pak duhej të dorëzoheshim para maskimit mjeshëtor që pasonte në skenën e radhës. Për këtë romani i fundit «Flaka misterioze...» është një roman tepër i rëndësishëm për ekspertët, paraprakisht të fenomenit Umberto Eco e pastaj edhe të temave tjera që vepra sjell me vete.

Bodoni, Eco dhe ne

Storia: Antikuari milanez Giambattista Bodoni zgjohet nga koma. Ai nuk i njeh njerëzit që i qëndrojnë pranë shtratit. As gruan e tij të bukur Paola. Libri fillon me pyetjen: si e keni emrin? Pacienti nuk e di atë. Shtrëngon ballin dhe provon emra nga më të ndryshmit. Ia qëllova? Jo. Ai vërtet e ka humbur kujtesën. Ai nuk di se ku ka lindur, prej nga vjen dhe kush është. Yambo, e thërret gruaja që i qëndron pranë dhe ia shtrëngon dorën. Kot. Zotëri Bodoni, i cili pas një infarkti më 25 prill 1991 ka rënë në koma, është shndërruar në një qenie pa identitet. Më vonë bëhet e qartë se Yambo nuk ka humbur tërë kujtesën, por vetëm atë të personit të vetë (fenomen ekzistent në medicinë, për të cilin Eco si duket i ka konsultuar mirë neurologët), sepse ai me saktësi e di kush është Pitagora, Shën Augustini, Abrahami, ai e di shumë për Aleksandrin e Madh, por jo për nipin e tij Alessandro. Giambattista Bodoni nuk njeh vetëm antikitetet dhe librat me të cilat është marrë si tregtar, por edhe historinë tyre, një personazh më i ditur se sa të gjitha enciklopeditë e Bertelsmannit, Brockhausit dhe Larousse-s bashkë.

Bodoni nuk pranon që jetën e tij t'ia rrëfejnë të tjerët. Rast i shkëlqyeshëm për Econ, i cili merr atë dhe ne për dore dhe – këtu nis ai investigimi i famshëm i Umbertos- dhe nisemi për

të kërkuar gjurmët e identitetit të humbur të kryepersonazhit. Stacioni i parë: fshati Solara, në rrafshnaltën e Po-së, në Piemont, atje ku ka lindur Yambo. Në tavanin e shtëpisë së pararendësve të tij shfaqen shenjat e para të rinjohjes, të kthimit të kujtesës. Peizazhet e natyrës i njeh, por nuk e di prej ku (!). Mjegulla ende është shumë e dendur sa për të parë qartshëm. Duke bastisur kutitë dhe librat e gjen një leksikon të vitit 1905, pastaj një radio që s'funksionon, mirëpo që atij ia ngjall iluzionin sikur të dëgjoj muzikë klasike, operë, Chopin-in natyrisht dhe shumë këngë popullore të asaj epoke. I ngul sytë në inicialet RL të shënuara mbi rregullatorin e kanaleve të radios dhe bën «aha», «Radio London», pra. Gjyshi i tij paska dëgjuar radion e armikut me qëllim që informacionet pastaj t'i krahasojë me ato të regjimit për të zbuluar të vërtetën (vlerësimi dhe krahasimi i tekstit). Dikur lodhet Bodoni me Homerin, Manzoniin dhe Flaubertin, madje edhe një botim origjinal të Shekspirit që mban datën e vitit 1623 dhe i përveshet literaturës me nivel «më të ulët» si ajo e Emilio Salgarit (Karl May italian). Pikërisht me fletoret komike, në reklamat e atëhershme si Micky dhe Donald, Vespa, Espresso, me figurat si Mussolini, Hitleri partizanët, fashistët dhe komunistët nis rikonstruktimi i historisë. Pllakatet dhe sojet e kutive të cigareve Eco i boton krahas rrëfimit,

Kur Bodoni hyjnë në fazën e pubertetit shfaqet figura e dashnores së tij të paharrueshme Lilës – po si ajo Luara e Petrarkës dhe Beatriçja e Dantes – e cila tragjikisht shpejt vdes në Brazil larg syve të kryepersonazhit. E kështu me radhë pastaj Yambo duke hulmtuar vetveten na rrëfen historinë kulturore të epokës duke filluar nga vitet e para të vitit 1900 e deri kur ai bie në koma më 1991, në vitin e bombardimeve të Bagdadit nga amerikanët.

Analizë e identitetit kontinental

Rrëfimi për antikuarin që humbjen e kujtesës e shfrytëzon për të gjetur një identitet të ri është vetë biografia e Umberto Ecos. Dhe më shumë: si në asnjë vepër tjetër më parë – qoftë ajo shkencore apo artistike – profesori dhe intelektuali i famshëm

italian përpiqet që ta njoftojë kohën me rëndësinë e prezencës së tij në kulturën postmoderne. Giambattista Bodoni lind një vit para Umberto Eco, ku tjetër veçse atje prej nga vjen autori, si fëmijë i ka po të njëjtat lodra, në rini edhe ky ka simpati për fashistët e pastaj bëhet antifashist dhe gazetar e më vonë intelektual i pakrahasueshëm dhe enciklopedi e gjallë. Yambo na shpalon dialogët që e kanë shpëtuar nga religjioni, na reciton poezi dhe anekdota që Eco i ka botuar më herët në përmbledhje esesh.

Jashtë asaj personale, biografikes e pse mos të themi edhe narcisoides, Umberto Eco përnjëmendtë ka bërë autobiografinë e ilustruar të postmodernës në formë romani. Mbi të gjitha romani është analizë e kërkimit të identitetit që ka dhe po zhvillon kultura kontinentale. E kush mund ta bënte një projekt të tillë më mirë se i urti gjenial nga Piemonti?

Citate në alivanosje

Eco ka bërë një punë të mirë që kësaj radhe në fund të librit ka botuar një glosar që sqaron terminologjinë e përdorur në libër, se për ndryshe lexuesin e tij mund ta paramendonim duke lexuar në tren me një valixhe të mbushur përplot libra enciklopedikë dhe fjalorë të shumë gjuhëve. Ndoshta po për këtë arsye kapituj të tërë e bëjnë Yambon të përgjumshëm, të përsëritshëm dhe të mërzitshëm.

Edhe në «Flaka misterioze e mbretëreshës Loana» citatet ta plasim trurin, duke filluar me Poen, Stevensonin dhe Mellvilin, pastaj vijnë Manzoni, Çehovi, Baudelaire, Augustini e natyrisht pse të mungojnë edhe Montaleja, Lili Marleni, Shekspiri, Danteja, Floberit dhe pa e lënë anash patjetër Umberto Econ dorën vetë. Kolazhet, që burimin e kanë nga biblioteka e madhe e autorit, nganjëherë ta krijojnë përshtypjen sikur duan t'ia marrin frymën prozës, ta zhveshin atë nga arti i bukur dhe ta degradojnë në shenja dhe fotografi si në ato librat e historisë për gjimnazistët.

Lexuesit që duan ta dinë arsyen se pse Eco romanin e ka titulluar «Flaka misterioze e mbretëreshës Loana» duhet të kenë

durim dhe të presin deri në faqen 249 (të botimit origjinal, italian). Aty do të mësojnë shpejtë e sipërfaqësisht se bëhet fjalë për figurën kryesore të një «Cartooni» që zhvillohet në Orient, që Yambo e ka lexuar si fëmijë.

Botuar:19.09.2006

http://floart.blogspot.com/2006_09_01_floart_archive.html#115867694316070203

Klasikët e romanit postmodernist

Valerio M. Manfredi, Umberto Eco dhe Alessandro Baricco. Tre autorë me tre histori, tre romane që sjellin imazhin e tre epokave dhe kulturave të ndryshme dhe që vetëm dy gjëra i kanë të përbashkëta: atdheun e tyre, Italinë dhe famën e arrirë ndërkombëtarisht.

Olimpia përpiqet t'i ikë kafshimit të një gjarpri, i cili vibrueshëm sillet rreth shtratit të saj. Britma e saj për ndihmë çan muret memece të ëndrrës dhe tërbon pallatin. Filipi s'gjetet askund. Artemisia vrapon me pelena në duar për të sukulluar foshnjën. Lind Aleksandri, i biri i Filipit.

Nga koha aleksandrine në vitin 1154. Baudolino nga Aleksandria e Piemontit vjedh një tabak letre dhe një pergamena nga kancelaria e peshkopit Otto – një ndërmarrje që mund t'i kushtojë me kokë - për të shkruar “Chronica” e tij mbi vrasjen misterioze të perandorit Fridrih Barbarosa

Më se shtatë shekuj më vonë, në anijen luksoze oqeanike “Virginian” në një skaj të korridoreve të saja marinarët e gjejnë një fëmijë për të cilin mendojnë se është një qenie, si në legjenda, që ka udhëtuar nga një epokë tjetër në vitin 1900, prandaj edhe e pagëzojnë me emrin Novecento, pra me vitin e gjetjes së tij.

Aleksandri, Baudolino dhe Novecento. Valerio Massimo Manfredi, Umberto Eco dhe Alessandro Baricco. Tre autorë italianë që tre viteve të fundit nuk zbresin nga maja e listës së romaneve bestsellerë. Të tre në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin intensitet, gjë që le përshtypjen sikur një depërtim i tillë të jetë

i programuar dhe atë për t'i kthyer Italisë famën dhe primatin dantesk në gjirin e kulturës evropiane. Një spekulim – i përdorur nga ca kritikë anglezë e gjermanë - i kapur madje nga përtej zonës së qiellit.

Valerio Massimo Manfredi

Ai u bë vetëm tridhjetë e tre vjeçar dhe me famë të amshueshme: Aleksandri i Madh. Menjëherë pas vrasjes së të atit të tij Filipit, në mëshon njëzetvjeçare princi i bukur, karizmatik dhe tepër i zgjuar merr fronin, detyron grekët të shuajnë kryengritjet për shpartallim të perandorisë së Maqedonisë dhe nis ekspeditat për “pushtimin” e botës.

Trilogjia e Manfredit mbi Lekën e Madh (siç quhet shqip) “Aléxandros – Il Figlio Del Sogno” (“Aleksandri – i biri i ëndrrës” përkth. kalk) edhe pse është pasardhës i një tradite të pasur sa i përket “romanit aleksandrin” sjell me vete detaje të reja në lidhje me jetën e perandorit legjendë të ngritur deri në shkallën e perëndisë: Që nga stacionet e para si fëmijë në mesin e katër shokëve të tij të ngushtë; dashuria dhe orgjitë e para; mësimet tek Aristoteli; roli i ndërmjetësuesit ndërmjet Olimpisë dhe Filipit; tërbimi pas lindjes së gjysmëvëllait të tij nga Euridike e deri tek marrja e pushtetit autori mbërrin të rrëfej historinë e mbretit të Azisë dhe sunduesin e gjithë botës me një gjuhë të pangarkuar shkencore, siç mund të pritej nga një arkeolog i njohur si Valerio M. Manfredi (1943 – Emilia Romagna), që ligjëron universiteteve të Romës, Parisit e Birminghamit.

Në krahasim me Eco, i cili me sukses përvetëson gjithçka nga epoka për të cilën shkruan, Manfredi për ta bërë më të “kuptueshme materien” përdor një gjuhë duke iu përshtatur standardeve moderne të saj (si lochos në batalion ose strategos në gjeneral e të ngjashme). Shihet qartë se vepra e Manfredit është një mozaik i kombinuar dhe rafinuar mirë i fragmenteve të lëna nga Plutarku, Diodori, Rufuzi, Pliniusi, Arsitoteli etj. për të ardhur deri tek një rrëfim i njësuar, respektivisht duke u ikur kontradiktave që rezultojnë nga versionet e shumta të sagave mbi Aleksandrin. Romani është botuar disa herë në

gjuhët kryesore të Evropës perëndimore dhe vazhdon të shitet me një intensitet të madh.

Umberto Eco

Fshatari Baudolino nga Alesandria e Piemontit, ku më vonë do të lindë njëfarë Umberto Eco, i mbushur përplot ide dhe kreativitet na sjell panoramën historike të një epoke e kulture me një shkathtësi gjeniale rrëfimi: se si në moshën trembëdhjetëvjeçare adoptohet nga perandori Friedrich Barbarosa dhe bashkë me të merr pjesë në pagëzimin e tij si perandor në Romë për të udhëtuar pastaj në Vendin e Shenjtë bashkë me kryqëzatat. Gjithë ato që i shkruan Baudolino në kronikën e tij i ka përjetuar. Mirëpo thelbi i rrëfimit të tij ka të bëjë me vrasjen misterioze të “prindit” të tij Barbarosa. Vrasjen e tij në një kështjellë të bukur mesjetare përderisa ai ka qenë duke fjetur. Një ndërmarrje tepër e rrezikshme në kohën kur edhe letra për të shkruar ka qenë e ndaluar.

Profesori i Semiotikës në Universitetin e Bolonjës Umberto Eco (1932) famën e tij në plan universal e arriti me romanin “Emri i trëndafilut” (1980). Që nga ajo kohë atij i përcillen të gjitha shkrimet dhe sidomos studimet si “Kërkime për një gjuhë të përkryer” etj. në shumicën e gjuhëve evropiane. Madje edhe artikuj gazetash si ato në “Katër shkrime morale” i mblidhen dhe i botohen në edicion të veçantë nga shtëpitë më prestigjioze evropiane. Eco, tashmë është bërë njëri nga intelektualët elitare në kontekst me strategjinë dhe ngritjen e mendimit për një kulturë të përbashkët kontinentale. Gjatë ekskursionit nëpër botën shkencore për të zbuluar pikat e përbashkimit të çdo identiteti nacional në Evropë në një kulturë të vetme, shumëkush e festoi apo mallkoi ndarjen e tij nga letërsia, nga proza. Njëzet vjet më vonë, pas botimit të “Emri i trëndafilut”, Eco doli me romanin e tij voluminoz “Baudolino”. Roman, i cili jo vetëm për shkak të famës së Ecos që dy vjet mban të pushtuara vitrinat kryesore të librit nëpër Evropë, por më shumë për shkak të stampimit edhe njëherë më shumë të vlerave të këtij rrëfyesi gjigant.

Edhe në këtë roman, si në atë të parin, Eco ndjek traditën

e Sir Walter Scott (Waverly) dhe Alexander Dumas (Grafi nga Monte Kristo). Ose; ai i mbetet besnik romanit historik që në vete vazhdimisht jo vetëm se paraqitet si një dokument i detajuar mbi kulturën e epokës në të cilën zhvillohet ngjarja por është edhe një kombinim i shumë tipave të prozës në një: “Baudolino” në të njëjtën kohë është roman mbi një personazh real historik dhe roman që duket sikur është shkruar nga ndonjë Sherlock Holmes i mesjetës.

Autori futet aq thellë në ngjarjet e asaj kohe sa që djegia e Konstantinopojës, masakrat e zhvilluara nga kryqëzata e katërt e deri tek përpjekjet e Baudolinës për të denoncuar vrasësin e perandorit dalin si në një film, me fotografi fare të gjalla.

As kësaj here Eco nuk le anash pa involvuar teoritë e tij mbi kulturën evropiane, problemet e gjuhës dhe çështje të tjera që i japin prozës herë-herë edhe karakterin e një eseje shkencore.

Alessandro Baricco

Më kot kërkojnë marinarët prindërit e foshnjës së gjetur në bordin e anijes “Virginian”. Askush nuk bë zë. Asnjërit prej tyre nuk ia merr mendja se fëmija, i pagëzuar me emrin Novocento do të bëhet njëri nga pianistët më në zë të historisë së muzikës dhe se kurrë nuk do të shkel më tokën. Novocento bëhet legjende dhe pagëzohet; “Pianisti oqeanik”. Ai jeton për muzikën e tij dhe me të ai ushtron mrekulli tek të gjithë që i dëgjojnë të rënat e gishtave të tij në tastaturën e pianos. Novocento bëhet themelues i Jazz –it.

Alessandro Baricco (1958), shkrimtari italian nga Turini, ku edhe jeton, me këtë roman u bë autor-kult me famë ndërkom-bëtare. “Legjenda e pianistit”, siç quhet në shumicën e gjuhëve të tjera (ndërsa në origjinal “Novocento”) edhe si film pati një jehonë të jashtëzakonshme. Film, i cili u bë nga bartësi i oskarit Guiseppe Tornatore u konsiderua si njëri nga filmat më poetik të dhjetë viteve të fundit.

Muzikologu dhe filozofi Baricco, i cili punon edhe si moderator televizioni dhe ka themeluar “shkollën për shkrim kreativ” (e njohur po ashtu edhe jashtë Italisë) edhe me ro-

manet tjera si “Vendi prej qelqi” dhe “Mëndafshi” vazhdon të mbetet si njëri nga autorët më të lexuar. E veçantë tek ky autor është sidomos krijimi i romanit fare të shkurtë: Për shembull versioni gjermanisht i “Noveçentos” i ka vetëm tetëdhjetë faqe dhe atë me shkronja të mëdha, një libër që sipas autorit, është bërë me qëllim për t’u vënë në skenë teatrale e që pastaj është riformuluar në formë romani.

Me një rrëfim poetik dhe një fantazi të mrekullueshme Baricco përbashkon muzikën, pasionin dhe miqësinë në një pikë, në atë të harmonisë ndërnjerëzore. Ndërkaq “Noveçenton e paatdhe e lartëson në emblemë të epokës sonë” – shkruan një kritik gjerman në zë.

Tre autorë me tri histori, tri romane që sjellin imazhin e tre epokave dhe kulturave të ndryshme dhe që vetëm dy gjëra i kanë të përbashkëta: atdheun e tyre, Italinë dhe famën e arriturë ndërkombëtarisht si nga autorët më të lexuar. Kritikët në relacionin e gjuhëve italishte-gjermanisht- frëngjisht -anglisht e spanjisht i konsiderojnë si autorët “klasikë” të postmodernës.

Botuar:19.09.2006

http://floart.blogspot.com/2006_09_01_floart_archive.html#1158-67779144114479

Homeri dhe Odiseja nuk kthehen më në truallin grek

Greçia, respektivisht letërsia greke, kur ishte e ftuara speciale e Panairit të librit në Frankfurt (2001), Shtëpitë Botuese perëndimore, si zakonisht, iu përveshën organizimit të (ri)prodhimit industrial të veprave të vendit të promovuar si mysafir të panairit. As kontributi grek, në këtë drejtim, për të prezantuar letërsinë e vetë sa më dinjitetshëm, nuk mungonte. Siç u shpreh edhe vetë shkrimtari Vassilis Vassilikos (i cili mori famën me romanin dhe filmin e njohur “Z”), gjatë një konference shtypi, në njërin nga sallonet e Panairit; “Po duket se vendasit e mi më me kënaqësi sjellin në jetë libra se sa fëmijë”. Dhe ai ka të drejtë në këtë konstatim, kur kihet parasysh se në Greqi, vetëm brenda vitit të kaluar, u prodhuan më se 8 mijë libra, një tendencë kontinuitive që nuk është patjetër drejtpërdrejtë e lidhur me pjesëmarrjen greke në panairin gjerman të letrave. Ka vite që në terrenin grek vërehet një “boom” në industrinë dhe tregun e librit.

Palamas, Kavafis, Ritsos, Elitys

Përkundër faktit se autorët grekë kanë arritur të aktivizojnë sensin, dëshirën dhe gatishmërinë e qytetarit të vetë për të lexuar, me një fjalë kanë gjetur metodën se si të ngacmojnë interesin e grekut të sotëm ndaj librit, ata nuk kanë arritur – përveç në planin turistik – të shpërthejnë muret e izolimit të letërsisë së tyre për të dalë jashtë stadiumit të tyre nacional. Pas romanit të heraklitasit Nikos Kazantzakis “Alexis Sorbas” që u bë i njohur

falë Holivudit dhe Antoni Quinn-it (1946) dhe çmimit Nobel që iu dha poetit Odysseas Elytis nuk ka pasur ndonjë “rast” tjetër që do të kishte shkaktuar interes jashtë vendit. Megjithëkëtë me pjesëmarrjen dhe prezantimin e letërsisë së tyre krijuesit grekë arritën që të mobilizojnë opinionin kritik mondan që ai të ballafaqohet me letërsinë e tyre aktuale, kështu duke nxitur një debat të ri në lidhje me identitetin, rolin dhe vlerat e letërsisë greke në gjirin e asaj botërores, gjë që në njëfarë mënyre, pjesërisht edhe ia arritën, nëse jo si letërsi e tërë, pra si kolektiv, atëherë nëpërmjet individëve – krijuesve të veçantë që sjellin vërtet një frymë të veçantë në letërsinë artistike, madje sipas një studiuesi të letërsisë greke; “kjo është mirë edhe për vetë letrarët grekë, është njëlloj peshimi vlerash, tash ata shohin se ku qëndrojnë”.

2. Tek dashnorët ose më saktë kritikët evropianë me një nostalgji të theksuar homerike debati po udhëhiqet nga një eufori referencash antike. Një numër i konsiderueshëm kritikësh, që tubohen rreth disa medimeve prominente euro-amerikane, të cilët shoqëruan panairin me komente e refleksione pandërprerë, që nga lajmi për pjesëmarrjen greke e deri në ditën e fundit, “harruan” të merren me letërsinë e sotme greke, ose iu qasën asaj vetëm në formë sipërfaqësore sa për të justifikuar paraqitjen, duke u zhytur sërish në stërinterpretimin e Mitologjisë Homerike, rëndësinë e antikës së lavdishme greke për majat e kulturës së sotme perëndimore e të ngjashme.

Në anën tjetër po aq e zjarrshme është edhe kritika që “ka alergji ndaj lavdisë greke”. Janë kritikët që zanafillat e lindjes së kreativitetit shpirtëror e mendor human nuk i shohin patjetër vetëm në epokën e Homerit, Eskilit, Euripidit, Sofokliut, por edhe në botën paraantike, orientale, duke u kapur për dokumenteve të para, shenjave të para të interesit human për artin. Ca ashpërsojnë polemikën e tyre duke ftuar në ndihmë faktet në lidhje me plagjiaturën që grekët kanë bërë në Antikë duke vjedhur mitet dhe legjendat e kulturave të përmbysura e të djegur nga vetë ata. Fakte kokëforta që injorohen nga “kori i elozhistëve, për të cilët bota nis dhe mbaron me Homerin”,

siç shprehet një kritik amerikan.

Ndërsa, të rrallë janë ata që me një dozë të matur përfolën kontributin grek në zhvillimin e intelektit human – i cili assesi nuk duhet përjashtuar – dhe me një përqendrim profesional, kritik e shkencor përpiqen të përballojnë euforinë që shkakton Greqia me emrin e saj të lavdishëm historik, duke u përpjekur të japin një vlerësim korrekt në lidhje me letërsinë e sotme greke ose mbi letërsinë e re greke – nëse bazohemi në pretendimin grek!

Pa mohuar argumentacionin e që të tri fronteve të kritikës rreth rolit grek në zhvillimin human, pa u bërë varës i njëres apo tjetres teori si dhe pa hulumtuar rrethanat dhe origjinën e vërtetë të një lulëzimi të tillë intelektual grekët janë krijuesit e “Poetikës”, filozofisë, dhe shumë drejtimeve tjera të shkencave humane. Duke filluar që nga parasokratikët e deri në shkollat e fundit platonike nëpër trojet evropiane përulemi përballë faktit rreth kontributit të një populli në përhapjen e filozofisë për mendimin dhe shpirtin e lirë, i cili më vonë do të inspirojë të gjitha etapat e zhvillimit të mendjes humane nëpër shekuj.

3. Ekziston një vakuum gati dymijë vjeçar në mes të letërsisë antike greke dhe rishfaqjes së saj në shekullin XIX. Letërsia e re greke, konkretisht, dokumentet e para postantike letrare - duke përjashtuar veprat e Andreas Kalvos Ioannidis, të shkruara në frëngjisht – datojnë me shkrimet e Dionysios Solomos, sidomos me veprën e tij “Kretasi” ku bëhet fjalë për ikjen e një ushtari grek nga thonjtë e soldnerëve të Ali Pashës. Poeti dhe rrëfyesi historik Solomos përpiqet që të shfrytëzojë “trashëgiminë” e poetëve të lashtë grekë, mirëpo i ndikuar tej mase nga letërsia e filozofia anglo - saksone, gjermanë e në veçanti nga Göte, Kant dhe Hegel nuk ia del të dëshmojë për një stil tradicional grek që do të lidhej me klasikët e antikës.

Megjithatë Solomo është sinonimi i kthimit të letërsisë greke si dhe udhërrëfyesi i romantizmit grek, i cili, ashtu si tek popujt tjerë bëhet epoka e një shpërthimi shpirtëror. Me krijimin e shtetit të ri grek (1830), të frymëzuar nga Solomos (duke ndjekur stilin dhe formën e tij të krijimit) në skenë paraqitet

një gardë krijuesish (Papadiamantis, Xanthopoulos, Martelaos, Danelakis, Gouzelis etj.), të cilët me të drejtë konsiderohen si prestarët e parë të Letërsisë Kombëtare greke. Një letërsi me barrën e pretendimit në shpinë për të konsistuar me historinë e Odisesë, pra për të arritur statusin e trashëgimisë së Homerit në letërsi. Pa sukses.

Palamas dhe Kavafis, edhe pse Kostis Palamas me veprën e tij “Këngët e atdheut tim” bëri një jehonë të efektshme jo vetëm në Greqi nga pjesa dërrmuese e teoricienëve që merren me Letërsinë e Re greke nuk e konsiderojnë atë si krijuesin e lirikës moderne greke, por Konstatin Kavafisin e lindur katër vjet pas tij. Me plotë të drejtë. Palamas nuk arrin të çajë rrethin e krijuar stilistik, gjuhësor e përmbajtjesor të romantikut Solomos.

Ndërsa Konstantinos Kavafis (1863-1933) në poezinë e tij arrin në mënyrë mjeshtërore, me një finesë origjinale; t’i përshtatet ndërtimit modern të poezisë në aspektin stilistik; të shfrytëzojë (deri sot asnjë krijues grek nuk ik dot këtij segmenti) Mitologjinë greke aq të preferueshme nga mendësia evropiane me një perfiditet të lehtë; duke i dhënë letërsisë greke një ngjyrë krejt tjetër nga ajo antike, pra një pamje reale, domethënë një imazh bizantin e ortodoks. Kjo nuk do të thotë me çdo kusht që Kavafis nuk ka rënë (dhe atë në fillim e në fund të jetës së tij bindshëm) në grackë të lirikës historike e romantike, sidomos në përmbledhjen “Gota e ngjyrosur” vërehet një kurs labil në këtë kontekst, mirëpo ato poezi nuk i dhanë atij famën e një poeti të përmasave universale, por vjershat mbi dashurinë, vjershat homoerotike që hapën një horizont të ri në lirikën greke dhe i thanë fund sundimit të vetëm e absolut të tragjikes, dramatikes mbi jetën e një letërsie në krizë identiteti. Vizioni për t’iu afruar të së Bukurës pa i vënë asaj parakushte dramatike shpëtuan jo vetëm Kavafisin, por edhe mbarë letërsinë që s’kapërcente dot kufijtë e një epoke mijëra vjet të perënduar e që s’imitohej.

Ritsos dhe Odysseas ElytisJani Ritsos (1909 – 1990), njëri nga poetët, të cilit, për dallim nga Kavafis, nuk mund t’i mëveshët asnjë grimë historiciteti, keqpërdorim të namit antik grek për të depërtuar në botën e letërsisë u bë viktimë e

ideologjisë së tij. Ritsos në jetën politike, krahas asaj letrare, ishte një militant i majtë që në njërin bllok ngrihej në kulm e në anën tjetër mallkohej si diletant. Një “diletant” letrar, poet e prozator, artist të të cilit nuk i ndalej dot fuqia ndikimit në gjeneratat e reja, segment që vërehet dukshëm tek krijuesit e rinj. Kundërshtarët e tij – në skenën letrare greke – nuk e mohojnë dot faktin se nga poetët e pasluftës Ritsos mbetet më i lexuari. Ritsos dallohet kryesisht për nga rebelizmi për një çlirim politik dhe të një krijimi, një gjuhe krejt apolitike. Paradoks që në krijimtarinë e Ritsos e humb domethënien themelore të kuptimit.

Odysseas Elytis (1911-1996) është bartësi i vetëm i çmimit prestigjioz Nobel për letërsi (1979). Elegjisti Elytis me veprën e tij “Oxópetra – në perëndim të pikëllimit”, poetikë që konsiderohet si “dialogu mistik me vdekjen”, është letrari i parë grek (deri më tani edhe i fundit) që u njoh se i takon gjenit homerik, përkundër përdorimit të terminologjisë mitologjike greke – tashmë të banalizuar – në një masë të tepruar, ai dialogun e vetë e bën me kohën e tashme, ose më mirë thënë ai bashkëbisedimin e bën (me plotë dashuri) me vdekjen e pakohë.

Letërsia e sotme greke

Elytiss, në vitet e nëntëdhjeta, ende para vdekjes së tij nuk është më prezent në skenën letrare greke. Jo vetëm fizikisht, por edhe si ndikim. Në jetën letrare greke paraqitet faza e katërt (pas epokës së romantizmit, Kavafisit dhe Palamas ose letërsisë së viteve të tridhjeta dhe Ritsos e Elytisit të viteve të shtatëdhjeta), një fazë në kërkim të identitetit dhe që nuk i drejtohet më Homerit për ndihmë, nuk do që të identifikohet me vitet e humbura të Odisesë te Kalypsoja, nuk kërkon shpëtim nga mangësia e fjalorit në mitologjinë greke, por që i përshtatet dhe ec baras me kohën dhe problemet e saja. Thjeshtë një “dorëzim” demonstrativ nga pritja për kthimin e Odisesë në letërsinë greke. Autorë që edhe ishin prezantues të letërsisë së sotme greke, shkrimtarë deri ato ditë të panjohur por me perspektivë.

Jo vetëm në Evropë – në hapësirën gjermanofone, frankofone, spanjolle, italiane – Shtëpitë Botuese më me renome u

futën në një garë për të përkthyer si letërsinë e traditës ashtu edhe më se tridhjetë autorë të sotëm grekë, por edhe grekët vetë nuk qëndruan duarkryq; ata bënë antologji të përkthyerë në gjuhët e sipërpërmendura dhe qysh para panairit ftuan gazetarët e redaktorët e medimeve në zë në Athinë për të lidhur kontaktet e duhura me qëllim që “ndërmarrja e prezantimit” të bëhej sa më dinjitoze. Suksesi nuk mungoi. Debati u zhvillua dhe po zhvillohet dhe librat e shkrimtarëve grekë janë në trend.

4. Po për çfarë letërsie bëhet fjalë? Njëri nga kritikët dhe gazetarët më prominentë të kulturës në Greqi, Vangelis Chat-sivassilou (Eleftherothypia) shprehet kështu; “Proza e sotme greke është një hartë tepër ekzakte politiko-geofizike e rajoneve greke”. Konstatim më të saktë nuk besoj se ka!

Igumenica, Heraklioni, fshati Kri-Kri me dhinë e tij në kodrat e gurta të Kretës, hujet e njerëzve të Peloponezit, hallet e njerëzve nëpër vendet më të thella të Greqisë së sotme dalin në shesh nëpërmjet letërsisë etj. - janë të përshkruar në formën më të përimtësuar që ekziston. Kjo është ajo forma e re e letërsisë greke, që për botën e huaj duke ekzotike e që ka zgjuar një interes të mjaftueshëm, nëse jo artistik, ani atëherë zbavitës. Element që u jep letrarëve grekë mundësinë e depërtimit dhe askush nuk mund të mohojë se nëpërmjet kësaj letërsie “zbavitëse” nuk depërtojnë edhe letrarët e njëmendtë si dramaturgu, romansieri dhe moderatori i ri kretas Petros Tatsopoulos (i cili tashmë është i kontraktuar me shtëpi botuese perëndimore e që deri tani nuk e ka pasur asnjë fjalë të përkthyer në gjuhë të huaj) ose autorja e romanit “Gratë e jetës së tyre” Lena Divani që po ashtu ka zgjuar një interes të bujshëm.

Kështu Panairi i Frankfurtit, nga grekët u shfrytëzua si shans për të kërcyer muret e izolimit nacional në letërsi e art.

Aksion i menduar djallëzisht bukur!

Botuar:19.09.2006.

http://floart.blogspot.com/2006_09_01_floart_archive.html#115867804776517270

NË 60-VJETORIN E LINDJES SË SHKRIMTARIT E ATDHETARIT, JUSUF BARDHOSH GËRVALLA

Jusuf Gërvalla lindi më 1 tetor 1945 në Dubovik të Deçanit, vranë mizorisht më 17 janar 1982 në Untergruppenbah të Gjermanisë.

Shembulli i tij mbeti i gjallë në gjithë ata intelektualë, shkrimtarë dhe qytetarë që nuk po e marrin rrugët e botës, por po rrinë e po qëndrojnë si burrat në vatrat e tyre.

Jeta e Jusuf Gërvallës ka qenë e vështirë, vdekja e tij ka qenë tragjike. Për këtë është thënë e shkruar shumë dhe do të thuhet e do të shkruhet shumë.

Por, edhe shkrimtari Jusuf Gërvalla pësoi vështirësira të mëdha.

Për poetin, prozatorin dhe dramaturgun Jusuf Gërvalla është thënë e shkruar relativisht pak.

Vepra e tij letrare nuk është tepër e njohur, me gjithë botimin shembullor që ia bëri Jusuf Gërvallës më 1992 Sabri Hamiti (Jusuf Gërvalla: *Vepra letrare*. “Ora”, Prishtinë, 1992; Flori Bruçi “Vrasësit e liridonëve”, roman, Prishtinë, 1996).

Opinionin e respekton dhe adhuron dëshmorin e kombit, simbolin e luftës për liri, shembullin e kurajës prej qytetari dhe intelektual, ndërsa duket se e harron shkrimtarin e rëndësishëm që ishte dhe mbetet.

Rolin i tij prej simboli të qëndresës e hijesuaka fakti se ishte

poet i dorës së parë. Fat ky i zi që duket se e ndan me sho-kun e idealit, Adem Demaçi (megjithëse i shpëtoi fatit të atij të fundit, të cilin ca çapkënë qurranë e quajnë “shkrimtar të dështuar” ose çaprashisin çilimillëqe për “gabimet” e tij).

Në letërsi, ai nuk i takonte qarkut të “lapidaristëve” të poezisë fjalëpakë që e shoshiste të tashmen me shkrimin plot simbole, plot alegori në petkun e arkaikes mbikohore e në frymën e visarit të traditave të lashta gojore.

Zëri i tij poetik ishte zë më vete, mjaft original, personal dhe individual.

Poezia e tij na flet drejtpërsëdrejti, ngrohtë, butë, thellësisht njerëzor e me një ndjeshmëri të stërholluar.

Në dy përmbledhjet e tij të para - “Fluturojnë e bien” (1975) dhe “Kanjushë e verdhë” (1978) - poezia e tij merrej kryesisht me vatrën e poetit tek janë mjaft kuptimplotë titujt e cikleve “Shtëpia në kornizë” dhe “Skena nga jeta e fshatit”.

Poezia e tij e përmallshme e këndon dashurinë, e kujton dhimbshëm (dhe pa idilë ruraliste) vendlindjen dhe na e rrëfen porosinë e saj qendrore, kërkimin e poetit për “pak frymë njeriu e pak dritë qiriri”.

Me kohë, duke u bërë gjithnjë e më shumë refleksiv, poeti kaloi gjithnjë e më shumë te një qark më i gjerë tematik dhe te të folurit poetik me bukuri e begati të rrallë metaforike e figurative.

Kështu, poezia e tij e përmallshme e vendlindjes gjithnjë e më shumë bëhet edhe universale.

Në vëllimin e tretë poetik, “Shenjta e shenjta” (1979), kemi të bëjmë dhe me fjalë e elemente si “hije”, “pluhur”, “frikë”, “terr”, “ftohtë”, “varr”.

Shkallëzohen vetmia dhe shqetësimet e poetit që flet shpesh edhe për fundin dhe vdekjen. Me një thellësi që nuk hetohet në lexim të cekët, na qet tablo tejet të qëlluara të groteskut që e quajmë “jeta”.

Thelbi kryekëput human i vargjeve, ligjërimi lirik dhe substancial i poetit të mallit, të dashurisë, të dhembjes, të vetmisë e të vdekjes e bëjnë Jusuf Gërvallën një zë të patjetërsueshëm

të poezisë së re shqipe.

Kënga “Do të kthehem o nënë” e kantautorit dhe shkrimtarit Jusuf Gërvalla, është vetëm njëra nga perlat e tij muzikore që i ka mbijetuar zhdukjes dhe si e tillë pas vrasjes së tij më 1982, për vite me radhë, është dëgjuar fshehtas nga njerëzit në Kosovë (Shyqri Galica, Flori Bruqi, Skendër Tafaj, Fatime Llugiqi etj).

E ruajtur me kujdes, së bashku me shumë këngë të tjera, ajo në këtë fillim vjeshte i ngjan një rikthimi të vonuar të kanjushës së verdhë poetike dhe muzikore të një artisti, krijimtaria e të cilit u pre nga plumbat.

Ky rikthim i vonuar, por i domosdoshëm i Jusufit tek njerëzit që aq shumë i deshi, thotë bashkëshortja e tij Suzanë Gërvalla, duke folur për dy cd-të me këngët e Jusuf Gërvallës.

“Kam pasur dëshirë përherë që të rikthej Jusufin në skenën muzikore, që të rinjtë ta dëgjojnë Jusufin, sepse nuk kanë pasur ku ta dëgjojnë zërin e tij. Gjithashtu, edhe gjeneratat tona, të cilat e kanë dëgjuar Jusufin, janë mallëngjyer shumë, e kanë pritur mirë, sepse dhe u ka pëlqyer kënga e tij. Aty do të jenë dy cd. Njëri do t’i ketë këngët origjinale të Jusufit, të cilat i këndon ai, ndërsa tjetri do të ketë 7 këngë të përpunuara nga kompozitorë të tjerë”, thotë zonja Gërvalla.

“Krijimtaria muzikore e Jusuf Gërvallës është shumë e gjerë dhe si e tillë ajo përfshin dhjetra këngë, të cilat kur ishte gjallë Jusufi i ka kënduar nëpër koncerte të ndryshme apo i ka incizuar në radio dhe televizion”, thotë më tutje Suzanë Gërvalla, duke shtuar se për fat të keq, nga opusi i tij krijues muzikor, nuk kanë shpëtuar të gjitha.

Fatkeqësisht në Radio-Kosova nuk kishte asgjë

Ishin shkatërruar krejt. Televizioni ka xhirime, por nuk kanë mundur ende t’i nxjerrin të gjitha, kanë nxjerrë pak. Ndërsa këto këngë që janë nxjerrë të pastra, janë nxjerrë nga Radio e Shkupit dhe nga aktorja e Teatri Popullor të Kosovës, z. Fatime Llugiqi, të ruajtura në një kasetë më kërshtëri.

“Sa i përket këngëve që janë përpunuar, unë e kam pasur një kasetë, të cilën e kam incizuar dikur, kur ka qenë Jusufi gjallë, e kam ruajtur dhe nga ajo kasete i kemi nxjerrë këto këngë që i kanë përpunuar”, më tha më 17 janar 1996 në promovimin e romanit tim “Vrasësit e liridonëve”, aktorja e mirënjohur, zonja Fatime Llugiqi.

Krahas krijimtarisë muzikore të Jusuf Gërvallës, zonja e Jusufit, Suzanë Gërvalla, ka lënë pas vetes edhe veprën e tij letrare dhe publicistike, të cilën ajo është duke e mbledhur dhe përgatitur për botim.

“Kam shumë materiale të Jusufit. Më vjen keq që kurrkush nuk është interesuar deri sot për ato, t’i marrë, t’i përpunojë, t’i nxjerrë në dritë. Prandaj detyrohem unë që t’i bëj. Sivjet është 60-vjetori i tij i lindjes dhe unë kam marrë iniciativën, ka shumë muaj që unë punoj në bibliotekë dhe po i mbledh të gjitha shkrimet e Jusufit që janë të botuara në gazetë. Kam punuar në Shkup, i kam nxjerrë nga “Flaka”, nga “Jehona”. Këtu i kam nxjerrë nga “Rilindja”, “Zëri”, “Jeta e Re”, nga të gjitha gazetatat dhe kur të bëhet dua t’ia bashkëngjit edhe një libër me publicistikën e Jusufit,” përfundon e shoqja e tij Suzanë Gërvalla.

Vepra letrare - kujtim i paharruar i fytyrës poliedrike të shkrimtarit martir

Duke rilexuar vëllimin “Vepra Letrare” të Jusuf Gërvallës, botim i Shtëpisë Botuese “Ora” të Prishtinës.

Botimet si ky i vëllimit të veprës letrare të Jusuf Gërvallës nga Shtëpia Botuese “Ora” e Prishtinës (më 1992, me rastin e dhjetëvjetorit të rënies së J.G.), janë shenjë nderimi e respekti ndaj figurës poliedrike të Jusuf Gërvallës, ngase para lexuesve nxori portretin letrar më komplet (deri më tash), duke botuar kështu në një vëllim të gjitha veprat e tij letrare. Botimi i kësaj krijimtarie për lexuesin shqiptar është një shtesë e rrallë dhe i çmuar, ngase për të, pra për krijuesin e artistin J. Gërvalla, gjithnjë mund të flitet e shkruhet në bazë të atyre veprave që na i la si të përfunduara, por edhe në bazë të veprave të nisura e të cilat s’arriti t’i përfundonte. Ky botim na jep të kulluar krijimtarinë

letrare të Jusuf Gërvallës të mbarështuar duke pasur për bazë kriterin e vitit të botimit të veprave të tij.

Në këtë vëllim janë përfshirë të gjitha veprat letrare të këtij autori të botuara si vëllime të veçanta, qoftë për të gjallë të tij (përmbledhjet e tij me poezi: “Fluturojnë e bien”, 1975; “Kanjushë e verdhë”, 1978 dhe “Shenjat e shenjta”), qoftë pas vdekjes së tij (romani “Rrotull”, 1983 dhe drama “Procesi”, 1984).

Kështu, duke marrë në dorë këtë botim (“Vepra letrare e Jusuf Gërvallës”) lexuesi do të komunikojë më lehtë me Jusufin si poet i një shprehjeje të veçantë e spontane, të lidhur ngushtë me ambientin e vendlindjes (që e karakterizon një varg poezish të vëllimit “Fluturojnë e bien”). Këtu do të gjejmë poetin e vetmuar, të ngjyer me ndjenjat e mallit dhe të vetmisë e kryesisht në brumin poetik të vëllimit “Kanjushë e verdhë”. Po ashtu, lexuesi këtu do të gjejë poetin e pikëlluar, i cili përmes idesë së vetmisë njerëzore e zbërthen faqen tragjikomike të jetës (kryesisht në poezitë e përmbledhjes “Shenjat e shenjta”).

Në këtë botim lexuesi do të komunikojë edhe me romancierin, i cili me një gjuhë të pastër e të rindërtuar mbi shprehjen ambientale rrëfen dhe vetërrëfëhet. Kemi, pra, këtu atë rrëfimin rrotull ose, thënë ndryshe, rrëfimin figurativ. Romani “Rrotull” i Jusuf Gërvallës është një roman i personazhit, në këtë rast konkretisht, i personazhit Ketë Avdisë. Ky personazh ka të lidhura rreth vetes fijet e linjat ngjyrëshumta të të gjitha të ndodhurave në një tërësi fabulore. Ngjarja e romanit shtrihet, apo zë fill që nga lindja e Ketës dhe mbaron me aktin e martesës së tij.

Përveç nga ky aspekt, romani “Rrotull” mund të konsiderohet dhe të studiohet edhe nga një aspekt tjetër - si roman i ambientit. Pikërisht katundi Vijujë (emër i figuruar) është ai ambienti romansor, me të cilin ngushtë lidhen edhe artikuloohen të gjitha veprimet, pasojat, dhembjet, ëndërrat, synimet, imagjinata e njerëzve të këtij ambienti e që janë ndërtues të fabulës së romanit “Rrotull”, ku autori provon të hyjë thellë në botën e njeriut të një realiteti të caktuar, duke prekur kështu plagë të ndjeshme të tij, siç janë mentaliteti prapanik, varfëria, kurbeti etj., karakteristika këto të njohura për njeriun e këtij ambienti,

apo plagë të njeriut të këtushëm që kullojnë vazhdimisht. Pra, siç do të shprehej edhe kritiku e studiuesi Sabri Hamiti: “Fuqia dhe vlera letrare e romanit ‘Rrotull’ të Jusuf Gërvallës qëndron në fjalën, në domethënien dhe orkestrimin e saj në tërësinë e tekstit”.

Siç shihet, Jusuf Gërvalla individualitetin e tij krijues e bëri në lëmin e poezisë, por ai nisi t’i kushtojë edhe prozës dhe dramës. Por, hapat e parë drejt krijimit të individualitetit të tij në këto dy gjini letrare u ndërpre në tragjikisht. Ai na la një roman të përfunduar (që na jep të kuptojmë se kishim të bënim me një prozator shumë serioz) dhe një dramë që siç shihet është hap i parë i tij në këtë fushë. Pra, drama “Procesi”, edhe pse e shkruar e fundit nga kjo penë estetikisht nuk është e nivelit të veprave të tjera. Drama “Procesi”, që trajton një proces të shpifur gjyqësor në Prishtinë kundër veprimtarëve kombëtarë, të cilët të prirë nga ideali i lirisë, nuk dorëzohen në asnjë mënyrë para shtypësve. Drama, jo vetëm që shpreh qëndresën e të burgosurve, të cilët para gjyqit e zhveshin maskën e pushtuesit, por në anën tjetër është një dëshmi tronditëse e një kohe të vështirë e shqiptarëve të Kosovës dhe luftës së tyre për çlirim.

Vëllimi “Vepra letrare e Jusuf Gërvallës”, shoqërohet edhe nga një parathënie e thukët studimore e shkruar nga pena e kritikut tonë letrar, sot njëri nga më të mirët në fushën e kritikës në letërsinë shqipe, Sabri Hamiti, i cili lexuesit ia zbërthen vlerat ideo-artistike e estetike të veprës së J. Gërvallës në përgjithësi. Një studim i tillë gjithësesi është shumë i rëndësishëm për një botim si ky. Ky botim shoqërohet edhe me shënime autobiografike, me një shënim të shkurtër për këtë botim dhe me një fjalë përkujtuese të Skënder Blakajt me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së J. Gërvallës dhe me rastin e këtij botimi, për të cilin ai shprehet kështu: “Botimet si ky çojnë në takim të sërishëm me Jusufin tonë”.

Duke shfletuar e rilexuar këtë botim të çmuar, shpresojmë se në të ardhmen, në një të ardhme të afërt, në një botim të këtuillë do t’i kemi edhe poezitë e Jusufit, që kanë mbetur jashtë veprave të tij të botuara, pastaj tekstet e këngëve, që ai i këndonte me

kitarë, prozat e pabotuara të shkruara gjatë viteve shtatëdhjetë dhe artikujt e tij të shumtë për artin muzikor e atë letrar.

FLETË TESTAMENTI

*në zgjimin tim të heshtur të më ngurosin
në fljimin tim të begatshtëm të verës
në nisjen time në fillimin tim të ri
në gjumë shëkuqsh me ndërrime të më zgjojnë
le të më puthë rrezja e qartë nga zëlluese
e druvarit të fjetur në rudinë*

*mysheku le të jetë gjithmonë i blertë mbi gurë
emër të mos ketë e shkronja le të flasë
në gjubën e vjetër të kafshës së zezë
guaca e kërmij le të vijnë për dasmë
mbi rrasën time*

*le të shtrihen edhe ata si dy yje
ftohtë le të bëjë verës e verës verë
e me një pikë ujë verdhësisë së barit tim
le t'i mëshirohen
vërmëni atje tek do të tregojë guri për udhën
deri te shtëpia ime bërë me dru e kashtë*

*le të thyhet çdo pasqyrë që ka balsamosur
ballin tim e mërrrolën e çastit plot mllëf
se ja tek po zgjohet er' e re e dashurisë së tokës
se jam i parrezikshëm kaq i pafuqishëm
mumie përfytyrim që krahasohet me rrabun
tek do të më vini përsëri ju pas*

*le të më lënë të fle qetë si pranë stufe
dimrit të madh të dashurisë sime
nuk do të përpëlitem s'do të rrotullohem
s'do të shplohëm natën nuk do të kollitem
me fjalët e mia le të më mallkojnë*

*në rrasën time atë rrasë të zezë të ftohtë
në duart që i kam prekur le të më lëshojnë
rrjedhës të qetë të fatit që pret
shigjet' e mërisë le të bjerë mbi dhë
në shkretëtirën e moskuptimit le të fiket
kurrë të mos vijë kur unë nuk i pres
ata që tërë jetën i prita, të dashurit
ç'po flas kështu pash zotin?*

NJERIU I ZI

*Jam i sigurt, kurrë s'do të bëj vetëvrasje
Kaq i hekurosor, i mirëfilltë, si arsyeja
E kam vrarë orën e murit me armën e nxehtë
Dhe kam ikur prej librit të përbitur që më shëmton
Me bukurinë e tij*

Vdekja s'është dobi as moshë as lindje e re

*Drurin e vjetër të tavolinës, shtizën, patericën
Boshtin e lanjerrësin, rrapicën e bronzte, lëpenë
Nurin e derdhur si pluhur mbi dritare në mesnatë
Strallin e piklat e vesës që shpërthejnë
Me rrezën e parë të dritës në agun vjeshtor –*

Vdekja nuk i ka

LUFTA DHE ARTI

*Tutje gjithnjë akull
Këndeje gjithnjë zjarr
Unë jam syri i Aladinit
E shoh veten si digjem në betejën e tmerrshme
të fjalës e të mendimit*

*Me shenjtëri të mallkuar
me përfytyrimin e qartë e krijoj
Në mua shushurijnë dete të qena në ëndërr*

*S'po flas kotnasikot
 Mund t'i merrni fjalët e mia e të niseni nëpër botë
 Unë s'kam guxim
 Kuptoj se pa dritën e tyre
 Nuk do ta di rrugën nëpër dritë
 Janë krijuar prej frenimesh prej kthesash theqafsh
 dhiarësh të shenjta zigzage*

*Unë nuk i shoh yjet pëshjtjellë në terr
 Gjithësia e ftohtë nuk e ka gji diellin
 Sikur të mos e ftohte ana e errët e planetit*

QENIE, VARR AS FRYMË

*një shishe bermetike
 grykëngushtë
 lëfytygatë
 në murin prej argjile
 në detin e ëmbël
 në lëkurën me pore drite
 në balsam të largët egjipti
 një të miliontin yll
 në çdo kristal
 në çdo gur të çmuar*

*bima mugullon në terrin e tokës
 në qullin e baltës
 qenie, varr as frymë
 sy i zbrazët
 nga gjithë bukuria mbeti vetëm kejo
 e preksbme e flakët dhe e pakuptueshme
 seç po lebetitem po më dridhet buzë
 zëri im i djeshëm se ku u bë
 amshim i zbrazët
 si syri që më sodit me plotëninë e trilluar*

*i ndritshëm e i thatë si mermer i zji
dashuria e të çmendurit nga frika
mes të gjithëfuqishmëve
një gogol druri mbuluar me të tharat e vjeshtës
një leckë e një enë e ndryshkur
ca pulla sedefi*

*në shesh i nxora gjithë rekuizitat e parajsës
e syri i zbrazët në roje sodiste
dhe përgjonte pamundësinë time të mundshme*

FLATRAT E DETIT TË HUMBUR

*Qepallat e gjata, hijet e syve dhe lagështia
Lumi i bardhë, trup i thyer leckë
Ec e ec e këmbët më sharrojnë në lym
Jam larg tokës
E qielli im i lartë s'më mban*

Të mos isha det i humbur, do të kisha flatra

LIBRI I SHEJTË

*shpuzë e errët matanë qelqeve që avullojnë
mesnatës së ngjyer me tëmblin e detit
në oborr po fshibej një hije dhe qerrja e drunjtë
kuajt sonte askund s'do të marrin udhë
në mur ndrit dhe pipërrin kandili
e në letër mes dy vijash të zezë si përherë
druri i vetmuar më tutje ca hithër
ia djegin këmbët fëmijës që ëndërron
drita e praruar gjerdan me guaca*

*ën' e verdhë atje lart në tavan - dhe teja
tok me djepin e vjetër që s'përkundet - e ha
nuk shihet atje rrëzë gardhi një vogëlush
që shiu i tetorit e qull ngadalë
në vatër u dogjën urët - s'ka mbetur më prush*

frika nga trupi im në shtrat po më fton

mbi tryezë ora e vogël rrah e s'pushon

PLUHUR E NGJYRË

*Sytë e tu qiell çerdhe e lumë i pakapërcyeshëm
ndërsa jam përgjumur përmbi tavolinë
im vëlla dhe fëmijëria ime pemën e kanë vjelë
kanë korrur kallinj
ime ëmë ka zier stonj
shelgjet kanë vajtuar
si poeti sentimental në vjeshtë
- po asgjë s'është zverdhur.*

*Duart e tua pushim diçka si ujë zgjojnë
ndërsa kam ecur shtegut rrëzë mali krejt vetëm
në njërin krah shkurre zogjsh
në tjetrin gështenjat
dhe gjarpërinj.
Im vëlla të ka dashur të ka marrë dhe tash nuk je
as ti as ai s'jeni dridhmë plot fletë
nga fluturimi yt tash vetëm ngjyrë
dhe pluhur ka mbet'.*

*Tash po vij
fëmijë që buzëqesh mbi krahun e nënës kur pret
para shitores qumështin - tash po vij i pikëlluar
në shportën time pemë e fletë
dhe shije gjumi.
Kur të zgjobem do të iki
tash po vij në prebrin tënd, mëmë
tokë e zezë e lapidar, bajame e verdhë.
Dashuri e paluar si arni në arkë
oh s'mund ta them
as ta rrëmbej.
Tash po vij*

*por di se në ngjyrën e pëlburës vetëm pluhur
mbi buzagazin tënd të shtrenjtë.*

NGA MEMOARET E NJË SHITËSI

*kur u ktheva nën pullazin tim mbuluar me kashtë
nën qepallat e lodhjes e të kohës botën
e në botë s'kish tjetër pos shkëlqim ari e qelqi
mbi rrashta e penda të larta zogj alumini
kish edhe uri edhe poetë edhe ujëvare në botë
kish njerëz prej druri e kafshë të buta kudo
kish edhe hieroglifë dy fjalë dhe gjurmë që s'fshihen
kish lumenj të egër e fosile të lashta
mes muresh të trasha fshesa dhe minj.*

SKENA NGA JETA E FSHATIT

*dritarja e avulluar semaveri i çajit edhe vjeshtë
i tillë i lirë rrethuar me sendet që vjetrohen
përmbi rafte ftonj një plakë si pikturë
a nuk qenka vallë krejt zjarri një trillim
bien gjethet e në kopsht femra kotet në luhajë
me goditje të rënda imagjinate me një botë prej letre
tek gjej ngushëllim mes sendesh që s'janë më
atje diku në botën time atje diku larg
eja përsëri netëve të vona si hije që sajon
pak frymë njeriu e pak dritë qiriri.*

FLORI BRUQI

A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar?

Rifat Kukaj u lind më 25 tetor 1938 në Tërstenik të Drenicës. U shkollua në Drenicë dhe në Prishtinë. Tre vjet punoi mësues në vendlindje për të kaluar pastaj në Redaksinë e Kulturës në Radio-Prishtinë, redaktor i emisioneve për fëmijë. Që nga viti 1975 punoi në Redaksinë e Botimeve “Rilindja”, redaktor i letërsisë për fëmijë.

Botoi mbi dyzet vepra letrare. Janë të përmenden romanet: “Bardhi e Mirushja”, “Rrasa e zogut”, “Shkrepi i diellit”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Vjollca magjike”, “Zogu i bardhë”, “Kokërrmeli e pilivesa”, “Gjeli në kuvertë”, “Xhuxhi nga xhuxhishta” etj. Vëllimet me poezi për fëmijë: “Gjerdani i blertë”, “Lejlekët në luhaja”, “Vallja e kallinjve”, “Deti u bëftë kos”, “Çka fshin dhelpra me bisht”, “Pëshurrani i gjyshit”, “Shtegu i lareshave”, “Trimëritë e karkalecit”, “Zogu i Lasgushit” etj. Vëllimet me tregime: “Harmonika”, “Përqaftimet e njoma”, “Rrëfenjëza”, “Ujku me kamerë”, “Djaloshi i zjarreve”, “Elefanti që fluturonte” etj. Ka botuar edhe vëllimet me poezi për të rritur: “Nusja”, “Qafa e Ujkonjës”, “Njeriu që nuk mund të vdiste” etj.

Ka shkruar mbi tridhjetë vepra të dramatizuara si radio-drama, drama, pjesë teatrore njëaktëshe etj. Ka shkruar edhe skenarin për filmin artistik “Lepuri me pesë këmbë”. Ka përkthyer njëmbëdhjetë vepra letrare nga sllovenishtja, serbishtja dhe kroatishtja.

Për sukseset e arritura në lëmin e letërsisë është fitues i shumë çmimeve letrare, siç janë: “Ismajl Qemajl Vlora” - Vlorë, “Oton Zhupaniçiq” - Lubjanë, “Ivan Goran Kovaçiq” - Zagreb,

“Neven” - Beograd, “Zmaj” - Novi Sad, dhe “Shpërblimi i Dhjetorit”, Shpërblimi i nëntorit”, “Ganimete Tërbeshi” - Prishtinë.

Rifat Kukaj do të bëjë emër jo vetëm në Kosovë, por në shkallë kombëtare. Pastaj Lufta e Dytë Botërore, vitet e dyzeta, shtettrrethimi i Kosovës, masakra e Drenicës etj. do të ushtrojnë jo vetëm trysni, por do të bëhen faktorë vendimtar që do të ndikojnë edhe në orientimin e konceptit përmbajtjesor të lëndës letrare, vlera këto me një taban ideoartistik të pranueshëm në shkallë kombëtare, ndërsa autori do të bëhet doajen i kësaj letërsie.

Rifat Kukaj, autor i një duzinë veprash ka vërtetuar individualitetin e tij krijues si në prozë ashtu edhe në poezi. Spektri letrar e artistik i autorit për letërsinë tonë për fëmijë përkon me boshtin vertebrior të individit, dhe sikur që njeriu nuk qëndron vertikalisht pa boshtin kurrizor, ashtu edhe letërsia shqipe do të mbase e mangët pa poezinë e Rifat Kukajt, i cili ka dhënë ndihmesë të madhe në edukimin e brezave të tërë shqiptarësh, pikërisht përmes artit letrar që ka krijuar në prozë dhe në poezi.

Sot nuk ka mundësi të hartohet një abetare as të hartohet një libër leximi apo antologji e poezisë për fëmijë ku të mos zërë vendin kryesor krijimtaria letrare e Rifat Kukajt. Degëzimet tematike janë të ndryshme, ai ka arritur të futet me ndjenjë në çdo pore të jetës fëmijërore, në fantazinë e fëmijës. Jo vetëm kaq, ai ka ditur të zgjojë kureshtjen e fëmijës, të zhvillojë mendjen e tyre duke bërë ndikim të drejtpërdrejtë mbi intelektin e zhvillimit mendor, dhe se në këtë aspekt ka dhënë ndihmesë të pakursyer.

Përpunimi i personazheve, apo figurave poetike, kanë origjinalitetin e vet dhe janë aq të afërta për lexuesin dhe të cilat janë kultivuar nga libri në libër me përkushtim e pasion krijuesi. Nëpër krijimtarinë kaq të begatë të Rifat Kukajt janë trajtuar me kujdes të gjitha relacionet e botës fëmijërore, si ato prindër-fëmijë, gjyshër-fëmijë, rrethi familjar-fëmijë, shoqëria-fëmija,

pastaj fëmija- natyra, fëmija-bota shtazore dhe deri te relacionet abstrakte të fantazive imagjinatave. Të gjitha këto relacione, apo më mirë t'i quajmë raporte të fëmijës me ambientin që e rrethon, janë trajtuar me kujdes dhe profesionalizëm të theksuar.

Shkrimtari Rifat Kukaj, po me aq kujdes e ka trajtuar edhe ambientin rural ku ka arritur t'i shquajë vlerat më pozitive të kësaj jete me rëndësi të veçantë, ku tabani ideoemocional i fëmijës, fushëveprimin e tij e ka pikërisht në fshat, atje ku jetojnë personazhet e përfshira në veprat e autorit, e këto personazhe zakonisht janë shpeshët dhe shtazët, të cilat bëjnë pa dyshim atë spektrin e ylberit, si të themi, atë mrekullinë e fantazisë së fëmijës. Pastaj, pamjet e natyrës, bjeshka dhe kontakti vizual me këto fenomene natyrore, jetën rurale e kanë bërë më tërheqëse dhe të përkëdhelur, ndërsa proceset që zhvillohen në këtë hapësirë janë të kapshme për logjikën e kësaj moshe, ku përmes personazheve ka arritur t'i ofrojë vrojtuesit, gjegjësisht fëmijës, dhe përmes tyre ka shtjelluar edhe shumë probleme reale të kohës dhe shoqërisë në përgjithësi.

Rifat Kukaj po me këtë pasion e ka trajtuar edhe jetën urbane dhe qytetare, sepse, siç thamë, ai ka një gamë prurëse për të gjitha shtresat qytetare të shoqërisë shqiptare. Prandaj, poezinë me motive qyteti e përshkon ai nervi i modernizmit dhe ky modernizëm rritej gradualisht në proporcione me zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi. Jeta tashmë akceptohet edhe përmes celuloidit, kurse autori në mënyrë artistike e tipizon përmes poezisë dhe për asnjë rast ky lloj i poezisë nuk ka mbetur prapa apo nën nivelin e zhanrit të poezisë me tematikë rurale. Edhe këtu autori i shkon deri në fund misionit në kërkim të imagjinatës së fëmijës që ambient primar ka jetën në qytet. Në të gjitha rastet, Rifat Kukaj nxjerr në pah ato vlerat fundamentale të një shoqërie për zhvillim dhe emancipim dhe ka ndikuar bindshëm jo vetëm në brezin e ri, por edhe te gjeneratat tjera. Me këto vlera që i theksuam më lart, karakterizohet edhe proza dhe krijimtaria tjetër e këtij autori.

Rifat Kukaj filloi nga e para qyshse nxënës, ndërsa vjersha e parë për fëmijë „Besimet e kota” iu botua në revistën „Pionieri”

më 1952, kurse vjersha e parë për të rritur në revistën letrare „Jeta e re” me titull „Të ishte” në vitin 1956. Prej atëherë ka botuar në të gjitha revistat e gazetat në gjuhën shqipe. Po me atë ritëm ka botuar edhe në gjuhë të tjera, sidomos në gjuhët e popujve të Jugosllavisë. Ka botuar rreth 100 libra me poezi, tregime e romane, për fëmijë dhe për të rritur. Pastaj tekste për ilustrime, pjesë teatrore, drama, skeçe, humoreska, përralla, fabula e deri te trajtesa të ndryshme letrare e shoqërore. Është autor i mbi 30 radio-dramave, ka shkruar skenarin për filmin artistik “Lepuri me pesë këmbë” etj.

Po ashtu, Rifat Kukaj është përkthyes i njohur, sidomos nga gjuha sllovene, kroate, serbe dhe në këtë fushë sot flasin shqip me dhjetëra autorë sllovenë, kroatë, boshnjakë, serbë, hungarezë të Vojvodinës etj. Pra, emra të njohur të poezisë për fëmijë të këtyre hapësirave, sikurse që flasin shqip edhe emra të njohur të letërsisë botërore për fëmijë ku përkthyes i veprave të tyre është Rifat Kukaj.

Për veprimtarinë e tij letrare është shpërblyer shumë herë dhe këto merita kombi ynë do t’ua përcjellë brezave të ardhshëm. Vepra e tij tani mbasi kaloi në amshim, atje ku nuk flitet më, do të marrë dimensione edhe më të mëdha, sepse krijimtaria letrare e Rifat Kukajt është një thesar me vlerë të veçantë në letërsinë shqipe për fëmijë.

Lepurushi me këpucë

Në oborrin e dajave të vet, Dreni ka parë Lepurushin për herë të parë. Me signuri që është çuditur. Ka parë një krijesë që pak i ngjet maces e mace s’është. Pakëz i ngjet qenit e qen nuk është. Vif nuk është. Ç’është? - ka bluar mendja e tij.

Fëmijët e dajave i kanë dhënë Lepurushit sallatë nga duart e tyre. Më vonë i ka dhënë edhe Dreni. Prekja e buzëve të lepurit ka qenë e butë, miqësore.

E ku ta di unë ç’kanë lozur tjetër me lepurushin. Po, si më treguan, Dreni ia paska avitur këpucët e veta para shputave. Ka dashtë t’i mbathë lepurushi këpucët. Paska kërkuar edhe një palë këpucë të vogla. Mos i ka vajtur mendja që t’ia mbathë katër këpucë në katër këmbë dhe të dalin

për të shëtitur qytetit?

Kështu e ka Dreni. Sa herë i them se shkojmë “ba” që në gjubën e tij domethënë shëtitje, ai nxiton te këpucët.

Duke dëgjuar ç’i kishte ndodhur Drenit te dajat, mora me mend diçka të pabesueshme. Po merrni edhe ju me mend se lehtë e keni. Mendja fluturon si zogju. Merrni me mend, nipin tim, Drenin, zëbathur duke ecur rrugës së qytetit, e pas tij një lepurush duke ecur jo me shputat e buta, por me katër këpucë!

- Tap, tap, tap, - këmbët e Drenit.

- Krrop, krrop, krrop, - këmbët e lepurushit.

E njerëzit nga të dy anët duke parë me habi ç’po ngjet.

A thua kështu ka menduar Dreni? Ndoshta po, ndoshta jo.

Po atëherë pse ka dëshiruar t’ia mbathë këpucët?

Parmbrëmë sa e pyeta për lepurushin e dajave, lëvizzi buzët ashtu si lepurushi dhe ngriti duart sipër veshëve. Uh, e paskan habitur edhe veshët e tij të gjatë. Nuk është larg mendsh se kur ta shohim një gomar, do të mendojë se është babai i lepurushit!

MASKA E KEQE

Ky nipi im Dreni, sa ka mbushur tre vjet e gjysmë. Çudi sa i pjell mendja. Një natë më tha:

- Ma blej një maskë! - nuk m’i ndante sytë.

Diktova se kjo dëshirë ishte e madhe.

- Maskë?! - e pyeta.

- Po.

- Çfarë maske?

- Maskë të keqe, shumë të keqe...

- Po, ç’po të duhet maska e keqe?!

- Ta vë kështu... - bëri me duar sikur e vuri një maskë dhe po e mbante me të dyja duart e vogla...

- Pse ta vësh maskën e keqe në fytyrë?!

- Të dal e t’i tuti milicët kështu: uaaaaaaaa!” - u kreshpërna, u hap, lëshoi një zë të ngjirur. Kjo ishte dëshira e tij t’i frikësonte policët që

silleshin çdo ditë nëpër lajzen tonë.

POEZI

1. ZOGU I LASGUSHIT

*Yll i ndritur në natë qershori
Sikur ra prej gjithësisë,
Ngazëllyeshëm, sytë m'i mori
Në degë t'qershisë.*

*U purtekëm unë e gjethet
Qetë e lehtë me petalet,
Qielli vetë nisi të prehet
Edhe malet.*

*Kënga nga zogju i brishtë
Lindi krejt ëndërrimtare,
Dritë feksoi n'flatra e bisht
Dhe n'për dritare.*

*Gëzim, shpresë, në gjë më derdhe
E hare të butë si pushi,
Zog-magji ti mirë se erdhe
Nga Lasgushi!*

*Ato porosi të larta
Te dritarja e shtëpisë
Po m'i thotë me vargje t'arta
Kalorësi i bukurisë.*

2. NËNË KAM POR JAM JETIM

*(Mikut të singertë, shkrimtarit Odbise Grillo,
që ma frymëzoi këtë njershtë)*

*Udhëtova nga anë e anës
Deri n'sheshin e Tiranës.*

*Aty pashë një vogëlush
Që i kishte sytë si rrush!
Dhe e putha në dy faqe
Ç'aromë lulesh-manushaqe!*

*E përkëdhela dhe në gushë
Si rrezja zogun në fushë.*

*Ai më pa me habi:
-Or xhaxha, kush je ti?!*

*Jam poet - ca i krisur
Nga Drenica larg i nisur...*

*Erdha të thith nënën në gjë
Bashkë me një vëlla të ri.*

*M'i fshej lotët ylli im
Nënë kam por jam jetim.*

*Na ndau skilja Evropë
Që u ndaftë: copë-copë!*

3. BALADËZ

*Me pushkë në krah
Një ditë dola për gjah.
N'shteg qëndroja si gubak
Zagari lehte n'imshtak.
U mbështeta për një ah
Harrova zagari e gjah,
Mbi dëborën e ndritur
Pikasa një zog të përbitur,
Aq i brishtë e krejt i ngrirë
Në acar ai martir
Në shpinë i shtrirë!
Këmbët thik përjetë*

Ah jetë, sa e shkrete.
Mbase shpresa i ka thënë:
“Shtriji e ngrobi në Hënë!”
Në mua vajtonte dita
Në dy zyçka ende drita
Po fiksonte por e mekur
Porsi Hëna e paprekur
Nga këmbët e zogut të gjorë
Orëprerit në dëborë.
Mbaron rrëfimi për një jetë
Në vargun e njëzetetretë!

4. BUKUROSH EDHE LAROSH

Kryet në det
Bishtin te retë...

Në këtë shpat
Puth shtëpitë,
Në atë shpat
Zogitë e fëmi' të...
Degë më degë
Edhe qershitë...

Bukurosh edhe larosh
Ah, ta kisha për krabosh!

Lart në qiell
I larmi bark
E gudulis
Lumi në bark...

Nuk është urë
Është pikturë!

Këndoi trishtili:
“Ciu, ciu, ciu...”

*Se ç'na doli
Pas shiut?!!!"*

5. NËNA

*Ti ke pak zjarrmi
Vogëlushe Leonorë,
E nënës i digjet
Zemra në krahavorë.*

*N'mëngjes, po e zëmë
S'të habet - nuk ha,
Urinë e tërë botës
Nëna at' ditë e ka...*

*Oh, pa pandehur gishtin
E gërvishte pak,
E di ç'ndodh me nënën?
Zemra i pikon gjak!*

*Mbi shtrojën më t'butë
Ajo shpesh këlthet:
-Kam dro' ndonjë pupël
Vashëzën mos ma vret.*

6. VESHËT E LEPURIT

*Në arën me grurë
Në fshatin Veshhtë
Lepuri herë i çonte
Herë i palonte veshët...*

*Në fshat po qante një fëmijë
Këtë lepur i s'desh ta dëgjonte
Ndaj veshët i palonte...*

*Në fshat po qeshte një fëmijë
Këtë lepur i desh ta dëgjonte
I lumtur veshët i çonte...*

7. DY MOTRA

*“Dy motra, ven’ e vijnë,
Njëra tjetrën s’e arrijnë...”*

*Kujdes, në ketesë
Mos e ngre kokën lart
Se më puthesh me asfalt!*

*Lëviz me këmbë mbaju me dorë
Hapi sytë-në semaforë!*

*Je i lehtë në Bicikletë, a dëgjon?
Por s’je vetëm në komunikacion...*

Botuar: 06.10.2005.

<http://floart.blogspot.com/2005/10/rifat-kukaj-shnime-pr-autorin-rifat.html>

Botuar më: 8 gusht 2005

<http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/Week-of-Mon-20050808/008371.html>

Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi

Mehmet Kajtazi lindi në vitin 1944 në Klodernicë të Drenicës martire. Një kohë të gjatë punoi si gazetar dhe redaktor i fejttonistikës në të përditshmen “Rilindja” (më vonë “Bujku”) dhe së fundi deri në vdekje punoi si redaktor profesional për prozë në Ndërmarrjen Botuese “Rilindja”, Prishtinë.

Mehmet Kajtazi vdiç në moshë shumë të re. Është autor i shumë veprave në prozë. Po përmendim vetëm disa : “Nata në gur” (roman, 1984), “Plaku dhe urat” (roman, 1986), “Zemër e thyer” (tregime, 1987), “Fundit i legjendave” (roman, 1990), “Shqiptarët në Goli Otok” (roman, 1991), “Kodra e pajtimit” (tregime, 1993), “Ushtimë e Alboderit” (roman, 1993), “Shote Galica” (roman, 1995), “Minatorët” (roman, 1995), “Thikë në portokall” (roman, 1995), “Gjeli i katedrales” (roman, 1996), “Santa Ana” (roman, 1998), “Guri i dallëndyshes” (roman, 1998), “Lindja në qiell” (roman, 2000), “Udha” (roman, 2000), “Ndeza e shiut” (roman, 2001), “Një diell tjetër” (roman, 2003). Dy romanet e tij të fundit janë përkthyer në frëngjisht dhe janë botuar në Zvicër. Trupa kombëtare e teatrit të Kosovës , mori pjesë shumë herë në festivalet ndërkombëtare me dramën e Mehmet Kajtazit “Nata e fundit në Goli Otok”. Regjisor i dramës në fjalë është artisti dhe regjisor i merituar nga Carrabregu i Deçanit, zoti Xhevat Qorraj. Artistët në dramën “Nata e fundit në Goli Otok” çdo herë lozin lojën e tyre të shkëlqyer (Mentor Zymberaj, Selman Tehaj dhe Asllan Hasaj).

Mehmet Kajtazi diti dhe nxori në pah vuajtjet shpirtërore

të popullit të tij të vuajtur gjatë shekujve dhe kosovarët ishin ata që gjakoseshin në kazamatet sllavokomuniste -në atë burgun famëkeq të Goli Otokut.

Subjekti i kësaj drame të hidhur për shqiptarë dhe Mehmet Kajtazin erudit është i thjeshtë, i dhimbshëm, por që mbart edhe vlera artistike e humane.

Një kombi nuk mund t'i mohohet dëshira për të qenë i lirë, dhe për t'iu larguar gjithnjë e më shumë robërisë.

Vuajtjet dhe gjendja e mjeruar e shqiptarëve kosovarë në burgun e Goli Otokut në ish-Jugosllavi ka qenë edhe subjekti i thjeshtë i kësaj drame, e cila në çdo detaj paraqet vërtetësinë e madhe të jetës dhe dëshirën për të qenë i lirë dhe i pavarur.

Përfshirja dhe preokupimet e shqiptarëve për bashkëjetesë është ana tjetër e këtij subjekti. Trupa kombëtare, më dramën e shkrimtarit dhe atdhetarit Mehmet Kajtazi "Nata e fundit në Goli Otok" është mirëpritur me sukses nga shikuesit shqiptarë dhe të huaj hiq më pak se 350 herë.

Në vend të përkujtimit për z. Mehmet Kajtazi, po shkëpusim shkrimin e tij me titull: "KULTURA BASHKON KOMBIN EDHE NË LOZANË TË ZVICRËS"

Ilirët bulbërojnë për Arbërinë

Nuk ishim as "të majtë" e as "të djathtë". Nuk ishim askushi, ma thanë Hyzër Olluri, Bislim Hoxha dhe Arsim Ferizji. Ata kanë ardhur nga anë të ndryshme të Kosovës (njëri nga Drenica, tjetri nga Dukagjini dhe i treti nga Ferizaj) dhe askushi do të ngelim, thonë ata, nëse nuk e shohim në harmoni popullin shqiptar në mërgim.

Biseda ka një forcë magjike, kur drejtohet nga vullneti i madh për harmoni kombëtare. "Këtë nuk e bënë krerët politikë shqiptarë në Zvicër", thonë ata, "këtë po e bëjnë 'Ilirët', po e bën hapërimi i tyre që me kulturë të bëhemi një. Kështu shprehet edhe Nadire Hoxha dhe tregon se vëllai i saj nuk është vrarë nga dora serbe, pse ai luftoi në emër të kësaj apo të asaj partie politike, por u vra nga ajo dorë gjakatare, sepse ai donte që Kosova të jetë e lirë.

"Unë lirinë e Kosovës e shoh edhe në sytë e birit të tij që ka emrin Nëntor, në nëntor më kanë vrarë vëllanë gjakatarët serbë".

Është rregull i përgjithshëm i shteteve të Perëndimit që ardhësit në tokat e tyre të mos zhvillojnë aktivitete politike, por, nëse ka njerëz të tillë që pandehin se identitetin e tyre mund ta ruajnë dhe ta kultivojnë në korniza politike, këtë edhe ua mundësojnë shtetet mikpritëse, por gjithnjë në pajtim me ligjet e shteteve ku ata kanë emigruar.

Shqiptarët, që nga koha e krijimit të pluralizmit politik në atdhe, tërë energjinë e tyre e shpenzuan në politikë: krijuan parti të ndryshme politike, ligjet e shteteve mikpritëse nuk lejuan që ato parti të regjistroheshin si parti, por krerët e atyre partive shumë të zhdëryjellët dhe në të njëjtën kohë edhe gënjeshtarë, nxituan që partitë e tyre t'i regjistronin në organet përkatëse jo si parti politike, por si shoqata me emra të ndryshëm. Kështu vepruan edhe në Zvicër.

Gënjeshtarët mund të gënjejnë veten, por jo edhe shtetet me përvojë shtatëqindjeçare si shtet, siç është Zvicra. Zvicra mirëfilli e dinte se krerët e ndryshëm politikë të këtyre partive po harxhojnë kot së koti energji, u tërhiqnin vërejtjen për këtë, por shqiptarët kur vendosin të merren me politikë, janë më ujqër së ujqerit, i prejnë hekurat e të gjitha kafazeve.

Si rezultat i një qëndrimi të tillë kobzji, në të gjitha shtetet e Perëndimit, duke përfshirë edhe Zvicrën, shqiptarëve iu servir në pjata një racion, që nuk kishte emër tjetër pos – PËRÇARJE.

Nga avulli plot xëc i këtij racioni shqiptarët nisën të akuzojnë shoqi-shonë si majtistë e djathtistë, e Atdheun rënkonte në robëri, se nuk punonte as dora e majtë, as dora e djathtë, do të thotë që nga mëngjesi merrte teposhtëzën rruga jonë. E themi kështu, ngase për t'u larë mirë fytyra në mëngjes, duhet të përdoren që të dyja duart.

Atdheun, jo vetëm që rënkonte në robëri, por symbylltas ecte drejt greminës. Këtë tragjedi ndër të parët e kishte betuar Jusuf Gërvalla, andaj me nxitim e vrau Jugosllavia, siç e kishte vrarë tërë Kosovën që nga dita kur e kishte ndarë Kosovën nga Shqipëria. Këtë tragjedi të madhe ia kishte sjellë kryesatrapin e Ballkanit, komunisti Tito. Krerët politikë shqiptarë, duke e njoftosur njëri-tjetrin, kishin krijuar mjegull të dendur para syve të tyre dhe fare nuk e shihnin vrasësin.

Ai tashmë ishte diku në një varr, por e kishte lënë prapa birin e vet, Slobodan Milosheviqin, i cili dredhinë e Titos nuk e kishte përsosur – kishte zgjedhur vrasjen si mjet të vetëm për zbulimin e shqiptarëve. Krerët e partive politike, edhe kur writej aq brutalisht Kosova nga “njeriu” që

kishte kultivuar deri në shkallë ndërkombëtare fashizmin serb, merreshin në mes vete, duke i këputur herë njërit, herë tjetrit dorën e majtë ose dorën e djathtë.

Ishin të gjitha sinjalet që shqiptarët po ngelnin pa duar. Këtë e betuan edhe të rinjtë shqiptarë në Lozanë të Zvicrës, të cilët më 1 nëntor 1994 krijuan shoqërinë kulturore, për të rritur e për të vegjël, krijuan grupin e valleve shqipe, e nxorën nga dheu rrënjën që po venitej pa diell dhe shpejt e shpejt rrënja mori emrin e vet: ILIRËT.

Ata që e quanin veten të djathtë thanë se me urdhrin e politikës sonë u krijua shoqëria kulturore artistike "Ilirët", kështu thanë edhe ata që pandebnin se i sjell diçka të mirë atdheut majtizmi shqiptar, që i kishte rrënjët te thembra e këpucës së Titos dhe të komunistëve të tjerë më të vegjël se ai edhe për nga pesha e trupit, edhe për nga prestigji, "Ilirët" si ilirët: kishin vendosur t'u takonin të gjithë shqiptarëve. Këtë fjali po e përsëris: të gjithë shqiptarëve

Ata ishin dhe janë të vetëdijshëm se kultura është mbretëreshë që i bashkon shqiptarët, andaj ata edhe sot "marrin urdhra" nga kjo mbretëreshë. Krerët politikë shqiptarë edhe sot janë të ndarë në Lozanë, e si rezultat i kësaj të keqe ata ngulmojnë që Festa e Flamurit të mos festohet bashkërisht, ata edhe përvjetorin e Jusuf Gërvallës e kremtojnë ndaras.

Po patën mundësi, ata një ditë edhe Diellin do ta ndanin. Shqiptarët e rëndomtë e shikojnë këtë punë të tyre (tepër të ligë dhe tepër tragjike) me skepticizëm dhe me përbufzje, por skepticizmi dhe përbufzja nuk mjaftojnë që të venitet rrënja e përçarjes dhe të zhduket një herë përgjithmonë. Të vetëdijshëm për këtë, "ILIRËT" edhe më shumë u mobilizuan që me kulturë t'i bashkojnë shqiptarët.

Më 15 mars 2001, biseduam në Lozanë me disa shqiptarë të përkatësive të ndryshme. "Ilirët" nga dita në ditë po i shtojnë radhët me artistë të rinj, të talentuar dhe me plot zell që të krijojnë harmoni në mesin e shqiptarëve në tërë Zvicrën. "Ilirët" dy herë zënë vendin e parë në Festivalin e Bernës, ku u prezantuan 25 shoqëri kulturore-artistike nga mbarë Zvicra.

"Shpesh kemi qenë në qendër të vëmendjes në shtypin qendror të Zvicrës", thotë njeriu më përgjegjës dhe më meritor në këtë shoqëri, Ilir Bytyçi. Në Lozanë, ku e kemi selinë, por edhe në tërë Zvicrën, dhe në shtetet e tjera, ne i kemi vënë vetes për detyrë parësore që të bulbërojmë pak

Arbëri edhe në mërgatë, andaj kur këndojmë para publikut ne e sjellim në gjirra të zemrave të shqiptarëve Gjirokastrën dhe Preshevën, Tetovën dhe Ulqinin, Prishtinën dhe Tiranën.

“Kur këndojnë ‘ilirët’”, thotë Arjeta Buzhala, “ne kthehemi në Kosovë, sado që kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet që unë nuk kam qenë në Kosovë”.

“Nuk kam qenë as unë”, thotë burri i saj, Afrimi, dhe tregon se krerët politikë “të djathtë” dhe “të majtë” nëpër tubime të ndryshme bërtitnin dhe klithnin se nuk i nënshtrohemi dot Serbisë dhe detyrë juaja, o bashkatdhetarë, është as ju mos të bëni asnjë hap për nënshttrim, pra as ju mos shkoni në ambasadë të Serbisë për të marrë pasaporta dhe, kur shkemonin mirë e mirë, bënin me dorë kah një kuti e madhe, bënin me gisht drejt saj, e mërgimtarët e gjorë i mbushnin kutitë e mëdha me deviza të shumta; pas një jave i shihnin krerët e partive politike shqiptare që udhëtonin me limuzina të zeza drejt ambasadës jugosllave për të paguar shuma të majme për t’u pajisur me pasaporta të shtetit jugosllav.

“Unë, si nusja ime, Arjeta, nuk deshëm të marrim pasaporta të huaja, andaj edhe për mua kaluan më shumë se dhjetë vjet që nuk e kam parë Kosovën. Unë në një mënyrë e shoh Kosovën përmes valleve të ‘Ilirëve’, po presim që këto ditë të marrim pasaporta të Zvicrës, ose të UNMIK-ut në Kosovë, nëse ngjet e kundërta, do të kthehemi përfundimisht në Kosovë: në Atdhe le të punojnë partitë politike, se pa to nuk bën në atdhe, por në mërgatë do të ishte mirë të shënohej fundi i tyre, se kështu do të shënohej fundi i përçarjeve, harmonia në valle dhe në jetë do t’i gëzonte mërgimtarët”, shkroi Mehmet KAJTAZI.

<http://www.shqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=1266>

Kush është Kolec Traboini?

Të shkruash për mikun tim virtual, shkrimtarin e madh Kolec Traboini, është vështirë ngase është shkrimtar poliedrik, i jashtëzakonshëm, meditativ dhe s'mund t'i shmangesh kërkesë e te mos shikosh 2 shekuj më parë se kush ishin të parët e tij! Pastaj, ai pas vetes e la pothuajse gjysmën e jetës në atdhe dhe në mërgim.

Rastësisht u njohëm kur më bëri një kritikë me vend...

E djeshmja ka vdekur dhe të vdekurin askush nuk dëshiron ta kujtojë...

Mirëpo, me gjithë këtë rrokulli të përditshme, me sa shoh nga krijimtaria jote, ti ke gjetur mundësi krijimi, fantazimi, me kompozime impresioniste e disi të paimagjinueshme për njerëzit e zakonshëm ...

Më sa duket, ti je shumë-shumë larg tyre; megjithëse edhe ti lëvrin mes turmash prej të cilave rrok tipat, karakteret, çastet dhe depërton në psikologjinë njerëzore të shqiptarëve...

Truri yt i rrok vargjet disi ndryshe: e trajton botën dhe psikologjinë e njeriut disi ndryshe...

I lexova shkrimet tuaja një nga një. Unë nuk jam specialist kritikash dhe nuk mund të të jap ndonjë mendim që të të vlejë.

Por, ndonëse më pëlqejnë shkrimet tuaja, unë nga shija dhe ndjesitë, anoj tek nje përzierje e tyre me realistët e vërtetë.

Më pëlqen një bashkim i së natyrshmes me te panatyrshmen, i reales me irrealen. Dhe për aq sa unë arrij të depërtoj në mendimet tuaja filozofiko-psikologjike, e ndjej se aty është dora e sigurt e nje muratori qe gdhend guximshëm forma të reja të jetës...

Natyrisht se ti, i dashuri Kolec Traboini, ruan frymën e shqiptarizmit edhe në Boston, edhe në Athinë, edhe në Shkodër, edhe në Tiranë.

Ti njeh konceptin e botës, pra mund të konsiderohesh në grupin e atyre shkrimtarëve të sotëm shqiptarë dhe botërorë që krijojnë stilin e vet të të shkruarit...

Të shkruan një njeri që të do vargjet shpirtërore, që ti e sheh shumë thellë tek prototipat e krijimeve tua.

Dhe mu për këtë kërkoj falje që pa të njohur personalisht, po shkruaj për ty një shkrim për kafepirësit në art-café, sepse dikush të njeh e dikush ta ka zili, e dikush...

Kolec Traboini u lind në Shkodër, dhe në moshën e njomë, pas vdekjes së babait, ka jetuar për disa vjet në shtëpinë e Fëmijës në Shkodër. Ka ndjekur për dy vjet shkollën Pedagogjike “Ndrec Ndue Gjoka” në Tiranë. Pas kryerjes së shërbimit ushtarak në Tropojë, ka punuar rreth 4 vjet në fabrikën e Fibrës së Kombinatit të Drurit në Shkodër. Më pas ka vazhduar studimet në Universitetin e Tiranës, dega Gazetari. Gjatë kohës që ishte student, botoi librin me tregime “Petalet e bajames së hidhur” 1973, që u vlerësua me çmim inkurajues në konkursin Kombëtar të Letërsisë dhe Arteve. Shkrimtari Naum Prifti në atë kohë botoi një recension vlerësues për tregimet e autorit si dhe stilin liriko poetik të rrëfimit të autorit të ri.

Përveç një tregimi në gazetën “Studenti”, “Fosforeshenca”, dhe një tjetri në gazetën “Drita”, më pas K. Traboini nuk do të shkruante tregime letrare.

Gjate shumë viteve ai shkruan skenarë për filma dokumentarë, vizatimorë si dhe realizon një sërë dramatizimesh për fëmijë në Radio-Tirana, ndër të cilët spikat dramatizimi me nëntë pjesë “Kreshnikët e Jutbinës”.

Në kinematografinë dokumentare ai do të fitonte për skenarët e shkruar prej tij e të realizuar në filma, mjaft çmime, duke përfshirë dy kupat e festivaleve të I-rë dhe të VIII-të, “Asdreni” 1976, dhe “Kështjella e këngëve” 1989, bashkautor me poetin Agim Shehu, si dhe një sërë çmimesh për filmat “Kol Idromeno”, “Hasan Prishtina” e tjerë.

Në vitin 1990 realizon me regji e skenar te tij filmin dokumentar “Dëshmi nga Barleti” i cili u shpall filmi me i mire dokumentar i Kinostudios Albafilm për atë vit. Në projektet e tij për realizimin e filmave autor-film, regji e skenar ai nis punën edhe me dy filma të tjerë “Fluturimi i pëllumbave” dhe “Requiem”, por rrjedha intensive e ngjarjeve në fund të 90-ta dhe fillimin e 91-shit, solli edhe prishjen e programeve të filmimit.

Në Kinostudio, si kudo në Tiranë dhe rrethe, nis të fryjë vrullshëm era proceseve demokratike, që do të sillte përmbysjen e shtetit despotik monist.

K. Traboini është ndër organizatorët e parë të formimit të degës së Partisë Demokratike për Kinostudion dhe bashkëiniciator me Mark Topallajn e Saimir Kumbaron për organizimin e mitingut të madh të intelektualëve të kryeqytetit para stadiumit Qemal Stafa, ku u ngutën të dalin në tribunë për të folur edhe ata që nuk kishin kurrfarë lidhjeje me idetë demokratike.

Merr pjese në demonstratat e mëdha të zhvilluara në kryeqytet, dhe në këtë atmosferë shkruan e boton shkrimin “Vlera e Simboleve Kombëtare” në numrin 3 të gazetës RD me 16 janar 1990 ku ndër të tjera thuhet se kish ardhur koha për të hequr simbolet komuniste duke përfshirë heqjen e yllit të kuq nga flamuri dhe nga stema e Republikës. Acarimi i gjendjes e detyron K. Traboinin pas shembjes së bustit, e kur komunistët kërkonin revansh monumentesh e ndoshta gjaku, të largohet nga atdheu familjarisht në drejtim të Malit të Zi ku kishte fshatin e babait të vet, Traboinin e Hotit, për të kaluar më pas në Greqi.

Në Athinë punon në ndërtim, mekanik, pastrues e soj e soj punësh të tjera për të mbijetuar, ndërkohe i revoltuar nga propaganda antishqiptare dhe shpifëse ndaj emigrantëve shqiptarë, me kursimet e pakta që kish, investon për hapjen e një gazete për emigrantët shqiptarë.

Gazeta “Emigranti” (më pas “Egnatia”) u shpërnda në sheshin “Omomia” ndër emigrantë ditën e 10 Prillit 1993. Gazeta doli në kushtet jolegale ashtu siç ishin ilegalë botuesi i gazetës K. Traboini dhe qindra e mijëra emigrantë shqiptarë

anëmbanë Greqisë.

Mizoria e Qeverisë Micotaqis mbi emigrantët shqiptar me operacionin çnjerëzor “Skupa” (Fshesa) e detyroi botuesin ta ndërpriste gazetën në disa numra për ta vazhduar sërish në vjeshtë me një ambicie për ta bërë gazetë serioze dygjuhëshe nën okielon “Drejt Evropës” dhe shtimin e faqeve të saj nga 4 në 12 faqe.

Në vitin 1995, me materialet e botuara në gazetën “Egnatia”, K. Traboini botoi të parin libër shqip në Greqi, albumin poetik të emigrantëve “Ballada e largësive”, i cili do të pasohet me dy libra të tjerë të tij po shqip “Gjurmë në histori”, letërsi dokumentare, si dhe “Kreshnikët e Demokracisë”, ky i fundit me satira politike bashkëkohore.

Albumi poetik i emigrantëve “Ballada e largësive” pati një jehonë shumë të gjerë në Greqi dhe veçmas në Athinë, në radhët e intelektualëve grekë. Në Shkrimin e tij “Ana tjetër e medaljes së emigrantëve”, botuar në revistën “Arvanon”, shkrimtari dhe studiuesi Aristidh Kola shkruan me entuziazëm për bijtë e një populli që edhe në kushte shumë të vështira të luftës për të mbijetuar, krijon edhe një art të madh poetik, sepse populli shqiptar, bijtë e të cilëve janë emigrantët, është një popull me frymëzim e shpirt poetik.

Ndërkohë shkruan me një frymë tepër mirëdashëse edhe shkrimtari grek Kotas Valeta krijimtaria e të cilit ishte botuar e bërë e njohur në Evropë.

Në vëren e vitit 1995 K. Traboini emigron familjarisht në Amerikë, vendoset në Filadelfia e më pas sistemohet në Boston ku jeton familjarisht.

Duke qenë një njeri që nuk i buzëqesh fati në mërgim, edhe në Amerikë vazhdon të bëjë punë të rënda e jashtë profilin e tij si kineast. Këtë mungesë ai e plotëson duke u marrë me krijimtari letrare. Gjatë kohës së qëndrimit në Amerikë, shkruan e boton dy libra të tjerë “Katërkëndëshi i mundimeve”, Tiranë 2000 dhe “Mos vdis dashuri”, Tiranë 2002, ShB “GlobusR”, të cilët janë pritur shumë mirë nga lexuesit në Shqipëri dhe jashtë dhe janë botuar shkrime vlerësuese në gazetatat shqiptare të Komunitetit

Shqiptar në SHBA “Illyria” dhe “Dielli”.

Në vitin 1994 Kolec Traboini është pranuar anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, me qendër në Bruksel, ndërsa në nëntor 2001 nga Kongresi i Lidhjes Shqiptare në Botë mbajtur në Prizren, është zgjedhur anëtar i këshillit drejtues të LSHB.

“Ballada e largësive” është i pari libër i botuar në gjuhën shqipe në Greqi. Ky album poetik i botuar në Athinë në 1995, që përfshin krijime të 32 autorëve emigrantë, është pritur shumë mirë nga opinioni letrar dhe lexuesit në Shqipëri dhe Greqi. Kanë shkruar për të në Athinë, në revistën arvanitase “Arvanon”, revistën greke “Radiotelevizioni”, si dhe janë botuar shkrime vlerësuese në shtypin shqiptar në Tiranë.

Në bazë të krijimeve të këtij libri, emigrantët shqiptarë në bashkëpunim me drejtuesit e Shoqatës së Arvanitasve dhe Bashkinë e Iliopulit, organizuan koncertin e fjalës artistike në Athinë në korrik të vitit 1995, ku morën pjesë edhe shkrimtarë të afirmuar grek me krijimtarinë e tyre poetike.

Ky eveniment ishte shprehje e dëshirave të krijuesve emigrantë dhe shkrimtarëve përparimtarë grekë, për ndërtimin e urave të miqësisë e të shkëmbimeve të përvojave artistike në mes dy popujve me dëshirën për harmoni, mirëkuptim e paqe.

“Nokturn” botuar nga shtëpia botuese GlobusR, Tiranë 2004, është vëllimi i dytë në krijimtarinë poetike personale të Kolec Traboinit, që bën një hap më tej në ambiciet e veta artistike.

Në këtë libër të ri përfshihen 112 krijime të reja gjatë vitit 2003, ku spikatin përpjekje për të pasqyruar jo vetëm botën shpirtërore të poetit, por edhe shqetësimet qytetare, gjithnjë nëpërmjet lirizmit e përjetimeve të thella emocionale.

Libri ndahet në 6 kapituj: Antikoha, Shën Valentini Poet, Vjeshtë Italiane, Porta e Dritës, Epistolar Poetik dhe Impresione.

Në këtë të fundit përfshihen mendime të shprehura në Shtyp dhe Internet mbi krijimtarinë letrare poetike të autorit, nga 12 njerëz të fushave të ndryshme që nga studiues e shkrimtarë

të afirmuar, kolegët në fushën e lëvrimin të artit e deri tek lexues e admirues të poezisë.

Shënojmë emrat e tyre: Aristidh P. Kola 1944-2000 (Athinë-Greqi), Naum Prifti (New York), Vllasova Musta (Tiranë), Spiro Gjikondi (New York), Kosta Valeta (Athinë-Greqi), Dalip Greca (New York), Ejvis-Maria Xhajanka (Gjeorgjia-USA), Zhuliana Jorganxhi (Trieste-Itali), Arben Çokaj (Gjermani), Klajd Kapinova e Uk Lushi (New York), Pilo Llanguri (Meriland USA).

Në vëllimin poetik “Mos vdis dashuri” botuar nga shtëpia botuese GlobusR, Tiranë 2002, autori ka përfshirë krijime të tij në një periudhë të gjatë kohore me poezi që datojnë nga viti 1985 e deri në 2002; të periudhës së poezisë së fshehtë nën diktaturë, poezisë së hapur në demokraci dhe të jetës plot peripeci në emigracion.

Ky libër është pritur mirë nga shkrimtarët e lexuesit dhe është vlerësuar si një sukses për autorin nga gazeta shqiptaro-amerikane “Illyria” në New York si dhe në shtypin e Tiranës.

Jehonë poetike

Nga vëllimi poetik i Kolec Traboinit “Mos vdis dashuri”, është marrë e përkthyer e botuar në rumanisht në Revistën letrare shqiptaro-rumune “Haemus” që botohet në Bukuresht nga Kopi dhe Adrian Kycyku poezia “Koha e prostitutave - Epoca prostituatelor”, Haemus, nr.11-14, 2002, f. 192-194 Revista “Prietenul albanezului - Miku i shqiptarit” që botohet në Bukuresht, Rumani, në numrin e saj, 23 shtator 2003, faqe 17, ka botuar të përkthyer në gjuhën rumune nga Ardian-Kristian Kycyku, poezinë “Hirushja - Cenusâresei” nga vëllimi poetik “Nokturn” i Kolec Traboinit.

Poezia “Athina - Atene” krijuar në vitin 2004 dhe përkthyer në italisht për lexuesit e Internetit nga Fatos Dingo, ka rrokur pëlqimin e disa lexuesve italianë që i shënojmë: <http://albellenic.splinder.it>

Është e bukur... Dhe ndjehet me të vërtetë zhuzhurima e ëmbël e një mbasditeje, e një qetësie të ngadaltë dhe të zhytur në

mendime plot me histori të mbyllura në vetvete, të patreguara. *Ellie Ellie_Arroway* (<http://ellie.splinder.it>) 13 marzo, 2004.

Shoh fytyra mesdhetare, që veç një herë i kam parë, që nuk e di nga vijnë e nga shkojnë, por veç me fytyra të njohurish më ngjajnë dhe fytyra ime me të tyren, me siguri, ngjasojnë...” Po, është një ndjesi e jashtëzakonshme, që e kam ndjerë shpesh me intensitet, nga Siria në Rumani (mesdhetar ad honorem). Jam e kënaqur që të lexoj përsëri edhe me këtë poezi. *Annie / justannie* (<http://justannie.splinder.it>) 12 marzo, 2004.

Kjo poezi është vërtetë një copë qyteti: ka formë të ngjeshur si një trup, është e përbërë nga aroma, gjëra, zëra. Është një urë shumë e bukur. /*Col/ colfavoredellenebbie* (<http://colfavore-dellenebbie.splinder.it>) 11 marzo, 2004]

Petalet e bajames së hidhur

Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” 1973

Është libri i parë i autorit, botuar kur ishte student në Universitetin e Tiranës në vitin 1973 e i vlerësuar me çmim në konkursin Kombëtar të Letërsisë e Arteve 1974. Në shtypin e Lidhjes së Shkrimtarëve është cilësuar si vëllim me tregime të ngrohta lirike plot frymëzim.

Në atë libër studenti gazetarisë Kolec Traboini, kishte mbledhur tregimet e botuar prej tij nëpër periodikët e gazetat e kohës, kryesisht në faqet letrare të gazetave “Zëri Rinisë” dhe “Puna”.

Vëllimi kishte 9 tregime, redaktor i librit ka qenë shkrimtari Odhise Grillo, piktore Safo Marko, tirazh 6 mijë kopje

Katërkëndshi i mundimeve

Shtëpia botuese GlobusR, Tiranë 2000

Autori i këtij libri për shumë vite ka punuar në kinematografi në seksionin e filmave dokumentarë ku profesioni i ka dhënë mundësi të njihje realitetin anekënd Shqipërisë dhe të përjetonte dukuritë e shoqërisë së shtypur e të ndrydhur shqiptare. Në një projektfilm dokumentar, në verë 1990, ai pëson “disfatë” kri-

juese, sepse objekti ku ai kish nisur xhirimet e filmit “Fluturimi i pëllumbave”, shkolla e korrektimit për adoleshentët, në periferi të Tiranës, u shkatërrua si institucion për t’i lënë vendin forcave të sigurimit të shtetit monist që po jetonte grahmat e fundit të jetës së vet të dhunshme. Fletët e skenarit, që ishin një dramë e gjallë e fateve njerëzore, shpeshherë të sakatuara prej fatit dhe pushtetit absurd, autori nuk i la në sirtar, por i hodhi në faqet e një libri, të cilin kritika e ka quajtur me të drejtë se nuk është roman, sepse i mungon një hapësirë e gjerë ngjarjesh të mpleksura rreth një boshti; por nuk është as tregim a përmbledhje tregimesh, sepse nuk shtjellohen ngjarje të veçanta e të shkëputura. Autori i ka quajtur shkurt “Rrëfim” ato “fletë skenari” të një filmi të paralizuar që në saj të idesë që mbartin e falë një narracioni situatash dramatike nga bota e adoleshentëve, ku përdoren me mjaft sukses edhe figura letrare të gjetura artistikisht, bëjnë që libri të të mbajë të tensionuar deri në fund.

Gjurmë në histori

Botuar në Athinë, 1995

Libri “Gjurmë në histori”, letërsi dokumentare, në të cilën përfshihen dokumente dhe dëshmi nga jeta e Palok Traboinit si dhe pjesë nga shkrimet e tij botuar në shtypin shqiptar në vitet e luftës për pavarësi, u botua nga i biri Kolec Traboini pas hulumtimeve të gjata nëpër vite, në arkivat, bibliotekat dhe kujtesën e njerëzve, sepse nga babai tij i vdekur nuk kishte arritur të ruhej asnjë dokument, madje vetë origjinali i poemës “Lufta e maleve” shkruar në Prizren më 1911 dhe botuar tashmë në këtë libër për herë të parë, ishte zhdukur dhe pak shpresa mbeteshin të gjendej. Libri në mënyrë të dokumentuar përfshin veprimtarinë atdhetare të Palok Traboinit si një kryengritës e bashkëluftëtar i heroit Ded Gjo Luli, si mësues i gjuhës shqipe që në vitin 1908 e për katër dekada me radhë, si publicist i shtypit të pavarësisë dhe poet, krijues i një poemë me rreth 1600 vargje mbi kryengritjen e Malësisë së Madhe në vitin 1911, dëshmi autentike të ngjarjeve me rendësi historike. Vlerën e librit e shtojnë edhe fotografitë origjinale të ruajtura

me kujdes nga Fototeka "Marubi" Shkodër.

Rapsodi ushtore

Ironi bashkëkohëse, 1995

Në punën e tij si gazetar e drejtues i gazetës "Egnatia", autori krijoi në zhanre të ndryshme të publicistikës, si artikuj, analiza, pamflete, por një vend të rëndësishëm do të zinin edhe fejtonet, alogoritë, satirat si në prozë ashtu edhe në vargje. Këto të fundit do të përbënin materialin letrar për krijim e librit "Rapsodi ushtore", ndarë në dy libra, pjesa e parë poema ironike "Kreshnikët e demokracisë" dhe e dyta proza satirike "Vrimat e Saçit". Në këtë libër në format xhepi, satirizohen veprimet e papërgjegjshme të politikanëve të vjetër e të rinj që dolën në skenën e historisë me makinacione e prapaskena, që e kanë burimin tek psikologjia e ruajtjes së pushtetit me çdo kusht prej atyre që kishin kaluar nëpër shtratin e Prokustit të ideologjisë komuniste. Për mbrapshtitë e veta në politikë dhe ekonomi, në këtë libër, e gjejnë veten rreth 50 persona të politikës shqiptare, që lëvrijnë gjallnueshem e të përqeshur në "Rapsodinë ushtore" të vitit 1995 për meritat e veçanta që kanë për gatimin në mënyrë aq të përvajtueshme të Kaçamakut tonë Kombëtar, çfarë ngjarjet e mëvonshme tashmë e kanë vërtetuar katërçipërisht.

Prozë satirike

Rapsodi ushtore

Paroditë "Rapsodi Ushtore" e nderojnë autorin dhe diasporën, emigracionin politik, sepse i bën jehonë kaosit, anarkisë që ka sjellë në vend demokracia false ose si i thonë shkodranët: DEMONKRACIA.

Dom Simon Jubani

Boston, 29. 6. 1996

Jehonë

Libri i Kolec Traboinit, konceptuar e realizuar si një vëllim në të cilin janë përmbledhur ese, artikuj publicistikë, një poemë,

fletë ditari, letra, deklarata, fotografi nga arkivi i Geg Marubit, faksimile, etj., i përket prozës dokumentare...

Libri, që ka lajtmotiv maksimën e Marin Barletit “Gjithsekush shkon në rrjedhën e gjakut të kombit të vet”, vlerësuar nga shkrimtari e publicisti Koleç Traboini si mesazh për brezat, mbyllet me listën e 41 trimave të Traboinit, rënë dëshmorë, që nga 23 marsi 1911 e deri me 5 tetor 1920.

Vëllimi “Gjurmë në histori” përfaqëson një prozë dokumentare, por edhe një përvojë krijuese për hulumtimin e figurave të atdhetareve tanë, lënë në harresën e kohës.

Dr. HAMIT BORIÇI, bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor Cyrih, qershor 1998

Jehonë

“Është kjo dukuri artistike-dialogët me vetveten-që vë në lëvizje fuqishëm botën shpirtërore të lexuesit, duke e bërë të përjetojë ndjenja të holla e të larta estetike dhe duke e pasuruar e fisnikëruar shpirtërisht. Këta dialogë thërresin në bankën e akuzës kriminale ndaj fëmijëve të mbetur pa prindër e të braktisur nga të tjerët, atyre që nuk kanë njohur kurrë përkëdhelje e dashuri, por që janë trajtuar egërsisht, duke përjetuar vetëm urrejtje, dhunë, tortura. Jo vetëm kaq; ato akuzojnë diktaturën edhe për krimin që i është bërë një populli të tërë, i cili ka jetuar një gjysmëshekull në “Katërkëndëshin e mundimeve”. Çiltërsia shpirtërore dhe humanizmi, përkrah mprehtësisë së gjykimit, të sendërtuara në dialogë të shkathët dhe plazmuar me një gjuhë të pasur figurative kanë bërë që “rrëfimet” të tingëllojnë si miniesë demaskuese për fenomenet kriminale të tiranisë së kuqe.

Gazeta “Dielli” e Vatrës dhe “Illyria”, New York, nr. 1001, 9-11 Janar 2001.

Jehonë

Libri me tregime “Petalet e bajames së hidhur” fitoi çmim inkurajues në konkursin Kombëtar të Letërsisë dhe Arteve në nëntor 1974.

Në recensionin e botuar në revistën “Nëntori” shkrimtari

i mirënjohur Naum Prifti i vlerësonte tregimet e autorit të ri si narracione të ngroha poetike, ku ndonëse subjektet ishin të thjeshta, ndërtimi i tregimeve me fraza lakonike e ritëm të brendshëm e plot ngjyra përshkrimi të natyrës, mjediseve dhe botës psikologjike të personazheve, të bënin të përjetoje emocionalisht leximin e librit.

MIRËDITA - KALIMERA

Mirëdita tokë e elenëve të lashtë!

Mirëdita Athinë

Ju burra athinjotë e nëna athinjote

Mirëdita çdo portë

Mirëdita...

Ju djem që labeni brigjeve të detit si spartanë

Ju greke të bukura që putheni në rrugë pa droje

Ti Akropol e ti Stadium Olimpik

Ju statuja të gurta që vështroni nëpër shekuj ciklopikë

Ju përendi të Olimpët

Mirëdita!

Mirëdita Elitis, Ludemis, Zei e ti Teo Angelopoulos

Irenë Papas e Teodorakis

Ju pershëndes me sjalen më të bukur shqipe

Mirëdita!

Vij nga Shqipëria

Vij tek ju me trastën e të varfërit

Brenda ka ca thërrime e ca vargje poetike

Për urinë e popullit tim.

Vij me dy vocrrakët e mi të uritur

me gruan që nga elenët ka një rremb gjaku.

Vij të trokas në zemrën tuaj

Të kërkoj pak dashuri, pak bukë e dy tjegulla si strehë

*Me një kalimera të ngrohtë tek porta.
Kalimera Thraki, Pelepones e ti Kretë e begatë
Mirëdita ju ullishte e ju vreshta me stafidhe
Flori tek ju ka shumë diell
Shumë më teper nga ç'kerkontë Ricosi i madh në Makroni-*

sís.

*Të mjerët ne sa larg kemi qënë të mjerët ne sa afër
Dhe s'trokisnim dot në portën tuaj
Por pinim si Sokrati në heshtje kupën e mjerimit.*

*Mirëdita diell i Athinës
Kalimera!*

*Ju përshëndes me dy fjalët më të lashta në botë
Unë Alvanosi
Kryelartë e mjeracak i këtij fundshëkulli!*

Athinë, mars 1991

ULLINJTË E ATIKISË

*Ju ullinjtë e Atikisë mrekullia e Atikisë
mburrimi se ju ka mbjellur Sokrati...
megjithëse i ndrituri Sokrat ishte krahthatë e pafuqi
atij veç mëndja i punonte prandaj ta do mëndja
se s'ka mbjellur ullinj në kopshtin e tij.*

*Në kopshtin e tij
vetëm filozofia zinte rrënjë...*

*Krahthati Sokrat
ti ishte gjendur një kupë vaj
megjithëse piu helmin vdjekjendjellës
do të kishte shpëtuar mrekullisht*

*dhe kështu
nuk do të turpërohej Hipokrati
* * *
Ju ullinjtë e Atikisë
mrekullia e Atikisë
mburreni se ju ka mbjellur
Sokrati.
...Kushedi
ç' mergimtar varrbarruar
ju ka mbjelle!*

Athinë, 15 Nëntor 1991

FRYJ MOJ ERË!

*Fryj moj erë e çmendur, fryj!
Diellin që më hiqte udhë e lashë pas malit
hëna mbeti varur në një degë
shtëpia fshehur lesave të gardhit
fshati i përhumbur nëpër mjegull.*

*Fryj moj erë e pabesë, fryj!
Gunën që më mbante ngrohtë e lashë në stan
fenerin e vjetër në dritare
shishen e rakisë në buzë të vatrës
gruan kacul me dy vocrrakë.*

*Fryj moj erë mizore në tokë të huaj
kallkan bëja zemren kurbetqarit
se kurrëgjë që ta mbajë ngrohtë nuk ka!*

Shkurt 1994

STATUJA ZEMËRGURTA

*U gjend i vdekur në sheshin Omonia
Sipas RTV Grek.*

Mos qeshni ju statuja të Olimpfit
 me mua që sot rri në heshtje
 ndërsa në fytyrë më bien riga shiu...
 Nuk është nderim për ju ky qëndrim solemn
 por kam trishtim në zemrën time
 për jetën e një djali që sot vdiq
 tek flinte në "Omonia", tek ky shesh
 me pllaka guri nën kokë e qiellin si kuvertë
 zbukuruar me kurora yjesh.
 Natën ra një yll e mbi kokë i fjeti
 bashkë me ëndrrën- sikur të ishin vallezër
 e kur erdh agimi- ngrinë që të dy...

Statuja të Olimpfit, vallë si mund të qëndroni
 aq të ngurta përballë këtij trishtimi
 që rrjedh fytyrës sime si pikë loti
 që rrjedh nga vetë qielli si rrëke me yje
 dhe qëndrojnë të ngrirë në nderim të fundit
 djalit që nga nëna larg mërgoi...

Statuja zëmërgurta asnjë dhëmbje
 nuk e trondit qëndrimin tuaj krenar
 prandaj në këmbët tuaja po lë trastën
 e mërgimtarit që u flijua sonte.
 Brenda një grusht dhé nga Shqipëria
 brenda kish një ëndërr e një shpresë
 për një arë të vockël buzë lumit
 për një shtëpi e një vreshtë
 djaloshi që Athinës i ra në prëbër
 si ta kish nënë, e më s'u zgjua.

Merreni këtë trastë - trofe mjerimi
 shtoni lavdinë tuaj në Olimp
 me dëshirën mijëvjeçare të flijimit
 që s'u shua kurrë nëpër këta tempuj!

*Gjithmonë do të ketë djem që flenë në rrugë
dhe yj që pikojnë në ëndërrime
nëpër këmbë statujash zëmërgurta
me të cilat kurrë s'u ngop ky shekull!*

Athinë 8 dhjetor 1991

SHI NË VARREZAT E KESIARIANISË

*Bie shi i imët, i trishtë në Varrezat e Kesiarianisë
mbi kryqet e bardhë e porcelanin e fytyrave
të grekërve të vdekur...*

*Lotojnë halat e pishave
ndërsa qirinjtë rëgëtojnë në heshtje
duke dhënë frymën e fundit.*

*Ngadalë çdo gjë humbet
nën pushtetin e ujërave qiellorë
bashkë me mua që ndërtoj muret rrethuese
brenda të cilave zotëron bardhësia e mermerit
e mbi ta shiu
vetëm shiu...*

*Rigon shi i imët mbi fytyrat e elinëve të dikurshëm
bie mbi fytyrën time
i vetmi i gjallë në këtë botë të vdekur
me fytyrë nga qielli
duke ju lutur zotit
të kem dhe unë si helenët
një varr në tokën time.*

*ndryshe shpirti im do të ngrihet nga varri
me një dëshirë demoniake
për tu përleshur me erërat e shtërgatën
pa gjetur kurrë prehje në dhë të huaj
pa gjetur amëshim nga qielli.*

*Bie shi i imët, i trishtë në Varrezat e Kesiarianisë
i imët i heshtur, i trishtë i butë
si lotët e nënave për mërgimtarët e humbur.*

Athinë, 20. 4. 1992

DAVID E MOISI*Mikut tim poet Ndoc Gjetja*

*Heu Ndoc Gjetja, ku ka mbriritë burri
me pa gjoksin lakuriq të një grekje të bukur
si një skulpturë e Fidias- e vehtja me ju duk
si me kenë vetë lakuriq në mes njerëzve.*

*Paj burri, kur nuk asht David lakuriq i Mikelanxhelos
dubet me kenë Moisi i menduem
tash kurrresi nuk po di çka po ndodh me shqiptarin
David pa kokrra e Moisi pa tru...*

*Tthonë, çdo gjë për Davidin e kurrja për Moisiun
mjer mishi që s'ha mish thotë njeriu...
si nuk u gjend një gjeth fiku a degë dafine
me mbulue çka të lbyr sytë në marramendje.*

*Heu Ndoc Gjetja miku im në Athinë
Evropa po të këndell gjoksjashtë kah vehtja
ty tash po të zgjohen shtatëqind dreqen nën lekurë
e je tuj e fut në shtrat si ta kishe grua.*

Athinë, 12 Qershor 1993

E SHTUNË E LAGUR MËRGIMI

*Ditë e punës së mërgimtarit shkoi
nëpër pelloje si të ish nje shpend uji
e zor se kthehet prapë nëpër këtë trage
në këtë fundjave që s'është aspak e bukur
veç krejt e qullur nga shiu dhe mërzi
që rigon në shpirtin e njeriut...*

*Shkoi dhe s'kthehet më
nën vështrimin e tij të dhembshëm*

*sepse mbeti vetëm dhe vetmia e mundon
disa herë më shumë se karrot e betonit
arave të Atikisë që sot lagen në shi.*

*Mbeti vetëm
me statujat e lagura të shenjtorëve
që përvujtësisht i nënshtrohen qiellit
dhe rreken ta bindin se mundimi
është një sprovë që nuk ta shuan shpresën.*

*Por litarët e shiut s'kanë të sosur
si rreke trishtimi pambarim
që me rrapëllimë i shuajnë shpresën
e kthimit në Atdhe
nga kjo tragë e dhimbshme
ku shkon e vjen mjerimi.*

*Bie shi në tokën e elinëve
Sot asgjë nuk e shpëton mërgimtarin
nga tundimi i shpirtit
që laget në shi më keq se statujat
që përvujtësisht i nënshtrohen qiellit.*

*Shi e prapë shi
në këtë të shtunë të qullur nga mërzi.*

Athinë, 7 dhjetor 1991

TË RROSH EMIGRANT NË ATHINË

*Të rrosh emigrant në Athinë do të thotë:
të ngarkosh në kamionin e z. Spiro Evastasiadhi
çimento tela dhe bekur
e me to të rrethosh tokat që sapo u blenë
nga pronarët e rinj athinjot në Maratonë...*

Të rrosh emigrant në Athinë do të thotë:

të kesh frikë nga policia greke
 se je i huaj je emigrant, je i paligjëshëm.
 Por kur je shqiptar e ndjen dy herë frikën
 dhe tri herë mungesën e njeriut
 sepse çdo natë Mega dhe Antena të servirin rubrikën
 "Alvanosët vjellin"...
 Paçka se bajdut i parë i botës ish një trojan, Paridi,
 që i vodhi Menelaut Helenën e bukur.
 Pas kësaj një grek dinak
 u dhuroi trojanëve një kalë të druritë
 dhe u rrembeu Lirinë...

Të rrosb emigrant në Athinë do të thotë:
 të mbash në xhëp
 diplomën e Universitetit të Tiranës
 e ti biesh kazmës sa të dalë shpirti
 duke parë endrra nën diellin e Mesdheut
 për të nesërmen, që ka zënë vend në zemrën tënde
 si filiz ulliri përballë detit
 me gjethe të thara pa jetë.

Të rrosb emigrant në Athinë...

Athinë, Nëntor 1991

KORINTH I NXEHTE '93

Një greke të bukur e desha me zjarr...

A. Pushkin

Mos më thuaj, Olga. Mos më thuaj.
 E di që ke pritur një vit sa një shekull.
 Ke kërkuar me sy nëpër rrugë, nëpër sheshe
 dhe atje në Omonia ku bashkohen të gjitha rrugët ke pritur.
 Por atje dhe ndahen moj Olga - edhe ndahen
 e shkojnë larg - shumë larg për të mos u bashkuar më...

E di moj Olga! E di!

Ke kërkuar përsëri në Korinth verën tjetër
po ne nuk erdhëm dot
s'e kaluam dot Qafën e mallëkuar të Botës
e ti u trishtove...

Kërkove me sy gjatë bregut në vetminë e dallgëve
e pyete gjyshe tënde arvanite:
“Përse nuk erdhën, moj gjyshe, ata djemtë nga Shqipëria?
Me kë do të labem unë në këtë verë të zhuritur?!

Jam gjashtëmbëdhjetë vjeçe, moj gjyshe, dua bashkëmoshatarë
të futem në det me ata - e kur të labem
të më drithërojë trupi, moj gjyshe - të më drithërojë
kur gjoksi im të preket sado pak nga trupat e çunave.

Të atij, dua të them
të atij, që ti e di ç'dua të them...

Përse nuk vijnë moj gjyshe Afroviti? Përse nuk vijnë?
Ata e dinë se unë i pres
me vështrim përtej Peleponezit
si Penelopa
në një kthim që nuk ka kthim”.

* * *

Ne nuk mund të vinim, moj Olga, nuk mundnim
edhe pse na thërriste gjaku yt i nxehtë
që përvëlonte verën
e trupi yt që na digte në çdo prekje
kur si delfinë të gëzuar të Egjeut zhyteshim
ujërave të kaltra korinhiote
e kur me stërkala njëri-tjetrin mbulonim
gjithë dëshirë, për të shuar
vullkanin e gjoksit tënd që përflakte
adoloshencën tonë...

E zjarrtë si ti moj Olgë, e thellë si ti
me sy të mëdhej Penelope.

*Ndërsa unë një Odise i lodhur i dërmuar
me anijen e shpresës të shkatërruar e shokë të mbytur...*

* * *

*Më dubet sërish një odise e mundimshme,
me dubet të kërkoj në det, në sterë e nëpër popuj
një Olgë të nxehtë
që ta shtërrojë këtë oqean që na ndan
... si ti në atë verë
në atë Korinth përvëltonjës të vitit '93.*

*Atëhere kur tërë Bota të jetë një Itakë
S'do ketë Penelopa që presin.*

Boston, shkurt 1996

VEGIM

Duke redaktuar poezitë e emigrantëve për gazetën "Egnatia"

*Vetëtima kuajsh të përgjakur
çanin qiellin
shkonin të lanin plagët në det*

*thundrat
prush muzgjesb nxirrnin*

*fëmijet klithnin si pulëbardha
e nuset gjoksndezura prisnin*

*nënat
kafshonin retë
duke pritur karvanet e kurrëmoskthimit
Athinë, Viti 0 ...i harrimit!*

Botuar: 19.08.2005.

<http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/>

[Week-of-Mon-20050815/008482.html](http://www.alb-net.com/pipermail/art-cafe/Week-of-Mon-20050815/008482.html)

Keze (Kozeta) Zylo

Mr.sci.Flori Bruqi

Kozeta Zylo ka lindur në Tepelene në një familje mezhgoranase me tradita të shquara atdhetare. Pasi diplomohet për gjuhë dhe letërsi (në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit më 1979), punoi deri në vitin 1997 si mësuese e letërsisë shqipe dhe botërore në disa gjimnaze të Tiranës, ndërkohë që përfundoi studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës.

E spikatur që në vitet 80 për prirjet dhe qëndrimet e saj antikonformiste, për të cilat provoi dhe ulje në detyre, znj. Zylo u përfshi energjikisht në proceset demokratike që çuan në rënien e komunizmit.

Mori pjesë aktive në krijimin e Partisë Demokristiane të Shqipërisë: që nga themelimi i saj: ishte anëtare e kryesisë dhe në vitet 1994-1995, sekretare e përgjithshme e saj.

Ajo e ka ushtruar me një dashuri dhe pasion të veçantë profesionin e mësuesisë, ku dhe ka gëzuar gjithmonë respektin e studentëve dhe të kolegëve të saj.

Si një mësuese e pasionuar, ka qenë mjaft aktive në shtypin e përditshëm periodik, dhe organizatore, regjisore e spektakleve të gjimnazistëve të Tiranës, etj.

Në Shkurt të vitit 1997, me shpërthimin e trazirave social-politike në Shqipëri, emigroi në SHBA, ku u integrua me kulturë dhe dinjitet në kolegjet e Nju-Jorkut.

Në Nju-Jork vazhdoi kualifikimet e mëtejshme në kolegji,

ku aktualisht është pedagoge në Globe Institute of Technology në Manhattan dhe shquhet ndër veprimtaret më aktive në komunitetin shqiptaro-amerikan.

Vit për vit ka organizuar festën e Flamurit në mjediset shqiptaro-amerikane, ku kanë qenë të ftuar kongresmenë dhe ambasadorë, për ta ngritur dhe me lart, zërin e Shqipërisë.

Ajo është zgjedhur anëtare e Këshillit Botues të Librit në Nju-Jork.

Përmes veprimtarisë së saj të dendur, si dhe krijimtarisë së kahershme publicistike, letraro-artistike, veçanërisht në poezi, Kozeta Zylo ka fituar respektin e studentëve shqiptarë në Nju-Jork, të komunitetit shqiptar në SHBA etj.

Kohët e fundit, ajo është prezantuar përpara publikut shqiptaro-amerikan me librin me poezi “Monumenti i Lotit”, ku promovimet ishin madhështore të cilat u pasqyruan denjësisht nga TV-të dhe gazetat e ndryshme shqiptare, si në Nju-Jork, ashtu dhe në Tiranë.

Është e martuar me z. Qemal Zylo dhe ka dy vajza, Valbonën dhe Klodianën.

Rreth librit të parë

Kozeta Zylo — Një penë e vogël në duart e njerëzve halleshumë!

— nga *BEQIR SINA, Nju-Jork*

Zylo: Me lotin desha të jepja Shqipërinë e shumëvujtur, se mëmëdheut tonë, tokës sonë të shtrenjtë, zanave të bukura të malit, kurrë, kurrë nuk iu ndanë lotët, nga sytë e tyre, por i gërryenin trupin dhe linin gjurmët dhe dramën nëpër të cilat ka kaluar toka jonë e lashtë. Desha të jepja Kosovën martire, që dhe pse në mijëvjeçarin e ri, akoma derdhen lot për pavarësi, të ngrija zërin nëpërmjet vargut se Çamërisë duhet t’i kthehen tokat e gjyshërve të tyre, që u pushkatuan dhe dëbuan nga pronat e tyre, ndaj me këtë daltë skalis vargjet.

Globe Institute of Technology, MANHATTAN (NY): Studentët, kolegët, adhuresit, familja së bashku me intelektualen poete Kozeta Zylo, kanë organizuar promovimin e librit “Monumenti i Lotit” në njërin prej mjediseve të kolegjit Globe Institute of Technology. Promovimi i këtij libri që ishte disi i veçantë për nga ana profesionale dhe interesimi (rreth 250 vetë), do të shënojë rikthimin e artistëve, të shkrimtarëve, poetëve në Amerikë, pas asaj periudhe të suksesshme promovimesh, që kaloi diaspora shqiptare në SHBA, vitin që lamë pas. E ka titulluar librin “Monumenti i Lotit”, monument siç thanë oratorët: “Jo nga ato monumentet e diktatorëve që shemben çdo ditë - por nga ato monumente loti që rrjedhin në faqet e çdo njërit, bëhen kripë e gurë, skaliten deri në pavdekësi. Aty poetja ka “skalitur” me daltën e zemrës, plot patos dashurinë e madhe që ka për familjen e saj - burrin Qemalin, vajzat Klodianën dhe Valbonën. “Monumentin e Lotit” për atdheun e saj, për vendlindjen e saj Mezhgoranin, për Tiranën, për Kosovën e Çamërinë. Ajo di t’u ngrejë “Monumente Loti” nëpërmjet poezisë së saj në këtë libër të parë edhe dëshmorëve luftës dhe trimërisë, ashtu si bukurisë, lumturisë, brengës dhe mallit.

Kishte thënë, që në ditët e para të kthimit nga Shqipëria, kur e pate vizituar pas 9-vjetëve, se atë që bëri me promovimin e librit të saj në Tiranë - do ta bënte edhe në Nju-Jork. Vendosi kështu, dhe e bëri! Jo se kishte lënë ndonjë gjë pa arritur suksesin e parë në Tiranë, por se në Nju-Jork, ajo ka aq shumë miq, shokë dhe kolegë sa pa atë promovim që bëri do t’u ishte “borxhli” të gjithë atyre, rreth 250 bashkatdhetarëve intelektualë, afaristë, poetë, shkrimtarë, artistë, muzikantë, pedagogë dhe studentëve të Globe Institute of Technology e të kolegjit Bermans Orst. E gjithë kjo ngjarje e madhe kulturore, me përmasa e vlera artistike shënoi rikthimin e aktiviteteve të munguara në bashkësinë shqiptare në Amerikë. Ndaj dhe emocioni e gëzimi nuk munguan e ishte krejt ndryshe. Pjesëmarrësit, në këtë promovim u larguan për disa çaste nga brenga e mërgimit dhe hynë si “pa pritur e pa kujtuar” në botën e bukur të vendlindjes. Promovimi që si një spektakël - i cili i dhuroi sejcilit kënaqësin që e shijojë me

permovimin e librit të parë të poetes intelektuale “Monumenti i Lotit”, autores Kozeta Zylo.

Roland Gjoza, shkrimtar e regjisor i mirënjohur nga Tirana, recensuesi kryesor i këtij promovimi, thotë se: “Po mendoja për lotin, si mund ta paraqesë lotin një skulptor dhe mu kujtua një thënie e Bethovenit kur shkroi simfoninë e nëntë: “Gëzimi vjen nëpërmjet dhimbjes”. Po më erdhi ndër mend gjithashtu vargu biblik i Nënë Terezës “më shumë së për bukë kemi uri për dashuri”. Këto asociacione, tha ai, më gëlonin ndërsa lexoja e rilexoja poezitë e Kozetës, një ndajnatë në shtëpi dhe i kisha harruar të gjitha adresat. Isha një njeri i lirë në një botë që më përkiste mua, në një botë të re, ideale, që e kishte krijuar poeti. Ato dy orë të mrekullueshme nuk isha më ai njeriu i pasigurt, i mbërthyer nga ankthi për të paguar billat, me një ndjenjë të çuditshme, sikur po qëndroja disi pezull as në qiell e as në tokë. I menduar nga dilemat, i përmbytur nga melankolia lënguese që të shkakton nostalgjia, jo s’isha ai që jam mësuar të njoh te vetja; njeriu i lodhur në rrugën e mundimshme të integritit.

Gjoza vijoj: “Në Globe Institute më bëri përshtypje një pedagoge që në kohën e lirë hapte kompjuterin dhe shkruante poezi. Pastaj ua lexonte studentëve ashtu thjesht, e frymëzuar, përplot emocion. Një ditë më tha: “Roland, eja të të lexoj një poezi”. Ishin vërtet vargje të ndjera drithëruese, me një dashuri të veçantë prej nëne të dhembshme për vajzën e saj, Valbonën. Një herë tjetër, me një ton disi alarmues, plot ankth dhe revoltë, më lexoi një poezi për Bardhyl Ajetin, gazetarin e “Bota Sot” të vrarë mizorisht për fjalën e tij të lirë. Për Kozetën mund të shkruhet shumë, po ky është libri i saj i parë. Le t’i lëmë fjalët më të mira për librat e saj të mëvonshëm.

Prezantuesen dhe udhëheqësen e promovimit të librit “Monumenti i Lotit” të Kozeta Zylos e bëri më shumë profesionalizëm dhe çiltërsi e bija e saj *Klodiana Xhevat Limani*, regjisor, dramaturg e aktor, i dha edhe më shumë ngjyra poetike, këtij promovimi me interpretimin e disa poezive të zgjedhura nga “ëmbëlsia” e faqeve të këtij libri. Muzika që “notonte” në çdo fragment nga notat e pentagramit, pasuruan programin,

luajtur me plot mjeshtri nga këngëtari i njohur *Frederik Ndoci*. Këndoi edhe *Bujar Gega* këngën që në kor u këndua nga rreth 200 pjesëmarrësit.

Përsëhendetën: *Ryan Buck*, Dean Student Services, *Majlinda Myrto*, *Roland Gjoza*; *Frederik Ndoci* recitoi “Polena e Puthjes” dhe “Udhëtimi me shkronjat”; pastaj përsëhendetën *Xberaldo Montone*, *Pandeli-Pierre Simesia* recitoi “Dy Statujat”, *Ikbale Cefa* poezinë, “Klodiana, engjëlli im”. *Shqipe Biba*, *Pëllumb Kulla*, *Naum Prifti*, *Mikele Arapi*, piktor i tablosë “Monumenti i Lotit”, *Zef Naçaj*, *Lavdie Balili*, *Entela Barçi*, pedagoge e muzikës, në violinë me një pjesë të kompozitorit të madh Bach, dhe” Lule borë”. Më pas përsëhendetën edhe *Iliriana Sulkuqi* me poezi, *Egezonjeta Nivokazi*, vajza nga Kosova recitoi “Cicërrim mirënjohje”. *Liri Alla* dhe *Lindita Fekushi*, gjithashtu foli dhe *Vera Preçi* nga salla, *Valbona Çano*. Xhevat Limani recitoi poezitë “Çamëria”, “Pengu im Kosova” dhe “Monumenti i Lotit”; “Shqipërinë e kam për jetë” dhe “Festa e Flamurit” u recitua nga dibrani *Fehmi Arapi*. Në fund u shtrua një koktej dhe u kalua në një program të pasur argëtimi me këngë e valle popullore.

Majlinda Myrto: Që në strofën e parë poetja thërret për padrejtësitë që i janë bërë popullit shqiptar, popullsisë çame:

Klithin zërat nga nëntoka: *Ç'bën kështu, o Evropa plakë, Jemi çamët të masakruarit, Po kullojmë akoma gjak!*

A nuk të emocionojnë këto vargje dhe të bëjnë të ngresh zërin me forcë përballë kancelarive memeece të Evropës ?

Steve Galegor, shërben në Staten Island si Pastor dhe është inxhinier arkitekt në profesion: “Ju faleminderit, që më dhatë rastin të them edhe unë dy fjalë në këtë promovim. Shqiptaria ma ka pasuruar mua jetën time. Pasi unë mësova shumë gjatë kohës që jetova në Shqipëri. Ajo çka unë mësova atje është se nuk duhet harruar asnjëherë por duhet mësuar më shumë. Unë ndjej një kënaqësi të veçantë kur ndodhem mes jush, pasi që shoh sesa ju jeni të lidhur me atdheun tuaj. Poezisë së Kozetës i përket një fjalë e cila është marrë nga ungjilli ku thuhet se “Këshilla në zemrën e njeriut është uji i thellë por njeriu në mend do të dijë të mbledh nga ai ujin” (F.U.20:5) Kjo thënie na ngjitet

të gjithëve ne që e ndjejmë këtë. Libri i Kozetës ka shumë vlera përbrenda. Ashtu siç është një poet i cili ka aftësi ta nxjerrë nga ai thesar atë që ne na tërheq më shumë. Falënderoi Kozetën që ka marrë “guximin” me çiltërsi dhe sinqeritet të na pasqyrojë në ndjenjat e saj. Poezia është nga ato gjërat që nuk mund ta bëjë çdo njeri. Në poezi të bëjnë përshtypje fjalët “e pathëna”, ato gjëra që nuk i shprehim dot, por i kuptojmë fare mirë.”

Ryan Buck, Dean Student Services: “Jam me të vërtetë i lumtur që jam prezent në këtë promovim të komunitetit shqiptar. Ashtu siç jam i lumtur që ndihmoj dhe i jap mësim këtij komuniteti me studentët që marrin mësim në këtë kolegji. Ndërsa sot, kemi një kënaqësi tjetër që të gjithë ne po kontribuojmë të nderojmë krijimtarinë e pedagoges sonë znj. Kozeta Zylo, e cila është pjesë e stafit të pedagogëve të kësaj shkollë të lartë, shkollë e cila promovon dijen e të gjithë studentëve nga e gjithë bota edhe të studentëve shqiptarë. Jam me të vërtetë i lumtur që ndodhem midis jush dhe t’i uroj suksese poetes Kozeta Zylo.”

Geraldo Montone, arbëresh, pedagog i kolegjit Globe Institute of Technology: “Unë flas si shqiptar, unë jam krenar se jam me ju! Jam këtu t’i urojmë suksese Kozetës. Kozeta është një inspiracion për mua dhe lexuesin e saj, një inspiracion për burrin dhe fëmijët e saj. Kozeta është një zonjë e madhe kur ecën, kur flet, kur jep mësim dhe kur shkruan poezitë. Ajo të bën të qeshesh edhe atëherë kur nuk ke ndër mend, të bën me humor edhe kur je i mërzitur. Të bën edhe më afër atdheut, edhe kur je kaq larg tij nëpërmjet poezive të saj.”

Pandeli-Pierre Simesia, shkrimtar: “Libri i Kozetës, është ‘Monumenti i dashurisë! Monumenti i errësirës! Monumenti i nënës për fëmijët e saj! Monumenti që kemi ne Shqiptarët!’ Zonja Kozeta Zylo me këtë libër nuk na vjen vetëm si poete, por kjo vjen edhe si një “skulptore”. Vjen si piktores, sepse, ka “skalitur” nëpërmjet poezisë mallin e Mezhgoranit deri te dashuria dhe dhimbja në të gjithë Atdheun e saj. Ajo vjen si skulptore e dy Monumenteve - të atij të Ali Pashë Tepelenës dhe të Monumentit të Lotit.”

Shqipe Biba, gazetare: “Sapo u ktheva nga Kosova, ku mora pjesë në një mision humanitar dhe erdha në këtë promovim t’i uroj përzemërsisht Kozetës suksese në krijimtarinë e saj. Të na dhurojë më shumë poezi që “çajné” shpirtin e lexuesit. T’i dhurojë më shumë krijimtari të gjithë atyre që e ndjejnë thellë në zemër poezinë e Kozetës dhe plagën e mërgimit. Monumenti i Lotit është monumenti i të gjithë shqiptarëve në kurbet”.

Pëllumb Kulla, ish-ambasador, shkrimtar e regjisor: “Është me të vërtet një kënaqësi madhe të marrësh pjesë në një promovim të këtillë, ku marrin pjesë kaq shumë intelektualë, shkrimtarë, poetë, artistë e afaristë të komunitetit. Kozeta dhe bashkëshorti i saj Qemali janë një familje shumë artdashëse dhe ndoshta nga më artdashëset që ka komuniteti ynë në SHBA. Poezia dhe arti është në shpirtin e kësaj familjeje. Ata janë edhe shumë afër me të gjitha aktivitetet e komunitetit.”

Naum Prifti, shkrimtar i njohur: “Shumë spontane janë bërë në Amerikë promovimet e librave. Ka një krijimtari të madhe nga kolegë e kolege. Libri i parë i çdo njërit prej nesh është një eveniment i madh për autoren vet, për familjen e saj dhe për gjithë letërsinë. Asnjëherë nuk dihet se cili libër do të jetë ai që do të lërë gjurmë, që do të hyjë në tempullin e letërsisë dhe do të hedhë hapa të sigurt dhe që do të gjejë jehonë të madhe në zemrën e mendjen e lexuesve. Dhe ndoshta do të mbijetojë me shekuj ashtu siç mund të na vijnë edhe sot rilindësit tanë të mëdhenj: Andon Zako Çajupi, Naim Frashëri, Fishta e një sërë autorësh të tjerë, deri në ditët tona.”

Poetja intelektuale *Kozeta (Keze) Zyllo*: “Ju faleminderit që merrni pjesë në promovimin e librit tim, “Monumenti i Lotit” dhe ja kështu mblidhemi së bashku si motra dhe vëllezër të një gjaku. Takimi i përbashkët me ju flet qartë për një respekt dhe dashuri të pakufishme për letërsinë dhe poezinë, që është forma më e përkryer e saj. Dashuria ime me vargun, me poezinë ka qenë një pasion i hershëm i ndërgegjes dhe shpirtit tim dhe këto copëza të shkaputura herë rrufeshëm e herë qetë-qetë formuan këtë libër me këtë titull sa simbolik, po aq dhe të brendshëm. Ky ritual i dashurisë dhe flirtit tim me poezinë, ka qenë një ritual që

është kryer brenda perëndeshës së frymëzimit dhe më në fund arriti që të shpërthente duke ju falur këtë libër. Duke lexuar këto rreshta në mendje më vijnë fjalët e Volterit, shkrimtarit, komediografit dhe enciklopedistit të madh francez (1694-1778), se në jetë ka pasur vetëm një mik të sinqertë, LIBRIN. Sigurisht që është e shpjegueshme ndarja me pjesën më vitale të jetës tënde, me njerëzit, me të afërmit, me studentët, nxënësit, nuk ka se si të mos lënë gjurmë në atë pjesë të ndërgjegjes tënde, që gjithmonë është si një rojë personale, besnike, që rri zgjuar për të shkruar diçka nga jeta ime apo dhe e tjetrit.”

Poezi

MONUMENTI I LOTIT

*Sa lot është derdhur,
Për ty nënokja ime Shqipëri!
Nëqoftëse do të kishim mundësi për t'i mbledhur
Me siguri do të krijohet një oqean i tërë,
Ndoshta oqeani më i madh kohor,
Në gjithë rruzullin tokësor.
Është lot i brezave, që pushtuesit panë me sy,
Është lot I vashave, për të dashurit,
Që u arratisën nga aty,
Është lot i pleqve,
Për fëmijët që i lanë në vetmi,
Është lot i bijës,
Që s'u ndodh pranë në vdekjen e nënës,
Është lot i fëmijës,
Që rritet pa parë baba me sy.
Janë varret e prindërve,
Që u mbuluan pa një grusht dhe të burrit,
Është lot im që çan palcën e gurit.
E si kalë i azdisur, vrapoj nëpër shekuj,
Për të qëmtuar brengat të qëndisur në shpirtra,
Që pena ime bashkë me skulptorin,
Të ngrenë madhërishtëm, monumentin e lotit.*

LOTI PIKTURË

*Në trokun e kalit,
Gjej gjurmën e zverdhur,
Të qytetit tim,
Zbrazur përjetësisht,
Nga kalorësit e ikur!
E kam lënë pikën e lotit,
Pranë gurit të sofatit,
Në portën e shtëpisë sime,
Ndërtuar në lashtësi!
Hej udhëtar!
Në të rëntë rruga andej,
Fotografoje lotin tim,
Në pikturë do jetë kthyer,
Ndoshta nga më të çmueshmet,
Deri më sot,
Në muzeumet e botës!*

Manhattan, 2005

MIRËNJOHJE AMERIKËS

*Fluturoj si zog i lirë mbi Nju-Jorkun e bukur,
E mallëngjyeshëm shoh ishujt rreth kryeqytetit,
Gradaçelat e larta që bisedojnë me qiellin,
E statujën e Lirisë që më ngroh me diellin.*

*Por nuk mahnitem jo nga këto perla,
Mahnitem më shumë nga ligjet shekullore,
Që mirë se të vini i thoni çdo emigrantit,
Mjafton t'i zbatoni ato në rrugë njerëzore.
Është i vetmi vend, që nuk njuh racizmin,
Edhe pse racist u treguam me të,
Villnin qeveritë, për imperializmin,
Si ujkonjat plaka, që s'bhqyenin dot më.*

*Ja, ashtu më duket duke fluturuar,
Dhe birin e robërisë shkund në Oqean,
Si amanet i të vdekurit, prush për Shqipërinë,
Ma digjni trupin, e birin përhapeni mbi vatan.*

*Se zëri i lindur, në tymrat e kohës,
Është më i fuqishëm në zanoret e lirisë,
Mbyt krrakjet e sorrave e kukuvajkave,
E del mbi ta, sa lashtësi e Ilirisë.*

*Unë e di, dhe ju e dini, o zemra të prangosura,
S' e si na futën stërkëmbshin në vallëzimin e shqipëve,
E si dogjën historinë, me hellin e zjarritë,
Dhe vodhën yllësinë, me gjubën e mbrapshtë.*

*Ndaj Amerikë endem e lirë, në sytë e tu,
Që nga tempujt e gjer në shtëpinë e bardhë,
Nuk thartohem nga kataraktet e botës, utbull,
Por më ke rrëmbyer të tërën, si zambak i rrallë.*

Manhattan, 2006

MOLLA E MIGJENIT

*Nxora nga sënduku, ëndrën e hershme,
Fshehur në shpirt, strukur si kotele,
Të ikja larg, larg për të kafshuar,
Vargjet e Migjenit, mollën e ndaluar.*

*Ja erdhi dhe koba, që si shtrëngatë më hodhi,
Në një botë të panjobur, hapin ndalova,
Kureshtjen shpejt, nga dega rrëzova,
Mollën e ndaluar, që asgjë s' shijova.
Molla e kuqe, kribur ishte brenda,
Kishte kobë që priste dhe më nuk duronte,
Kalbësira e viteve i zbehtë kureshtjen,
Nga qulllosja e saj, dhëmbi se kafshonte.*

*Me vargun e Migjenit ngrirë në buzë,
E uritur vazhdoja të kërkoja,
Nëpër kopshte, zyra mondane qëndrova,
Por mollën e ndaluar kurrë se shijova.*

*Buza e ngrirë si shegë u ca,
Me rruaza të kuqe shkruan në gushë,
Mollën e ndaluar që se shijove këtu,
Është në dbeun tënd, mbjellë në çdo fushë.*

Brooklyn, Shkurt 1999

POLENA E PUTHJES

*Puthjet e ëmbla janë si flutura,
Që fluturojnë magjishëm, në hapësirën e zemrës,
Ndezin gjakun, shtojnë ritmin e jetës,
E etshëm thithin burimin e vesës.*

*Jam ngjizur e tëra, brenda teje
Dy zemrat rrabin si një e vetme,
Nuk lëkunden nga stendat muzgjet,
Lëvizja kryhet si dëshirë e përjetshme.*

*Në prush le të digjet puthja, qershi,
Në llavën e zjarrtë të dashurisë,
Unë nuk do të jetoja dot pa të,
Do të ishja si kali gërdallë, ngordhur që i ri.*

*Kjo ndodh në sytë e dashuruar,
Kur ti floçka puthjesb me të në buzë,
E unë ashtu e marrosur,
E vjedh floçkën dhe e shtamos në gushë.
Tani si një engjell më vjen puthja,
Kur shpërtrat bashkohen në një,
Shigjeta e shikimeve është tretur e tëra,
Dashuria përhapet si polenë në të.*

Keze (Kozeta) Zylo, Manhattan

VJESHTA

*Vjeshta erdhi me gjetben e verdhë,
Duke pikturuar oborrin tim,
Si një tapet të floringtë veshi gjithçka,
Biles dhe zemrën time, paksa me trishtim.*

*E magjepsur shtribem e tëra,
Mbi gjetbet si zemrat me vena, që zhurmojnë nën mua,
Kurrizin më përkëdhelin me fëshfërimën e tyre,
Papritur një gjethe këputet nga pema dhe më thotë "të dua".*

*Oh, ç'më kujtore vjeshtën e Tiranës sime,
Ku në këtë stinë gumëzhinte shkolla,
Rëniet e gjetheve nga pemët atje,
Preknin më butë se buzët e njoma.*

*Gjethja e verdhë me vjeshtën e artë,
Të shton xhelozinë paksa për gjithçka,
T'i hyen flokët në ngjyrën e grunjtë,
Si për t'i thënë Hënës, kam ngjyrën tënde, mos m'u nda!*

*E përsbëndes vjeshtën e verdhe: mirëerdhe!
Gjetben e saporënë e stamos në dritare,
Dielli i përhimë rrezaton nga kapilarët e gjetbes,
Si dehe të romancës sime, luajtur në kitarë.*

Staten Island, shtator 2005

KULLAT BINJAKE

*Terrori ma kaploi shpirtin,
M'u fut në trup, si hekur i nxehtë,
Ku në kullat digjeshin njerëzit,*

Nga avionët, zjarr, futur fshehtë.

*Nga ballkoni im çdo ditë u shikoj,
Miss Bota, qëndronit vite me radhë,
Në çdo konkurs, ju kisbit fituar,
Si nuse të bukura, mbi kalë të bardhë.*

*U trondit bota, për të madhen bata,
Zinxhiri i vuajtjeve, do të ngrejë kala,
Do të përhapet, terrori si një murtajë,
Të mjerët njerëz që do t'i hajë.*

*Tymi djegësirë më shponte hundët,
Më bllokonte frymëmarrjen, mushkëritë,
Bashkobet me dhimbjen, për njerëzit brenda,
Që ranë në grackë në të zezën ditë.*

*Nga dritarja brenda, fjollë e zezë futet,
Në vend të diellit rrezeartë,
Çaj në lajmet, ndërpritet puna,
Hedhje njerëzish, varr, nga majë e lartë.*

*U vra njeriu, LIRLA, u vra bota,
Filluan qeveritë të villnin vrer,
Ecejaket e mundimshme, të zgjidhnin, lëmsbin,
Nga djajtë e verdhë, që mbollën aq tmerr.*

Brooklyn, 11 Shtator 2001

Burimi: <http://floart-press.blogspot.com/search?q=Kozeta%28Kez%29Zylo>

Kush është Gani Xhafolli?

GANI XHAFOLLI u lind në fshatin Drenofc, afër Prishtinës, më 25 nëntor 1942. Punoj në arsim: Në Drenofc, Barilevë, në Lipjan dhe në Magure, si mësues. Në Radiotelevizionin e Prishtinës prej vitit 1979 ishte redaktor në programin për fëmijë. Në vitin 1990 pushtetarët e shtetit Jugosllav e largojnë me dhunë nga puna së bashku me 1340 punëtorë të RTP-së. Xhafolli ka të kryer Akademinë pedagogjike në Prishtinë. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

Deri më tash ka botuar këto vepra letraro-artistike..

1. *TE PORTA E EDHAVE.*
2. *ZOG SHIU (poezi) 1979.*
3. *ËNDRRA NË SHUPLAKË (poezi) 1981.*
4. *ZOGJËT FLUTUROJNË MBI LULE (poezi) Tiranë, 1984.*
5. *VJERSHEN S'E ZË GJUMI (poezi) 1985.*
6. *LULE MA JEP DORËN (poezi) Shkup, 1986.*
7. *KROI THËRRET DALLËNDYSHET (poezi) 1987.*
8. *SHTËPLA ME KULM TEPOSHTË (roman) 1988.*
9. *PLESHTI HA ME DY LUGE (poezi) 1990.*
10. *KUQ E ZI (poezi) Cyrih, Zvicër, 1990.*
11. *LEJLEK I SYRIT (poezi) Shkup, 1992.*
12. *PO (roman) Shkup, 1996 (i shpërblyer me çmimin e dytë).*
13. *TË DUA (roman i shpërblyer me çmimin e parë, 1997).*
14. *NUSE NËN MOLLË (dramë) 1997.*
15. *GJEOMETRIA E SYRIT (poezi) 1999 (e shpërblyer për veprën*

më të mirë nga LSHK).

16. *GISHTI IDIOT (poezi) 2000.*

17. *PRINCESHA E VOGËL (poezi) 2000.*

18. *SHTEPLA ME KULM TEPOSHTË (roman) Shkup, 1999 (ribotim) .*

19. *DIELLI ME TRI DRITARE (monografi letrare) 2000.*

20. *NË GOJË TE GJARPRIT (roman) 2000.*

Në dorëshkrim Gani Xhafolli ka këto vepra letrare:

MOLLA NË ARKIVOL (roman për të rritur).

PRINCI PA KOKË (poemë me ilustrime kolazh nga autori).

PLUS TRI (përmbledhje me poezi për fëmijë).

2 vëllime me poezi për të rritur.

1 vëllim me pjesë skenike për fëmijë.

1 roman për fëmijë: GISHTI ME SHTATË GERMA dhe

5 dorëshkrime tjera në korigjim.

Autori i shquar Gani Xhafolli shpeshherë në regjimin monist publikonte shkrimet e tij me pseudonimin Ylber Sokoli:

Autori Xhafolli u nderua me këto shpërblime:

LEJLEK I SYRIT, Shpërblimi (çmimi) kulturor “Ismail QEMAIL VLORA” nga Shoqata Mbarëshqiptare në Shqipëri, Tiranë.

Romani “PO”, është shpërblyer tri herë si vepër më e mirë në trojet shqiptare. Romani:”TE DUA”, fitoi shpërblimin e parë në konkursin letrar të LSHK në Jurinë profesionale : Rexhep Hoxha, Ymer Elshani dhe Arif Demolli.

Vëllimi poetik”GJEOMETRIA E SYRIT”, u shpall libri më i mirë nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës

Më 1997, në Manifestimin tradicional për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, fitoi Çmimi letrar “Vehbi Kikaj”, juria shpalli librin më të mirë, romanin “PO”.

Gani XHAFOLLI , është autor i më tepër se 100 shpërblimeve në konkurse letrare, me poezi dhe tregime për fëmijë si dhe me pjesë skenike.

Loja skenike “ LULJA PALESTINEZE “e përgatitur

nga Trupa Teatrale e Komunes së Gjilanit, është shfaqur para shikuesve më tepër se 40 herë.

Regjisorja prishtinase Melihate Qena ka dramaturgizuar lojën me kukulla të Romanit “Po” në Teatrin: DODONA, Prishtinë.

Gani XHAFOLLI është redaktor dhe recensent i 100 veprave letrare për fëmijë dhe për të rritur.

Është fitues i PENËS së artë të revistës “Pionieri”.

Në RTP ka realizuar më tepër se 200 emisione si dhe serialet televizive “POSTA – POSTA” ; NE NË TV “;ALO ALO 67.

Gani XHAFOLLI në vitin 2001 është zgjedhur sekretar i LSH të Kosovës.

Librat dhe shkrimet e tij janë të përkthyer në shumë gjuhë: Arif Bozaxhiu, Bajram Rogovali, Hasan Merxhani, Enver Baki. (turqisht); Mirko Gashi dhe Ismet Markoviq-Plavnik (kroatisht). Shkrimet e Xhafollit janë të përkthyer në shumë gjuhë të tjera, si maqedonisht, jevge (Ali Krasniqi), në polonisht, në sllovenisht, anglisht etj.

Gani Xhafolli është origjinal në fushën e poezisë si dhe romaneve për fëmijë tek ne. Shkrimet e Xhafollit dallohet nga të gjithë shkrimtarët e tjerë. Mjaft interesante është toponomastika e librave të tij. Toponomastika shtrihet në tërë Dardaninë, që nga Toplica gjer në skajet e Çamërisë. Edhe gjuha e romaneve të Xhafollit është krejt origjinale.

Gjuha, e Xhafollit është sa poetike aç edhe simbolike, përplot figura dhe refleksive e ndriçime origjinale dhe sugjestive (SHTËPIA ME KULM TE POSHTË) cili tërheq vëmendjen për shumë aspekte të reja, sidomos në punë të procedimit stilistik; i cili krijoi romanin e vërtetë të ri në letërsinë tonë për fëmijë.

Sa i përket poetikës së këtij romani e që kërkon një shkoqitje më të hollësishme, vërehen disa risi që nuk i hasim më parë në prozën tonë për fëmijë, sidomos në aspektin e procedimit, teknikës së rrëfimit, të relacionit të syzheut dhe fabulës, pozitës së narratorit, organizimit jo të rëndomtë gjuhësor, etj.

Xhafolli pa dyshim se thyen disa konvenca, kallëpe tipike tradicionale të prozës sonë për fëmijë, duke treguar për mundë-

sitë e reja në këtë lëmë, jo vetëm sa i përket procedimit, pasurimit të teknikës së rrëfimit me përdorimin e modeleve e të formave të ndryshme të shprehjes letrare...

Libri i poezive “Gjeometria e syrit” në tekstet e tij poetike shquhet për një interpunksion të veçantë me elemente të shenjzimit të ideve të shumta, që vargu si mikrostrukturë e tekstit, si dhe teksti në tërësi i japin mundësi semantike. Libri Gjeometria e Syrit është një klithje metafizike e shqiptarit të plagosur... Marrë në përgjithësi, libri me vjersha “Gjeometria e Syrit” pasuron poezinë më të re, sidomos në formën e vargëzimit, që herë-herë pretendon të duket tepër moderne, por edhe me qasjen origjinale dhe të transponimit krejt të mëvetësishëm. Gani Xhafolli është poet i risive. Ai di t’i këndojë, në mënyrën e vet, dashurisë për atdhe, por edhe intimes.

Poezia e G. Xhafollit për shumë aspekte është specifik.

Gjeometria e syrit kapërthen dhe e lë të hapur unazën e historisë sonë që nga antika deri në ditët e sotme, kur “kemi harruar si dukemi kur dridhemi”.

Gani XHAFOLLI me përmbledhjen e vet “TE PORTA E EDHAVE”, dëshmoi se ka aftësi dhe fuqi ta çojë përpara poezinë shqipe për fëmijë, së paku në një intonacion specifik, të cilin nuk e kishim më parë.

Bota poetike e Gani Xhafollit është e kamur dhe e larmi-shme. Preokupimet e tij janë karakteristike, kurse mënyra e shprehjes poetike ka një intonim të mëvetësishëm dhe si e tillë veçohet nga krijimet e niveleve të ndryshme të autorëve tanë. Gani Xhafolli është emër që premtton shumë. Me përmbledhjen e parë: Te porta e edhave, ai jo vetëm që startoi me sukses në fushën e letërsisë, por edhe solli risi në formë e tematikë.

Në vargjet e këtij libri vërejmë atë orientimin e ngulmimit të autorit drejt shprehjes dhe vargut modern.

Botuar: 17.10.2005.

http://floart.blogspot.com/2005/10/flori-bruqikush-eshte-gani_11295670733555276.html

Kush është Nehat S. Hoxha

U lind në Ferizaj, Kosovë, më 1951. Edukimin themelor dhe atë të mesëm i mbaroi në vendlindje, kurse studimet e ekonomisë në Universitetin e Prishtinës dhe Provimin e posaçëm profesional për punë të tregtisë së jashtme (specializim) në Beograd.

Në skenën e letrave shqip u shfaq nga vitet '70, me poezi, tregime, vargje për këngë, përkthime, sidomos ato letrare nga anglishtja.

Botoi vepra autoriale me poezi e prozë:

1. *Vdekja e poetit, Rilindja, Prishtinë, 1990;*
2. *Lindje në ployë, Redaksia "Fjala", Prishtinë, 1992;*
3. *I mërguar në atdhe, Druck Art, Prishtinë, 1996;*
4. *Fjalor Elementar Anglisht-Shqip, 1996*
5. *Oguri, roman, Ministria e Kulturës, 2003*

Vepra të përkthyera nga anglishtja:

1. T. Williams, "Menaxheria e qelqtë" (dramë), 1983
2. L. Hjuç, "Mbretëria e frushkullit", (Poezi), 1985
3. R. Tagore, "Bukurezat", (Poezi), 1986
4. H. Xhibran, "Profeti", (Poezi), 1987

5. O. Uajlld, "Kallëzime", (Tregime për fëmijë), 1988
6. U. B. Jejts, "Ringjallja" (Katër drama), 1989
7. E. A. Poe, "Politiani", (Dramë), 1989
8. L. Gillis, "Korb midis egërsirash", (Dramë), 1987
9. S. Beket, "Fundi i Lojës", "Jehona, Shkup, (Dramë), 1987
10. K. Marlo, "Dr. Fausti kobzi", (Dramë), 1989
11. N. Shop, "Furka e misterhme", (Dramë), 1990
12. A. Gajtani, "Lule më lule", (poezi, nga shqipja në gjuhën serbo-kroate, Tuzla, BH) 1989;
13. O. Uajlld, "Je ai që je", (Dramë), 1988
14. F. A. Hajek, "Individualizmi dhe rendi ekonomik", "Eureka, Prishtinë, 1996;
15. Panteon i Laureatëve të Çmimit Nobel për ekonomi: prej klasikëve deri në shekullin tonë;
16. O. Uajlld, "Saloma", (Dramë) 1985
17. T. S. Eliot, "Vrasja në Katedrale", (Dramë), 1988
18. Kënga e Rolandit, 1987

Dhe qindra e qindra filma artistikë, arsimorë e vizatimorë, të përkthyer për TV, Radio, Gazeta, revista e periodikë.

Redaktor i qindra librave të krijuesve tanë letrarë, figurativë, muzikorë.

Aktivist i të gjitha përpjekjeve për çështjen e Kosovës, kombëtarisht e ndërkombëtarisht gjatë gjithë periudhës mbi tridhjetë vjeçare, sidomos me delegatat ndërkombëtare që vizitonin Kosovën dhe për ato aktivitete është "shpërblyer" nga regjimi serb me burgje disa herë.

Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës

Një buqetë poezish nga Nehat S. Hoxha

Lule dhe Këngë

*Lulja e do këngën
Kënga e rrit lulen
Kështu ka thënë Zoti
Njëra-tjetrës i përkulen*

*Lulja i jep këngës
Ngjyrën kuq të gjakut
Kënga i kthen lules
Shpirtin e zambakut*

*Kur ligjëron kënga
Lulja e merr ngjyrën
Dritëson nga brenda
Zbukuron natyrën*

*Fryte dashurie
Janë lulja dhe kënga
Lumturi njerëzje
Për një jetë pa brenga*

25 gusht 2006

Si quhet dëshpërimi

*Për 55 vjet rresht trupi më mblodhi të gjitha fëlliqësirat e botës
e njerëzit e mi i quajnë bukuri përrallore.*

*Për 55 vjet rresht turpi shtresoi bukurinë e shëmtisë si rreng dashurie
kurse të mitë ngazëlleben me gënjeshtërën që u zbukuron jetën*

*Kishim ëndrra nga më të fismet
për stolinë e virtyteve që bëjnë të kamur
jetesën me identitet estetik për dashurinë globale*

në sofër bote shqiptare dhe atë të botës së madhe

*Nanuritëm iluzione për t'i ikur vërtetësisë së rrojtes në këtë jetë
dhe fituam zhgënjimet më të fundme të fundrrinave tona
teksa sinonim të shqubeshim për zotërinj të cilësive dhe fatit*

*Arritëm ballë muri pa derë dhe na u humbën rrugët
që kishim shtruar me limfën e shpirtit*

Si qubet dëshpërimi me gjuhë bote

MBRETËRIA E JETËS

*Mirëmëngjesi vdekje
Urdhëro urdhëro
Do çaj kafe llokum raki
apo një kupë shpirt
Mysafire më e përditshme në derë
për ty nozullimet i kam si përherë*

*(Si s'më le një ditë të vetme të më marrë malli
për emrin tënd - për praninë tënde?)*

*Urdhëro urdhëro
Kam një gjysmë nate qyshse gjë nuk di
cilin nga njerëzit e mi ke mbetur pa marrë në gj*

*Do çaj kafe llokum raki
apo një kupë gjak*

*O ç'i krisur që je i lumi poet
Ku flet mbretëresha me mbret varfërie?!*

*Vajti gjysmë jete, u bë pikë e ditës
Erdhi si në çast ora e vizitës:
- mirëdita vdekje - urdhëro urdhëro
Do supë prej angrrash a prej kockë kafke*

*Do zemër të pjekur, shkrumbuar në prush
apo mushkëri a veshka të njoma
sa s'më janë ftohur të sotmet kufoma*

*Urdhëro urdhëro
E di që nuk flet
Ti mbaro gostinë
fjalët i them unë
Ndaj më more burrat që ruanin votrën
më more dhe nënë motra edhe bija
more moshë urtie dhe more ferishte
për jetesë më le yajet e mërgimit
kurse për çdo kremte: këmishë të pikëllimit*

*A ngopesh a s'ngopesh s'është gjëpunë për mua
shko në Mbretërinë tënde - në daç rri tek unë
Por s'vij dot me ty pa mbaruar punë!*

*Mirëmbërëma, vdekje! Urdhëro! Urdhëro!
Hyrë. Rri sa të duash!
Gjë gosti nga unë mos prit pa dalë dielli!
Atëbotë të pres me tryezën plot.*

*Mirëmëngjesi, vdekje!
Urdhëro, urdhëro!
Do çaj, kafe, llokum, raki
Apo një copë zemre 3.000 vjet përditë kopanisur
mbase me të ngop barkun tënd të grisur!*

*Pra, ti frymën ma merr!
Ma merr edhe trupin
siç more lirinë edhe robërinë.*

*Ja që (Sic!) s'të jap -
S'të jap Dashurinë!*

NOJMA E SHQIPES

*i kushtohet Shqipës aq të kamur nga bukuria
dhe kaq të drobitur nga robëria*

*Pushtetin sterrë netve djallëzore
me ditët tash kaq vjet që vijnë me rroba zije
e përballa falë nojmës së syrit tënd
tek më hapte shtigje një orbite të bruzjtë
tej territ tej retinës tej zemrës sime*

*Net bartolomejshe në sund sterre
i mbaja në dry me shpresën tek ti
në rendje pareshtur tërbimi
më shkulin dorën
më shkulin krabun
këmbët rropullitë ballin me dritë
Po zemra ngjeshur me dashurinë për ty
i zbonte e më gdhinte një tjetër ditë të zisë*

*Lirikën aq shumë e dua
porse ma vrugon patetika
Kordhëzëhveshur më përmbys edhe mbretërinë e ëndrrës
Je nojmë dashurie - nojmë djalli je
Shtojzovalle a bijë bushtre
Orëshuar jetën mos e le
Sepse vjen dhuna vjen ankthi vetmia vjen
Drobitem zgërfaqem ronitem
Por, vjen Shqipja e më shenjon
Davaritet vagëllia
dhe unë rilindem
rilindem rilindem*

I MËRGUAR NË ATDHE

*O moj botë, e lumja botë
në sytë e tu a nuk ke lotë
Për të qarë, për të qarë*

për ç'më ndodhi, ç'më ka ngjarë
 në vendin tim plot pikëllim
 ku gjëmon e oshëtin
 ku qan nëna përmbi dhe
 mbi kokë djali besë e fe
 Ti ku je moj, ti ku je?
 Si s'e sheh moj? Si s'e sheh?

Dhjetëqind vjet, moj! Dhjetëqind vjet
 me kufij në tokë e det
 s'mund të shihet me vëllanë
 ndaj e ndanë dhe e ndanë
 me sinorë e sinorë
 ku ndrin dielli, bie borë
 i kërkojnë pasaporta
 kur i shkon birit ke porta:
 A ke parë moj, mbi këtë dhe
 mërgimtarë në atdhe?

Na dhe jetën, na dhe Torën
 Shenjtin Libër, edhe shkollën
 Ramajanë Mahabharatë
 ku na njeh dhe gur' i thatë
 Na dhe besë na dhe Kur'an
 këngë kreshnike e Rolan'
 Nibelungë, ah e bung
 për t'na bërë gurë e cung
 për t'na thënë: të pa-fe
 pse mërgoheni në atdhe!?

I mbrujtur me kuq e bardh
 me zemër e me karar
 kisha marrë udhën e botës
 me trastën e dijes mbarë
 Kaq qindijeç që isha bërë
 terr e dritë më kishin vvarë

*Hesiod, Homer, Eskil
Virgjil, Dante e Shekspir
rrugës më pikonin ar
e ti botë - s'më kishe parë.*

*I mveshur me Lord Bajron
Edgar Po, edhe Milton
Me De Radë e me Pushkin
Me Konicë e me Naim
seç stolisa dhoma bote
ku ndrinte fytyra jote
e pas shpine seç më nxinte
err karpatesh tek më vinte
Dhe ti bëje sikur s'sheb
ç'po më ndodhte në Atdhe*

*O moj botë, e lumja botë
në sytë e tu a nuk ke lotë
për tëqarë siç qaj unë
për këtë punë - dreq-o-punë:
zogj degdisim në mërgim -
ne mërgohemi në atdhe
e na shtypin me rrëmbim
dhe ti bëhesh sikur s'je.
Deri kur moj, deri kur
s'do të jesh me ne?*

*Pra, unë me shtatë nga antika
të thur vargje, s'të ngul thika
ndaj t'i njoh të shtatë çudirat,
gjuhët, tempujt, gjithë të mirat
Si shumë m'ke rënduar duaj
në vend timin jam i huaj;
Merre mundin, ndalo turpin
nga plagët ma shëro trupin!
Provo vallen ti me mua -*

do ta shobësh sa të dua!

HËNA NË DRITARE

*As hëna më vjen çdo natë në dritare
pranverash gazmore siç e kish zëkon
Jo pse retë e qiellit vjellin zjarr e vrer
po pse Lulja ime ma merr copa-copa
viseve t'përtejme përditë ma mërgon*

*As hëna më vjen çdo natë në dritare
si herash të luma që e kish zëkon
ç'prej se dhuna flet, udhë të mbarë uron
për motrën e bijën dhe për birin tim
çdo të shtunë e të diel - udhëve pa kthim*

*As hëna i hap sytë mbushur plot lot
nga dita kobzëzë kur përçolla Lulen
kur dielli u thye në syrin e saj
e zemra m'u bë krejt çik-e-thërrime*

*Po fundosej hëna nën dritaren time
një natë kur po prisja t'më kthehej gëzimi
me shpresën ushqyer vetëm nga kujtimi
me plagë, në rrugë, në stinë, në votër...
në ankthe me sytë verbuar nga malli
m'u bë që në cep të buzës së hënës
si ditësh me shend pashë buzët e Lules
e hëna fundosej nën dritaren time*

*As hëna po rrinte në dritaren time
e dera s'trokiste
E dera s'trokiste*

GJURMË LASHTËSIE

*Se ç'na vijnë si jehonë përrallash
nga shekuj që s'mbahen mend
zëra fletësh e kavallesh
dhe na mbushin plagë e shend
Në këtë kohën tonë të re
me rrënjë të vjetër
Mbi tokë, në qiell e mbi re
kurrë nuk ndodhi tjetër
përveç Shqip qysh para jetës
me labutë e me gërnëtë
bilbilët e së vërtetës
e mbollën këtë tokë me jetë*

*Në korije këndon bilbili
mbi male hap kerahët Shqiponja
stolis kopshtin trëndafili
dhe kështu shqubet Shqipe-Zonja*

KREJT NORMAL

*Jam një popull krejt normal
Bukën e ha bukë po era bukë s'i vjen
Nëpër të gjitha gjymtyrët e mia
Ajrin e thith ajër po ajër s'i vjen era
E, pra: krejt normal një popull jam*

*Jam një popull krejt normal
Çdo damar i prerë më rrjedh gjak
dhe erë tjetër pos erë gjak
nuk i vjen aspak*

*Pak si shpesh bie në lak
e lak kurrë s'i vura kurrë
Ani që jam një popull krejt normal
Krejt normal një popull jam
Tokë e qiell i kam për besë*

*Tek një diell unë kam shumë shpresë
 Vdes naga frika - s'më tremb gjë
 Zi e huaj s'më vjen e bardhë
 E, pra - krejt normal një popull jam*

SIBILA

*Gjithë natën e lume era rrahur me rragatë
 Theu qelqe, porta e pullaz të kokës sime
 E nata s'kishte të sosur
 E s'kishte të sosur*

*Brambullinte mureve të zemrës sime të pjekur
 Dhimbjet i përballja por me sy s'i shihja
 Ndaj sytë m'i kishte marrë Sibila dje
 E, s'po e pillte nata
 S'po e pillte ditën
 kur ndoshta Sibila do më kthente sytë*

*Sibilë-moj, Sibilë sy-det
 Dil aty ku u pamë mbrëmë
 Merr sytë e mi dhe sillmi të të shoh edhe një herë
 pa të vdes dhe të kënaqem duke vdekur me ty
 derisa të vdes krejt*

POEZISË UNË

*Nisem. Lodhem. Eci. Molisem.
 Pas të vij me hap s'të zë.
 Rri. S'lëviz. S'të vij.
 S'të thërras.
 Po ti ç'ke moj që më qasesh
 Me helm, me gaz?*

Muxhahedinët si «Golden Boys»

Rrugëve të qyteteve pakistaneze, lagjeve plot pluhur dhe baltë, Levy kërkon njerëzit që kanë pasur kontakte me gazetarin Pearl: policë lokalë, informantë që çdo fjali e lënë përgjysmë, duke mbajtur dorën zgjatur, ushtarakë të lartë, agjentë të policisë sekrete, avokatë dhe pjesëtarë të organizatave të ndryshme islamike. Takimet me ta shndërrohen në skena ekzotike, të frikshme, imazhe të një kohe që me qindra vjet s'leviz fare.

Bernard- Henri Levy merr një dhomë pikërisht në hotelin ku ka filluar e gjithë tragjedia – hotel i cili në librin «Kush e vrau Daniel Pearl?» del si një qendër e komandosëve të organizatave islame. Ne jemi pranë tij kur ai fillon t'i ndajë me kujdes një nga një fijet e merimangës: ta shkapërderdhë mitin e rrezikshëm të terrorizmit islamik. Pikërisht në këtë «çerdhe» autori përpilon teorinë mbi «golden boys» të xhihadit dhe izmës së tij.

Levy është mjeshtër i orientimit në xhungël: makineria vrasëse e xhihadizmit nuk është vetëm një «bindje totale», fli fanatike ndaj besimit, fésë, porse ajo është edhe një industri, një biznes me profite miliardëshe në xhepin e sheikëve dhe shërbimeve të ndryshme sekrete - kështu thotë njëri nga konstatimet e Levyt.

Ky paska qenë edhe shkak i ekzekutimit ritual të Daniel Pearl. Ai ka depërtuar më shumë se sa duhet në aparatën e Al-Qaeda dhe është ballafaquar me ato fakte që s'duhej: bashkëpunimin dhe mbështetjen e Pakistanit zyrtar që gëzojnë organizatat

e ndryshme fanatike e terroriste islame.

Pakistani? Njëri nga aleatët besnikë të SHBA-ve në këtë luftë kaotike qenka njëri nga kandidatët më potentë të atij «boshti të së keqes» që presidenti amerikan nuk e heq nga goja? Ky është apeli qendror – shikuar nga aspekti politik – që Levy e bën nëpërmjet librit «Kush e vrau Daniel Pearl»?

Levy faktet për këtë i gjen në arkivat e pluhurosura të shërbimit sekret hindus.

Autori në konkurrencë me personazhet

Rrëfimi sipërfaqësisht rikonstruktohet në bazë të dy biografive themelore: në atë të gazetarit «martir» Daniel Pearl – i cili duke kërkuar origjinën dhe bazën e njeriut të mbiquajtur «këpucëbomba» zhytet në strukturat «mafioze» të Al – Qaeda-s dhe vritet para videokamerës – dhe vrasësit të tij Omar Sheikh, të dënuar me vdekje si organizator i vrasjes së të parit. Një terroristi që dikur ka pasur namin e kosmpolitit dhe absolventit brilant të School of Economics të Londrës, e i cili, pas kthimit në Kashmir dhe udhëtimit për në Bosnjë, Afganistan, Pakistan (dimensioni ndërkombëtar i xhihadizmit) shndërrohet në një njeri brutal, në konto të cilit shkojnë dhjetëra vrasje dhe rrëmbime. «Edhe ky armik i perëndimit është shkolluar në perëndim», thotë Levy plot mllëf.

Ndërsa biografia themelore që mban litarët në dorë, ngrihet vetvetiu mbi dy të parat duke rrëfyer e përplotësuar historinë me hipoteza dhe konstatime të letrarizuara e sidomos duke ecur nëpër kujtimet personale, është ajo e vetë autorit Bernard-Henri Levy. Pra, përtej të mirës (Pearl) dhe të keqes (Sheikh) ekziston një zonë që qëndron mbi ta, ajo zonë e Unit suprem të Autorit Levy. Ai rrëfen për veten më me përkushtim, për odisejadat e tij në Pakistan 1971: si perkrahës i flaktë i Z. A. Bhuttos, i cili bënte luftë për të marrë pushtetin. Bangladesh 1973: si luftëtar i një njësie rezistence të një fisi në afërsi të Afganistanit. Bosnjë 1992-93: si judë perkrah myslimanëve të Sarajevës që përpiqen t'i rezistojnë okupimit serb (pikërisht në kohën kur mendohet që edhe Omar Sheikh të ketë qenë atje), pastaj pasojnë Ankara

dhe Dubai (1994) e më në fund Izraeli (2002).

Në këtë mënyrë shkrimtari, që në vitin 1970 debutoi me librin e tij të suksesshëm «Indes Rouge», nuk i del zot asaj që premtonte në fillim të librit, pra nuk sjell një rrëfim emfatik («do të vëzhgojë si ai, do të mendojë dhe ndjejë si ai...»), por një «roman» që duket më shumë autobiografik për nga aspekti letrar e përmbajtjesor i tij, e që dy biografite e tjera (po të spekulojmë) i përdor si ilustrim për ngritjen e një botëkuptimi filozofik personal mbi «dimensionin gjeografik e filozofik të xhihadizmit». Bota dhe gjithë tragjedia që plasohet në vepër nuk shihet me sytë e Daniel Pearl, por me syzet e Bernard-Henri Levyt.

Pra, përpjekja për të ndërtuar rrëfimin, nisur nga duktusi multiperspektivësh kolidon me kryepesonazhin «hijerëndë»: vetë autorin!

Kritika

Në Amerikë romani nuk u përfill fare. Në botën gjermanofone u kritikua ashpër. Në Francë u ngrit në pedestal. Edhe rreth përcaktimit të zhanrit ka mospajtime: është roman, libër publicistik e gazetaresk, apo një pamflet propolitik i ngjashëm me ato librat e gjermanit Handke?

Libri është një formë e përzier rrëfimi që në Francë ka arritur sukses: një lloj kolazhi letrar-gazetaresk që ndez sidomos në fushën e trilerëve, romaneve historiko-dokumentarë dhe romaneve kriminale. Një lloj «romani» që jashtë Francës ende nuk gjen përkrahës në fushën e shkencave të letërsisë. «Kush e vrau Daniel Pearl» është një kolazh i tillë: përderisa në njërin kapitull flitet me gjuhën e ftohtë të fakteve dhe gazetarisë hulumtuese, në tjetrin kapitull del në pah mjeshtëria letrare, artistike e Levyt kur përshkruan, rrëfen, mediton për çështje të komplikuara filozofike, si natyra e krimit, gjendja e njeriut rrugës për «në amshim» etj.

Lexuesi me lehtësi ndjek hapat e autorit rruginave labirint të Madrassa-s (atij qyteti ku është e ndaluar hyrja e të huajve), sikur të ishte vetë aty. Çdo detaj, qoftë edhe ai më i parëndësishmi, në gjuhën e Levyt, shndërrohet në një element peizazhi

që ngulitet e mbetet në memorien e lexuesit si stampë. Natyra e rrëfimit a la Sherlock Holmes tërheq, intensifikon kureshtjen e recipientit dhe i merr atij të drejtën e kalkulimit, baraspeshimit apo formimit të një pikëpamjeje personale mbi definimet që shtron Levy në libër. Autori di si ta «burgos» lexuesin (sidomos atë naiv, të padjallëzuar) brenda mureve të rrëfimit të tij deri në atë masë sa që ky i fundit, që në faqet e para e humb aftësinë e dallimit ndërmjet fiksionit dhe realitetit.

Ajo që pak a shumë degradon nivelin artistik të veprës është fjalori i rëndë që Levy kultivon në libër: Bastardët, barbarët, errësira islame, demonët e të ngjashme, dhe atë jo vetëm kur bëhet fjalë për terroristët, por ato shpërthejnë në shumë situata e çaste ku s'duhej të ishin.

Në mungesë të përgjigjes finale

Levy di t'u përgjigjet shumë pyetjeve në kontekstin islam-perëndim. Është një analizë e kompletuar letraro-politike me një strukturë dhe apel të qartë në aspekte të shumta morale, kulturore e filozofike. Kuptohet nga prizmi i «kufizuar» i autorit. Mirëpo është e qartë se: «Kush e vrau Daniel Pearl» është një libër që më shumë se çdo kanal tjetër i mundshëm, të lehtëson udhëtimin në zemrën e organizatës aq të përfolur terroriste Al-Qaeda, dhe jo vetëm kaq e mbi të gjitha: ai është një homazh për një gazetar që mizorisht u ekzekutua para kamerave vetëm pse donte të zbulonte një të vërtetë. Pikërisht atë të vërtetën që s'duhej ta shpaloste, dhe bëri që të merret vendimi për likuidimin e tij - nëse e kuptojmë drejt nëntekstin e Levy-t – dhe atë jo vetëm nga Al-Qaeda. Për këtë arsye, përkundër dënimit me vdekje të Omar Sheikh-ut, Levy edhe më tej pyetet: kush e vrau Daniel Pearl-in?

Botuar: 19.09.2006

[http://floart.blogspot.com/2006_09_01_floart_archive.](http://floart.blogspot.com/2006_09_01_floart_archive.html#115867729394344104)

html#115867729394344104

Rekuiem për...

Iku edhe shtërgu i fundit komunist. Qeveria e përcolli me nderime të larta politike e ushtarake. Ithtarët e tij i bënë homazhe, duke kujtuar me nostalgji kohën e artë të Titos. Në ekrane Bakalli në përçafim me Titon dhe në shoqëri me gjeneralin serb Lubiçiç. ..

Rekuiem

Vetëm fjalë miradije për të ndjerin - kanë thënë latinët e lashtë. U derdhën shumë lot, ode, dafina e perla. U quajt njeri karizmatik, marathonomak politik, emblemë, sharm i një gjenerate, artist si Clark Gable... njeri i qejfeve, i gotës e duhanit. Agim Çeku e përshëndeti me lavdi: Bacën Mahmut e kanë cilësuar mprehtësia intelektuale dhe veprimi politik... Ulpiana Lama: Ai ishte Prometeu, i cili ruajti sekretet e Olimpikut për popullin e vetë. Pajazit Nushi: Ishte komunist, por jo dogmat... i ishte bashkuar aradhes çlirimtare të idealistëve të mëdhenj të lirisë së Kosovës... Ekrem Kryeziu: Ka qenë vizionar që ka lëvizur muret e robërisë sonë dhe i ka çarë ato me Kushtetutën e vitit 1974... Ramiz Kelmendi: Njeri i rrallë të cilin Kosova do ta ketë mall për shumë mote. Veton Surroi: Mahmuti dhe gjenerata e tij mësuan artin e shtetbërjes në Beograd... Ata kishin dëshiruar të shkolloheshin dhe e bënë, kishin dëshiruar autonominë dhe e bënë... Ekrem Murtezai e cilësoi më së miri: njëri ndër politikanët dhe bashkëpunëtorët më të dashur e të besueshëm të Titos. Ah këta Ekremat si karamelat! Njëmend kishte kush ta vajtonte patriarkun komunist. Më së shumti derdhën lot

Nushi e Surroi. Mahmuti ka lënë shumë pinjoj e miq që kanë kullotur në livadhin e tij. Ata e ringjallën si Krishtin për Pashkë. Ai ishte komunist i kaltër, e jo i kuq. Mahmuti ishte kalorës i garës politike jugosllave... Ishte vetë demiurgu i autonomisë së pushtimit, si shkalla më e lartë e lirisë dhe e subjektivitetit politik... një shpikje kushtetuese që i jepte Kosovës shtetin, por jo edhe emrin. Ai arriti të krijojë një emblemë të re të shqiptarit kosovar, atë të jugosllavizmit, si një shenjë e re identiteti. Ah, ky asimilimi filluaka së pari në shpirt, pastaj kaluaka në kokë për të përfunduar në gjuhë! Tito ishte simbol i jugosllavizmit, ndërsa Mahmuti një sindromë e titizmit. Uh, ai Tito Krimineli që kishte vrarë mbi 50 mijë shqiptarë pas Luftës së Dytë Botërore dhe kishte flakur mbi 420 mijë të tjerë për në Turqi! Sa republikanë shqiptarë dergjeshin burgjeve në kohën e Bakallit? Ngjarjet '81 ia kishin prishur vizionin politik Karamahmutit, vetë teorinë e integritit jugosllav. Kur nuk kishte mundur ta ruante më nën pushtim Kosovën, kishte rënë si kaskader. Tito i paskësh thënë në trenin e kaltër se nuk beson që Mahmuti do ta prishte Jugosllavinë! Ai kishte hedhur hijen e zezë mbi ngjarjet historike se i paskësh organizuar dikush tjetër e jo shqiptarët. Më vonë ky kaskader bëhet kallauz i bisedimeve sekrete me Serbinë për Kosovën në një konfederatë të re, duke i prirë shpurës në përqaftim me Milosheviçin në Dedinjë. Ndjesë pastë ky kaskader! Në purgator do t'i lajë të gjitha mëkatet. TMK-ja e përcolli deri në varr. Tanimë ajo është specializuar për rituale mortore. Ah, të gjithë titistët i varrosi!

Rauf Dhomi i dha lamtumirën e fundit: Tani kemi për t'u ndarë e kurrë më s'kemi për t'u parë!

Botuar: 20.04.2006

<http://www.shqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=546>

Persekutimi komunist mbi vajzat e Bajram Currit

Në hyrje të qytetit të Shkodrës, në lagjen e njohur Par rucë, në katin e dytë të një pallati, trokasim lehtë në derën me mbishkrimin: Familja Bajram Curri. Sakaq, dera hapet e përpara del një mezogrua, pak bionde e me buzën në gaz. E njohim që është bijë e kësaj familjeje me emër të madh, mësuese Mimoza...

Ajo na shoqëron për në dhomë, ku përqafohemi me nënën Hajrie, paksa e lodhur nga mosha, sëmundja dhe fatkeqësitë e jetës, por që përsëri nuk do ta japë veten. Mirësevini!- urojnë ato dhe ulemi. Sjellim ndër mend se po në këtë shtëpi ka jetuar dhe e kemi takuar vite më parë, gruan kreshnike të Bajram Currit, nënë Dervishen. Ishte si çetinë mali, me vështtrimin e saj shqiponjë, me një zemër të madhe. Prandaj të gjithë e miratonin veprimin e bashkëshortit të saj, trimit të madh të Kosovës e të Shqipërisë, se përse i kishte thirrur që në martesë e gjithnjë me emrin domethënës, Ajkunë (marrë nga legendat për kreshnikët e maleve tona). Kur B. Curri ishte në Vjenë, ajo fshihej sa në një shtëpi në tjetrën, në Gjakovë e në Tropojë dhe e maskuar si malësore, pasi serbët jepnin shuma të mëdha që ta shtinin në dorë Ajkunën e bukur. Më tej, nënë Hajria vazhdon, duke e kujtuar atë: Ishte burrneshë e vërtetë. Kur një herë e kërkuan malazetët në zyrë, pa iu dridhur aspak qerpiku, iu drejtua atyre: *-Pse i thirrni gratë nëpër zyra, a nuk ju vjen marre-a?* Ndërsa ata e pyetën: *-Për kë punon Bajram Curri?* Dhe ajo ua ktheu, aty për aty: *- Për Shqipni, për liri.* Nëna Hajri, tashmë mjaft e moshuar

(lindur në Gjakovë më 27.06.1919, i ati u vra në shpellën e Dragobisë më 29 mars 1925), sjell ndër mend prejardhjen dhe vendbanimet e tyre, sidomos në qytetin e dashur të Shkodrës. Kaloi një jetë të thjeshtë, por dhe të trazuar. Ajo tani kujton: Kur iku në Vjenë, baba më la në barkun e nanës. Në periudhën e Kongresit të Lushnjës, ai erdhi nga jashtë dhe qëndroi në Margegaj të Malësisë së Gjakovës (Tropojë). Sa kisha nisur të ecja. Më mori për dore nëna e Hysni Currit, Zylihaja dhe më çoi te Bajram Curri. Më tregonin se isha nisur drejt e në prehrin e tij, sikur të ma ndiente zemra se ai ishte babai im. Më vonë shkova pas tij, në Shkodër, në Tiranë, në Gjakovë e kudo. Hajria ndoqi pesë vjet shkollë në Shkodër dhe pas Luftës së Dytë Botërore punoi vite me radhë po aty, sporteliste në një hotel të vogël. *Kam hequr shumë keq*, thotë ajo e pezmatuar. *Kemi mbetur edhe pa bukë, se nuk ishim në gjendje; isha e vetme, me nanën dhe dy vajzat e vogla. Kam shtitë çdo gja, të miat dhe të nanës që të jetonim, se merrnim një pension të ulët.* Burri i saj vuajti afër 17 vjet në burgjet e diktaturës. Kohët e fundit ajo përjetoi humbjen e vajzës, Valdetit dhe të shoqit, Ragip Metës. Pothuajse të njëjtin fat në jetë pati dhe motra e madhe e Hajrisë, nënë Feride Curri. Nuk pati fëmijë dhe burri i saj, Hivzi Ohri vuajti gjithashtu burgjeve e vdiq shpejt; kështu që vitet e fundit të jetës ajo i kaloi e vetme, në Tiranë (u nda nga jeta më 23.05.1979). Ato kanë pasur dhe një motër, tre vjet më të vogël se Hajria, Ganimetin, e cila vdiq në Gjakovë nga tifoja, në moshën 18-vjeçare. Unë kam pasur rastin të hyj në këtë familje qysh në moshë të re dhe kurdoherë kam ndërë aty ngrohtësinë e të gjithë pjesëtarëve të saj: të nënë Ajkunës, nënë Ferides e nënë Hajrisë dhe të motrave, Mimoza e Valdet Meta. Gjithnjë mikpritëse, përherë buzagaze e të edukuara dhe pa asnjë shenjë mendjemadhësie që kishin lidhje me burrin e madh të kombit, Bajram Currin. Por ruanin thellë në zemrat e tyre një plagë të përbashkët: Gjakovën e Kosovën. Sa herë ua sillje ndër mend ato, psherëtinin: Ah, sikur t' i shihnim ato të lira! Sa mall të madh kemi për atë krahinë kreshnike! Por edhe për Shkodrën e Malësinë e Gjakovës, për Hasin e Lumën e tërë vendin, kanë folur ato e flasin me respekt e dashuri, pasi e

strehuan dhe e mbajtën babanë e tyre luftëtar, se kudo gjetën zemër e bujari të madhe. Nëna Hajri tregohet e gatshme të dëshmojë për episode nga jeta e nënë Ajkunës, nga jeta e saj dhe e motrës Feride, nga jeta e dy vajzave, Mimosës e Valdetit. Kanë bërë një jetë të thjeshtë dhe me mjaft sakrifica e kanë përballuar atë, sepse nuk trashëguan asgjë nga Bajram Curri, se tërë pasurinë ai e shkriu për popullin dhe përballimin e luftërave kundër armiqve të shumtë. Ndër të tjera, nënës Hajri i ka mbetur merak të shkruhet më tepër dhe për kujdesin që ka treguar i ati për shkollimin e fëmijëve tanë, në Shqipëri e në Kosovë. (Tashmë janë të njohura faktet se ai dërgoi fëmijë kosovarë në Normalen e Elbasanit; për meritat e tij në fushën e arsimit kombëtar, u zgjodh kryetar nderi i Kongresit Kombëtar Arsimor, Tiranë, 1924; për qeverinë demokratike të Fan Nolit propozoi ministër të Arsimit, Sali Gjukë Dukagjinin ose Qamil Balën; u interesua për sigurimin e mësuesve të shkollave shqipe në prefekturën e Kosovës etj.). Tani ajo nxjerr nga valixhja e saj një fotografi të vjetër, ku kanë dalë katër djem, që B. Curri i dërgoi nga Shkodra me bursë në Vjenë të Austrisë. Ata janë: Hajrulla Curri (nipi i tij), Rexhep Krasniqi (kosovar), Xhevdet Dani (shkodran), Menduh Angoni (gjirokastrit). Më 5 maj 2000, ndërroi jetë mbesa e B. Currit, Valdet Duraku (Meta). Me atë rast, dy mësues nga Shkodra botuan një homazh në shtyp. Aty shkruanin edhe këto radhë: Ndër cilësitë e saj, përmendim se Valdeti shquhej për korrektësinë në punë, mendimin e thellë, përgatitjen e lartë shkencore, afërsinë dhe dashurinë për nxënësit.-Nxënësin duhet ta duash sa fëmijën tënd, thoshte ajo, duke nënkuptuar kështu një nënë të mirë. Ta nderosh e ta respektosh atë edhe pse është ende i vogël, por megjithatë ai është një personalitet. Po me cilësi të tilla u rritën dy mësueset, Valdeti e Mimoza, se kishin genin nga gjyshi Bajram e gjyshja Ajkunë, se kishin edukatën e nënës Hajri e të tezes Feride. Për të shkruar për nënat e bijat e familjes Curri se sa e meritojnë, duhen faqe të tëra. Virytet e larta të nënave, grave e vajzave shqiptare i kanë dalluar të gjitha, gjyshen, nënën dhe bijat e kësaj familjeje të njohur atdhetare. Të tilla janë dashuria për

atdheun, bujaria, thjeshtësia, mirësia, zemërgjerësia, respekti e nderimi për të tjerët. Prandaj ato mbeten në kujtesën e atyre, që i njohën, si nëna dhe edukatore të paharruara. Përkujtimi - 81 vjetori i rënies së Bajram Currit 81 vjet më parë, më datën 29 mars 1925, në përpjekje me ushtrinë mbretërore në Tropojë, në vendin e quajtur Pas-Kollate afër fshatit Dragobi, ra duke bërë qëndresë të armatosur Bajram Curri. Ai ishte biri i një familjeje të përzënë nga Malësia e Gjakovës më 1862 si rezultat i internimit nga otomanët të babait të tij Shaqir Curri. U bë udhëheqës legjendar i disa luftërave të viteve 1910, më mbrapa mbështetës i Ismail Qemalit dhe në Kongresin e Lushnjës mori detyrën e kryekomandantit të ushtrisë kombëtare...

Botuar:01.05.2006.

<http://www.sqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=657>

Polemikë pa dorashka

Quhem Klajd Kapinova me banim në New York. Sapo më telefonoi një mik nga Manhattan-i dhe më tha: shikoje urgjentisht e-malin e toplistës art-cafe.

I nderuar z. Vasil Qesari, së bashku nuk njihemi dhe për herë të parë kemi ndarë pikëpamje të ndryshme në këtë listë për temat e letërsisë, ku ju mbron pikëpamjet tuaja, ndërsa unë të miat. Deri këtu nuk ka pasur asgjë të keqe midis nesh. Më vjen shumë keq që keni lakuar emrin dhe mbiemrin tim për një e-mail që nuk është i imi. E-maili im është klajd.kapinova@yahoo.com dhe asnjëherë nuk kam shkruar dhe nuk shkruaj me pseudonime apo me emra që nuk janë të mitë. Për sa i përket z. Bepin Pjetrit, është e vërtetë që të dy jemi rritur në jetimore, ndonëse z. Bepin është më i madh se unë. Bepi nuk më njeh mua dhe, dhe as unë nuk e njoh shumë mirë tjetrin, pasi që mosha dhe jeta na ka hedhur në udhë të ndryshme deri sot. Sapo mbërrita në SHBA, Bepi kërkoi që të ruajmë lidhjet me e-mail, por unë nuk kisha mundësi t'i përgjigjesha, sepse isha pa punë dhe jetoja në shtëpinë e një mikut tim, dhe, ndonëse ishte vërtet mik, nuk kisha dëshirë të abuzoja me telefonin dhe kompjuterin e tij. Për më tepër, për mua mund të pyesësh në shkollën e mesme në Koplik, ku unë kam mbaruar maturën dhe i bija shatit edhe për një vit në fermën e zooteknikës në Shkodër. Kam punuar në Shllak si mësues. Zotin Gjon Ndoc Shllakun, që është dirigjent, nuk e njoh fare dhe nuk kam ndonjë faqe interneti timen që të hedh shkrimet e të tjerëve. Është fjala për librin e mikut tim, Fritz Radovani me titull "Nji katakomb nën dhe", botuar në Kroaci (dokumente nga arkivat) të ribotuar

edhe në Shkodër. Pra, siç shihet, z. Ndoc ka ngatërruar autorin e librit, që sot jeton në Australi. Pra, si Bepini dhe dirigjenti Gjon Shllaku, nuk kanë asnjë lidhje me mua. Nuk e pashë të arsyeshme të analizoj shkrimin tuaj në adresën time, mbasi mendoj se ka ndodhur një keqkuptim midis jush dhe meje.

Edhe një herë ju uroj të gjitha të mirat në punën tuaj dhe kërkoj nga ana e juaj të më kërkonin ndjesë publike për fyerjet pa baza që më keni drejtuar mua.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Klajd Kapinova

Gërmime në llagëme të pista ...

Në përgjigje të shënimit tim “Nje skriboman ...” shkruar ditët e fundit prej meje në forumin “Art Cafe”, mbas shumë fyerjesh të ulëta e ndërhyrjesh idiotike rreth personit dhe mendimeve të mia, bërë në mënyrë publike, si edhe në postën time private nga njëfarë Klajd Kapinova (Illyricum6@aol.com), një shkrim tjetër, i marrë “hua” u postua po prej tij, pikërisht ditën e djeshme. Kësaj radhe, i gjori kalorës me “fytyrë të vrerosur”, pra Klajdi dora vetë, duke dashur të më “varroste” njëherë e mirë, e me dëshirën për të dalë “fitimtar” në këtë betejë të marrë, të shpallur vetë prej kohësh, më ka bërë një nder të madh, duke më rritur “pazarin” shumë, e duke më vënë në qendër te ca “ngjarjeve” si dhe të një epoke të caktuar, për të bërë kështu publik faktin se kush jam unë, nga rrjedh unë dhe se si i kam “shërbyer” regjimit të kaluar. Shkurt, më ka bërë “biografinë”.

Temë kjo, mjaft e njohur dhe e preferuar në një pjesë të mirë të shtypit shqiptar, të cilin me të drejtë Ismail Kadareja e ka quajtur “shtyp i zi”, e që është bërë ndërmjetës e “complisse” i luftës së pistë politike që bëhet atje; i larjes së hesapeve, grindjeve mes klaneve, shpifjeve kundër personave të caktuar, helmimit të “ekologjisë” shpirtërore, vazhdimit të “luftës së klasave” etj. Shkurt muhabeti, mister Kapinova, ka sjellë në “Art-Cafe” një shkrim të kësaj natyre, dhe kjo e fundit, pa u vrarë fare në ndërgjegje se kështu cenon rëndë personalitetin dhe fyen keqas

jetën dhe imazhin e një njeriu (për të cilën gjë përgjigjet para ligjit), ka dashur të më bëjë pra “biografinë”, tamam siç e bënin dikur edhe sekretarët e devotshëm dhe inatçorë të Enverit ...

E, ndërkohe, duke kryer këtë veprim shoh se ai ka rënë edhe më poshtë se ç’ka qenë më parë, duke e pasuruar kështu edhe me tej shënimin tim “Nje skriboman ...”, me gërmimet e bëra në terrene e llagëme mjaft të pista, gjersa ka arritur të gjejë mbështetje te ENVERI, dora vetë. Një moment! ... Jo te Enveri i Gjirokastrës, por tek ai i Lepenicës, i cili i ngjan të parit në një, a në disa gjëra që kanë një emërues të përbashket: “luftën e klasave”. Pra, ka gjetur shpëtim te pena e një “figure” të diskredituar në qytetin e Vlorës, i cili ka bërë dhe bën pjesë gjallërisht në “korin e zi të kukuvajkave”, që gjatë gjithë jetës së tyre janë dalluar për mediokritet, zvarritje, jargavitje, mitomani pa kufi, dëshirë të shfrenuar për pushtet, servilizëm, mercenari ndaj çdo flamurmbajtësi, e me plot cene të tjera nga më të ulëtat...

Nuk do të doja ta bëj të gjatë, as për të bërë sqarime a “polemikë” me autorë e shkrime të kësaj natyre. Ata që e kanë lexuar atë, besoj se e kanë kuptuar se përse behet fjalë, nga fjalori i përdorur në të; nga mendësitë, stili i njohur i dënimit të “armiqve” të Partisë; nga gjykimet e shpifjet e ulëta të një mitomani të pashoq. Veçse, diçka do të shtoja për të mbyllur një herë e përgjithmonë atë. Mua me njeh Vlora tej e mbanë. Dhe jo vetëm ajo, por edhe e gjithë krahina. Me njeh aq mirë sa që kur shkoj aty, për çdo vit, nuk bëj dot dhjetë hapa pa u ndalur nga miq, shokë, të njohur e dashamirës të shumtë. Por, Vlora po ashtu, njohu këto vitet e fundit edhe njëfarë ENVER Memisha, dikur një servil vullnetar dhe tepër i rregullt i gazetës “Zëri i Vlorës”, dhe më pas drejtues i SHIK -ut famëkeq të Sali Berishës. Një person i padëshiruar dhe i urryer, i cili nuk shkeli në qytetin e tij të lindjes për shtatë vjet me radhë nga frika e hakmarrjes për shpifjet e bëra në shkrimet tij të botuara në Tiranë (ku edhe tani jeton), si nga gjyqet e “llogaritë” që ka me dhjetëra e dhjetëra ndaj qytetarëve vlonjatë...

Epilog

Fli tani i qetë, o Klajd, martir i kombit !... Ti detyrën tënde ndaj armiqve të tij e ke kryer duke hyrë madhërisht në “altarin” e atdheut !...

Simbad Detari

P. S.: Meqenëse shumë lexues, pa te drejte nuk ia kanë dëgjuar emrin këtij “ushtari të panjobur” që punon ditë e natë për triumfin e “demokracisë” terroriste, ndonjë prej jush që ndesh me këtë shënim, do të ishte i lutur të shkruante diçka rreth temës: Kush është ky Klajd Kapinova! Ky luftëtar i palodhur që po shkrin jetën në emigracion, për të vënë gjërat në vend, në historinë e vorbullës shqiptare... Sa për veten time, unë e kam shkruar atë dhe e keni këtu më poshtë:

Një Skriboman ...

Një skriboman me emrin e një romani amerikan të Teodor Drajerit, me mbiemrin sllav të një fshati blegtorësh në Skrapar a gjetkë, me qytetari të pretenduar shkodrane e me “mision historik” për rishikimin e Historisë së Shqipërisë, është bërë me të vërtetë i bezdisshëm duke na dhënë, herë pas here leksione se si duhet shkruar ajo. Kohët e fundit, ky person e të tjerë “studiues” anonimë të tipit të tij, kanë vënë në diskutim dhe vetë personalitetin e Ismail Qemalit, duke pretenduar se ato që shkruajnë ata, janë të reja e të panjohura. Krejt “ndryshe” nga ato që janë shkruar nën komunizëm.

(Sa për të “panjohurat”, mos shkoni tepër larg, por mund të lexoni, në vend të Tajar Zavalanit, të cilin personi në fjalë e cilëson sikur të qe “babai” i historiografisë shqiptare, dy veprat madhore kushtuar Ismail Qemalit, arkitektit të pavarësisë sonë, shkruar nga Nermin Vlora dhe Enzo Falaschi, të dy të përbuzur e të sikterisur nga Tirana e kohës së Enverit).

Për më tepër, ky person, i cili tund e shkund përditë flamuj shumëngjyrësh, kërcënimesh e shigjetash druri, të kalbura, e krahas tyre edhe “dyer billdingesh” në Nju-Jork, më sa duket i është mbushur mendja të “tund” edhe themelet e asaj, çka, në Shqipëri është tashmë e shenjtë: historia dhe “shenjtoret” e saj të

afirmuar. Ky individ, pjesëtar i zellshëm i “korit të kukuvajkave” që këndojnë çdo mbrëmje me hare debilësh dhe gaz zemërak, marshin mortor për vdekjen e çdo gjëje të shenjtë që kanë shqiptarët, zë pastaj edhe emrin tim në gojë, duke përmendur profesionin dhe televizionin që unë kam pasë themeluar vite të shkuara në qytetin tim të lindjes, e që ishte i pari televizion i pavarur në Shqipëri; një krijesë e pafat, e cila, megjithatë edhe sot kujtohet me mjaft respekt nga qytetarët e Vlorës mbarë ...

Simbad Detari

Botuar: 22.11.2005.

<http://floart.blogspot.com/2005/11/floart-i-buaqon-letrat-e-vasil-qesar.html>

Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviqit

Argumenti: Analiza dhe Komente

Kjo letër u adresohet të gjithë atyre që në një mënyrë kanë pasur lidhje me koncertin e “bujshëm” të Goran Bregoviqit në Tiranë; organizatorëve, sponzorizuesve, mediave përcjellëse dhe spektatorëve të “zjarrtë”.

Mallkim gjithë pjesëmarrësve të këtij që as emrin s’mund t’ua them Zotërinj, pse ndjeheni inferiorë? Zotërinj “kozmodopolitë”, që keni pritur Goran Bregoviqin, kam dëshirë që të jua përkujtoj disa gjëra, të cilat ju i dini më mirë se unë. Goran Bregoviqi është një muzikant serb (në të vërtetë, ai rrjedh nga një familje e përzier serbo-kroate, por formimi i tij, edhe artistik, është dhe mbetet serb); njëri nga ata që cilësohen se kanë përkrahur, në një mënyrë a në një tjetër, ekstremistët serbë, që kanë shkaktuar masakrat e tmerrshme në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit të kaluar. Përveç të tjerash, ai nuk guxon të shkojë as në Zagreb, e aq më pak në Sarajevë (jo pse frikësohet nga banorët tejet paqësorë të këtyre dy kryeqyteteve, por e ndalon diçka që është e ngjashme me atë që nuk e lejon të vijë në Prishtinë). Ai është njëri nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të regjisorit Emir Kusturica, i njohur për përkrahjen e dhënë elitës politike serbe të fundshekullit XX (me gjasë, ju e çmoni

edhe atë shumë). Përveç kësaj, Goran Bregoviçi njihet edhe për shumë këngë e kompozime që thërrasin për ekstremizëm, që ftojnë në vrasje. Ne nuk e dimë të sigurt, por duke iu referuar një burimi mirë të informuar (vlerësimin e të cilit e kemi dëgjuar këto ditë), kompozimet e tij kanë ngjyrim të theksuar çetnik. Për më tepër, ai është një “artist”, i cili kurrë nuk ka thirrë për ndaljen e gjakderdhjes (një artist me epitete, çfarë ju i dhatë këto ditë, duhet ta bënte këtë doemos), edhe pse ai ka pasur mijëra mundësi të bënte këtë, për shkak të famës që gëzon tek një komb, i cili, po ashtu, ende nuk po kërkon falje për krimet e bëra. Unë nuk e di nëse i keni kuptuar tekstet e këngëve të G. Bregoviçit apo jo, mirëpo ne ju kemi parë se keni rënë në delirium atje në Pallatin e Kongreseve. Në mes tjerash, në ekstazë ka qenë edhe Manjolla Nallbani, e njohur tek ne për këngët kushtuar dhimbjes së shkaktuar nga bashkëkombësit e Bregoviçit. Marr të drejtë të pyes, Zonja Nallbani, na tregoni kur keni qenë e singertë: atëherë kur këndoje për lotët dhe dhimbjet e fëmijëve të Drenicës apo në natën e dytë të koncertit të Goranit. Sa për njoftimin tuaj, sinqeriteti në të dy rastet nuk është i mundshëm, në rast se ende ekzistojnë kufizimet e përbotshme të një personaliteti njerëzor. Sa për kryebashkiakun e Tiranës, kjo fletë është tepër e bardhë për të paraqitur të gjithë atributet që i meriton ai. Vetëm një çështje, kanë ekzistuar milionë destinacione më të mira për atë çelës që i është dorëzuar Bregoviçit. Inferioriteti i shprehur publikisht nga një person që e mban veten të jetë karizmatik. Vetëm për një punë gëzohem për Edi Ramën. Simbolika e kundërt e dorëzimit të çelësit të një qyteti, ai historik, i dorëzimit të çelësave të kalave (qyteteve të atëhershme) nga renegatët tek armiqtë tanë. Pra, le ta trajtojmë këtë gjest ashtu. Edhe ju të tjerët, që keni kënduar, vallëzuar, hallakatur e grisur fytyrat për Bregoviçin, ta dini se ai dhe bashkëkombësit e tij, kurrë, nuk do të pranojnë që në qendër të Beogradit, të jehojnë tingujt e muzikës shqipe. Pra, ju jeni treguar inferiorë. A jeni më të vërtetë? Andaj, zotërinj “kozmpolitë”, pse ndjeheni inferiorë? Pse ndjeheni të vegjël përpara pjesëtarëve të një kombi, që nuk ka forcë ta dënojë të keqen, që nuk ka forcë të

kërkojë falje për krimet e bëra në emër të tij dhe, së fundi, një kombi që nuk ka mundur të nxjerrë në dritë madje një libërth, ku do të shprehej e vërteta. Një komb, i cili nuk mund të nxjerrë asnjë disident të vërtetë përveç konformistëve të mjerë dhe një kombi i cili, ende, zgjedh për heronj kriminelët e njohur dhe të ndjekur ndërkombëtarisht, dhe i cili komb, brez pas brezi, prodhon elita që kërkojnë të derdhet gjak fqinjësh, posaçërisht, po e them prapë, posaçërisht, gjak shqiptari. Mos u arsyetoni duke thënë se vetëm politika apo konjunkturat e veçanta politike e kanë fajin dhe se kombi nuk ka faj; ky është një arsyetim idiotesk dhe pyetni njohësit e vërtetë të këtyre gjërave-kjo nuk qëndron fare. Faji është kolektiv. Këtë e tregon edhe mospranimi i këtij faji, mungesa e forcës për të kërkuar falje në mënyrë kolektive dhe, për të mos e zgjatur, aspiratat e serbëve për të derdhur ende gjak shqiptari. Ftesa dhe sponsorizimi i një “artisti” të këtij kombi, sidomos nga viktimat e këtij kombi, është edhe një inferioritet. Pse, zotërinj, pse? Zotërinj, pse mendoni se kombi serb ka kulturë të lartë, kur në njëzet-tridhjetë vitet e fundit, nuk ka nxjerrë asnjë artist, intelektual, shkencëtar e aq më pak një politikan, i cili do të fliste (apo bënte) diç morale, diç normale, diçka të pranuar nga bota normale, jashtë kësaj ballkanike. Zotërinj, pse mendoni se miksturat rome janë vepra të mëdha arti? Në Pallatin e Kongreseve, tek spektatorët, unë pashë artistë shumë më të mirë se Bregoviqi. Çfarë ju shtyn të mendoni se ai është më i madh? Çfarë ju shtyn të jepni epitete të tilla, të cilat një orkestër e tillë do t’i merrte vetëm nga njerëz që janë nën ndikimin e alkoolit apo ndonjë lëndë tjetër dehëse? Për fund, ju që keni rënë në trans duke vallëzuar dhe kënduar me Goranin (sigurisht, tanimë ai është bërë i afërt për ju, për këtë e thërras vetëm në emër), mos mendoni se këngët e tij ishin vetëm serbisht (duke e ditur se ju nuk e keni pasur “fatin” të mësoni gjuhën serbe, unë guxoj të mendoj se nuk i keni kuptuar vargjet-edhe ashtu të pakta - të Bregoviqit; pse atëherë gjithë ai delir dhe ato dridhje të belit në Pallatin e Kongreseve), ato ishin përzierje melosesh, ku dominonte fryma rome. Nëse ju e quani art të mirëfilltë këtë, unë ju uroj për orientimin. Fare në

fund, vetëm ta dini se lotët e fëmijëve të Kosovës, për të cilët ju keni shkruar dhe kënduar këngë, ende s'janë tharë; mund të jenë edhe lotët e ndonjë fëmije, i cili është dashur të merrte pjesë në edicionin e radhës të “Gjeniut të vogël”, në TV-në tuaj (KLAN), por ju, për hatër të Goranit, ua keni shtyrë emisionin e tyre të dashur. Ju lumtë edhe për këtë!

Prof. dr. sc. Hasim Rushiti nga Prishtina

Botuar: 12.04.2006

<http://www.sqip.dk/modules.php?name=News&file=print&sid=476>

**PSIKANALIZË,
ASTROLOGJI
& EROTIKË**

Ç'është psikologjia, psikanaliza dhe kush është Sigmund Freud

Psikologjia është një subjekt i popullarizuar, që kohëve të fundit është duke u rritur interesimi për studimin e saj. Fjala psikologji për të parën herë është paraqitur në Angli më 1693, por nuk është përdorur dhe nuk është kuptuar një kohë të gjatë, deri në vitet 1800. Është kuptim i përbërë nga dy fjalë greke “psyche” dhe “logos”. Psyche në mënyrë origjinale nënkupton frymëmarrje (respiracion), por më vonë është kuptuar si shpirt, sepse frymëmarrja është ndikuar shpirti, i cili ende nuk e ka lëshuar trupin.

Në mitologjinë greke Psicho ka qenë një grua, e cila ka qenë në marrëdhënie dashurie me perëndinë e dashurisë, Eros. Ai ishte dashnor i saj, por kishte një kusht ndaj saj: që mos t'i shikonte fytyrën e tij kurrë. Por, nga kureshtja, Psichoja një natë vendosi një qiri për t'ia shikuar fytyrën. Në momentin kur e kupton Erosin, atëherë e magjeps atë. Për të arritur cakun, është dashur të bënte një luftë të madhe me përplot rreziqe, por në fund ajo është transformuar në perëndeshë dhe i ishte bashkangjitur Erosit në parajsë.

Psycho simbolizon shpirtin njerëzor. Gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë, kuptimi i fjalës psiche është shndërruar në kuptimin e mendjes. Logos, një fjalë tjetër greke, ka nënkuptuar shkencën, ose arsyen. Sipas rrugëve Greke, psikologjia është një kuptim mbi arsyen ose mbi mendjen, apo siç thuhet sot

studimi - mbi mendjen.

Psikanaliza u formua nga Sigmund Freud, i cili edhe e krijoi atë duke u bazuar së pari në mendimet e tij personale dhe pastaj që ta dijë vetë se si dhe perse ai ishte i frikësuar nga vdekja, fobia dhe dhimbja. Ai filloj duke e analizuar së pari veten e tij, çka e shpuri më vonë deri të ajo, kur ky filloi edhe t'i analizonte njerëzit e tjerë, pra pacientet e tij. Psikanaliza është vetëm ajo që të tregojë dhe hulumtojë se përse njerëzit sillen në mënyra të ndryshme tërë jetën dhe se do të ishte mirë që të dihet përse njeriu frikohet nga lashtësia, errësira, nga insektet etj., por do të ishte edhe mirë që të dihej nga kjo se, përse njerëzit kanë nganjëherë edhe sjellje kriminale dhe çka fshihet prapa tyre.

E tëra u pasqyrua në një pjesë të madhe të njerëzve për shkak të psikikës së tyre të sëmurë, por edhe të gjendjes së përgjithshme psikike. Psikanaliza i përkushtohet njohurisë dhe shpirtit të njeriut. Freud ishte vetë mjek dhe gjendjet neurotike të pacienteve të tij për të ishin shumë interesante për t'i studiuar. Psikanaliza i sqaron ankthet dhe ankthet e detyruara si një lloj përjetimi të tronditjes. të cilat kanë lënë gjurmë qysh në fëmijëri. Njeriu nuk duhet që të ketë probleme të mëdha, ose thjeshtë të jetë i sëmurë psikik që të kërkojë ndihmë nga Psikologu për trajtim në ndonjë terapi. Por, shumica e njerëzve e kanë një frikë në veten e tyre që të mos jenë si të shënuar ose regjistruar, mendojnë se kjo është një punë që duhet të mbahet sekrete.

E vërteta është se psikoterapia në të shumtën e rasteve merret me problemet e jetës së përditshme të psikologjisë njerëzore, të cilat probleme, çdo njeri i njeh për veten e vetë, por lufton kundër tyre duke i mbajtur si sekrete në brendësinë e vetë.

Por psikoterapia ka të bëjë më se shumti me mjekimin e lirë mental sesa me atë të psikiatrisë, qe në çdo rast qëllimi i tërë kësaj është që njeriu të jetë mirë dhe i mençur me veten e vetë, ta zbulojë “unin” e vetë, sesa të mjekohet me medikamente ose tek ndonjë lloj qendre psikiatrike pa nevojë.

Brenda këtyre viteve, shumica më kanë kontaktuar dhe thuaja se çdo njëri ka thënë se “Unë nuk kam probleme të

mëdha psikike që të kërkoj mjekim në psikoterapi.” dhe nga kjo ka rezultuar se ata nuk e kanë marrë si rast serioz nevojën e mjekimit të tyre në këtë drejtim, por në fillim janë mbyllur në vete, duke i ikur të vërtetë, dhe më pas, pas një kohe, kur nuk kanë mundur të rezistojnë, janë lajmëruar prapë që të kërkojnë ndihmë. Psikoterapia nuk është asgjë tjetër vetëm terapi e lirë dhe udhëzim për mirëqenien shpirtërore. Është normale të jetë jonormale.

Shumica e njerëzve kanë një marrëdhënie të mirë, siç edhe e quajnë: marrëdhënie dhe dije normale. Të jesh sikur që je vetë dhe të kesh një vetëbesim të plotë, kërkohet që njeriu të largohet nga ai mendim duke e bërë në vete këtë që ta vlerësojë veten si të tjerët dhe të fillojë t’i bëjë pyetje vetvetes se kush në të vërtetë është ai ose ajo, ose kush jam unë. Është e pamundur që njeriu të ketë mundësi që të jetë sikur ata të tjerët, sepse këtu njeriu bie ndesh me origjinalitetin e tij personal. Nëse ti mendon se je si të gjithë të tjerët, nuk duhet harruar se ti je më ndryshe nga të tjerët dhe origjinal në veten tënde. Edhe nëse je i sëmurë psikikisht, ke të drejtë të llogaritësh se je një pjesë e njerëzimit dhe kërkon respekt nga rrethi, pavarësisht nga bindja jote njerëzore ose nga momentet e ndonjë lloj sëmundjeje në jetën tënde.

Çdo njeri vlen aq sa edhe tjetri. Një Psikoterapeut mundet të të ndihmojë ty që të kuptosh dobësitë e tua dhe të mësohesh të jetosh me një pengesë tënden, të cilën e mban të fshehtë, ose në anën fizike të trupit, me një fjalë, të mësohesh të jetosh edhe si hendikepuar, sepse je qenie njerëzore, si të gjithë. Nëse ke problem serioz, do të ishte më mirë që ta kuptosh natyrën e atij problemi dhe si të tjerët e kuptojnë këtë lloj problemi, e jo të rrih i fshehur në hijen e turpit ose të luftosh me veten tënde dhe me ajrin që të rrethon.

Mendimet joreflektuese

Një pjesë e mendimeve tona formulohen në një kohë të largët, ose të harruar, dhe nga një situatë e vështirë e fëmijërisë; kjo është një shenjë e përshtypjes infantile, dhe këto mendime mund të na bëjnë një errësirë dhe mungesë vullneti që të planifikojmë të ardhmen tonë dhe mundësitë tona në jetën e mëtejshme.

Këto mendime, me te cilat as nuk mundemi të mendojmë, na vijnë në kokë pa dëshiruar dhe këto e bëjnë një lloj bllokade, me ç'rast ne nuk mundemi të reflektojmë më për së afërmi, nëse ndonjë person tjetër nuk na këshillon që të llogarisim ardhmërinë tonë, sepse këto mendime të lartë zotërojnë mbi ndjenjat tona në mënyrë mekanike dhe në atë automatike; por edhe zvogëlojnë dëshirën tonë për jetë. Këto janë mendime që nuk bën të mendojmë për to. Procesi i mendimit ndalet dhe futen mendime që në mënyrë të pakontrolluar sillen vetëm në një rreth, nuk shkojnë më përpara, por vetëm aty, ndërsa ne bëhemi të papjekur që të mësohemi nga përvoja e hidhur.

Nganjëherë, këto lloje të mendimeve janë larg nesh dhe nuk gjenden me ne për të mirën e uni-t tonë, por vijnë në kokat tona aq shpejt në cikle të papërshtatshme, kur as ne nuk e dimë se çfarë po ndodh vërtet me ne. Ne “dimë” se çdo herë jemi pa fat, dhe se nuk është ide e mirë që te provojmë të ndryshojmë, sepse ne nuk mund t'i bëjmë disa gjëra, se të tjerët kanë çdo herë të drejtë, se te gjitha femrat janë joreale (falso); burrat janë zullumqarë, dhe të tjerët largohen nga ne; nëse ata na njohin në brendësinë tonë se çka fshehim dhe çfarë mbajmë në vete. Në këto rrethana nuk lind asgjë më shumë se vetëbesimi i ulët, i cili atëherë patjetër duhet të kërkojë këshillën dhe ndihmën e Psikoterapeutit.

Sigmund Freud (1856 - 1939)

Sigmund Freud u lind më 6 maj të vitit 1856 në Freiberg, një qytet në Mähren (Çekia e tashme). Familja e tij i takonte kulturës hebraike në këtë qytet, dhe ky ishte njëri nga 130 çifutët në qytetin e banuar prej 4500 banorësh. Freudi filloi universitetin në moshën 17 vjeçare, por nuk u legjitimua si mjek (examen) derisa mbushi 25 vjet. Por, kur u legjitimua, pra kur mori examen, ky menjëherë u punësua në spitalin e Vjenës. Në vitin 1903 Freudin e takojmë si profesor, pas 17 vitesh përvojë pune të profesionit (koha normale ishte tetë vjet), ndërsa në vitin 1886 u martua dhe kishte gjithsej gjashtë fëmijë.

Puna e parë e Freudit në teorinë psikanalizës “Studie

über Hysterie”. E shkroi së bashku me kolegun e tij të punës, J. Breuer dhe ky libër u publikua në vitin 1895, pra nëntë vjet pas hapjes së klinikes së tij private. Libri i parë që ai shkroi ishte “Traumdeutung” - “Shpirti i Traumës” që doli në qarkullim më 1899.

Në fillim të vitit 1902, një grup studiuesish u interesuan aq shumë rreth kësaj, sa që filluan të takohen me Freudin çdo javë në shtëpinë e tij për të diskutuar idenë e librit të ëndrrave dhe shkrimet e tjera në aty.

Freudi shkroi edhe një sasi të madhe librash dhe artikujsh mbi psikanalizën qysh nga viti 1900. Në këtë kohë, ai ishte 40 vjeç, që zakonisht llogaritej si një moshë produktive në bazat e shkencave shoqërore.

Në vitin 1908 u formua shoqata e psikanalistëve, ku në fakt, shumë studiues të jashtëm udhëtonin shpesh në Vjenë për të studiuar tek Freudi, dhe për këtë punë ai u nderua me shumë urime, premtime dhe komplimente.

Në vitin 1909 Freud u bë Doktor nderi në Clark University në Amerikë, dhe po në atë vit u mbajt edhe kongresi i parë mbi psikanalizën në Salzburg të Austrisë. Freud u propozua edhe për marrjen e çmimit Nobel, por edhe pse zbuloi shumë, kontribuoi shumë dhe dha teori të rëndësishme, ai nuk e mori kurrë këtë çmim.

E bija e tij Anna Freud, filloi të shkonte së bashku me të nëpër seminare të ndryshme dhe zëvendësonte edhe vendin e tij nganjëherë. Anna, e cila shkoi për analiza tek babai i saj dhe e studioi psikanalizën tek ai, ishte edhe si sekretare e tij, motër medicinale por edhe si kolege më e besuara e tij.

Përforcimi i nazistëve në Gjermani dhe përndjekja e çifutëve, krijoj një pasiguri tek Freud. Në një bashkëpunim të hershëm rreth një libri, Woodrow Wilson (Thomas Woodrow Wilson ka lindur më 28 Dhjetor 1856 në Staunton, Virginia, ShBA dhe ka vdekur më 3 Shkurt 1924 në Washington (D. C.). Ishte prej 1913 deri 1921 President të ShBA-Kryetar i Amerikës).

Freud e njihte ambasadorin amerikan në Francë, William

Bullit, dhe kishte marrëdhënie të mira me të. Ky i ndihmoi Freudin që të dalë në Angli për shkak të pasigurisë së tij në Gjermani; e gjithë kjo ndodhi në vitin 1938, kur ky kaloi në Angli.

Në vitin 1923 Freud e kishte fituar diagnozën e kancerit në gojë dhe për shkak të kësaj i bëri me dhjetëra operacione që në fillim në Austri. Pak pasi që ai erdhi në Angli, dhimbjet e tij u rritën aq shumë sa që ndikuan që ai edhe të kërkonte nga mjeku që t'i jepte një morfinë vdekjeprurëse më 23 shtator të vitit 1939...

Shkrim i botuar: 15.05.2006.

<http://floart.blogspot.com/2006/05/sht-psikologjiapsikoanaliza-dhe-kush.html>

A duhet besuar horoskopit?

Astrologjia është një art i parashikimit. Kaq antik dhe kaq shumë i diskutueshëm. Shkenca e mohon, por shumë njerëz i besojnë. Përse? Pse jemi të ndikuar nga parashikimet e astrologëve? Sa ndodh ajo që parashikohet në të vërtetë? Ajo që bëjmë shpesh të gjithë, është që të shohim nëse na ka shkuar ashtu siç tregonte horoskopi i ditës pararendëse. Dëshmitë e para mbi këtë art i kemi para shumë mijëvjeçarëve më parë, në Mesopotami.

Shekuj të tërë zhvillimesh shkencore nuk kanë ndikuar në zvogëlimin e interesit. Miliona njerëz besojnë akoma në të: disa në mënyrë të verbër, të tjerë nuk e besojnë fare. Ndër këta nuk mungojnë as personalitetet e famshme, si Ronald Regan. Ish-presidenti amerikan, kur ishte në Shtëpinë e Bardhë, nuk bënte asnjë takim pa u këshilluar me astrologun e tij të besuar; ashtu siç bënin një herë e një kohë mbretërit dhe perandorët që, para se të merrnin një vendim, duhej të dëgjonin se çfarë thoshin yjet për atë veprim. Gjëja më e çuditshme është se edhe sot shumë ndërmarrje ua besojnë astrologëve përzgjedhjen e kandidatëve të tyre. Disa vjet më parë, për shembull, një i ri italian, i sapodiplomuar, denoncoi një ndërmarrje në Torino pse e kishin pushuar nga puna, pasi kishin marrë vesh për shenjën e tij të zodiakut. Përse kaq shumë interes për parashikimin dhe profilin personal sipas shenjës së caktuar, kur dimë se shkenca e kundërshton këtë të fundit? Pse besojnë ata që e lexojnë? Përgjigjja mund të jetë se, shpeshherë duam që të tjerët të na përcaktojnë personalitetin tonë dhe atë të të tjerëve në mënyrë që të perceptojmë realitetin. Fillimisht pak histori.

Babilonasit ishin të parët që besonin se kishte një lidhje

ndërmjet qiellit të pafund dhe tokës. Dëshmia e parë e kësaj hipoteze është libri “Enuma Anu Enlil”, ku gjenden tentativat e para të interpretimit të ngjarjeve të jashtëzakonshme, të ndara në katër kategori të mëdha, secila e lidhur me një hyjni. Në kohët e lashta, universi ishte një mister absolut dhe çdo shfaqje si: kometa ose eklipsi, ishin përcaktuar si dëshmi të një vullneti superior, shenja të ndodhive pozitive ose negative.

Profecia bëhet një çështje personale. Me kalimin e kohës, astrologjia përhapet edhe në Mesdhe. Grekët ishin të parët që filluan të parashikonin, jo vetëm ngjarjet që do të ndodhnin, por edhe fatin e çdo individit, në bazë të pozicionimit të planetëve. Edhe pse ka kaluar shumë kohë që atëherë, edhe sot vazhdon që pozicionimi i yjeve të ndikojë në jetën e secilit prej nesh. Për psikologët që studiojnë fenomenin, mundësia e “njohjes” së një njeriu në saje të karakteristikave të atribuara nga shenja zodiakale, është e sigurt. Me fjalë të tjera, përse duhet të rrimë, të lodhemi duke analizuar dikë, kur na mjafton një profil i thjeshtë zodiakal për të kuptuar se kush është personi që kemi përballë? Besimi i verbër që vjen nga horoskopi dhe nga planetët e qiellit, është shpjeguar nga psikologët si një nevojë për të përcaktuar personalitetin vetjak dhe atë të të tjerëve. Disa herë na duket sikur horoskopi gjen gjithçka që përshkruhet dhe del e vërtetë. Psikologët për këtë thonë se shpeshherë mendja jonë na “gënjën”. Disa studime kanë dalë me rrjedhjen se në fjalët e një astrologu, ose të horoskopit, kanë tendencën që të besojmë në mënyrë të pandërgjegjshme të gjitha ato që na thuhet, duke bërë që shpeshherë mendja të na rrijë për një kohë të gjatë aty.

Nostradamusi i kohës.

E njëjta gjë ndodh edhe me parashikimet për të ardhmen e njerëzimit: Nëse mendojmë rreth disa astrologëve “të mëdhenj”, nga ata mbahet mend vetëm ajo çka ata kanë parashikuar dhe ka ndodhur, duke harruar gjithë pjesën tjetër, sipas një mekanizmi të përzgjedhimit të kujtimeve. Për shembull, astrologjia Jeanne Dixon, mbahet mend në Shtetet e Bashkuara për parashikimin e saj të saktë: vdekjen e Presidentit John F. Kennedy gjatë man-

datit të tij. Shumë pak janë ata që kujtojnë parashikimet e saj të gabuara, si: parashikimet që njerëzit e parë që do të shkonin në Hënë do të ishin rusët, si dhe kurën përfundimtare, e cila do të shëronte të gjitha llojet e tumoreve, që ishte parashikuar që në vitin 1967, por që nuk ka arritur akoma edhe në ditët tona. Ka dhe një tjetër motiv që disa herë na bën të mendojmë se horoskopi funksionon. Shpeshherë besojmë në mënyrë të pandërgjegjshme. Shpeshherë ndihma psikologjike ndikon në një farë pike në mënyrën tonë të të jetuarit. Është mekanizmi me të cilin psikologu Richard Wiseman shpjegon dhe fatin. Ata që ndihen “të pafat”, të shumtën e herëve mendojnë se të tjerët do të sillen keq me ta; e kundërta ndodh me “fatlumët”. Edhe në astrologji ndodh diçka e përafërt: për të realizuar një parashikim, mjafton që të kesh besim. Nëse një vajzë lexon në horoskop se mashkulli i saj ideal i përket shenjës së ujorit, ka mundësi që kur të takojë një mashkull të pashëm të po kësaj shenje, të mendojë se ky do të jetë ai i duhuri, duke u bërë më joshëse në mënyrë që ta bëjë atë për vete. Ju lexues, çfarë mendoni lidhur me këtë? Jeni si evropianët që konsultohen rregullisht me një ose më tepër horoskopë? Mos harroni se një efekt me të vërtetë “terapeutik” për horoskopin është besimi vetëm kur parashikohen fakte pozitive.

Botuar: 17.09.2006.

<http://flori-press.blogspot.com/2006/09/dubet-ti-besojm-horoskopit.html>

Psikologji erotike

Dyshimet e mëdha për puthjet dhe parapërgatitjet e aktit seksual. Këshillat për “orgazmën e duhur” dhe rregullat për seksin e sigurt. Por edhe historia dhe anatomia që nuk mësohen në shkollë. Përgjigjet për të gjitha pyetjet dhe pasiguritë e adoleshentëve. Dhe të atyre [shumë ndoshta] të prindërve të tyre.

Një kuriozitet: fjala *kondom* rrjedh prej njëfarë doktor Condomi, që me kërkesën e Mbretit Carls II i Anglisë, fabrikoi një prezervativ të prodhuar prej zorrëve të kafshëve, veçanërisht tepër efikas kundër shtatëzanive. Idenë e kishte marrë nga prezervativët që shekuj më parë përdorshin nga romakët.

Një përgjigje për dyshimin e përhershëm: nuk ekziston një masë standarde e penisit, por është e vërtetë që popujt e racës afrikane kanë një madhësi mesatare pothuajse dy centimetra më të madhe se ajo e të bardhëve.

Një këshillë erotike: gjatë një raporti seksual, është mjaft e mundshme që ta rrisësh ndjeshmërinë duke stimuluar njëkohësisht edhe klitorisin.

Tek libri “Loveline” seksit i jepen shumë përgjigje, pa asnjë lloj kufiri dhe asnjë lloj turpi, censure apo autocensure. Në treqind faqet e librit, që pritet të dalë së shpejti në Itali, janë rrëfyer pyetjet më të jashtëzakonshme, ato më të ankthshmet, që shpeshherë duken si qesharake. Dyshimet e adoleshentëve janë të ndara sipas argumenteve. Të gjithave u janë dhënë përgjigje nga seksologët. Dhe që mund të përmbliidhen në disa më kryesoret, të cilat marrin më poshtë përgjigje.

Biseksualiteti

Ka ca momente në jetë ku duket mjaft e vështirë të zgjedhësh në mëngjes një bluzë për të veshur. Kështu është mase e kup-tueshme të kesh raste kur nuk është e lehte te kesh ide të qarta edhe në jetën sentimentale-erotike. Një njeri biseksual nuk duhet të jetë detyrimisht i përfshirë në një maredhenie të dyfishtë: edhe me një burrë edhe me një grua në të njëjtën kohë. Në këtë kuptim, biseksual mund të jetë një njeri që përcaktohet si person që zgjedh njerëzit, dhe jo seksin e partnerit.

Jam një vajze e fejuar dhe seksualisht e kënaqur. Një mike e përbashkët imja dhe e të fejuarit tim, “me vjen rrotull” dhe ai duket mjaft i eksituar nga ideja që unë të kem një histori me një grua. Do të doja të beja dashuri me të në sy të të dashurit tim. Ju ç’më këshilloni?

Kjo do të ishte një sjellje e rrezikshme për ty dhe për lidhjen tënde për aq kohë sa duket se nuk ke tendenca biseksuale. Ky takim për të cilin flet, me tepër sesa dëshirë, duket si një sfidë që ti kërkon t’i bësh të dashurit.

Cybersex

Anketat kanë treguar se nëntë për qind e lundruesve nëpër internet e përdorin këtë mjet për motive seksuale dhe 32 për qind e përdorin për komunikime seksuale. “Chat”-et erotike apo takimet nëpërmjet internetit kapin një numër të madh përdoruesish dhe 77 për qind e këtyre përdoruesve e kanë provuar së paku një herë se ç’është seksi online. Ka njerëz që e përdorin këtë marrëdhënie seksuale në internet [cybersex] si një zëvendësues të lidhjeve në jetën reale, por shumica e frekuentuesve të “chat”-it e bën për t’i dhënë më tepër kuptim “jetës reale”.

A është “cybersex”-i tradhti?

Nëse quhet tradhti edhe ajo që bëhet me anë të mendimit, atëherë edhe seksi virtual duhet të konsiderohet si i tillë. Sondazhet kanë treguar se rreth 57 për qind e njerëzve i konsiderojnë praktikatat e seksit virtual si një tradhti e mirëfilltë, ndërsa një 30

përqindësh mbështet idenë se pjesëmarrja në të tilla praktika është një alternative që e bën me të kënaqshme jetën e përditshme seksuale.

Antifekondimi

Kjo bën bashkë të gjitha metodat dhe sjelljet që lejojnë të kryesh raporte seksuale pa rrezikuar shtatëzani të padëshiruara. Spermicidi i parë i historisë është përshkruar në një papirus: një tampon i leshtë i lagur me mjaltë dhe me lëng akacieje. Grekët dhe romakët e lashtë përdornin fshikëzat dhe zorrët e holla të kafshëve si pengesë për fekondimin. Në vitin 1960, doktor Pincës shpiku të paren pilule kontrceptive.

Kam nevojë urgjente për një përgjigje: nëse me partnerin jemi fërkuar në zonat gjenitale, unë kam qenë e veshur me mbathje dhe ai ka pasur një ejakulacion, a rrezikoj të mbetem shtatzënë?

Përjashtohet çdo lloj rreziku për të mbetur shtatzënë nëse nuk verifikohet se sperma ka hyrë në vagjinë, kështu që fërkimet, me apo të mbathura, nuk sjellin asnjë rrezik për shtatëzani.

Përmasat e penisit

Në të gjitha kohët përmasat e penisit janë lidhur me pjellshmërinë, me pushtetin dhe mbizotërimin. Nuk ekziston ndonjë përmasë minimale apo normale, përderisa vagjina është një organ elastik, i aftë për t'iu përshtatur çdo përmase të penisit. Shpesh, një penis i vogël ndikon në mënyrë negative në anën emocionale, duke krijuar jo vetëm probleme në çift por edhe në raportet sociale dhe ato të punës.

Kam dëgjuar se njerëzit me ngjyre e kanë organin gjental më të madh se të bardhët. Është e vërtetë apo është një legjendë?

Është e vërtetë se popullata mashkullore e racës afrikane nuk e ka lidhjen mbështetëse të penisit, prandaj organi nderet në krahasim me planin abdominal rreth dy centimetra me tepër sesa organi i meshkujve të racës së bardhë.

Ejakulacioni i parakohshëm

Është ajo gjendje në të cilën mashkulli nuk arrin të vendosë kontrollin mbi ejakulacionin. Sipas një emërtimi klasik, një ejakulacion i parakohshëm mund të quhet i rëndë, nëse ndodh përpara penetrimit, apo edhe brenda 15 sekondash apo disa shtytjesh të shpejta. Ka dy lloje kategorish të ejakulacioneve të parakohshme: ato absolute që ndodhin me të gjithë partnerët dhe format që shfaqen vetëm me një partnere te rastësishme.

A është e vërtete që duke ndaluar në mënyrë të pjesshme fluksin e gjakut në tru, duke ushtruar një presion për shembull në fund te grykës, mund të vonohet orgazma?

Nuk është e vërtetë. Ajo që përftohet me një ndalim përkatës të oksigjenit, arrihet madje të shtohet kënaqësia e orgazmës. Kujdes: Zakonet e “mbytyjes” mund të jenë të rrezikshme, madje edhe vdekjeprurëse.

Masturbimi

Vjen nga latinishtja “manu stuprare” që do të thotë “të dhunosh me duar” dhe tregon stimulimin me dorë të organeve gjenitale për të arritur në vetëkënaqësi. Nuk provokon asnjë rrjedhojë negative për ata që e praktikojnë, por kontribuon në pasurimin e jetës erotike. Autoerotizmi nuk konsiderohet si një kënaqësi seksuale në një moment të tërheqjes së trishtuar nga bota, por si një përvojë drejt seksualitetit të mirë. Është tepër e rrezikshme për femrat të fusin në organet gjenitale objekte të huaja, si lapsat apo furçat.

A është e vërtetë që, nëse sportistët masturbojnë përpara një ndeshjeje mund të kenë rezultate negative?

Jo, madje në këtë rast, masturbimi duke qenë një mënyrë e shëndetshme e zbrazjes së tensionit seksual mund të ketë një funksion qetësues dhe të mbushjes me energji. Gjithmonë, nëse përpara një gare apo një ndeshjeje nuk e ekzagjeron.

A është e vërtetë që masturbimi rrit përmasat e penisit?

Jo, praktikat e masturbimit nuk sjellin asnjë modifikim në organet gjenitale.

Petting

Termi rrjedh nga anglishtja “to pet” [të përkëdhelësh, të ledhatosh]. Praktikohet përgjithësisht nga adoleshentët të cilët nuk janë ende të gatshëm për një raport të plotë seksual. Por me termin ‘petting’, nënkuptohen edhe të gjitha veprimet parapërgatitore që bëhen përpara një akti të mirëfilltë seksual. Seksologët kanë krijuar një listë të praktikave të petting-ut: puthja me gjuhë, përkëdhelitë nga mesi e poshtë, nën rroba, përkëdhelitë në gjoks, prekja e organeve gjenitale.

E kam gjuhën shume të shkurtër dhe kjo më krijon probleme gjatë petting-ut. Arrij të puthem, por nëse e nxjerr shumë jashtë gjuhën, më dhemb pjesa e bajameve. A duhet të operohem?

Gjatë një puthjeje nuk është dhe aq e nevojshme që të shfrytëzohet gjuha në gjithë maksimumin e gjatësisë së saj, madje një prekje e lehtë me gjuhë mund të dhurojë puthje më të ëmbla. Duhet të evitoni çdo lloj ndërhyrjeje kirurgjikale.

Seksi oral

Meshkujt dashurojnë imazhin e një gruaje të gatshme vetëm për kënaqësitë e tyre, femrat ose e pëlqejnë që në kontaktet e para ose më pas i druhen për ta praktikuar më pas me kalimin e kohës në fazën e petting-ut. Nuk ka teknika të veçanta, kjo varet mbi të gjitha nga fantazia. Një problem mjaft i përhapur është se shumë meshkuj nuk dinë se si duhet ta bëjnë edhe ata seksin oral. Frika kryesore qëndron në faktin se lëngjet vagjinale janë të pakënaqshme në shije apo në nuhatje.

Për të bërë seks oral me një vajze, a është e nevojshme që ajo të shtrihet për të ndjerë më tepër kënaqësi apo mund të qëndrojë edhe në këmbë?

Është e mundshme të behet edhe duke qëndruar në këmbë, por përsa i takon intensitetit të kënaqësisë, ky është një faktor personal.

Zonat erogjene

Janë ato pjese të trupit të cilat janë veçanërisht të ndjeshme ndaj stimulimeve seksuale. Për meshkujt: zona erogjene kryesore është penisi, por tepër erogjene është edhe goja, gjuha dhe gishtat e këmbëve. Për femrat: këmbët, vithet, sqetullat, qafa, buzët, zona e veshëve, thithkat dhe pika G.

E dashura ime më ledhaton thithkat dhe unë ndiej një eksitim të madh, por a nuk është kjo një zonë erogjene femërore?

Thithkat kanë një rendësi të veçantë në fazën përgatitore të aktivitetit mashkullor dhe nuk ka asgjë femërore në këtë ndjeshmëri të veçantë.

Shkrim i botuar :30.07.2006.

<http://floart.blogspot.com/2006/07/flori-bruqipsikologji-erotike.html>

Çka janë sëmundjet ngjitëse seksuale?

Sëmundjet ngjitëse seksuale janë sëmundje që ngjiten nga kontakti trupor gjatë marrëdhënieve seksuale. Këto shkaktohen nga viruset, bakteret dhe parazitët. Këto po ashtu njihen si infektive ngjitëse seksuale apo me emrin e vjetër *sëmundje veneriane*. Ekzistojnë 25 lloje të sëmundjeve ngjitëse seksuale. Këto të gjitha kanë të përbashkët atë që të gjitha ngjiten nga marrëdhëniet seksuale, duke përfshirë seksin vaginal, anal dhe oral. Sëmundjet e përmendura në këtë fletushkë nuk janë të gjitha sëmundjet ngjitëse që ekzistojnë, mirëpo thjesht ato më të zakonshmet. Ne po ashtu kemi informata për HIV.

Si mund të dini që keni sëmundje ngjitëse seksuale?

Çdonjëri që është seksualisht aktiv mund të jetë në rrezik prej sëmundjeve ngjitëse seksuale. Disa prej sëmundjeve mund të kenë simptoma si shkarkesë nga organet gjenitale, dhembje kur urinojnë, ënjtje dhe inflamacion në organe gjenitale. Shumë sëmundje ngjitëse seksuale, si *klamidia*, nuk shfaqin simptoma. Për këtë shkak rekomandohet të bëni kontrollim për shëndet seksual, t'i bëni analizat për sëmundje ngjitëse seksuale, nëse mendoni se jeni në rrezik. Ndonjëherë mund të kalojë kohë e gjatë deri me shfaqjen e simptomave, kështu që ju mund infektoni dikë gjatë kësaj kohe, prandaj është e nevojshme t'i bëni analizat dhe të merrni tretman mjekësor. Nëse jeni në marrëdhënie me partner dhe është vërtetuar se keni sëmundje ngjitëse, kjo nuk do të thotë se ai/ajo ka pasur marrëdhënie seksuale me

dikë tjetër. Simptomat e sëmundjeve ngjitëse seksuale mund të shfaqen me muaj pas infektimit.

Si mund ti parandaloni sëmundjet ngjitëse seksuale?

Ju mund të evitoni rrezikun nga sëmundjet ngjitëse seksuale, nëse gjatë marrëdhënieve seksuale përdorni kondom, si dhe ju dhe partneri juaj t'i bëni analizat. Sa më shumë partnerë që keni, aq më shumë rrezik keni të infektoheni me sëmundje ngjitëse seksuale. Mënyrat e tjera që mund ta zvogëloni rrezikun janë përdorimi mbrojtës për gojë dhe kondom gjatë seksit oral, t'i pastroni lodrat seksuale pas përdorimit, t'i pastroni duart pas seksit dhe të pastroni organet gjenitale rregullisht.

Pse është me rëndësi të dini se ju keni sëmundje ngjitëse seksuale?

Shumë prej sëmundjeve ngjitëse seksuale janë ngjitëse dhe mund të shkaktojnë dëmtime për një kohë të gjatë apo përherë, por edhe mund të shkaktojnë dëme në pjellshmëri nëse infektimi nuk trajtohet. Shumë prej sëmundjeve ngjitëse seksuale mund të infektojnë partnerin tuaj gjatë seksit dhe disa nga sëmundjet mund të barten nga nëna në foshnjën e palindur. Sëmundjet ngjitëse seksuale mund të ndihmojnë bartjen e HIV.

Doracak për sëmundjet ngjitëse seksuale

Vagjinosis bakterial nuk është saktësisht sëmundje ngjitëse seksuale, sepse nuk ngjitet gjatë marrëdhënieve seksuale. Megjithatë, mund të keqësohet nga seksi dhe më shpesh shfaqet te femrat, të cilat janë aktive seksualisht se tek ato që nuk kanë pasur marrëdhënie seksuale asnjëherë. Shkaktohet nga çrregullimi i baktereve normale të shëndosha që gjenden në vagjinë. Edhe pse janë relativisht të padëmshme dhe kalojnë pa u dalluar ndonjëherë mund të shkaktojnë erë të keqe. Përderisa nuk ka shpjegim të qartë pse ky infektim ndodh, sugjerohet se përmbajtja e spermës që është alkaline mund të jetë njëri nga shkaqet, sepse mund të shkaktojë ngacmim me bakteret e

vagjinës natyrale të cilat janë acidike. Përdorja e spirales mund të jetë shkaktare gjithashtu. Femra nuk mund të infektjë mashkullin me këtë infektim, mirëpo është me rëndësi që infektimi të trajtohet, sepse ndonjëherë infektimi *vaginosis bacterial* kalon në tubat fallopiane dhe mund të shkaktojë infektim më serioz. Infektimi *vaginosis bacterial* shërohet me krem për vagjinë apo antibiotik.

Balanitis shpesh referohet si simptoma e infektimit, por nuk do të thotë se është infeksion vetvetiu. Saktësisht nuk është sëmundje ngjitëse seksuale, është pasojë e aktivitetit seksual. Ndodh vetëm te meshkujt dhe paraqitet si pezmatim në krye të penisit dhe ndodh më shpesh te meshkujt që nuk janë të bërë synet. Po ashtu mund të shkaktohet nga mos-higjiena, nga ngacmimi i kondomëve dhe pastave, nga përdorimi i tualetet me parfum dhe nga infeksionet mukotike. Mund të parandalohet duke mos përdorur disa nga tualetet dhe duke e pastruar lafshën e penisit. Mund të shërohet me krem për ta reduktuar inflamacionin, si dhe me antibiotikë, nëse është e nevojshme.

Klamidia është njëra nga infeksionet bakteriale ngjitëse seksuale më të zakonshme. Nëse nuk shërohet, mund të shkaktojë probleme serioze. Klamidia e infekton qafën e mitrës te femra. Por, infektimi i uretresë, rektumit dhe syve mund të shkaktohet te femrat dhe te meshkujt. Simptomat e infeksionit mund të shfaqen në çdo kohë. Shpesh ndodh që simptomat të shfaqen 1 deri në 3 javë pas infektimit. Por, simptomat mund të ndodhë që të mos shfaqen për një kohë të gjatë. Mësoni më shumë për **klamidia**.

Morrat pubikë janë parazitë të vegjël në formë të gaforres që jetojnë në qime dhe pinë gjakun. Kryesisht ata jetojnë në qimet pubike, mund të jetojnë në flokë, por mund të gjinden edhe në nënsqetulla, në trup, edhe në qimet e fytyrës, si vetullat. Ata mund të jetojnë edhe jashtë trupit, kështu që mund të gjinden në rroba, në shtrat dhe peshqir. Ju mund të kenë morra dhe të mos jeni i vetëdijshëm për këtë, por pasë 2 ose 3 javësh ju mund të përjetoni kruarje. Morrat zakonisht kalojnë në trup

nga kontakti gjatë seksit me personin që është i infektuar, por edhe nëse i ndani rrobat me dikë, peshqirët apo shtratin. Ende nuk ka mënyrë efektive për ta ndaluar infektimin, por nëse jeni të infektuar, atëherë ju mund të parandaloni të tjerët të infektohen, duke larë rrobat dhe çarçafët e shtratit me ujë të nxehtë. Kremërat e ndryshëm mund të blihen në barnatore për t'i mbytur morrat. Rruarja e qimeve pubike nuk do të thotë që i largon morrat.

Epididmitisi do të thotë inflamacion i epididmitisit, tuba që gjendet në krye të testiseve ku sperma qëndron. Epididmitisi nuk është gjithmonë rezultat i sëmundjeve ngjitëse seksuale, por zakonisht shkaktohet nga prezenca e infektiveve si klamidia apo gonorea. Simptomat e infektimit janë ënjtja dhe dhimbje në testise dhe qeset e tyre. Mënyra më e mirë për të parandaluar infektimin është, duke përdorur kondom gjatë seksit, sepse kondomi e parandalon infektimin e klamidias dhe gonoreas. Epididmitisi vetvetiu nuk mund t'u ngjitet personave të tjerë, mirëpo infeksionet e tjera që kanë shkaktuar epididmitis mund të ngjiten (Shikojeni pjesën për infektimet klamidia dhe gonorea) Tretmani për këtë infeksion bëhet me antibiotik.

Herpesi gjenital shkaktohet nga virusi herpes simpleks. Virusit mund të infektojë gojën, pjesët gjenitale, lëkurën përreth anusit dhe gishtat. Pas fazës së parë të përhapjes së herpesit, virusi vendoset në fijeza nervore ku qëndron pa u dalluar dhe nuk shkakton asnjë simptomë. Simptomat e infektimit fillestar zakonisht ia fillojnë prej ditës 1 deri në 26 pas infektimit dhe zgjasin 2-3 javë. Femrat dhe meshkujt mund të kenë një apo më shumë simptoma që përfshijnë kruarjen apo ndjesi shpimi gjilpërash në pjesët gjenitale apo pjesët anale. Flluska të mbushura me lëng mund të pëlcastin dhe lënë lëndime të vogla që shkaktojnë shumë dhimbje. Personat me infektim mund të kenë po ashtu dhimbje gjatë urinimit, nëse urina kalon në pjesët e lëndimit nga flluskat. Por, edhe simptoma sikurse kur personat vuajnë nga gripi si dhimbje koke, temperaturë, dhimbje të shpinës, gjëndra të ënjtura. Mësoni më shumë për **herpesin gjenital**.

Lythat gjenitale janë rritje të mishit, të cilat mund të paraqiten çdokund në organet gjenitale të femrave dhe meshkujve. Ato shkaktohen nga virusi që quhet virus njerëzor papilloma. Lythat mund të rriten në organet gjenitale apo në pjesët e tjera të trupit posaçërisht në duar. Pas infektimit me lythat gjenitale, kalojnë 1 deri 3 muaj që lythat të paraqiten në organet gjenitale. Ju apo partneri juaj mund të dalloni gunga të vogla të bardha apo ngjyrë roze apo më të mëdha në formë të karfjolit. Lythat mund të paraqiten në vulvë, penis, në testise apo në anus. Ato mund të paraqiten në formë individuale apo në grup. Mund të shkaktojnë kruarje, por zakonisht nuk shkaktojnë dhimbje. Shpesh nuk shkaktojnë simptoma të tjera dhe mund të jetë e vështirë të dallohen. Nëse femrat kanë lytha në qafë të mitrës, kjo mund të shkaktojë gjakderdhje apo shumë rrallë shkarkesë nga vagjina me ngjyrë të pazakonshme. Mësoni më shumë për **lythat gjenitale**.

Gonorea është infeksion bakterial. Ngjitet seksualisht dhe mund ta infektojë qafën e mitrës, uretrenë, rektumin, anusin dhe fytn. Simptomat e infektimit mund të shfaqen në mes 1 deri 4 ditë pasë ekspozimit. Por, ndonjëherë është e mundshme të infektoheni dhe mos të kenë simptome. Infektimi është më e mundshme të dallohet në meshkuj se në femra. Mësoni më shumë për **gonorean**.

Infektimi i zorrës mund të ngjitet gjatë seksit. Dy infeksionet më të zakonshme janë amebiasisi dhe gjiardiasis. Këto janë infeksione bakteriale dhe kur të kalojnë në zorrë mund të shkaktojnë dhimbje në bark dhe jashtëqitje të shpeshta. Infektimi i zorrës mund të ngjitet gjatë seksit me dikë që është i infektuar posaçërisht gjatë aktiviteteve që përfshijnë kontaktin me feçe dhe seksi anal. Infeksioni mund të parandalohet duke përdorur kondom, mbrojtës për gojë dhe dorëza lateks. Lodrat që përdoren gjatë seksit duhet të pastrohen pas përdorimit dhe duart të lahen pasë kontaktit me feçe. Ilaçet kundër jashtëqitjes ndonjëherë mjaftojnë për tretman të infektimit, por edhe antibiotikët mund të përdoren.

Hepatiti shkakton inflamacionin e mëlçisë. Ka disa lloje të hepatitit, më të zakonshmet janë hepatiti A, B dhe C. Këto tri lloje të virusit veprojnë ndryshe. Hepatiti mund të shkaktohet nga alkooli dhe nga disa lloje të drogës, por zakonisht infektimi ndodh nga infektimi viral. Mësoni më shumë për **Hepatitin**.

Molloskumi është sëmundje e lëkurës që shkaktohet nga virusi molloskum contagiosum. Shfaqet në formë të gungave të vogla në lëkurë dhe mund të zgjat prej dy javëve deri në disa vjet. Molloskumi shkakton gunga të vogla në formë të perlave në madhësi të qukave në kofshë, prapanicë, organe gjenitale dhe ndonjëherë në fytyrë. Ato ngjiten gjatë seksit dhe nga kontakti me lëkurë. Ngjitja mund të parandalohet duke përdorur kondom dhe duke iu shmangur kontaktit me lëkurë dhe seksit me personin që është i infektuar përderisa shërohet. Në shumë raste ky lloj infektimi nuk ka nevojë për ilaçe, sepse zhduket me kohë. Megjithatë, praktikohen tretmanet si ngrirja e gungave apo lyerja me një lloj kemikale.

Uretirisi i paspecifikuar është inflamacioni i uretresë në meshkuj. Ky inflamacion mund të shkaktohet nga disa lloje të infeksioneve, por zakonisht nga klamidia. Inflamacioni mund të përjetohet me muaj edhe në disa raste me vite në marrëdhënie. Simptomat përfshijnë dhimbje dhe ndjenja të djegies gjatë urinimit. Lloj lëngu i bardhë i vrenjtur mund të shfaqet në krye të penisit, posaçërisht dallohet në mëngjes. Ndjenja për të urinuar shpesh po ashtu është njëra nga simptomat. Shpesh mund të jetë që nuk keni asnjë simptomë, por kjo nuk do të thotë që nuk mund të infektoni partnerin tuaj. Mësoni më shumë për **Uretrisin të paspecifikuar**.

Zgjeba shkaktohet nga morrat parazitë nën lëkurë dhe shkakton kruarje. Morrat janë shumë të vegjël dhe nuk mund të shihen dhe shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm që janë të infektuar. Infektimi mund të shkaktojë kruarje dhe mund të fillojë 2 deri në 6 javë pas infektimit. Shenjat e infektimit mund të jenë si vija të kuqe nën lëkurë të duarve, prapanicës dhe organeve gjenitale. Mënyra më e zakonshme e infektimit është gjatë

kontaktit seksual, mirëpo është e mundshme që infektimi të ndodhë me këmbimin e rrobave dhe të peshqirëve me dikë që është i infektuar. Por kjo mënyrë nuk është shumë e zakonshme. Nuk ka mënyrë efektive ta ndaloni infektimin, por nëse jeni i infektuar, mënyra që mos ta infektoni dikë tjetër është t'i lani rrobat dhe çarçafët me ujë të nxehtë. Për t'i mbytur këta morra është mënyra më e mirë ta lyeni trupin me krem që mund ta blini në barnatore.

Sifilisi nuk është infektim i zakonshëm në Britani të Madhe, por është më shumë i zakonshëm në shtete të tjera. Është infektion bakterial. Zakonisht ngjitet gjatë seksit, por edhe mund të ngjitet te foshnjat e palindura nga nënat shtatzëna. Simptomat e sifilisit janë të njëjta te meshkujt dhe femrat. Janë vështirë të dallohen dhe mund të shfaqen 3 muaj pas seksit me personin e infektuar. Sifilisi i ka disa faza, faza e parë dhe e dytë janë më infektuese. Mësoni më shumë për **sifilisin**.

Infeksioni mukotik është infektion që shumohet, që hetohet në lëkurë dhe normalisht qëndron si baktere jodëmtuese. Por, nëse shumohet, mund të shkaktojë kruarje, ënjte, dhembje dhe shkarkesë te femrat dhe meshkujt. Femrat mund të përjetojnë shkarkesë të bardhë të trashë dhe dhimbje gjatë urinimit. Meshkujt mund të përjetojnë shkarkesë të njëjtë dhe kanë vështirësi në lëshimin e penisit. Infeksioni mukotik mund të ngjitet gjatë seksit me personin e infektuar, por infektimi mund të ndodhë nëse vishni rroba të ngushta nga najloni apo goma. Infektimi mund të ndodhë edhe nga disa lloje të antibiotikëve. Ndonjëherë infektimi është i paqartë, mirëpo ngjitja mund të parandalohet duke përdorur kondom gjatë seksit. Meshkujt duhet të e pas-trojnë vendin nën lëshimin e penisit. Shërimi i infeksionit mukotik bëhet duke zbatuar tretman kundërkërpudhor. Infektimi mukotik mund të përsëritet, posaçërisht te femrat.

Trikomanas vaginalis shkaktohet nga parazitët që gjenden në vagjinë dhe uretrenë e meshkujve. Shpesh nuk ka simptoma. Nëse simptomat janë prezente, ato mund të jenë si dhimbje gjatë urinimit dhe shkarkesë te meshkujt, dhimbje gjatë seksit dhe in-

flamacionit në vulvë të femrave. Ngjitja normalisht ndodh gjatë seksit oral, anal dhe vaginal me personin e infektuar. Shërimi bëhet me antibiotikë dhe infektimi nuk përsëritet.

Informatat në web faqet tona art-café, floart dhe flori-press nuk jepen si zëvendësim për këshilla profesionale mjekësore.

Ju lutem konsultohuni me mjekë nëse keni ndonjë brengë për shëndetin tuaj.

Mr.sc.Flori Bruqi

http://www.frosina.org/forum/forum_posts.asp?TID=34953

http://floart.blogspot.com/2005/12/flori-press_1133897245651_68110.html

Fjala e redaktorit

Zbardhje e çështjes kombëtare

Pas një periudhe të gjatë kohore dhe pas luftës në Kosovë, si një sihariq i rrallë na vjen një vëllim i përmbledhur me shije të hollë dhe me një gamë të gjerë temash e disiplinash me larushi të begatë nga fushat e publicistikës, historisë e historiografisë, diskursionit, shkencës, figurash krijuesish me rëndësi madhore nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore; nga psikologjia, mjekësia, seksologjia; nga fusha e polemikave, artikuj të inteligjencës, të cilët do të frymëzojnë dhe pajisin lexuesin tonë me informacion të kamur, vështirë se do të mund të gjente lehtë një vëllim të vetëm, siç është ky.

Poeti i frymëzimeve të “Zjarrit të Diellit” (1995), me një guxim dhe përpjekje të ngulmët flak dashurinë për poezinë dhe i rreket zbardhjes së çështjes kombëtare në Kosovë nëpërmjet diturish të nduarnduarshme, të spikatura për ndodhjet e situatat aq të ndërlikuara të shekullit të tretur dhe të këtij qindvjeçari, për të shfletuar një sasi njohurish dhe për t’i ofruar njeriut një sofër ushqimesh të sojit të vet.

Është fare vetjake kjo përpjekje. Dhe kaq e devotshme: lexuesi mund të endet nga rrafshi në rrafsh të parapëlqyer sipas shijes që ka, dhe sipas kërkesës.

Temat që janë shtruar kanë aq shumë të dhëna, sa nuk ka ndodhur ndonjëherë gjëkund në një libër të mëparshëm.

Urojmë shëndet e sukses për një disiplinë kaq të pëlqyeshme dhe dobiprurëse për lexuesit tanë.

Nebat S. Hoxha

Fjala e recensuesve

Libri a përmbledhja e studimeve “Guxim shqiptar“ e intelektualit, studiuesit dhe shkencëtarit Flori Bruqi konceptohet si një punim kompleks historiko-letraro-shkencor me vlera, përmasa dhe hapësira shumëdimensionale, të përfshira në tetë kapituj, me 45 tematika, dhe me 382 faqe; me materiale mjaft të zgjedhura dhe me interes, të studiuara dhe të përpunuara me kujdes të veçantë dhe të shkruara me vërtetësi reale, historike dhe kombëtare; në të cilën përmbledhet një gamë e gjerë dhe mjaft e larmishme e shumë fushave të jetës të së kaluarës dhe të së përditshmes, që kërkohen dhe janë të nevojshme të njihen, të mësohen dhe të përvetësohen nga gjithsecili, për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të tyre në punë dhe në veprimtari.

Titulli i librit “Guxim shqiptar” përbën në vetvete një vlerësim special dhe një gjetje shumë të goditur të autorit, shprehur në mënyrë simbolike, që i lejon çdo patrioti shqiptar, me ndjenjë atdhedashurie, të zgjojë dhe të ringjallë tek ai: kombin (etnik) shqiptar, popullin e lashtë pellazgjiko-Ilirro-shqiptar, legendat e kahershme martire edhe të Mujës dhe Halilit, traditat zakonore, besën shqiptare, trimëritë heroike, të koduara në kanune dhe të trashëguara brez pas brezi si të shenjta dhe të paprekshme, duke u bërë simbol i vëllazërimit ballkanik, siç është treguar gjatë historisë shekullore dhe të propoganduar nga të huajt.

Konsiderata më e veçantë e librit duhet të jetë përfundimi që do të nxjerrë lexuesi nga leximi i librit, i cili mendoj dhe kon-

kludoj se do të përmblihet në qëllimin që i ka përkushtuar vetes autori: në kontributin, mbështetjen dhe dashurinë që manifeston ai për Mëmëdheun, duke Ju përkushtuar në gjithçka dhe për çdo gjë, që qartazi shprehet dhe duket gati në çdo artikull që lexohet në libër, ku ndihet dhe konceptohet patriotizmi, ndjenja atdhetare, emri ilir, epirotas, arbëresh, shqiptar, që kudo e ndesh. Shkurt, nënkuptohet boshti ideor atdhetar, i pushtuar me brezin e kuq shqiptar mbarëkombëtar.

Ndërsa, vlera e vetë autorit Flori Bruqi duhet çmuar dhe admiruar me korrektësi dhe me modesti, përpara këtij punimi vëllimor, me tematikë të shumëllojshme, të profileve të ndryshme dhe me materiale të bollshme dhe me vështirësi interpretuese; të cilat janë paraqitur me mjeshtëri, me një mori njohjesh teknike, profesionale dhe artistike, të cilat i kanë dashur autorit kohë, mund, sakrifica dhe mjaft durim për t'i përballuar dhe për të arritur suksesin e merituar. Ato duhet ta gjejnë shpjegimin e vet të vlerësimit në përgatitjen e tij të lart profesionale, në njohjen mjaft të mirë të gjuhës shqipe, të pastërtisë dhe rrjedhshmërisë së saj, si dhe të shumë gjuhëve të huaja, të profesionit të vet; të vullnetit dhe durimit të një intelektualit të aftë, mjaft aktive dhe konsekuent për t'ia arritur qëllimit. Bindje për këtë mund të formosh nëse u referohesh punimeve dhe veprimtarisë letrare, artistike dhe shkencore që ka realizuar dhe kryer autori, në një kohë të shkurtër, ku brenda 11 vjetëve ka shkruar 24 vepra madhore të gjinive të ndryshme si dhe mjaft shkrime shkencore, që e kanë detyruar të bëjë “haram“ edhe gjumin.

Zbërthimi analitik që mund dhe duhet t'i bëhet librit “Guxim shqiptar” është shpërblimi më adekuat, më i pranueshëm dhe më i zakonshëm që kërkon dhe që duhet t'i jepet me të drejtë autorit, siç e meriton, me gjithë vështirësitë objektive dhe subjektive që hasen. Në kapitullin e parë mbi “Lashtësinë e historisë“ autori ka meritë se ka ditur të zgjedhë dhe të na përfaqësojë historinë tone në periudha kohe të ndryshme, duke përfshirë tërë territorin iliro-arbëror me tema të denja, historikisht dinjitoze, me mburrje kombëtare dhe me të kaluar heroike.

Shkrimi “Pirrua i Epirit”, kontribut i z. Sitky Jahjaj, i qëmtuar me vërtetësi nga autori Bruqi, është mjaft i qëlluar në këtë

libër; se na njeh me sundimtarin më të shquar të Epirit, pasardhës i Akilit, i biri i Aiakidit dhe përfaqësues i denjë iliro-epirot dhe strateg i zoti, që diti të fitonte mbretërinë e humbur më 296 p.e.s. dhe që epirotët për trimërinë e tij e thërritnin ‘shqiptonjë’ dhe ushtarët ai i quante ‘bij të shqipes’, duke krijuar më pas traditën shqiptare. Pirrua e rriti autoritetin e tij dhe të epirotasve, pellazgjiko-ilir me aftësi, trimëri dhe zgjuarsi, sa maqedonasit e shëmbëllyen me Aleksandrin e Madh dhe e ftuan për ta udhëhequr. Pirrua ëndërronte perandori në perëndim. Ai i shkoi në ndihmë Tarantos kundër romakëve, që vërtet fitoi, por në histori ka hyrë me shprehjen “ fitore si e Pirros “. Ai, në Sicili, më 278 p.e.s. mundi kartagjenasit; por karriera e tij aq e lavdishme u shemb në muret e Argosit nga goditja e një gruaje.

Artikulli “ Beteja e Kosovës 1389 dhe kontributi i shqiptarëve “është një meritë tjetër e autorit, sepse evidencën rëndësive e betejës së Kosovës si bashkim-unitet i ballkanasve kundër Perandorisë Osmane, si vendi i betejës së Fushë-Kosovës, të pjesëmarrjes së popullsisë masive të krahinës së Kosovës dhe vlerëson Milosh Kopiliqin si trim kosovar, i quajtur edhe princ arbëror, që Car Llazarit, mbreti i Serbisë dhe komandanti i betejës së Kosovës, pranoi të zhvillonte një bisedë “kokë më kokë” me të si një komandant ushtrie, me historinë e një trimi që vrau sulltan Muratin II dhe ra si dëshmor, kurse popullsia kosovare e përjetësoi në këngë dhe e ktheu në legjendë të vërtetën e tij.

Në këtë betejë të koalicionit ballkanik, autori ka meritë se e pësjtjellon ngjarjen me korrektësi. Faktin bashkëpunimin e dhëndurëve të Car Llazarit, Gjergj Ballshajt dhe Vuk Brankoviçit me takimin e tij në 1388 për koalicion, se përmend luftëtarët e shquar shqiptarë, si: Gjergj Ballshaj, Theodor II Muzakaj i Beratit, i cili u vra në betejë, për të cilët flasin edhe kronikat turke; se Beteja e Kosovës u mbështet nga një koalicion i gjerë, ku morën pjesë serbët, Vuk Brankoviç që drejtonte popullatën e Kosovës, shqiptarët dhe boshnjakët, duke iu kundërvënë historiografisë falsifikuese serbe, që mohon forcat e koalicionit, injoron historinë, ul vlerën e pjesëmarrjes së shqiptarëve dhe të boshnjakëve dhe akoma më keq, Milosh Kopiliqin e bëjnë

serb dhe i shtrembërojnë mbiemrin. Këto konfirmohen nga vetë serbët, që u “zgjuan” vonë për ta njohur, besuar dhe për ta propaganduar betejën e Kosovës si mit në favor të tyre, kur etnologu Vuk Karaxhiç u kujtua dhe mblodhi disa rapsodi nga një i verbër rreth betejës së Kosovës, që më pas i besuan dhe ata vetë. Çudia vazhdoi edhe në ditët tona, shpjegon autori, kur Slobodan Millosheviç, për interesat e veta, të forcimit të pushtetit politik dhe moral, mitin e betejës së Kosovës e ktheu në thirrje për unitet, ku gjente edhe shkakun e humbjes së betejës dhe për jehonë organizoi 600-vjetorin e saj me pretekst për të rindërtuar apo dëbuar shqiptarët dhe për të luftuar kundër pavarësisë së Kosovës me terma të irredentizmit islamik, të terrorizmit, apo krimit të organizuar, të fabrikuar po nga ata vetë.

Mbrojta e Plavës dhe e Gucisë e viteve 1879-1880 është një dukuri tjetër e autorit, që dëshmon për atdhetarizëm, duke dokumentuar heroizmin dhe patriotizmin e pashoq të krahinës së Plavës dhe të Gucisë, të heroit të krahinës, Ali Pash Gucisë me shokë, të Kosovës, të Lidhjes së Prizërenit, të gjithë Shqipërisë, në mbrojtje të së drejtës dhe të tokave shqiptare, me vendosmëri, me luftë të pandërprerë, me gjakderdhje të pashoqe dhe me diplomaci kundër malazezëve, që sulmuan dy here në mënyrë të organizuar dhe me egërsi për të pushtuar Plavën dhe Gucinë në dhjetor 1879 dhe në janar 1880, por u sprapsën me trimëri, me guxim nga forcat e organizuara shqiptare, edhe pse u përdor dredhia dhe përkrahja e Fuqive të Mëdha. Evropa e kuptoj më në fund se vendi atje ka zot shqiptarët. Dëshmitë dhe faktet angleze mbi konfliktin shqiptaro-malazez rreth Plavës dhe Gucisë të viteve 1879-1880 të përmbledhura në librin e studiuesit Idris Lamaj botuar në Nju-Jork në 1999; konfirmojnë pa ekuivokë shkrimin e autorit Bruqi.

Në vazhdim përmendim artikullin” Skënderbeu dhe rëndësia e infrastrukturës logjistike për të udhëhequr luftën “që autori me të drejtë e paraqet si një aspekt të rëndësishëm dhe tepër të veçantë të epokës luftarake të Gjergj Kastriotit, që historiografia dhe Sesionit Shkencor i Akademisë tonë, kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut e kishin mënjeluar atë,

duke e kthyer në legjendë strategjinë dhe betejat e tij luftarake, të cilat mbeten si të fundit .Ky shkrim shfaq interes dhe ka vlerë se për herë të parë evidentohet një koncept i ri, një ekspozim i një faze përgatitore dhe një moment vendimtar që duhet t'i jepet rëndësi në arritjen e suksesit të fitores së betejave, të vlerësuara me të drejtë edhe nga vetë Skënderbeu, që del më se qartas në artikull. Sekreti i Gjergj Kastrioti –Skënderbeut, që i rezistoi Perandorisë Osman dhe fitoi, i dedikohet jo vetëm se ishte vërtet i zoti si strateg, por më tepër se ai iu kushtua dhe kuptoi rëndësinë e infrastrukturës logjistike për të udhëhequr luftën, duke u mbështetur nga suita e tij jofisnike, përbërë nga klerikë, e nga grupi i tij laik, që kryenin punën e diplomacisë, të legatave në qytetet e Italisë, të tregtisë, të lidhjes e bashkëpunimit me shtetet fqinje të Evropës Juglindore dhe Perëndimore nga ku siguronte paranë, armatimet, pagesën e mirë të ushtarëve, bazën financiare dhe organizimin. Në këtë shkrim del se si strategji të tij, Skënderbeu kishte Rodonin si kështjellën kryesore dhe se Lezha për të ishte udhë-lidhëse midis detit dhe malësisë

Shkrim tjetër kurioz, origjinal dhe me interes mbetet “Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët”, ku autori jep informacione, njoftime historiko-premtuese mbi origjinën autentike edhe të mbiemrit të Napoleonit, perandorit të Francës .Studimet e autorit hapin fushë veprimi, sjellin burime të besueshme, mendime dhe citime optimiste të mjaft autorëve autoritarë të huaj, që na konfirmojnë bindjen dhe konsideratën që kanë të huajt të pranojnë se heronjtë tyre kanë origjinë shqiptare dhe që meritojnë përgëzime. Shkrimi sjell citimin e R. Anzhelit, që i kujtonte botës se Napoleoni është po aq shqiptar sa edhe Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu, ku folklori popullor e ka rrënjësuar në këngë: *Ti shqipe ishe e Aleksandrit , zaptove botën dhe vajte deri në Indi. Me Pirron vajte kundra romakëve me Skënderbeun pëmbi osmanllinj.* Na kujton dëshminë e Xhozefinës për preardhjen nga Mali i Peloponezit të Napoleonit, thënien e vëllait të Napoleonit se kemi orgjinë arbëreshe, afrimi i Napoleonit me Ali pashë Tepelenën, dënimi nga ana e Napoleonit e gjeneralit të tij, që i theu në besë shqiptarët, si dhe supozimet se a dinte

shqip Napoleoni, a i njihte zakonet shqiptare, na mbushin me krenari të ligjshme se trualli iliro-shqiptar ka rritur brezni trimash dhe burra të mëdhenj shteti, duke sjellë plot shembuj edhe nga historia.

Kapitulli i Dytë: Për Ramushin

I. “Dora e Zezë e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës” (Intervistë me Z. Adem Demaçi).

Intervista me z. A. Demaçin duket mjaft serioze, e bërë në kohë të përshtatshme, me përmbajtje shumë dinjitoze dhe përbën një thirrje për drejtësi, për patriotizëm dhe dinjitet njerëzor.

Përgjigjet janë parimore, mendimet janë të çiltra, realiste, burrërore, objektive dhe pa dorashka.

II. “Hero në luftë, hero në paqe - Ramush Haradinaj”

Titullin e shkrimit e konsideroj mjaft të përshtatshëm, emrin shumë të merituar, ndërsa përshkrimi mendoj se duhet të ishte më heroik, siç është, siç njihet dhe siç kërkohet të dihet për situatën dhe jo thjesht biografik. Akademia jonë në vitin 2005 ka reaguar me një letër ndaj Gjykatës Ndërkombëtare në Hagë në mbrojtje të Ramush Haradinajt me këtë tekst: Krimineli dhe viktima nuk mund të ulen në një bankë gjykimi.

III. Ramushi - viktim e situatës (neo) koloniale

Shkrimi mendoj se është një portretizim i denjë i figurës së Ramushit, ku përshkruhen kontributi dhe meritat e tij të padiskutueshme, puna dhe veprimtaria e tij prej një aktivisti, luftëtari dhe udhëheqësi trim dhe patriot. Atë e karakterizon burrëria e pashoq, guximi, zgjuarsia dhe drejtësia, për të përballuar padrejtësitë dhe akuzat e sajara. Sugjeroj që figurës së Ramush Haradinut t’i jepet një vend më i merituar, më patriotik dhe më dinjitoz siç e meriton dhe e do situata.

Kapitulli i tretë: *Antropologjia* . “Jakov Milaj dhe raca

shqiptare”. Shkrimi është një kontribut i spikatur i autorit, që çmon librin “Raca Shqiptare” si një vepër dinjitoze, që nxjerr në pah për herë të parë dhe në mënyrë më të plotë, veçoritë antropologjike të shqiptarëve, duke i vlerësuar jo vetëm si një komb i kulturuar, por e përcakton me një prejardhje gjenetike *sui generis*, duke e veçuar si një racë që vërteton origjinën dhe identitetin shqiptar. Ai na e kujton racën shqiptare, për ta besuar vetveten shqiptari, për ta njohur atë, se populli i Arbrit ka një origjinë të vetme, të përbashkët dhe autentike, në të gjithë vendin ku banon, pa pasur ndryshime esenciale ndaj përkatësisë fetare, krahinore, toskë apo gegë; por ka nevojë për një politikë shoqërore, që të mbrojë figurën fizike të racës shqiptare. Autori argumenton qartë dhe me fakte bindëse se vepra e Jakovit zë një vend të merituar në literaturën antropologjike shqiptare, se evidenton dukshëm cilësitë fizike, pasqyron filozofinë, shkencën dhe terminologjinë e kohës së vet dhe merr shumë informacione të vjera, ku njihet me tipat fizikë në evolucionin e tyre, që e përcaktojnë shqiptarinë si race të veçantë. Flori Bruçi u kundërvihet me të drejtë, me argumente dhe fakte bindëse disa “studuesve modernë”, që duan t’i errësojnë vlerat e punimit shkencor të Jakov Milajt.

Kapitulli i Katërt. Politika

Arvanitasit, Çamëria, Epiri i Veriut dhe gjendja sot

Shkrimi evidenton me mjeshtëri, me hollësira, me dokumente dhe me fakte historike: *1. Djallëzitetë e qarqeve greke ndaj popullit arvanitas, që i dha pavarësinë popullit grek, ku mbi 90 % e tyre me heronjtë legjendarë, si: Xhavellon, Boçarin, Bubulina etj.; u bënë therorë në luftë. 2. Gjenocidin e egër të shovinistëve grekë me Venizellon në krye ndaj popullit çam autokton, parabelenik në token e tyre, të cilët i shfarosën, i dëbuan mbi 30 mijë çamë dhe i persekutuan, duke a u marrë tokat dhe gjithë pasurinë në sy të Fuqive të Mëdha. 3. Agresivitetin dhe armiqësinë ndaj fqinjët të tyre Shqipërisë për pretendimet absurde dhe të padrejta për Vorio-Epirin, duke bërë vrasje, tortura, djegie dhe dëbime masive me dijeni të Evropës. 4. Padrejtësitë ndaj Shqipërisë, duke e copëtuar më dysb në 1913 si dhe pabesinë ndaj popujve fqinjë dhe dinakërinë që kanë treguar ndaj Fuqive*

të Mëdha. Autori përmend me argumente qëndrimin agresiv të qarqeve greke, që mbajtën gjatë periudhës së demokracisë, ku dogjën shkolla, fshatra dhe bënë tortura dhe masakra që të kujtojnë periudhën e kaluar. Dëshmi e qartë e dinakërisë dhe djallëzisë së tyre, që nuk njih kufi, është dhe ardhja e Janullatosit si kryefetar i ortodoksëve shqiptar, për të sjellë ngatërresa ndërjetare. Artikulli mbetet si një akt mbështetës, nxitës dhe si një dokument me rëndësi për popullin çam për të kërkuar të drejtat e tyre legjitime, nëpërmjet të gjitha formave deri në Starzburg, me anën e organizatës së tyre politike.

A ka intifadë shqiptare në Iliridë? Artikulli është i parapëlqyer se nxjerr në dukje dhe merr më shumë në konsideratë përpjekjet e shqiptarëve të Iliridës, për të fituar dhe konfirmuar me ligje dhe me kushtetutë të drejtat e mbi 40 % të shqiptarëve në shtetin maqedon. Ai mbështet miratimin e të drejtave të njeriut, gjuhën amtare, flamurin kombëtar, njohjen e identitetit dhe të zakoneve të popullit shqiptar, të padiskutueshëm për një komb.

Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë. Shkrimi nxjerr në dritë një të vërtetë aktuale, që duhet të bëhet shembull i një veprimtarie të guximshme vetëmohuese dhe burrërore në mbrojtje të të drejtave të popullit të tij të shumëvuajtur dhe nxit rininë për t'u bërë flamurtare në interes të atdheut.

Nder, respekt dhe krenari është përcaktimi i Albin Kurtit, që mbetet një shembull frymëzimi për të gjithë rininë kosovare.

Mirupafshim në Kosovën e lirë. Përbën një përgjigje mjaft sfiduese, shumë kuptimplote dhe tepër korrekte për kërkesën absurde dhe të papërgjegjshme, që bën një pretendues që mban edhe petkun e zi të një kleriku, kur me dashje harron arkivat e Raguzës, të Gazulit, Buzukut etj.

A do të ketë një Nuremberg Shqiptar për komunistët dhe krimet e tyre? E vlerësuar si një deklaratë që bënë jehonë dhe formulon një thirrje për drejtësi, ajo duhet të konsiderohet si nxitëse për të gjetur zgjidhje sa më objektive dhe në një kohë sa më të përshtatshme.

Kapitulli i pestë. *Spiunazhi*

Agjntura greke dhe Sigurimi i fshehtë i Shtetit Shqiptar. Autori me të drejtë na njeh në libër me këtë material faktik, për të na vënë në dijeni më mirë edhe më tepër për ndërhyrjet, pabesitë, agresionin dhe spiunazhin grek ndaj Shqipërisë, popullit dhe kufijve të tij, të nisur prej kohësh qysh gjatë periudhës së Luftës Nacional-Çlirimtare. Aty evidentohen me fakte, dëshmi dhe me deklarata nga spiuni grek, të deponuar para seancave gjyqësore të gjykatës shqiptare, për grupet e spiunazhit, të rrjeteve organizuese dhe të çetave veri-epirote, që kryenin masakra, tortura dhe shkatërrime në dëm të popullit dhe të shtetit shqiptar.

Kush janë agjentët me influence në Kosovë? Në shkrim njihemi me fakte dhe dokumente mjaft interesante të sigurimit të fshehtë, që kanë shërbyer si forcë lëvizëse në situata kritike, duke lozur rol vendimtar edhe më të fuqishëm se forca ushtarake apo diplomacia për të arritur fitoren. Për ta bërë më bindëse forcën e sigurimit, sillen fakte nga historia e sh. III p.e.s. të Sun Xus, që thoshte se spiuni është i domosdoshëm. Kujtohet mashtrimi i kalit të Trojës, apo aftësitë e spiunazhit rus të Zorkit në Japoni, ose lufta e spiunazhit midis KGB dhe CIA, që përmbysi pushtetin sovjetik si dhe së fundi terrorizmi i 11 shtatorit 2001, që kanë dëshmuar për forcën kolosale të sigurimit dhe të organizimit të fshehtë në arritjen e fitores. Në këtë aspekt, thuhet në shkrim, duhet parë agjntura e spiunazhit të fshehtë serb në Kosovë, që ka punuar dhe punon nga të gjithë krahët, duke rekrutuar kosovarë të gënjyer në bashkëpunim me mendjen e djallëzuar për të krijuar frontin e spiunazhit që e ka tronditur Kosovën. Agjentët më të rrezikshëm në Kosovë mbeten spiunazhi - sigurimi i fshehtë dhe organizmat klandestinë, që kanë vepruar në mënyra të fuqishme, të padukshme e mashtruese dhe të paraqitura si mjete më të fuqishme se çdo armë vepruese, që arrin të parashikojë dhe të paralajmërojë fitoren.

Kapitulli i gjashtë. *Gjuhë, letërsi*

Origjina e gjuhës shqipe. Artikulli vlerësohet si një përshkrim, prezantim dhe studim i thellë dhe i përpunuar i historisë dhe

shkencës së origjinës së gjuhës shqipe, e përcaktuar siç është e vetme në familjen paraindoevropiane, duke u përballuar me dy teza : të ilirishtes më të besueshme dhe të trakishtes; të denja dhe të dokumentuara nga albanologët e huaj dhe vendës. Gjuha shqipe autoktone në Ballkan, e pellazgëve me “figurë hënore“, që autori e nxjerr të shkruar nga viti 1462, por që dokumentet e fundit e sjellin edhe më herët rreth 1200, të zbuluar në Vatikan.; kurse logjika natyrisht të çon akoma më herët.

Ndjen kënaqësi dhe krenari kombëtare, kur njihesh me fakte historike nga të huajt, nga klerikët shqiptar dhe nga albanologët tanë mbi gjuhën shqipe të shkruar, mbi alfabetet e krijuara, të përpunuar në kongreset gjuhësore, të ngritur në gjuhë standarde, të njohur me veçoritë e gjuhës sonë, të elaboruar nga korifenjtë: K. Kristoforidhi, E. Çabej, A. Buda, M. Domi, I .Ajeti dhe nga arbëreshët me në krye J. De Rada dhe që kjo gjuhë e Naimit po flitet sot nga 15 milionë shqiptarë në botë dhe nga 7 milionë vendës në Ballkan, si dhe nga albanologë në shumë shtete, dhe po mësohet në shumë universitete të botës dhe ku gjen libra shqip në vendet më të zhvilluara të rruzullit tokësor. Rëndësia e këtij artikulli qëndron në faktin se aty gjendet gjithçka që duhet, e shkruar me kujdes, me vërtetësi, me hollësi dhe në baza shkencore.

Censura dhe shterpësia letrare. E konsideroj një diskutim filozofik me objektivitet real, gjetjen dhe shqyrtimin e vërtetësisë letrare atje ku nuk ka krijimtari të lire, të vërtetë, por të censuruar. Atje ku shkrimtari bëhet i vetëdijshëm se ai sheh, ndjen dhe mendon, por nuk mund t’i thotë, se të tjera është i shtrënguar të shpreh, edhe pse vetë nuk i beson. Kështu, ca heshtin, të tjerë mundohen të bëhen përkthyes dhe ndokush i fut shkrimet në sirtar, se kështu i duket më drejt për t’i ruajtur; duke konkluduar se censura censuron ata që pranojnë të censurohen – servilët e regjimit. Materiali i autorit i shtjellon me hollësi dhe nxjerr si përfundim se censura të shpije në shterpësi letrare, që në regjimin totalitar, krijuesi dhe artisti arrijnë të kthehen në një zanatçi, të instrumentalizohen dhe të diktohen nga censuruesi, duke i dhënë tema të gatshme për të shkruar, për ta deperson-

alizuar; për të qenë pa personalitet, pa vullnet, pa dëshirë dhe pa dashuri. Kjo ka sjell si konkluzion edhe boshllëkun që ekziston edhe në ditët e sotme në letërsi, që po kthehet në imitim të perëndimorëve. Autori diskuton edhe si dëm në letërsinë shqipe përkthimet e veprave të I. Kadaresë nga Jusuf Vrioni, në aspektin se janë përkthyer vepra shqip në gjuhë të huaj, që nuk sjellin aq vlera letrare, se sa përkthimet e letërsisë nga gjuhët e huaja në shqip, se kontribuojnë më shumë dhe krijojnë horizont më të gjerë letrar, duke detyruar disa shkrimtarë të heqin dorë nga të shkruarit në kohën e diktaturës.

Lavdi De Radës. Kjo jehonë dhe thirrje evidenton personalitetin dhe autoritetin e figurës më të shquar letrare të letërsisë së re, që përfaqësoi me dinjitet iluminizmin e ndritur, që do të lindte dhe do të frymëzonte patriotizmin, idealizmin, traditat dhe heroizmin e popullit shqiptar. J. De Rada lëvroi me mjeshtëri, me zgjuarsi, me shumë kujdes dhe me aftësi profesionale rapsodinë shqiptare, duke sjellë një xhevahir të traditës gojore popullore, shpalljen e Milosaos në 1836 si kryevepër e parë shqiptare në botën shqiptare, duke i thurur lavdi trashëgimisë popullore dhe detyroi të zgjohej kureshtja e të huajve La Martin dhe Ygo, që ta admirojnë etj. Ai shkroi vargun e famshëm "Erdhi ditë e Arbrit", duke dhënë kushtrimin se dy shtetet e veriut të Bushatllijve dhe e jugut të Ali pashës, nuk u varrosën, por janë ripërtërirë me idenë e re të çlirimit kombëtar. Jetoj gjatë dhe prapë Arbërinë të lirë nuk e pa, por edhe kur u bë e përgjysmuar Shqipëria, atë nuk e njohu dot se ajo ishte analfabete.

Branko Merxhani. *Ky emër i harruar i gazetarisë shqiptare*

Përmendet me të drejtë si një nga penat më të spikatura dhe më të mprehta të viteve '30-të në Shqipëri, si gazetar, publicist

dhe përkrahës i idesë së neoshqiptarizmit për një zhvillim kulturor jashtë politikës dhe u dallua si një aktivist i palodhur, për përhapjen e dijes dhe të atdhetarizmit, kudo ku punoi në Shqipëri, Athinë e në Turqi. Bashkëpunorët e tij, Nexhip Alpani dhe Petrua flasin me respekt për kontributin e vlefshëm dhënë në publicitet, ndërsa Flori me konsideratë shprehet: figura e harruar e Branko Merxhanit duhet të nderohet, të respektohet dhe të vlerësohet me dinjitet në median e sotme.

Ismail Kadare. Në librin *kronik në gurë*, thotë autori, dëshiron të ndryshojë rrjedhën e romaneve si nga ana e paraqitjes dhe të ngjarjeve, megjithëse shfaqen edhe shumë mendime dhe alternativa komplekse; por duket se ajo po ndjek vazhden e luftës, për të reflektuar dhe për t'i parë personazhet me syrin e një fëmije, të vetvetes, pa pasur ndonjë ndikim partishmërie, duke pasqyruar edhe vlerat e një rëndësie etnografike që Gjyrokastri e ka pasur traditë.

Klasikët e romanit postmodernë. Është në nderin e autorit që në librin e tij diti të zgjedhë dhe të përfshijë tri personalitetet më të denja, më të kërkuara dhe më të zgjedhura, që kanë bërë emër dhe e kanë përfaqësuar me autoritet dhe me dinjitet epokën postmoderne me veprat e tyre. Le t'i përmendim për respekt: Valero Massimo Manfredin me *trilogjinë e Aleksandrit të Madh*, Umberto Econ me *Flakët misterioze të mbretëreshës Loana* dhe Aleksander Bariccon me *Novoçenton* apo *Legjendën e pianistit*, të tre autorë, me tri histori dhe vetëm me tri romane, sollën imazhin e tri epokave, duke pasur vetëm dy gjëra të përbashkëta: atdheun -Italinë dhe famën e tyre ndërkombëtare.

Homeri dhe Odisea nuk kthehen më në truallin grek. Artikulli evidenton me hollësi dhe me fakte krizën dhe vështirësitë që po has letërsia greke për të kapërcyer izolimin kombëtar të literaturës së vendit, e cila u vu në dukje më së qarti në panairin e Frankfurtit në gjermani. Grekërit po përpiqen të mbijetojnë, nga mbiprodhimi i botimeve, që i sjellin në jetë më lehtë se fëmijët e tyre. Po përkthejnë sa më shumë në gjuhë të huaj, hoqën dorë nga fjalori mitologjikë grek dhe nga Homeri, që ishte krenaria e tyre, siç bëri Elitys, edhe sepse ishte formuar boshllëk i madh

mbi dymijëvjeçar, nga lulëzimi helenik, që akuzohet se kishte vjedhur mite dhe legjenda nga lindja.

Në 60-vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Bardhosh Gërvalla. I njohur si intelektual me merita, autori thekson se nuk duhet të harrohet, por të çmohet si shkrimtar me vlera të larta si poet, prozator, dramaturg, atdhetar, si një figurë poliedrike dhe simbol i kombit, mbasi mbetet edhe nga më prodhimtarët në trashëgiminë e dorëshkrimeve.

A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar? Vlerësohet si një vepërimitar mjaft inkurajues, që ka shkruar mbi 40 vepra letrare, libra dhe romane dhe mbi 30 punime të dramatuara, duke arritur një sukses të merituar në lëmin e letërsisë, ku spikatin proza dhe poezia, të vlerësuara edhe me shumë çmime. Kontribut të veçantë ka dhënë në edukimin e brezit të ri dhe në letërsinë e fëmijëve.

Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi. Njihet si gazetar me kontribute të veçanta, por ka shkruar edhe vepra letrare në poezi dhe në dramë. Përmendet si aktivist dhe atdhetar dhe kujtohet me respekt dhe me nderim për dramën e tij “Një natë e fundit në Goli Otok”, që i kushtohet popullit të tij dhe përshkruan vuajtjet e torturat në këtë kamp internimi. Në kujtim të tij autori përmend shkrimin e tij “Kultura bashkon kombin”.

Kush është Koleç Traboini? Autori me dashamirësi përgjigjet se është një shkrimtar, gazetar, publicist, që ka shkruar vepra letrare, prozë, poezi, skenarë, me tematika të ndryshme, të karakterit shoqëror, patriotik, erotik dhe dallohet për një stil të tij origjinal dhe për një humor të hollë me karakter konstruktiv dhe dashamirës. Ai ka drejtuar gazetën *Egnatia* me përgjegjësi dhe ka dhënë një kontribut të ndjeshëm me shkrimet e tij në hapësirën virtuale me të cilat mund të njiheni edhe në libër.

Kozeta Zylo. Prezantohet si një aktiviste e dalluar e komunitetit shqiptaro-amerikan e Nju-Jorkut, si një intelektuale dhe pedagoge e respektuar në institutin amerikan Globus në Bruklin, si një publiciste, letrare dhe poete, që po bën karrierë. Intervistat e shumë intelektualëve e vlerësojnë Kozetën si një poete me

perspektivë dhe e komentojnë librin e saj poetik, *Monumentin* si një vepër me perspektivë. Ajo ka shkruar edhe një libër tjetër poetik, ku jepen përshtypje të mira.

Kush është Gani Xhafolli? Njihet si shkrimtar. që ka publikuar mbi 20 vepra letrare, si poezi, romane dhe është vlerësuar me çmime. Ka ende shumë materiale në dorëshkrime, që presin radhën për t'u botuar. Nga poezitë më tepër i është çmuar libri poetik "Gjeometria e syrit", për të cilën ka mjaft komentime interesante.

Kush është Nebat S. Hoxha? Ka bërë emër si letrar, poet dhe përkthyes. Ka shkruar 5 libra artistikë dhe ka përkthyer mbi 18 vepra artistike nga anglishtja, me materiale të filmit artistik, arsimor dhe vizatimor. Ai ka bërë dhe mjaft adaptime për TV, radio, gazeta dhe për revista. Është një aktivist dhe organizator i palodhur dhe pjesëmarrës në delegacionet e huaja.

Mubaxhedinët si "Golden Boys". Flitet për Bernald Henri Levyn, autor i librit "Kush e vrau Daniel Pearl", që është një dokument, që bënë një analizë letraro-politike, me aspekte të shumta moralo- kulturore e filozofike; që më shumë se ç'do burim i mundshëm, të lehtëson udhëtimin në zemrën e Al-Kaidës dhe është një homazh për një gazetar që mizorisht ekzekutohet pse donte të zbulonte një të fshehtë të vërtetë.

Rekuem për.. Aty njihemi me përshëndetje, konsiderata dhe alternativa të "përzemërta"!

Persekutimi komunist mbi vajzat e Bajram Currit. Dëshëroj që artikullin ta parafrazoj me një nënkuptim të lartë për nder të Bac Bajramit, duke shprehur për familjen: Konsideratë të veçantë, respekt, nder, admirim për fisnikërinë, atdhedashurinë, mirësjelljen, mikpritjen që kanë manifestuar pjesëtarët gjatë jetës së tyre me gjithë keqtrajtimet që kanë pësuar. Kjo bëhet edhe në përkushtim të kujtimit të të paharruarit Bajram Curri, heroit legjendar të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Polemikë pa dorashka. Klajd Kapinova. Duke mos dashur të prononcohem ,të më falni; por për të mos qëndruar indiferent, do të dëshiroja të jepja disa mendime shoqërore: I konsideroj si

replika të pakuptimta midis intelektualësh. Të pasinqerta midis shoqërisë. Me interpretime jomiqësore për jetën dhe pa baza morale për kohën.

Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviçit. Argumenti : Analizë dhe koment

Konkluzioni që del nga artikulli është më se i qartë: një "akuzë" e drejtë, e ndershme dhe e sinqertë që u drejtohet organizatorëve, edhe pjesëmarrësve dhe një fyerje për popullin shqiptar e sidomos kosovar, që me dashje apo pa dashje ose të rënë në kurth, kanë lejuar një bashkëkombës serb të japë koncert në mes të Tiranës, duke u njohur si i padëshirueshëm, për të penguar pavarësinë e Kosovës me gjithë autoritetin e tij.

Kapitulli i shtatë. Psikoanaliza, Astrologjia dhe Erotika

Ç'është psikologjia, psikanaliza dhe kush është Zigmund Frojd (Sigmund Freud)?

Shkrimin e vlerësoj si një artikull shkencor, përshkruar me mjaft saktësi, me nocione shumë të qarta, korrekte, me karakter filozofik, që përbën një material mjaft të nevojshëm për çdo intelektual të çdo profile. Aty gjen të zbërthyer terminologjitë e nevojshme të psikologjisë, psikanalizës dhe të psikoterapisë. Nga leximi me kujdes i materialit del një kokluzion i madh: ne të gjithë kemi nevojë dhe duhet ta njohim më mirë vetveten, megjithëse është e vështirë.

Figura e Zigmund Froidit jepet mjaft e qartë, me të gjitha atributet dhe veprimtaritë e tij prej një shkencëtari kolos, që krijoi psikanalizën duke filluar nga vetja e pastaj kaloi tek pacienti.

A duhet besuar Horoskopi? Ai vlerësohet dhe konsiderohet si një art parashikues, me histori shumëshekullore, me ecuri trashëgimore, me njohje dhe besueshmëri të shumë brezave, të kthyer në "mjet-art-parashikim", "i besueshëm", por edhe sfidues. Pra, a duhet besuar? Shkenca i bie shkurt – JO, se s' ka baza shkencore. Po a i mbush mendjen "botës"?! Kjo kushtëzohet

me shansin- fatin-ndikimin dhe besimin. Shumëkush e beson astrologjinë qiellore, sepse thuhet se horoskopi gjen gjithçka. Ndoshta! Por, kjo vjen nga besimi i verbër dhe se mendja jonë gënjehet. Mirëpo, ato kanë marrë një përhapje kaq të madhe nëpërmjet shenjave të zodiakut, sa që profecia është kthyer si në një perëndi dhe megjithatë nuk duhet besuar.

Psikologjia erotike. Të dhënat e paraqitura, ndonëse me informacione të shkurta, dhe me materiale orientuese të sferës erotike, mendoj se nuk do ta justifikonin prezencën e tyre të qëndronin krahas materialit aq serioz historiko-letraro-shkencor që është parashtruar në libër me aq kompetencë dhe dinjitet.

Kapitulli i tetë. Çka janë sëmundjet ngjitëse seksuale?

Shkrimi është një literaturë shkencore–popullore mjaft e nevojshme, shumë e rekomandueshme dhe më se e domosdoshme për t’u njohur nga të gjithë, për të pasur dijeni për sëmundjet seksualisht ngjitëse, për t’u ruajtur, për t’u mbrojtur dhe më në fund edhe për t’u mjekuar. Materiali është mjaft orientues, i asimilueshëm, i kuptueshëm, por ka nevojë edhe për plotësime.

Dr. NAMIK M. SHEHU,

Sekretari shkencor i Akademisë, Nju-Jork

Nga forma elektronike te forma e shtypur

Libri “Guxim Shqiptar” i Flori Bruqit është një përzgjedhje, një seleksionim i punimeve më të mira elektronike, botuar në faqet e rrjetit (web sites), bas i të cilave që dhe është autori dhe që tash i afrohen publikut lexues të përmbledhura në një vëllim më vete. Me një fjalë, libri është bërë që edhe publiku lexues, i pamësuar me botimet elektronike, të njihet me tema të ndryshme, që kanë gjetur një trajtim të gjerë e të denjë pikërisht në këtë formë. Pra, kemi një kalim nga forma elektronike te forma e shtypur.

Nga temat e ndryshme historike, për seriozitetin dhe thellësinë e trajtimit, tërheq vëmendjen artikullit “Mbroytja e Plavës dhe e Gucisë”, sado që janë me interes edhe disa ide të hedhura për origjinën shqiptare të perandorit francez Napoleon Bonaparta.

Një peshë jo të vogël ka kapitulli “Për Ramushin”, në të cilin është përmbledhur intervista e z. Adem Demaçi me titull “Dora e Zezë” e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës”, artikulli i autorit “Hero në luftë - hero në paqe: Ramush Haradinaj”, si dhe artikulli “Ramushi, viktimë e situatës (neo)koloniale”. Megjithatë, pjesa qendrore e librit i kushtohet antropologjisë, në të vërtetë veprës “Raca shqiptare” të Jakov Milajt, ku edhe autori, pos mospajtimeve të hapura me disa autorë, jep dhe ndihmesën e vet në ndriçimin e kësaj çështjeje shumë të ndjeshme.

Në kapitullin “Politikë” kanë gjetur vend shumë tema

aktuale, sikundër është çështja e pazgjidhur çame, çështja në ka 'intifadë' në Iliridë, frika që kanë udhëheqësit tanë nga kryetari i "Vetëvendosjes", Albin Kurti me titullin shumë domethënës "Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë", dy artikuj për mjekun e dëgjuar shqiptar, z. Namik Shehu etj.

Një kapitull që do të zgjojë interesimin e lexuesve është pa dyshim "Spiunazhi", ku kanë gjetur vend artikujt "Agjenturat greke dhe Sigurimi i Fshehtë i Shtetit Shqiptar", "Kush janë agjentët me influencë në Kosovë" dhe "Aktivitetet kriminale të shtyra nga shërbimet sekrete armiqësore në Kosovë". Por, kapitulli më i gjerë dhe më i larmishëm është "Gjuhë & letërsi", ku hetohet edhe karakteri i ndjeshëm hulumtues i autorit, sidomos në portretizimin e figurës së Jusuf Gërvallës dhe vlerave të veprës së tij letrare; pastaj disa anë të panjohur të shkrimtarit tashmë të ndjerë, Mehmet Kajtazi etj. Janë me interes edhe artikujt për Koleç Traboinin, Rifat Kukajin, Kozeta Zylon, Gani Xhafollin, Nehat S. Hoxhën, si dhe një varg temash nga letërsia botërore.

Libri mbyllet me kapitullin "Psikanalizë, astronomi dhe erotikë", ku trajtohen tema nga këta lëmenj interesantë të jetës njerëzore

Abdullah Konushevi

Prishtinë, më 3 dhjetor 2007

Botues:
FLOMED, Prishtinë

Flori Bruqi
Guxim Shqiptar

Përgatitja kompjuterike
DRILA-SOFT

Tirazhi
1000 copë

Shtypi:
Printing Press

Tirazhi:
1.000 copë

Katalogimi në botim- **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-92

821.18-8

Bruqi, Flori

Guxim shqiptar / Flori Bruqi. - Prishtinë; Flomed,
2008.-402 f.;24 cm.- (Biblioteka Lumi i Bardhë)

ISBN 978-9951-415-03-3



Flori Bruqi (1952) , është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës si dhe moderator i Agjencionit informativ në internet “Floart-Press”(www.bruqi.com).

Deri më tash botoi këta libra:

1. *Zjarri i diellit*, poezi, Prishtinë, 1995.
2. *Ndërgjegjja*, roman, Prishtinë, 1995.
3. *Vrasësit e lironëve*, roman, Prishtinë, Tiranë, 1996.
4. *Ringjallja*, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
5. *Gjarpërinjtë e pallatit*, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
6. *Dorëzëza*, roman, Tiranë, Prishtinë, 1997.
7. *Tokë e djegur*, roman, Shkodër, Tiranë, Prishtinë, 1998.
8. *Burri dhe gruaja*, libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
9. *Pallati i Akereonit*, roman, Tiranë, Prishtinë, New York, 2000.
10. *Vademecum DDD*, libër shkencor, Prishtinë, 2002.
11. *Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike*, Prishtinë, 2004.
12. *Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut*, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
13. *Delikuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike*, Prishtinë, 2004.
14. *Vademecum për preparate higjienike të “Schulke – Mayr” – it*, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
15. *Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jospportistë para dhe pas vrapimit 400 metra*, punim magjistrature, Prishtinë, 2005.
16. *Antropometri - Jakov Milaj*”Raca shqiptare”, Prishtinë, 2005.
17. *Si ta njohim internetin*, Prishtinë, tetor 2005.
18. *Sëmundjet infektive seksuale*, Prishtinë, tetor 2005.
19. *Udbëzues i shkurtër i preparative dezinfektuese*, Prishtinë, 2006.
20. *Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t’u relaksuar*, Prishtinë, janar 2006.
21. *Kosova nuk është i berzë e zezë*, Prishtinë, dhjetor 2005.
22. *Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian*, Prishtinë, 2005.
23. *The Economic Aspects of Sports Recreation and Health*,
Sport ritmi i zemrës, Prishtinë, janar 2006.
24. *Determinantet socio-psikologjike të ushtrimit fizik (Hulumtim sociopsikokinezologjik me studentët e Universitetit të Prishtinës)*, Prishtinë, 2006.
25. *Guxim shqiptar*, Prishtinë, 2008.